

Jusuf BUXHOVI

TRILOGJIA GJERMANE

1

Vdekjet e Kolonelit

Redaktor:
Ramadan Musliu

I

Kolonel Drenin e zgjuan kur Skulptori kishte kaluar qafën e parë që ndante rrafshlartën me ultësirën e detit dhe ndodhej diku në rrugë për në portin detar në kërkim të anijes së fundit, që do ta kthente prej nga kishte ardhur. Sikur të mos dëshironte të pajtohej me gjendjen pa Skulptorin, një copë herë fërkoj sytë dhe këtë më shumë e bëri nga ballafaqimi me vetminë, që përfundimisht duhej ta pranonte si të pashmangshme se sa të mbrohej nga rrezet e diellit të fortë të mëngjesit, të cilat i binin ngultas. Vetëm kur preku letrën që i rrinte para dhe në të pa fjalët „kemi humbë një betejë, por luftën jo“, Koloneli pranoi realitetin e hidhur, që e njihte, dhe e priste dhe po mos të hetonte telegrafistin Bruner, i cili ishte aty për t’ia bërë me dije se ishte koha të niseshin, do të shpërthente në një çirrije lemëritëse përdërisa të lirohej i tëri nga dufi i lidhur mulla gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve sa kishin zgjatur bredhjet si hije nëpër vijat kah shtriheshin frontet ndërshqiptare. Por, duket se ishte pikërisht letra, të cilën e mori me kujdes dhe e paloi, që Kolonelin e qetësoi, ngaqë ajo për pak e ndërlidhi me bisedën e gjatë që kishin bërë atë mbrëmje, ulur nën degët e hapura të manit të gërmuqur, kur Skulptori, ndonëse gjithë dëshpërim të cilin nuk dëshironte ta shfaqte, i kishte folur thujse me pasione për „luftën e cila do të vazhdonte pa marrë parasysh se çfarë do të ishin rrethanat“, që e quante „pjesë të një zhvillimi të pashmangshëm, ku ajo, me zhvendosjen nga poshtë-lartë dhe shtrirjen në një rrafsh të gjerë botëror, hapte mundësitë e qartësimit të përgjithshëm“, pra kthente te domosdoja e zgjidhjeve që atë e kishin ushqyer dhe e kishin sjellë deri te shpërthimi, e tjera, e tjera, që ashtu si i thoshte dhe siç i shpjegonte, atij i dukeshin si pjesë të fantazisë së një artisti, i cili shqetësimet krijuese i ndërthurte me ato të jashtme dhe kështu ngatërronte kahun e tyre sa të dukeshin si pjesë te ndonjë promenade vere...

Ç’është e vërteta, shkrimet e Skulptorit, ndonëse Koloneli i njihte moti, qysh nga koha e takimeve dhe bisedave të gjata në Vjenë dhe Berlin, ku prej tyre dhe me anën e tyre ishte hapur edhe ajo çështja e pjesëmarrjes në luftën e paqartë me dëshirën t’i ndihmohej shtetit sapo të shpallur shqiptar të merrte veten para se të shembej, që pastaj edhe ishte kthyer në një realitet, mbrëmjen e fundit sikur kishin marrë atë kah, që e kishin zhveshur nga ato të cilat nuk i takonin dhe të tjerat që i ishin mbështjellë për ta paraparë ashtu si dëshirohej, aq sa ai të duket i megjulluar dhe i pashpresë fare. Këtë Koloneli nuk kishte dashtë t’ia thoshte

Skulptorit dhe kishte bërë përpjekje tepër të mëdha të përmbahej prej asaj ngulfatje, që e mbërthente gjithnjë e më shumë kur ai i thoshte se ajo farë lufta e përgjithshme dhe e madhe botërore, e cila tashmë ishte në prag të shpërthimit, kishte edhe të mirën e vet, sepse për pak do ta fashiste apo do ta ngrinte atë „luftën e ngatërruar“, bashkë me kobët e saj të mëdha, në të cilin ishin përfshirë shqiptarët, meqë sipas tij, lufta e madhe në rrjedhën e saj, pashmangshëm tërhiqte edhe prapaskenat dhe pështjellimet tjera deri më atëherë të shpërndara gjetiu, që dikur doemos duhej t'i ktheheshin si peshqesh.

Kur fliste kështu, Koloneli e dinte se Skulptori parimisht kishte të drejtë, se ajo lufta e madhe dhe e përgjithshme, që do të ishte e para e llojit të vet, ku duhej se në të përfshihej e gjithë bota, ishte për t'u pritur se në vorbullën e asaj, si një termet i fuqishëm i cili shpërthen furishëm, së paku sa të zgjaste, thithte edhe luftërat e vogla dhe ngatërresat tjera dhe, si dridhje e përbashkët i bartte në epiqendër, por ai nuk dinte se me këtë kthesë aty nuk ndryshonte natyra e atyre çështjeve të cilat kishin sjellë gjendjen ku ishte, që do të thotë se ato mbeteshin të gjalla dhe madje me mundësi edhe më të mëdha të shpërthimeve të mëtutjeshme, ngaqë edhe si të mbyllura apo për pak të anash kaluara, ato ndjekin kahun e pleksjeve të tyre, me ç'rast edhe luftërat e largëta apo edhe të huajat përherë shfrytëzohen për hesape të brendshme, pa marrë parasysh pasojat tepër të rënda afatgjate që lënë... Koloneli deshi t'i fliste për përvojën e hidhur të fesateve shqiptare dhe inatet e tyre që merrnin valë në ato rrethana sa nuk i ndalë kush, por hoq dorë ngaqë Skulptori gjithnjë shkaqet i ngatërronte me pasojat saqë ndonjëherë ato i shihte si lëvizje të natyrshme me të cilën mund të shpjegohej krijimi i ndonjë vepre artistike por jo edhe pleksjet historike, që ushqente ajo.

„Kjo botë“, deshi të thoshte Koloneli, dhe mendjen e kishte te ajo shqiptare, “sikur ka disa rregulla të veçanta, që e përçudnojnë“, por hetoi se tashmë ndodhej përpara atyre të cilët prisnin shenjën e nisjes, që duhej ta jepte, me të cilën mbyllej e ashtuquajtura kohë e bredhjes në vëzhgim të asaj lufte të paqartë, të cilën shqiptarët me vullnet të madh e zhvillonin kundër vetvetes për ta hapë atë të luftës botërore në pritje, e cila patjetër se do të vinte edhe aty, rreth së cilës Skulptori i kishte thënë se mbase paraqiste një fat të madh, ngaqë atë farë luftën e mbyllur dhe të ngatërruar shqiptare në atë hapësirë të ngushtë dhe jashtë rregullave, sikur lumi i madh vërshues që me vete merr përroskat dhe ujërat e mbetura, sa ora e kthen në pjesë të luftës së njëmendët, me fronte të qarta dhe kundërshtarë të dukshëm, ku patjetër do të kishte fitimtarë dhe humbës të parashikueshëm, por edhe zhvillime fare të paparashikueshme, që pastaj, në përputhje me kahun e tyre dhe rrethanat e dala do të vendoseshin edhe gjendjet e reja, të cilat, ndonëse nga ai këndvështrim mbeteshin njësoj të paqarta për të gjithë dhe kjo paraqiste ngushëllimin e vetëm në prag të asaj fatkeqësie të përbashkët, e cila nuk do ta kursente askënd...

Këto deshi t'ua bënte me dije atyre të cilët e pritnin atë farë shenjën e nisjes, që sa për sy e faqe duhej t'i ngjante urdhrit, por hoq dorë, ngaqë ishte i vetëdijshëm se ato që do t'i thoshte ishin të tepërta, jo vetëm se diheshin, por pse ishin pjesë e atyre hamendjeve të njëjta që kishin pasur kohë me bollëk për t'u bluar dhe sosnin te i njëjti pellg i turbullt si për ata që me siguri kishin pritur një zhvillim të tillë, dhe nuk ishte se nuk i druanin rrjedhës së paqartë dhe atyre që mund të vinin në ato rrethana kur shtirja e asnjësisë kthehej në veprim lufte, por edhe për ata, që gjendja e re i ballafaqonte me një realitet të zhveshur në të cilin sikur humbeshin fare. Dhe në vend se të fliste dhe t'ua mbante ders për gjërat që tashmë shiheshin dhe mund të merreshin me mend se kah do të rrotulloheshin, ua lëshoi një sy ashtu shkarazi sikur sado pak të dëshironte t'ua bënte me dije se ua kuptonte shqetësimet, të cilat mundoheshin t'i bënin zap, bashkë me të tjerat që i mbanin të ndryra dhe nuk kishin si të mos sëmbonin nga brenda për t'u kthyer në brengë të hapur çastin kur në atë hapësirë aq të rrudhur, e cila duhej se ishte shumë e vogël për t'i përballuar gjithë atyre të cilat vlonin në të, por edhe të tjerave që i përplaseshin nga jashtë, fillonte ajo bredhja tjetër në kërkim të luftës së pritur me shumë të papritura, ku dilnin në pah të gjitha ato të cilat ishin fshehur por edhe thadruar nën strofullin e bredhjes së përbashkët gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh dhe atyre që

kishin ndodhur në të. Nga ai vrojtim çapitës megjithatë, e para gjë që i ra në sy Kolonelit, ishte përgjysmimi i njësitit, që ashtu si ishte i ngjante një grushti njerëzish të bërë shuk dhe të njësuar për nga rëndimi i heshtjes, të cilët deri para pak kohe shpërthenin nga kureshtja dhe vlimet e brendshme, që secili i bartet me vete si pjesë të të fshehtave dhe detyrave të tjera të marra nga dika, të cilat vetëm në një luftë të tillë të mjegullt mund të ruheshin. Ata tashmë e dinin se ndryshonte gjendja e tyre, ngaqë gjakosjen e brendshme shqiptare, që i kishte fshehur, e zëvendësonte një më e madhe, ajo e luftës së përgjithshme, në të cilën do të pjesëmerrnin dhe do të gjendeshin kundër njëri tjetrit edhe ata të cilët paralojën e saj ishin munduar ta vendosnin mbi kurrizin e shtetit të sapoformuar shqiptar, por edhe të tjerët, që me sjelljet e tyre ishin shtirur sikur nuk ndodhte gjë...

Kur kishin zbritur nga anija dhe kishin prekur tokën e panjohur për t'u takuar në atë kodrinën ku tash ndodheshin, pra pikërisht para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, kishin qenë njëzet e gjashtë veta, vullnetarë, por me përjashtim të skulptorit Vili Garshauer, priftit Gjon Lleshi, sportistit Hajek, poetit Hartman, polakut Avramicki dhe të studentit Zenel Xhema dhe telegrafisti Bruner, të gjithë ishin ushtarakë të zejes, kush me ndonjë përvojë lufte në vendet përreth apo më gjerë, e kush pa të fare, oficerë nga shkalla e togerit deri te grada e kolonelit, që e kishte ai, por në atë njësit më shumë rëndësi kishin marrëveshjet që të ruheshin interesat e përbashkëta të misionit të shpallur i cili bëhej në mbrojtje të mbretit dhe qeverisë së përkohshme shqiptare, se sa rendi e komandimit, të cilën e ushtronte nga një ujdje fare e natyrshme e arritur gjatë takimit të parë në anije, ku ishte thënë se ajo çështje do të përcaktohej në përputhje me zhvillimet në vend.

Në atë përpëlitje Kolonelit ia kapën sytë një dymbëdhjetëshe jo të rëndomtë pa emërues të përbashkët dhe me shumë të panjohura, e cila i ngjante një togu të panatyrshëm, i formësuar ashtu shthurshëm nga shkaputjet e brendshme dhe humbjet e parapara, të cilat kishin filluar nga lirimi i dhunshëm prej pjesëve të tepërta, përfytyrim ky që sado i pritshëm, e trandi frikshëm, ngaqë sakaq ia ktheu shqetësimet, të cilat i lidheshin me ngjarje dhe situata të vështira të humbjeve të përjetuara gjatë asaj bredhjeje, ku ndonëse nuk luftohej, siç pritej, vrasjet e padenja nga jashtë dhe ato tepër dinake të shkaktuara nga brenda, i jepnin asaj një kah nënçmuese aq edhe djallëzore, saqë në rrethanat tjera me të drejtë do të shtrohej çështja se a mos duhej heqë dorë prej saj fare, e tjera, e tjera... Sigurisht se ishte frika nga përfytyrimi i plotë shkallmues i atyre të cilat kishin ndodhur brenda gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh dhe mbërthimi i tyre ngulfatës, që Kolonelin e bëri të nxirrte fare ftohtas përsëritjen e rëndomtë „lavdi zotit...“ pa e ndërlidhur me atë „dhe luftës së drejtë“, që iu duk se këtë herë mezi preku njësitin, por mjaftoi të shpallte atë nisjen e paqartë pa pasur nevojë të shpjegonte marshutën që kishin para, e cila nuk mund të ishte tjetër pos e njëjtë nga ajo e fillimit, pra me atë të ditës së zbarkimit nga jahti „Donau“, kur në kodrinën e Mollasit ishin bashkuar sipas hartës së sjellë nga togeri austriak, konti Sombah, një oficer i zgjuar artilerie, i cili kishte njohuri të mira edhe për telegrafin dhe çështjet tjera të orientimit të luftës dhe nuk kishte pasur nevojë të jepte kurrfarë arsyesimesh e as njoftimesh të tjera se prej nga ishte ajo hartë, kush e kishte hartuar dhe kur do t'i pushonte afati i vlerës e as të thoshte se pse veprimet e tyre duhej të fillonin pikërisht nga ai vend dhe në atë mënyrë.

Si edhe atëherë, kur në atë luftën për mbrojtjen e shtetit të sapoformuar shqiptar dhe mbretit nga jashtë hyhej me dëshirën e shpallur botërisht t'i ndihmohej shpëtimit të tij pa pasur nevojë të nxirreshin arsyet e njëmenda, (të cilat niseshin nga udhëheqja e idealit e deri te interesat e secilit veç e veç), edhe këtë herë, nuk ishte e nevojshme të thuhej asgjë rreth atyre që diheshin dhe priteshin, si ishte çështja e përsëritjes së bredhjes për t'i ra ndesh një lufte botërore, e cila, po t'i besohej fjalëve të Skulptorit dhe atyre të cilat i thoshte me përkushtim të madh, i gjithë ngatërrimi i luftës së brendshme shqiptare dhe fatkeqësitë e shumta pritej të zhvendoseshin te ajo lufta e madhe dhe e njëmendët për t'u bërë pjesë e çështje së përgjithshme, ku shteti i ri, ndonëse i pavendosur fare dhe para grahamës së fundit nga ato që i kishin ardhur nga brenda dhe nga jashtë, sikur mrekullisht fitonte rastin të ndalte

ambisin, që më vonë, si pjesëmarrës i asaj lufte dhe përkrah fitimtarëve, me çka merrej me mend se për fatin e i tij vendosej në një rrafsh tjetër të lartë, e të tjera, e të tjera, të cilat përballë asaj gjendjeje tepër të mjerë dhe fare të pashpresë dukeshin si përralla mizash. Ato që më dëshirë do t'i thoshte Koloneli me atë rast, megjithatë edhe më tutje nuk duhej të thuheshin dhe kjo atij i solli ngulfatje, që po të mos ishte nisja, do ta shembte.

Kur u nisën, dielli që ishte ngritur ca dhe kishte marrë kahun e harkut po i binte pas, Kolonelit ia krijoi përshtypjen se rrëshqitja e ngadalshme tatëpjetës së ultë po i çonte drejt një shformimi, që megjithatë i kthente te pika e nisjes, prej nga pak nga pak bëheshin hije të pakapshme, të cilat vetëm si të tilla i duheshin atij ngatërrimi të pafund për t'u bërë pjesë e asaj lufte të madhe, e cila ishte në prag dhe kushedi se ç'kah merrte. Mbase këtë përshtypje Kolonelit ia krijoi takimi i ftohtë me pamjet që i dolën përpara, të shkreta fare, si pjesë të ndonjë zhvendosjeje përrallore, ku gjësendet formohen dhe shformohen pandalshëm dhe qëllimisht, por jo edhe rrethanat. Që t'i ikte këtij përfytyrimi të ashpër Koloneli nuk kishte tjetër pos t'u jepej mendimeve, për të cilat kishte më së shumti nevojë në ato çaste tepër të vështira, që më vonë, gjatë mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, do t'i përshkruajë si „udhëtim i pandalshëm kah ai fundi i pashmangshëm, që i takonte gjykimit...”

Dhe mendimet, për ta kursyer nga lëmshi që ia sillnin ato të cilat ia kishin krijuar atë ngatërrim, nuk kishin si të ishin tjera pos të lidheshin me të fejuarën Helenoren, që i thoshte Nora, të cilën Koloneli e merrte me mend se pikërisht në atë kohë të mëngjesit, kur po riniste atë bredhjen që tashmë e paramendonte se nuk kishte si të përfundonte ndryshe pos në njëfarë askundje të paqartë dhe fare të humbur, ajo ndodhej në bufenë e redaksisë në katin e tretë, prej nga si në shuplakë të dorës dukej e gjithë hapësira e „Ballplazit“ dhe atje pinte kafën e parë, gjithnjë duke shfletuar faqet e gazetave ditore, me të cilat niste punën me aq përkushtim.

“Është një si dehje e brendshme, që kërkon aromën e plumbit“, i thoshte ajo duke ia përkëdhelur dorën lehtas, që atij i krijonte ndjenjën e afrisë së çuditshme me dufin e saj... Pa të, dhe e mbërthyer nga brenga për fatin e tij të paqartë, sigurisht se gjatë shfletimit të gazetave, së pari ndalej te lajmet që vinin nga Shqipëria, por edhe të tjerat të cilat lidheshin me luftën e re të madhe dhe shenjat e saj gjithnjë e më të dukshme, që pas atentatit të Sarajevës pashmangshëm çonin kah ajo, që sipas të gjitha gjasave do të ishte një luftë e përmasave botërore dhe do ta prekte jo vetëm Ballkanin dhe mbretëritë që shtriheshin drejtpërdrejtë në të, atë të Habsburgëve dhe të Bosforit, por do të përfshinte edhe Rusinë, Britaninë e Madhe, Francën dhe të tjerët, ku pastaj edhe Gjermania dhe Italia nuk mund të rrinin manash, të bindura se prej saj duhej të nxirrnin përfitime në përputhje me forcën që kishin. Në një letër të dërguar me anën e një oficeri gjerman vetëm dy javë pasi ishin ndarë, i cili kishte ardhur me anijen luftarake „Breslau“ dhe një javë më vonë ia kishte dorëzuar telegrafisti Bruner me rastin e një takimi thuajse të pavërejtur, që ai e kishte pasur me adjutantit e mbretit në kërkim të shkëmbimit të shifrave të ndërlidhjes, kishte hetuar brengën e luftës së re, ku bënte me dije se bota ndodhej para një çrregullimi të madh dhe këtë e thoshte me shqetësimin që ndjejnë ata të cilët preken drejtpërsëdrejti prej saj dhe parandjenje shembjet e mëdha dhe të pandreqshme... Duke mbajtur vëmendjen te zhvillimet, që ajo i quante „me shumë të papritura në planin diplomatik por edhe atë të lëvizjes së aleancave dhe të kundëraleancave të luftës“, sikur kishte anashkaluar fare Shqipërinë dhe domosdonë e „bërjes së saj“, siç e thoshte përherë gjatë bisedave të pareshtura që kishin, ku ajo çështje prekej edhe atëherë kur mbretëronin të tjerat, që atë e përjashtonin. Letrën e Norës nuk e kishte rilexuar, si do të pritej, por gjithë dridhërimë e kishte bërë shuk dhe e kishte futur në xhepin e brendshëm të xhaketës, ku ruante fotografinë e saj si dhe pjesët e një letre, të cilën ajo ishte përpjekur diç të asaj dashurie ndaj tij ta shprehte me disa fjalë shqipe, që mund të merrej me mend se i kishte mësuar nga studenti Zenel Xhema.

“Do të ketë një luftë të madhe, që do ta ngatërrojë botën“,shfreu Koloneli gjithnjë me mendimin tronditës se çfarë mund t’i sjell ajo Shqipërisë?...

Shqetësimet e Norës, po atë ditë, Koloneli ia tregoi edhe Skulptorit dhe ato shërbyen si një masë paraprake ndaj veprimeve të tyre të mëtutjeshme, që duhej të ishin të kujdesshme dhe shumë të matura, pra të mos shënohej kurrë farë ndërlikimi në asnjërën anë, qoftë edhe nëse duhej mbrojtur mbreti, çështje kjo që lidhej me betimin e tyre, por e gjitha të përqendrohej te sjelljet me të cilat pamundësoheshin plagët e reja, të cilat në ato rrethana ishin shumë të dëmshme. Skulptori i kishte thënë se ishte pikërisht porosia e Norës nga Vjena, që sipas tij mund të ishte sajua nga qarqet e rëndësishme dhe dashamirëse, të cilat e kishin më se të qartë se lufta e ardhshme me Serbinë do të paraqiste një luftë e cila me siguri se do të hapej edhe tutje kufijve të saj, ku shqiptarët duhej të përfitonin ndër të parët, për të hequr pushtuesin por edhe për të krijuar shtetin e pavarur në hapësirat etnike, dhe për këtë, si parakusht, ishte një fitore e thellë e monarkisë austro-hungareze në Ballkan, e cila mundësohet edhe në saje të një aleance me Gjermaninë dhe Perandorisë Osmane, ku vlerësohej se pikërisht shteti i pavarur shqiptar do të paraqiste pikëpjekjen më fatlume dhe të mundshme të të dy perandorive të fuqishme, pra të asaj danubiane dhe osmane, nga shkakut se aty kryqëzoheshin dy bota, që nuk duhet të luftoheshin më, por të afroheshin, dhe për këtë, gjatë historisë së gjatë, shqiptarët kishin dhënë dëshmitë më të mira të këtij bashkë jetimi civilizues, dëshmi këto që deri para pak kohe Skulptori i kishte thënë se i ishin kthyer në kobe, por mund të pritej me të drejtë t’i ndihmonin të bëhej ai që në të vërtetë duhet të jetë...

“Këto i ka lufta e madhe“, thoshte gjithë entuziazëm Skulptori, fjalë këto që Kolonelit i kishin tingëlluar paksa ngatërrueshëm, nga shkakut se mund të ishin pikërisht përparësitë të cilat zinte ngojë ai, që asaj mund t’i ktheheshin në fatkeqësi, si i ishin përplasur deri më atëherë dhe si dukej mbi të njëjtat thureshin prapaskenat e ndryshme, të cilat zienin në kuzhinën ndërkombëtare në përbërje të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, ku ishte më se e qartë që italianët, por edhe francezët bashkë me rusët luanin lojëra të tjera, me të cilat bëhej çmos që krijesa Shqipërizë të mbetej në vorbullën e çrregullimeve të pandalshme, ku do të parandalohej çfarëdo bërje e saj Shqipëri. Nëse këtyre u shtoheshin veprimet e hapura luftarake të serbëve e të malaziasve si dhe ato të grekëve, me të cilat nga veriu,veri-lindja dhe jugu pamëshirshëm qëllohej trangu shqiptar, ndërkohë nuk ngurronin edhe brenda dhe me zell të madh t’i fusnin gishtat për ta përçarë atë ngado dhe kudo, veprime këto që me asgjë nuk pengoheshin apo nuk parandaloheshin nga forcat ndërkombëtare të cilat kishin marrë përsipër garantimin e administrimit të shtetit shqiptar, atëherë pamja bëhej edhe më e zymtë dhe ankthi i frikës i arsyeshëm...

“Lufta e re do t’i heq këto telashe“, i thoshte Skulptori dhe shtonte se ajo do t’i qëllojë për vdekje kundërshtarët e monarkisë danubiane por edhe të Shqipërisë.

“Duhet të ndodh një luftë e përgjithshme për t’u parandaluar prishjet që janë bërë... Pa të nuk ka ndreqje...”

Sado që nuk denjonte të shfaqte mëdyshje se mbase ajo luftë edhe nuk do të fitohej nga Vjena, si parashikohej, apo kahet e saj mund të ishin tjera nga përmasat që shikoheshin në „Ballplaz“, me çka ndryshonin rrethanat, megjithatë Koloneli zinte ngojë politikën dhe diplomacinë, që do ta thonë fjalën e fundit, e ku, bazuar nga sjelljet e pasqyruara deri më atëherë dhe përkundër zotimeve të marra se korifeu ndërkombëtar nga Vjena, Parisi, Londra, Berlini, Roma dhe Rusia do të vepronte në përputhje me përgjegjësinë që del nga marrëveshja e tyre, nuk ishte për t’u pritur se ato do të sillleshin ndryshe, pra përgjegjshëm.

„Lufta e re mund të sjell telashe të reja dhe ato së pari t’i përplasen Shqipërisë...“ mendonte Koloneli zëshëm dhe këtë e bënte me një shqetësim të papërmbajtshëm, që i sillte shkallmim.

Skulptori i thoshte se „rrethanat do të ndryshonin“, se ato do të sillnin rreshtime të reja dhe të pashmangshme në taborin ndërkombëtar, të cilave u duheshin „lidhjet e reja historike“ e të tjera, e të tjera, dhe ngulmonte se ato nuk mund të ishin të tjera pos ta forconin fitoren e

aleancës perandorake Vjenë-Stamboll-Berlin, me të cilën Ballkanit i kthehej normaliteti dhe frymëmarrja si nyjë e pakapërcyeshme që lidh perëndimin me lindjen...

“Në këtë hapësirë Shqipëria luan një rol të rëndësishëm... Ajo duhet bërë që botës t’ia kthejë baraspeshën dhe qetësinë e humbur mbi të...“, thoshte ai jo rrallë në një gjendje thuajse tallandie, fjalë këto që Kolonelit pak nga pak po i ktheheshin në thirrjen gjithëpërfshirëse „pa Shqipëri nuk ka jetë...“, me të cilën atij paksa i plotësohej zbrazëtia që e hetonte gjithnjë e më shumë kohëve të fundit nga frika e humbjes së plotë të atdheut në atë mjegullim të madh...

Zaten këto edhe kishin qenë arsyet pse Koloneli, i frikësuar se ajo tronditja e madhe që do të shfaqej pas shembjes së perandorisë osmane, mund ta lente edhe pa atdheun, i cili assesi të merrte veten nga çasti i shpalljes së pavarësisë, i ishte bashkuar thirrjes së Skulptorit për të shkuar në Shqipëri si vullnetar, që si parandjenjë e një shqetësimi kishin nisë të zënin fill para shumë vitesh, qysh kur ishte kthyer nga Berlini si oficer i gardës perandorake pasi kishte kryer studimet në Akademinë Ushtarake, të cilat i kishte vazhduar për gjashtë vjet, dhe prej andej, në sajë të angazhimit të kushëririt Aqif beg Drenit, i cili ishte këshilltar i lartë në ministrinë e brendshme, ishte dërguar me detyrë në Siri, dhe aty, edhe pse kishte dhënë sprovat e para tepër të suksesshme të luftës me britanikët, të cilët nga Egjipti dëshironin t’i shkëputnin perandorisë edhe pjesët tjera arabe, kishte hetuar se ajo nuk e kishte të gjatë jetën, veçmas në pjesët europiane dhe ato arabe, gjë që këtë ia kishte tumirë edhe i ati, i cili punonte si teknik i lartë në pjesën e hekurudhës Konja-Halep, e cila ishte në ndërtim, në kuadër të njërit nga projektet më të mëdha të perandorisë që duhej të lidhte kryeqytetin me Bagdadin e me këtë edhe Europën me Azinë.

“Kjo hekurudhë në fund do t’ia hajë kokën perandorisë“, i kishte thënë ai me një brengë të thellë...

Dhe ai kishte të drejtë ngaqë me marrëveshjen që Porta kishte lidhë me Berlinin, gjermanët jo vetëm merrnin përsipër ndërtimin e kësaj hekurudhe tepër të rëndësishme për ardhmërinë e lidhjeve perëndim-lindje, por mbretëria e re vilhelmiste, me anën e aksioneve të shumta të fituara në lindje, shfaqej si faktor i ri force në botë, ku lidhja me Perandorinë Osmane i jepte asaj një rëndësi të posaçme, me të cilën anashkaloheshin francezët, por edhe britanikët në rajonin e Lindjes së Afërme dhe asaj të Mesme, që njëherësh atë e ballafaqonte me rrezikun e fërkimit me fuqitë tradicionale imperiale Britaninë dhe Francën por edhe Rusinë, e cila ndiqte rrugën e tyre, dhe ato do të bënin çmos të parandalonin jetësimin e boshti në formim e sipër Berlin-Vjenë-Stamboll.

“Shqipërinë duhet me e ba para se të ndodh shembja e madhe, që mund t’ia humb gjurmët përgjithmonë“ - i kishte thënë i ati dhe ia kishte bërë me dije se e mira e së mirës do të ishte që ajo, në këtë drejtim, hapat e parë t’i bënte po të vihej nën mbikëqyrjen e perandorisë së Habsburgëve.

„Shqipërinë duhet kthyer prej nga ka ardhur... Rrugët tjera e çojnë kah zhbërja...“

Vetëm pak kohë pasi ishte emëruar komandant i zonës ushtarake të Halepit dhe me këtë ishte ngritë furishëm në hierarkinë e lartë ushtarake të perandorisë, i ati i kishte vdekur në një fatkeqësi pune, bashkë me dymbëdhjetë punëtorë të tjerë nga shembja e dheut sipër një ure të pambaruar mirë. Kur kishte shkuar në spitalin e Konjës dhe aty e kishte gjetur thuajse pa frymë, me ta parë, ai sikur kishte marrë vetën dhe fjalët e fundit që ia kishte thënë ishin ato të cilat lidheshin me bërjen e Shqipërisë para se të ndodhte shembja e madhe, të cilat Kolonelit i ishin ngulitur si amanet, që përherë e më shumë e kishin stisur, sado që deri më atëherë rrallë kishte menduar për Shqipërinë e edhe më rrallë i kishte rënë ta zinte ngojë, ngaqë lidhje fizike me Shqipërinë asnjëherë nuk pati, ndërsa ato shpirtëroret nuk shënonin ndonjë shtytje të veçantë, nga shkaku i ngjarjeve të vitit 1878 dhe atyre që kishin ndodhur në fund të asaj vere, kur kushëri i tyre Abdullah pashë Dreni, fillimisht njëri ndër udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare, kishte rënë në konflikt me të vetët, ngaqë nuk kishte dashtë ta thyente besën dhe ta dorëzonte Maxharr Pashën, që i kishte rënë në konak, dhe kjo kishte bërë, pas vrasjes së Maxharr Pashës nga forcat e Lidhjes si dhe fundit tragjik të Drenit në kullë, pjesa e

farefisit e ndodhur në kryeqytet dhe pjesët tjera të perandorisë, të ndjente njëfarë ftohjeje të dyanshme, e cila i vinte si nga bashkë atdhetarët e shumë në kryeqytet, të cilët nuk ishin në gjendje ta këpusnin pengun e besës dhe mallkimin e saj, por edhe nga pushtetarët, të cilët, ato që kishin ndodhur në Gjakovë i lidhnin me intriga politike, që jo rrallë vlerësoheshin në përputhje me interesat e caktuara...

Që t'i ikej sado pak atij mosbesimi të dyfishtë, që do ta përcjell familjen e tyre pareshtur, ishte përkujdesur Hilmi beg Dreni, i cili mbante poste të rëndësishëm në pallatin e Sulltanit dhe njëherësh ishte këshilltar për çështjet e hekurudhave, kur të atit ia kishte mundësuar dërgimin në një shkollë teknike në Gjermani, ku dhe e kishte kryer dhe pasi që ishte martuar me të bijën e Eshref Pashës, ishte caktuar mbikëqyrësi i hekurudhës në ndërtim në pjesën që çonte nga Halepi për në Bagdad. Me që pjesën më të madhe të fëmijërisë e kishte bërë i ndarë nga i ati, i cili kthente në Stamboll nga tri ditë një herë në muaj, ishte e natyrshme se pa praninë e tij, nuk kishte si të zihej ngojë Kosova dhe Shqipëria, edhe pse turbullirat e herëpashershme atje dhe vlimet që vinin prej andej nuk ishin që nuk bënë jehonë në kryeqytet, veçmas kur kihej parasysh pozita e lartë e shqiptarëve në hierarkinë politike dhe ushtarake të perandorisë, ku ata luanin një rol tepër të rëndësishëm dhe thuajse mbanin frenat e shumë sektorëve të rëndësishëm të shtetit.

Kur në moshën dymbëdhjetë vjeçare u nis për t'u shkolluar në Gjermani dhe prej andej kthehej një herë në vit gjatë pushimeve që zgjasnin vetëm gjashtë javë, edhe ai përfytyrim i lehtë i Shqipërisë, të cilin e kishte nga bisedat e rralla të të et me kushërinjtë, që kur takoheshin flisnin dhe këndonin shqip, sikur iu zbe fare. Dhe po mos të ishte ajo porosia e të et para se të vdiste se duhej bërë çmos Shqipëria të bëhej para se të bëhej vonë, se vetëm ajo ishte në gjendje t'ua ruante anin dhe nishanin, dhe po mos të ishin trazirat e shumta që ngjanë me rastin e revolucionit xhonturk, kur Aqif beg Dreni me dy kushërinjtë tjerë, së pari ishin burgosur nga xhonturqit e më vonë edhe ishin gjykuar me burgim të përjetshëm nën akuzën për tradhti ndaj perandorisë, (që me asgjë nuk ishte vërtetuar dhe pas kthimit të sulltan Hamidit në pushtet, ata ishin liruar, por mospajtimet e familjes së tij me krerët e xhonturqëve i kishte mbajtur të hapura), me siguri Shqipëria edhe më tutje do t'i mbetej si një hije e varur mbi nurin e kujtimit të fatit tragjik të Abdullah Pashë Drenit në Gjakovë.

Por, kthimit të pandalshëm të vëmendjes kah Shqipëria iu hapën dyert nga ndërhyrja e vendosur e gjyshit të fuqishëm dhe me ndikim të madh Eshref Pashës, me të cilën ai për t'i shpëtuar rreziqeve të cilat i kërcënoheshin në ato rrethana të turbullta politike, ndikoi te veziri i madh Izet Pasha ta emëronte atashë ushtarak në Berlin, mision të cilin do ta ushtrojë vetëm dy vjet e gjysmë, për të hequr dorë prej tij kur ushtria perandorake, veçmas armata e parë me qendër në Selanik, që mund të thuhej se ishte ndër më të përgatiturat ushtarakisht, në vjeshtën e vitit 1912 do t'ua lëshojë në dorë ushtrisë serbe dhe asaj malaziasë Kosovën, Maqedoninë dhe Plavën e Gucinë, ndërkohë pak më vonë e njëjta do të ndodh edhe me armatën e jugut në Janinë, e cila do t'ua lëshojë grekëve Janinën dhe gjithë Çamerinë, me çka praktikisht Shqipërisë i merreshin pjesët më të rëndësishme etnike dhe i pamundësohej të bëhej ajo që duhej të ishte si shteti i pavarur dhe me ardhmëri të qartë. I njoftuar për mundësitë e njëmenda luftarake të armatës perandorake dhe i pajisur me njohuri të shumta jo vetëm nga burime diplomatike, por edhe nga ato të shërbimeve të tjera të vendit, kishte të dhëna të besueshme se qarqe të caktuara ushtarake me ndikim, me sjelljen fare të papërgjegjshme në linjat e frontit karshi Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, në të vërtetë kishin vepruar në përputhje me frymën e një marrëveshjeje të fshehtë të Sulltan Hamidit me anglezët dhe rusët me të cilën Ballkani duhej t'ua lëshohej sllavëve të jugut dhe Greqisë në shkëmbim të vise të caktuara në Lindjen e Afërme dhe atë të Mesme, ku synohej forcimi dhe përqendrimi i saj i ardhshëm. Militantët xhonturqë, në programet e tyre, gjoja për forcimin e perandorisë, ç'prej kohësh kishin shpallur idenë e një shteti të fortë, që do të mund të rikthente fuqinë e dikurshme vetëm nëse forcohej nga lindja dhe juglindja dhe do të udhëhiqej nga fryma e nacionalizmit turk e do të drejtohej nga një qendër me çka i jepej fund hierarkisë thuajse federaliste pesëqind vjeçare të

perandorisë osmane, ku përfaqësuesit e popujve të ndryshëm, sidomos ata nga pjesët europiane, ndër të cilët shqiptarët kishin paraqitur fuqinë e saj kryesore lëvizëse...

Çështje e vërteta, te ky vendim fuqishëm kishin ndikuar edhe dy faktorë tjerë: gazetarja Helenora von Braun, korrespondente e „Die Presses“ nga Vjena në Berlin, e fejuara e tij e mëvonshme, me të cilën ishte njoftuar gjatë një pritje që kishte organizuar për shtypin gjerman si atashe ushtarak i perandorisë Osmane në hotelin „Roma“ në Berlin si dhe Skulptori i njohur austriak Vili Garshauer nga Vjena, me të cilin e kishte njoftuar Nora gjatë vizitës së parë që ia kishin bërë Vjenës dhe ai i mrekulluar prej saj dhe takimeve tepër interesante dhe të përzemërta që kishte pasur me shumë intelektualë të Austrisë, por edhe me personalitete të tjera ushtarake dhe politike të „Ballplacit“ dhe të Gracit, kishte vendosur të lëshonte postin e atasheut ushtarak në Berlin dhe këtë ta bënte gjoja për arsye shëndetësore, ngaqë çfarëdo azili politik apo konfrontimi politik me Stambollin nuk do të pritej mirë as nga austriakët e as nga gjermanët, me të cilët Perandoria Osmane kishte marrëdhënie tepër të mira dhe thuajse ndodhej në rrugë këto lidhje t'i ngjiste në nivelin e një aleance tjetër të madhe, e cila pak më vonë do të jetësohej gjatë luftës që do të shpërthejë, pa marrë parasysh se do të shfaqet e kobshme për të dy palët.

Nora, e cila me dëshirën e tij kishte kaluar nga Berlioni në redaksinë e Vjenës, si redaktore e politikës së jashtme, ku problematika e Ballkanit gëzonte një mbikëqyrje të veçantë, me ato që ia kishte thënë, sikur e kishte ndërlidhur fuqishëm me porositë e të et për bërjen e me çdo kusht të Shqipërisë shtet të pavarur para se të bëhej vonë. Gazetarja e shkathhtë u kishte dhënë opinion të gjerë ngjarjeve në prag dhe gjatë luftërave ballkanike, ku i kishte mbajtur në qendër të vërtetimit krimet e armatës serbe dhe asaj malaziasë gjatë dhe pas pushtimit të Kosovës dhe të Maqedonisë si dhe përpjekjeve të saj të vazhdueshme që ato t'i kthejë në fakte të kryera, të cilat praktikisht konferenca e ambasadorëve në Londër, e cila do të fillojë nga fundi i vitit 1912, diku në pranverën e vitit tjetër do t'ia pranojë dhe kështu, kjo konferencë do të bëjë dy të padrejta njëherësh: atë të ngatërrimit të asaj pjesë të mbetjes së Shqipërisë si shtet nën ombrellën e paqartë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit me princ Vidin si regjent të saj, si dhe të lënies së Kosovës, të Maqedonisë dhe të pjesëve të Plavës dhe të Gucisë bashkë me Ulqinin, Tivarin dhe Tuzin nën Serbinë dhe Malin e Zi. Shkrimet e shumta të Helenora von Braun në „Die Presse“ rreth Kosovës dhe Shqipërisë si dhe të dhënat për krimet e tmerrshme që ushtronin pushtuesit atje ndaj popullatës së pambrojtur së cilës i kërcënohej shkatërrimi dhe zhdukja fizike madje, jo vetëm tronditën opinionin e gjerë austriak dhe gjerman dhe bënë që ai të vihet në anën e tyre duke sensibiluar kështu politikën e këtyre vendeve të ishte sa më e ashpër ndaj okupatorëve serbë dhe malazias, (që si do të shihet më vonë, e gjitha përshpejtoi luftën që ndodhi pas pak kohësh), por ato hapën edhe çështjet e ndërgjegjes morale intelektuale të këtyre vendeve, me ç'rast thuajse nga të gjitha anët filluan të shkruhen letra, të hartohen dhe të përhapen memorie të ndryshme, të bëhen protesta tek fuqitë e mëdha europiane dhe diplomatët e tyre, dhe kështu, për herë të parë, ndikuan edhe mobilizimin e vullnetarëve në mbrojtje të shqiptarëve si popull, që po përballohej me asgjësimin.

Njëri ndër ta, që i printe kësaj fushate me shumë përkushtim dhe emocione madje, ishte skulptori i njohur austriak Vili Garshauer, një burrë shtatlartë, me leshra të gjata dhe mjekër vezake, i cili atelienë në Rudolfsplatz të Vjenës pak nga pak me ato që ekspozonte aty (kryesisht ishin pamje dhe fotografi nga tragjikja e aktualitetit në Kosovë, të marra nga burime të ndryshme që ndodheshin atje, të cilat i shoqëronte me rrëfime autentike si dhe copa të shkrimeve të botuara nëpër gazeta), e kishte kthyer në një tribunal, ku haptas paditej soldateskën e Beogradit për krime të papara lufte kundër njerëzimit, që i zhvillonte sy botës ndaj një popullate të pambrojtur...

...

Një ditë të ftohtë dhjetori me shi të imë të përzier me sqotë, me Norën ishin futur në atelie dhe nga ato që kishte parë për pak nuk i kishte ra të fiktë. Nora e kishte mbajtur për krahu dhe e kishte dërguar te kanapeja anësore dhe një copë herë ia kishte fërkuar qafën dhe ballin. Kur ishte qetësua paksa kishte parë Skulptorin, me disa letra nëpër duar, të cilat po atë ditë kishte marrë nga konsulli austriak nga Shkupi dhe disa të tjera nga një prift katolik në Prizren, me të cilin mbante lidhje të kamotshme, qysh kur ai shërbente në Lezhë dhe në prag të luftës ishte emëruar famullitar i dioqezës së Prizrenit. I tha se fatkeqësisht, nga ato që i shkruante prifti, gjendja sa vinte e përkeqësohej, veçmas në pjesët e Dukagjinit nën pushtimin malazias, ku dimri i fortë që atje kishte shpërthyer me borë dhe ngrica të mëdha shfrytëzohej për zhdukjen në masë të popullatës. I foli për veprimet e çetnikëve të Savë Batarës në afërsi të Pejës dhe pjesët përreth Drinit të Bardhë, me ç'rast kishin vrarë mizorisht të rinjtë e nxënë, dhe ashtu pa koka, të masakruar tmerrësisht, trupat e tyre të ngrirë nga të ftohtit e madh, i kishin vendosur para një xhamie në Lugut të Baranit, me ua përkujtue të tjerëve se çfarë i pret nëse nuk ikin sa më parë apo nuk pranojnë të kryqohen botërisht dhe të vejnë kapicat malaziase...

“Ky tmerr duhet ndalë disi. Nëpër metropolet europiane pihet dhe vallëzohet sikur nuk ndodh gjë, ndërkohë që atje vriten dhe masakrohen gra, fëmijë, pleq... Kjo duhet ndalë doemos!”

Nora, që ia dinte vrullin Skulptorit dhe kishte dertin e shkallmimit të tij nga turret dhe emocionet të cilat e mbërthenin njësoj kur frymëzohej apo dëshpërohej, u përpoq ta qetësonte disi. I tha se ajo që ndodhte atje përnjëmend ishte e rëndë, se askënd me sado pak vnerë njeriu, nuk duhet ta lejë të qetë dhe ta zërë gjumi, e tjera, e tjera, por ia bëri me dije se aty ishin të bisedonin për mbijetimin e jo për vdekjen, e cila ndodhte dhe duhej ndaluar disi sa më parë, fjalë këto që Skulptorin përherë e preknin në tel dhe paksa e mbërthenin, gjë që kështu edhe ngjau, kur pas pak, me një përmbajtje të mundimshme, u dëshiroi mirëseardhje dhe ua hodhi përpara gotat me uiski pa akull.

“Mbase vetëm kjo na shpëton nga turpi?...”, tha pasi i çoku me të tyret dhe nxitoi ta hurrpaste të veten.

„Ndoshta Koloneli nuk pi?”

„Helmit, një pikë tjetër nuk i bënte gjë”.

Koloneli ia tha këto pasi ngriti gotën dhe të zbrazur ia la para.

„Përkundrazi, sikur e qetëson”, ia ktheu Skulptori me njëfarë mëdyshjeje tronditëse.

Pas rrufatjeve të para Nora ktheu bisedën nga zymtësia ku ishte, kah njëfarë qartësimi, që pak nga pak u bart aty ku duhej të mbetej, pra te çështjet e qëndrimit të intelektualit ndaj rrethanave të tilla si dhe borxhit ndaj tyre. Hiq emocionet e rastit, që nuk ka si të mos ndezën përballë gjendjeve të tilla, pjesa tjetër e bisedës u përqendrua te çështja e veprimit të përbashkët dhe të ndërlidhur, që për Skulptorin tashmë paraqiste një preokupim të madh, të cilin me këtë rast, duhej nisur sa më parë dhe me të gjitha...

Kështu, krahas përpjekjeve të vazhdueshme për ndjeshmërimin e përhershëm të opinionit dhe të politikës të veprohet me mjetet dhe mundësitë e parashtruara, ai kishte idenë e thirrjes dhe dërgimit të vullnetarëve në Shqipëri, që duhej nisur për atje sapo të krijoheshin rrethanat e përshtatshme, të cilat, sipas tij lidheshin me pranverën dhe këtë e arsyetonte jo aq me aspektin ushtarak, që as çonte gjitha që kandar kur dihej se atje ushtarë kishte me bollëk dhe mjaftonte të shfrytëzoheshin si duhej dhe ku duhej, por regjistrimi dhe nisja për atje si dhe prania e të huajve duhej të merrej më shumë si një demonstrim intelektual dhe moral i opinionit europian në mbrojtje te një popullate të pambrojtur së cilës i kërcënohej zhdukja fizike si dhe përkrahjes së çështjes shqiptare, me çka politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare i bëhej trysni e drejtpërdrejtë që kjo tragjedi të mos shfrytëzohet për kusuritje të ndryshme tejet të dëmshme, siç veprohej, por për zgjidhjen e saj sa më të shpejtë dhe të drejtë, veçmas kur kihet parasysh gjenocidi i cili vazhdonte të ushtrohej mbi popullatën e pambrojtur nga të gjitha anët... Kur Nora i tha se deri në pranverë mund të ndodhte udhëtimi

i tyre për në Shqipëri të kthehej në një vajtim morti, Skulptorit sikur iu kthyer shqetësimi i pakmëparshëm bashkë me emocionet, që megjithatë mezi i bëri zap.

„Kësaj i frikësohem më së shumti“, tha dhe për pak zuri fytyrën me duar. Vazhdoi pastaj të fliste si vjeshta dhe dimri qëllimisht ishte zgjedhur për luftë kundër popullatës së lënë në mëshirën e pamëshirë në mënyrë që ato që nuk i kryejnë armët t’i marrë përsipër moti...

„Shpallja e misionit të vullnetarëve në mbrojtje të Shqipërisë është e vetmja gjë që mund të bëjnë intelektualët dhe me siguri se do të ketë ndikim të fuqitë e mëdha“, tha Skulptori dhe shtoi se “disa gjërave u duhet edhe çështja e ndërgjegjes si dhe përgjegjësia e saj”.

Nga mbërthimi që e kishte mbajtur edhe pas gotave të uiskit Koloneli, sikur nuk kishte qenë në gjendje me e përcjellë kahun e bisedës deri në fund, apo që kjo tash nuk i kujtohej. Megjithatë nga ajo ditë e tutje takimet me Skulptorin thuajse nuk kishin munguar dhe ato paraqisnin më shumë se një ngushëllim shpirtëror. Kështu, ndodhte që ato fillonin kah mesdita, kur ai rëndom vinte në atelie dhe vazhdonin deri në orët e vona të natës, kur Nora kthehej nga redaksia me numrin e ri të gazetës që në orët e mëngjesit priste lexuesit e rregullt.

Shkuarjen si vullnetarë në Shqipëri Koloneli e merrte për punë të kryer dhe priste vetëm rrethanat e motit, pra pranverën, por kjo sikur nuk ia qetësonte brengën e shpirtit e cila sa vinte e i shtoej nga lajmet e liga që merrte prej andej si dhe nga ato që ndodhnin në hapësirën diplomatike dhe politike, ku krahas seherit ndaj veprimeve kriminele të soldateskës serbo-malaziasë në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe viset tjera të pushtuara prej tyre, në të cilat masakrohej popullata e pambrojtur, me sjelljen sikur nuk ndodhte gjë, e cila tregoej edhe ndaj pushtimit të veriut dhe veri lindjes së Shqipërisë nga trupat e asaj, që në konferencën e Londrës megjithatë konsiderohej „shtet autonom shqiptar“, sikur duhej t’i krijohej alibia copëtimit të etnisë së shqiptare, me ç’rast „tërheqja“ e Serbisë dhe Malit të Zi nga pjesët e pushtuara të shtetit të pranuar shqiptar, që do të bëhej „pas trysnive ndërkombëtare“, do të qiste në harresë ato të cilat kishin ndodhur në Kosovë, Maqedoni dhe në Malit të Zi, me çka sikur tumireshin oguret e dyshimeve se Beogradi, nga disa fuqi europiane, moti kishte dritën e gjelbër t’i qëronte hesapet me shqiptarët, të cilët vlerësoheshin si „mbetje e papranueshme shpirtërore e perandorisë osmane në Ballkan, që duhet prerë me rrënjë...”

“Kjo lojë vazhdon qysh nga koha e Kongresit të Berlinit“ i kishte thënë Nora dhe për këtë me të drejtë kishte fajësuar edhe Portën e cila nga Kriza lindore e tutje dhe veçmas pas shfaqjes së xhonturqve në skenën e saj të ngatërruar por tepër të rrezikshme politike, (të cilën ajo e quante vetëvrasëse për fatet e perandorisë), vazhdimisht hapësira shqiptare ishte shfrytëzuar për pazarllëqe me fuqitë e mëdha, ku ishte më se e qartë se bëhej përpjekje të përfitohej shumëçka me anën e kusuritjeve në kurriz të saj pa qarë kokën për pasojat e rënda që tërhiqte ajo. Nora me të drejtë hidhte gur e dru ndaj rrënimit të paskrupullt të kartës shqiptare nga ana e osmanëve në vend se ajo të shfrytëzohej si atu e fortë për t’i mbrojtur interesat e saj në Europë dhe gjetiu, jo me shpenzimin vend e pa vend dhe më çmim fare të ultë, por me hedhjen e saj në lojë në përputhje me faktorin shqiptar dhe kërkesat e tij të drejta, si një tërësi të fuqishme me identitet etnik, kulturor dhe administrativ, që do të mund të shfrytëzohej për strukturime të reja për ruajtjen e interesave perandorake në ato hapësira ku ajo edhe më tutje mund të vazhdonte praninë strategjike, të cilën ia mundësonte vetëm faktori shqiptar, si tërësi, dhe askush tjetër. Ajo kishte bindjen se osmanët, por edhe Vjena dhe Berlioni kishin bërë gabimet të mëdha kur gjatë përpjekjeve të ruajtjes së status quosë në pjesën europiane, nuk kishin mbështetur autonominë e brendshme shqiptare në kuadër të perandorisë osmane, si zgjidhje kalimtare, por atë e kishin përjashtuar kategorish dhe kjo u kishte shkuar për shtati atyre që punonin në dobi të sllavëve të jugut, në radhë të parë të serbëve si ombrellë e tyre, që parashihej t’u takonte Ballkani, por pa shtetin shqiptar edhe pse dihej se ata ishin njëri ndër popujt më të vjetër të saj, me një shtrirje të gjerë popullative

përafërsisht të njëjtë me të tjerët dhe përthekonin një hapësirë të njësuar etnike ndër më të pastrat. Në një analizë të gjatë që kishte botuar në „Die Presse“ në prag të fillimit të luftës ballkanike dhe e kishte përsëritur sa e sa herë gjatë bisedave me diplomatë dhe politikanë të njohur austriakë, gjermanë dhe të tjerë, mbështetjen e autonomisë shqiptare në kuadër të perandorisë osmane, ku do të përfshiheshin të gjitha pjesët e etnisë së saj, Nora e kishte quajtur projektin më të madh të mbrojtjes së perëndimit europian në hapësirat ballkanike, me të cilin thoshte se në njërën anë pengojë hegjemonizmin sllavo-rus, i cili ishte në rritje e sipër, dhe në tjetrën anë edhe më tutje ruheshin lidhjet e oksidentit me orientin, që aq natyrshëm dhe aq fuqimisht shfaqeshin aty, lidhje këto si të mbëltuara edhe më tutje do t'u ndihmonin afrive dhe jo kundërshtive të të dy boteve, të cilat nëse do të ndiqnin kahun që ua parashikonin francezët dhe rusët si dhe ortodoksia me temjanin e saj mesjetar, shpejt do të mund të ktheheshin në luftë të civilizimeve, që nuk do të kursente askënd nga kontinenti i vjetër.

“Mos lejoni një kryqëzatë të re aty ku është djepi i qytetërimit tonë...“, ishte apeli i Helenore von Braun, që përhapej nga faqet e gazetës „Die Presse“, jehonë kjo e cila dukej se kishte mbetur e fashitur, por në atë shalakatje nëpër atë tatëpjetën e butë për në Mollas, Kolonelit serish ia gjeti kokën dhe iu kthye në klithmën „mos lejoni një vrasje të madhe, mos lejoni kobe të përsëritshëm...“, që iu bë se përpara po ia hapte një pellg gjaku nëpër të cilin duhej të zhytej bashkë me ata që i shkonin pas...

...

Përfytyrimi i gjakut sikur e trandi Kolonelin dhe bëri t'i ikte disi atyre mendimeve trishtuese, por ishte realiteti nëpër të cilin kalonte, që serish po e kthente te ajo gjendje, madje tash fare haptas sa t'i dukej se e po e shihte dhe po i zinte frymën kundërmimi i tij, siç i kishte ndodhur pikërisht para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh kur në rrugën e cila duhej t'i qonte për në Kavajë, kishin ndeshur gjurmët e plogës së parë të gjaku me dhjetëra të vrarë e të masakruar, që kishte shënuar betejën e parë të luftës vëllavrasëse shqiptare, e cila pastaj ishte zhvilluar pa rregulla dhe pa kurrfarë mëshire midis kryengritësve dhe përkrahësve të mbretit pa kursyer fare edhe ata që dëshironin t'i rrinin sa më larg, dhe për të qenë fatkeqësia më e madhe, ajo kishte vazhduar edhe pas largimit të mbretit, kur vendi ishte pushtuar nga katër anët dhe ishte bërë pikë e pesë dhe e gjitha kishte ndodhur në emër të gjoja Shqipërisë dhe shpëtimit të saj!...

Aty edhe ata kishin pasur humbjen e parë, që pas masakrimit të togerit Huber te teqeja e Leqes, në mënyra të ndryshme, i kishte gjetur edhe dymbëdhjetë të tjerë, të cilët u ishin bashkuar atyre njëqind e njëzet e shtatë viktimave të tjera, që gjatë asaj vere në gjithë Shqipërinë lanë vullnetarë e huaj, të shumtën ushtarakë gjermanë, austriakë e rumunë, por edhe intelektualë dhe krijues të ndryshëm të ardhur nga vise të Europës dhe nga Amerika Latine madje.

Koloneli hetoi se kishin ecë më shumë seç pritje dhe këtë ia bëri me dije kodrina e parë që e kishin lënë pas si dhe shfaqja e asaj lugine të rrasur me përroskën e vogël, tashmë të tharë, e cila shpinte në Mollas, kur para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, në ndjekje të pikave të hartës së sjellë nga konti Sombah, të parat kishin takuar ato pesë-gjashtë shtëpi të vogla, të cilat me disa drunj gungaçe pranë, që më vonë kishte marrë vesh se ishin drunj mani, të cilët rriteshin vetëm në ato anë, dukeshin sikur ishin aty ashtu jo natyrshëm për t'u bërë pjesë e atij ambienti të shkallmuar. Për ndryshim nga atëherë, kur nga ajo pikë kishin hedhë shikimin prej nga kishin takuar një vend, që tmerrësisht ua kishte prishur përfytyrimin për vendbanimin shqiptar me kulla dhe mure të larta përreth, të cilin e kishin pasur nga disa vizatime dhe fotografi që gjendeshin në atelienë e Skulptorit por edhe të tjerave që herë pas herë shfaqeshin në shtypin austriak dhe gjerman, këtë herë përpara u doli një shkretim edhe më i madh, i cili pasqyrohej me po ato shtëpi të kallura, por tash fare të rrënuara, që lenin përshtypjen e përfshirjes në një zezonë të pa fund dhe tepër të madhe.

„Ky vend sikur është i krijuar për gjëra të tmerrshme“, ndjeu t’i fliste dikush dhe pa priftin Gjon Lleshi, që kryqohej pareshtur. Edhe telegrafisti Bruner, por edhe të tjerët rrinin si të shtangur. Mbase ata kishin mendjen të ngjarjet e kaluara që ndërlidheshin me kujtimin e hidhur të masakrimit të togerit Huber.

Kur u thanë këto dielli ishte në kupë të qiellit dhe në atë shtangie sikur nuk hetoheshin as rrezet tepër të forta që binin pingul dhe as zukatja e disa mizave të mëdha që silleshin përreth dhe bëheshin gjithnjë e më të shumta. Telegrafisti Bruner i tha se do të ishte mirë të ecte para tyre për të bishtnuar rreziqet të cilat mund t’u dilnin, si kishte bërë studenti Zenel Xhema para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, kur ata kishin pritur aty dhe ai me flamurin e bardhë, të cilin ia kishte dhënë Skulptori dhe i kishte thënë ta ngrinte sa më lartë, hap pas hapi u ishte afruar çufrinave, dhe pasi ishte përplasur në një si hendek, ku i ishte duke se kishte rënë në ndonjë kurth që u përgatitej të huajve, ishte kapë nga dy apo më shumë veta dhe, pa u pyetur nga ishte dhe pse ishte aty, e kishin lidhur me një litar dhe me sy të mbyllur me një shami të pistë me kundërmim të rëndë, e kishin dërguar në pjesën lindor, në një shpatinë rranzë shtëpive, prej nga Koloneli dhe Skulptori me ankth, por si të ngrirë kishin përcjellë kapjen dhe lidhjen e parë që u kishte ndodhur në Shqipëri në rrethanat të cilat as që kishin mundur t’i merrnin me mend. Në atë shtangie, megjithatë, togeri von Hase, një austriak nga njësitë rezerve, kishte bërë gati mitralozin e lehtë të vetmin që kishin dhe kishte kërkuar pozicionim lufte. Ngjashëm kishte kërkuar edhe togeri Klein, një gjerman nga Bavaria, farmacist me profesion, i cili u ishte bashkuar ndër të fundit vullnetarëve dhe këtë e kishte bërë, si thoshte për arsye të një lidhjeje dashurie të veçantë, të cilën e kishte ndjekë gjatë nëpër gjithë botën dhe si do të shihet më vonë, do t’ia hajë kokën...

Koloneli u kishte dhënë shenjë të pritnin, gjë që kjo nuk i kishte pëlqyer mitrolozgjut, që shihej se ziente nga dëshira për ta përdorur armën të cilën e kishte bartur me aq përkujdesje edhe pse ishte e paqartë sa dhe si do t’u hynte në punë. Rumuni Skanea, që thoshte se kishte njëfarë përvojë lufte në Galici dhe tha se ajo gjendje ia përkujtonte një situatë të ngjashme të cilën e kishin pasur karshi një kurthi, që ishte bishtnuar me suksese në saje të gjuajtjes nga larg me disa breshëri, e kishte quajtur të arsyeshme pritjen deri sa të binte terri dhe pastaj të tentohej me të shtëna të frikësoheshin armiqet. Zhurma e armëve luan rol përballë gjendjeve të paqarta, kishte folur rumuni. Kur Skulptori i kishte thënë se nuk shihte armiq dhe as kishte ndonjë nevojë për demonstrim të armëve para njerëzve të frikësuar dhe të hutuar fare, që mund të merrej me mend se në ato rrethana me të drejtë nuk dinin kënd kishin mik dhe kënd armik, rumuni sikur ishte zënë ngushtë dhe kishte çapitë diçka rreth të papriturave që i prisnin kudo dhe përkujdesjes të cilën duhej treguar para se të bëhej vonë.

Sikur të dëshironte t’ia hiqte frikën por edhe mjegullimin jo vetëm atij por edhe të tjerëve dhe të bënte me dije se nuk ishin aty për ta kërkuar me çdo kusht luftën edhe ku nuk ishte, e më së paku midis shqiptarëve dhe me shqiptarët, Koloneli kishte përsëritur atë që e kishte thënë edhe gjatë takimit të parë në tavernën e jahtit „Dunau“ se „lufta e tyre bëhej për ta mbrojtur shtetin e sapokrijuar shqiptar dhe mbretin e ardhur nga Gjermania, që rrezikoheshin nga armiqet e saj të përbetuar nga jashtë“, ku ai kishte theksuar serbët, malaziasit dhe grekët dhe kishte dashtë t’i përmendte edhe italianët, por këtë nuk e kishte bërë për arsye se italianët ishin anëtarë të Këshillit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe merrnin pjesë në përbërje të fuqive që shtetit shqiptar duhej t’i garantohej mbijetimi, dhe nuk i kishte përmendur edhe nga shkaku se përkundër dredhive të tyre të njohura dhe oreksit ndaj Shqipërisë, që ndonjëherë edhe nuk e fshihnin, përkundër faktit se në mënyra të ndryshme vepronin tinëzisht për t’i nxitur përçarjet e brendshme shqiptare, ata megjithatë nuk duhej krahësuar me forcat të cilat gjatë kësaj lufte kishin pushtuar dhe gjakosur për vdekje shqiptarët dhe vazhdonin përpjekjet të mos ua lenin të merrte vetën as at gjysmë shteti që kishin shpallur dhe këtë e bënin nga bindja se po të bëhej ai, edhe si i përgjysmuar, përherë do t’u nxirrte telashe planeve të tyre për t’i zhbërë ata nga hapësira etnike, plane këto që në njëfarë mënyre përputheshin edhe me synimet dinake të disa qendrave evropiane... Dhe pasi

që kishte shtuar se ishin aty edhe për t'i penguar hasmëritë e brendshme të mos merrnin krye pa nevojë, se ishin aty për të ndihmuar të përballoheshin vështirësitë të cilat i dalin një vendi, që për fat të keq, nuk di se cilat plagë i ka më të mëdha dhe cilat duhet shëruar më parë, Koloneli kishte thënë se këtu ishin të gatshëm për të gjitha të priturat dhe të papriturat deri te vdekja, pos të vriteshin me shqiptarët. Kishte thënë se edhe shenjat më të vogla të zënies së tyre me shqiptarët jo vetëm do të fiknin edhe shpresën e fundit që i mban ata të cilët i besojnë bërjes së Shqipërisë dhe për të janë në gjendje edhe të vdesin, por kjo do t'u shkonte më së miri dhe më së shumti për shtati atyre të cilët nga jashtë dhe nga brenda punojnë me zell të madh me i armiqësue shqiptarët me botën, që ata të ndjehen të vetmuar, të lënë pas dore dhe si të tillë t'i nënshtrohen fatit...Koloneli kishte përkujtuar se, në mos për tjetër, në atë rremet, qëndrimi i tyre në Shqipëri, qoftë edhe si bredhje e kotë, duhet me krijue përshtypjen se ai vend dhe njerëzit e saj nuk janë të harruar...

Më pas kishte mbretëruar një heshtje shurdhe, e cila sikur pritjes ia kishte rrënuar përmasat kohore dhe ashtu e kishte kthyer në një gjendje të përhershme ankthi me të cilën patjetër duhej mësuar. Të rrudhur dhe gjithë shqetësim kishin pritur se çfarë do të ndodhte. Nga pjesa ku studenti Zenel Xhema mbahej nuk dukeshin farë lëvizje dhe as që shfaqeshin shenja të tjera me të cilat mund të kapej ngjarja. Koloneli u përpoq me kot të hetonte ndonjë veprim çfarëdo qoftë që do ta nxirrte nga ajo gjendje as ashtu e as kështu, por ishte e kotë. Kur dielli i butë doli në anën tjetër të kodrinave dhe merrte rrugën e perëndimit kah pjesa e detit, Koloneli i shkoi mendja të nisej vetë andej kah kishte shkuar studenti Zenel Xhema mbase ashtu diçka do të ndryshonte, së paku asaj pritje t'i jepte fund, edhe pse e dinte se ashtu hapeshin të papriturat tjera të ndryshme me të cilat mund të ngarkohej panevojshëm fillimi i paqartë. Por ishte mbrëmja dhe pastaj nata që mund t'i zinte, e cila sikur kërcënonte të futeshin në ndonjë zhvillim të paqartë fare, ku nuk përjashtohej edhe lufta, të cilën nuk do ta dëshironte.

Megjithatë, njëfarë parandjenje që kishte nga përvoja gjatë luftës kundër britanikëve, kur jo rrallë ishte gjendur para situatave kur duhej me çdo kusht të anashkaloheshin mosmarrëveshjet apo keqkuptimet e panevojshme me beduinët arabë për t'u bërë ajo e njëjmena me britanikët, që silleshin skaj oazave dhe përdornin dredhi të ndryshme, Koloneli ushqente shpresën se pas çindisë, kur bëhej lutja e pasdites, e cila lidhej me afrimi e perëndimit të diellit, robët apo kushdo tjetër liroheshin dhe ndaj tyre pasonte sjellja në përputhje me mëshirën. Këtë nuk ia tha as Skulptorit, as priftit e as kontit Sombah, që dukej sikur e lente durimi, sepse e para gjë që do të thoshin do të lidhej me atë se aty nuk kishin përpara as shkretëtirat e as beduinët arabë, por një peizazh të turbullt dhe të shkërmoqur shqiptar, të cilin askush nuk e kishte me tamam të qartë se çfarë ishte, çfarë fshehte dhe si duhej vepruar... Me siguri se përballë atij realiteti, pandehmat apo arsyetimet që i vërtiteshin nëpër kokë Koloneli rreth asaj se sjellja e njerëzve të përhumbur përballë situatave të rënda nganjëherë thuaje ishte e njëjtë, do të ishte e tepërt dhe madje do t'i merrej edhe si mbetje nga bindjet e mentalitetit të fatalizmit lindor, që edhe ashtu në atë vend nuk mund të përjashtohej.

Dhe përnjëmend, kur po afrohej koha e çindisë, nga ajo pika e cila tashmë dukej si e pajetë, panë tek lëvizte diçka, që në fillim u shfaq si një shenjë e zezë me diçka të bardhë, e cila pas pak u qartësua se ishte studenti Zenel Xhema me flamur në dorë, të cilit mbas i shkonte njëri me të zeza, që për pak humbën prapa një çufrine, por nuk vonoi dhe ata u shfaqen serish dhe fare qartë tek po i ngjiteshin pjerrtësinës anës së majtë gjithnjë duke ndjekur vijën e disa leqeve, të cilat mund të ishin pjesë e kalimeve që atë vend e lidhnin me pjesën e jashtme. Pamja e cila po u hapej dhe qartësohej sikur të gjithë i nxori nga ngrirja e pakmëparshme por sakaq i futi në shqetësimin e të papriturës, që u pasqyruan serish me përpjekjet e togerit von Hase të përgatiste armën, gjë që ky veprim u pezullua nga shenja e Koloneli ta lente të qetë...

“Është fakir“,i tha Koloneli Skulptorit, i cili ishte bërë i tëri sy e vesh tek shihte si xhybja e zezë, që i shkonte përtokë, mbështillte një trup të madh e të bëftë, që ecte hapatrupash drejt tyre pa as më të voglën shenjë të mëdyshjeve...

Zënia ngojë e fakirit, sikur e përpushi për pak Skulptorin, që në njëfarë mase njihte psikologjinë e të tillëve dhe kishte mirëkuptim për ata të cilët ngatërrojnë realitetin me irealen, por kur i tha se ai ishte një dervish bektashi madje, që të tillë në Shqipëri kishte si shumë, se përhapja e tyre bashkë me tarikatet tjera, fliste për një shumësi shpirtëror dhe mendore, por edhe për bashkëjetesën e tyre, kjo sikur e trandi dhe po mos të ndodheshin në gjendjen në të cilën gjendeshin, me siguri se do të kërkonte të bisedonin shtruar rreth asaj dukurie për të cilën nuk kishte gjitha që njohuri. Për ta mbyllur disi hutimin që iu bë se e shkaktoi te Skulptori me fjalët e fundit, që nuk i shkonin gjendjes, Koloneli tha se „të tillët i besojnë ardhmërisë“, me çka deshi t’i hapte shtigjet të cilat deri më atëherë aty shiheshin si të mbyllura.

Përnjëmend doli se dervishi, sa më shumë afrohej, shpalonte dukjen e një të përmbajturi, që nuk kishte kurrë farë dyshimesh se ata ishin aty me sherr. Përkundrazi, sapo u afrua nisi të thotë një si ilahi në persishte, të cilën Koloneli, që kishte njohuri të mira nga ajo gjuhë, me të shpejtë e mori për shenjë të afrimit të miqësisë, gjë që asaj iu kundërpërgjigj me një të ngjashme, që shkëmbehen në raste të tilla midis bashkëmendimtarëve, por edhe mysafirëve dhe të panjohurve të rastit. Dervishi, që si doli nuk kishte marrë kurrë farë të dhënash nga studenti Zenel Xhema,(nga që atij nuk iu kishte hequr fare shamia nga fytyra që nga çasti i kapjes, kishte qenë i bindur se ata ishin të huaj kushedi se çfarë dhe kushedi se nga, por nuk ia kishte marrë mendja se do të kishte punë me një që atij iu duk më dervish se ai), nxitoi t’i binte te këmbët Kolonelit dhe t’ia puthte ato, me çka rrotulloi gjendjen e cila deri më atëherë ishte gjithë frikë, tendosje dhe ankth madje.

Më kot u mundua Koloneli ta ndalte dervishin nga veprimet e nisura, që pasoheshin me nxjerrjen e disa çirrjeve të cilat as ai nuk i kuptonte. Skulptori kishte bërë sytë katër dhe shihte priftin Gjon Lleshi t’i jepte ndonjë sqarim apo t’i thoshte diçka që do t’ia hiqte dufin i cili i ishte kapë. Gjendja ndryshoi skajshmërisht kur e zgjidhen studentin Zenel Xhema dhe ai nisi t’i tregonte priftit se nuk kishte parë asgjë, se nuk kishte dëgjuar asgjë, se kishte përshtypjen se kishte qëndruar ashtu kotnasikoti në një humnerë të errtë dhe po mos të ishte lidhja, që nuk e dinte se kush ia kishte bërë, me siguri se do të kujtonte se e gjitha kishte qenë pjesë e ndonjë përfatimi të çuditshëm.

„Pandehja se ishit të huaj“,tha dervishi si i zënë ngushtë dhe u struk pa ditë çfarë të bënte. Vetëm shikimi i ishte ngrirë kah Koloneli dhe priste ta nxirrte nga ai mashtrim.

Koloneli e shikoi miqësisht pa dënuar t’i jepte shpjegime, gjë që dervishin nuk e liroi nga përmbajtja që iu kishte lidhur dhe po e mbante ashtu.

„Po ta dija se nuk jeni të huaj do të shikoja punën time...“,tha qetas dhe deshi të largohej.

Që ta afronte disi, Koloneli nisi me i folë disi hapatrupçe në persishte për motin e nxehtë dhe atë vapën tej mase, që po i thante, por dukej se ai pos ilahive dhe ndonjë dua që kishte mësuar përmendsh, nuk kuptonte tjetër nga ajo gjuhë. Më vonë Koloneli ia ktheu në shqipen që mezi e fliste, të cilën e plotësonte me shenja të duarve dhe lëvizjet tjera të trupit.

„Ky është një ngatërrim djalli“,foli dervishi dëshpërueshëm, por ishte ndërhyrja e priftit Gjon Lleshi, që pasoi pas shenjës së Kolonelit, me ç’rast ai nisi me i tregue se ndodheshin aty në përbërje të njëfarë lëvizjeje e cila kishte për qëllim zhbërjen e luftës në ato anë, se kishin për qëllim me i ndihmue kthimit të paqes dhe mirëbesimit e tjera, e tjera, që dervishin edhe më tutje e mbajtën në një hutim, prej të cilit doli vetëm pasi kërkoi ta linin të qetë të meditonte paksa dhe këtë e bëri duke fërkuar kokën për një gur, që pas pak ia nxori gjakun në ballë.

„Kot e keni me atë paqen, ngaqë këndej pari qoftëlargu ka herë i ka marrë punët në dorë“,tha dervishi, që edhe më tutje shikonte Kolonelin sikur të kërkonte prej tij diçka të posaçme,të cilën megjithatë nuk ishte në gjendje ta merrte nga shkak i ngatërrimit të vet...

Pak pa ra terri i parë, pasi u përgjak edhe dy herë tek fërkonte ballin për guri, dervishi foli e tha se në teqenë e tij, që ishte gjysmë ore rrugë në drejtim të kodrinës përballë, që i thoshin teqeja e Leqes, kishte nën përkujdesje gjashtë burra të moshuar, shtatë gra dhe njëmbëdhjetë fëmijë, pra gjithsej njëzet e katër frymë, që tha duhet t'i mbrojë nga e liga e cila kishte shpërthyer në ato anë ç'prej kohësh. Kur u pyet se për çfarë të lige ishte fjala dhe si do t'i bënte ballë asaj, dervishi foli e tha se ajo ishte lufta, që bëhej kudo dhe ngado, prej kujtdo dhe kurdo, një luftë që as kishte fillim dhe as kishte fund, ku e vetmja gjë e saj që shihej dhe mbetej ishte vdekja qençe e tepër poshtëruese dhe tha se në atë luftë të pashpallur të secilit me secilin dhe secilit kundër secilit, ku të gjithë ishin kundërshtarë dhe armiq me njëri tjetrin edhe pa ditë se pse, nuk mjaftonte as t'i rrihej larg, e as afër, sepse njësoj qëllonte dhe njësoj gjente ata që e donin dhe ata që nuk e donin, që njësoj qëllonte edhe ata që e bënë dhe ata që nuk e bënë...Kur u pyet se kush ishin ata të cilën e bënë atë luftë dhe çfarë qëllimesh kishin, ai tha se të gjithë, që të gjithë e bënë atë luftë dhe kjo ishte më e keqja sepse nuk dihet as kush e nis e as kush e sos e aq më pak që në atë hallakatë shihet ndonjë qëllim...Tha se megjithatë në atë rremet të pashembullt ndjente për detyrë t'i mbronte ata që kishte në teqe dhe kishte lutë zotin të kalonte andej pari ndonjë i huaj, që së paku ta mbante luftën larg teqesë, por takimi me ta ia kishte marrë shpresën e fundit... Kur u pyet se ç'ishte ajo që ia lidhte shpresat me të huajt dhe për ta, dervishi tha se e vetmja gjë që në atë katrahurë kobi paraqiste njëfarë çmimi ishte i huaji, ngaqë me të mund të nxirrej ndonjë përfitim nga dika, ku theksoi mundësinë e mbrojtjes, për aq sa ta mbash të huajin pranë peng, apo t'i vihesh në çfarëdo shërbimi...

„I huaji këtu është zot dhe shejtan njëherësh pa të cilin nuk bën...“

Sapo i tha këto dervishi iku sikur të mos ishte. Ishte e kotë ta ndalje ngaqë thoshte se kthehej tek ata që shpejt do të prekeshin nga shejtani dhe shtonte se ai tashmë ishte nisë për të ta dhe mund t'i arrinte çdo dakik...

Çirrja që la dervishi dhe terri që pushtoi hapësirën, u kthyen në një jehonë oguri,e cila Kolonelit dhe të tjerëve u futi të dridhura të ethshme sa ishin gati të lëshoheshin pas tij. Dhe mbase do ta bënë këtë, po mos të ishte gjendja tallanditëse në të cilën ndodhej dervishi, gjendje këtë të cilën Koloneli e njihte dhe kërkonte paksa përmbajtje, dhe po mos të ishte dyshimi se nuk ishte vetëm dhe i pambrojtur si thoshte, kur dihej se ai kishte sjellë studentin Zenel Xhema, i cili ishte kapë në befasi dhe ishte lidhur nga dikush dhe kishte mundësi të ishin të armatosur apo një zot e di se çfarë njerëzish, që me atë veprim, ndonëse kishin bërë me dije se nuk kishin ndërmend të përdornin dhunën, megjithatë nuk përjashtohej se pas asaj sjellje ata kishin lënë ndonjë porosi, e cila doemos duhej qartësuar para se të bëhej vonë...Njëherë, madje, i shkoi mendja se dervishi, qoftë edhe pa dashas dhe pa sherr, mund të paraqiste një karrem nga dikush për t'i futur në ndonjë kurth, kështu që edhe çirret rreth rrezikut që u kanosej fëmijëve dhe të moshuarve, të cilat kokës së tij mund t'i ishin qepur rastësisht nga ato që shihte apo dëgjonte të ndodhnin në atë hapësirë, duhej t'i shërbenin këtij mashtrimi?...

Por kjo hamendje sikur nuk e kënaqi Skulptorin, cili shtoi se dervishi dukej thellësisht i frikësuar dhe i brengosur, pra lente për të kuptuar se ndodhej në hall të madh dhe kjo i detyronte të ndërmerrnin diçka.

“Duhet prituri mëngjesi“, foli Koloneli dhe urdhëroi studentin Zenel Xhema bashkë me një tjetër të bënë roje gjithë natën në të dy anët dhe porositi se duhej të ishin të vëmendshëm dhe të njoftonin për çfarëdo që hetonin në afërsi.

Por, pjesën tjetër të natës, përderisa i zgjuan krismat e ardhura nga ana lindore e kodrinave, të cilat pastaj u shoqëruan me disa të tjera nga ana e kundërt, askush nuk futi gjumë në sy. Kolonelit nuk i hiqej dervishi dhe lutjet e tij. Herë ndjente brejtje ndërgjegjeje,

pse nuk kishte vepruar, e herë i jepte të drejtë vetes, që ishte përmbajtur, ngaqë ishin fare të papërvojë dhe të papërgatitur për t'u futur në atë ngatërrim që nuk ia kishte marrë mendja se mund të ishte i tillë. Sidoqoftë ishin krismat dhe shpërthimet që u dhanë fund hamendjeve të Kolonelit dhe ai me t'i dëgjuar ato, brofi dhe kërkoi të bëheshin gati, edhe pse nuk e kishte të qartë se çfarë do të thoshte gjendja e gatishmërisë të cilën e shpalli ashtu kryenëvete, dhe ç'është më keq, nuk e dinte si duhej vepruar në ato rrethana fare të paqarta nate, kur nuk kishte as të dhëna nga pararojat e as të tjera që i duheshin luftës çfarëdo qoftë ajo.

„Kësaj i thonë marrëzi“, i tha vetit Koloneli dhe kjo i dogj si shumë, sepse si ushtarak i profesionit, që kishte komanduar mbi tri brigada me tridhjetë mijë ushtarë në shtatë beteja kundër perandorisë britanike nëpër shkretëtirat e Lindjes së Afërme, në një front i cili ndonjëherë si gjarpër shtrihej edhe dy mijë kilometra, dhe të shtatë herët, nëse nuk kishte fituar, së paku nuk kishte humbur, dhe kjo paraqiste një sukses të madh, që kishin qenë të fundit të perandorisë osmane në ato pjesë e cila pak nga pak ishte bërë pre e anglezëve dhe francezëve, pra edhe aty, ku nuk kishte fronte të qarta e as fushëbeteja të denja për luftë, ai duhej të kishte të gatshëm planin e veprimit, në mos i thëncin veprim lufte, atëherë së paku diçka që do t'i shërbente lëvizjes së thjeshtë të mos zihej si miza në mjaltë...

Ndoshta këto hamendje do ta ngarkonin edhe më po mos të ishte sjellja gati hysterike e togerit Huber, një ushtaraku nga Saksonia e Ultë, i cili thoshte se kishte përvojë lufte në disa pjesë të Ballkanit, që zuri të çirrej me sa zë kishte dhe të nxirrte disa fjalë të shkëputura të cilat askush nuk ia kuptonte. Më kot u mundua Skulptori bashkë me spanjollin Rafaelo ta bënte zap dhe të merrte vesh se ç'hall kishte. Spanjolli madje ia futi në gojë si me zor njëfarë pluhuri që tha se edhe demat e tërbuar i bënte palë kur u futej në hundë. Një copë herë zgjati marrja me të, deri sa iu afrua prifti Gjon Lleshi, dhe pasi që çirrjeve të tij iu kundërpërgjigj me një çirrje edhe më të madhe, e zuri me duar për fyti dhe pas një shtrëngimi, që dukej se do ta lente pa frymë, saksoni u qetësua fare. I bërë pulë, nisi të ngashërente dëneshëm dhe kërkoi ujë, që ia hodhi kokës.

„Duket se ka shenja të hysterikëve“, tha prifti dhe bëri të ditur se ata i qetëson vetëm përdorimi i forcës së mbikëqyrur, pra me shkaktimin e dhembjeve të mëdha, që në famullinë e tij përdorej vazhdimisht në raste të ngjashme. Por shtoi se ndaj të tillëve duhej pasur kujdes, sepse pas qetësimit e humbin pusullën fare.

Dhe njëmend doli se togeri Huber, pasi kishin pushuar të shtënat, ishte qetësuar dhe kishte ndejë një copë herë i strukur pas spanjollit Rafaelo, dhe në atë hallakamë kur po bëheshin përgatitjet, që së paku, për pak të ndërrohej vendi, përderisa të shfaqej agsholi dhe të shihej se çfarë në të vërtetë kishte ndodhur, qëndrim ky që Koloneli e kishte marrë në marrëveshje me Skulptorin dhe togerin von Hesel, i cili nuk i hiqej, ai thuajse padiktueshëm i ishte shmangur spanjollit Rafaelo, i cili, me ta hetuar mungesën e tij, e kishte bërë të madhe dhe kjo kishte mjaftuar ata serish të përfshiheshin nga një panik e përgjithshme sa Kolonelit i ishte dashtë për herë të parë ta ngrinte zërin dhe të kërkonte rregull. Madje, një çast deshi të thoshte se lufta nuk është për qyqarë, por u përmbajt, sepse kjo do të ishte fjala më e papërshtatshme, që aty nuk duhej nxjerrë kurrë.

Kur njësitë ishte rreshtuar disi, ishte parë mungesa e togerit Huber. Prifti Gjon Lleshi ishte i pari, pa pritur çfarë do të vendosej me atë rast, mori vrapin kah rrëpira që çonte luginës dhe tha se togeri kishte marrë malin. Pas i shkoi edhe studenti Zenel Xhema dhe një tjetër që nuk u pa se cili ishte, por shpejt u mor vesh se ishte sportisti Hajek.

„Filloi keq“, deshi të thoshte Koloneli, por këtë herë ishte Skulptori, i cili tha se ajo ishte nata më e gjatë dhe më e turbullt e jetës së tij, që duhet shpresuar se dikur do të kalojë dhe nuk do ta ketë sherrin aq të madh, fjalë këto që gjithë çështjes disi ia hoqën shqetësimin, por sikur ia kthyen zabullimën e një pritjeje të ethshme, e cila u thye vetëm pasi doli drita dhe para tyre u shfaq po ajo pamje e shkretë e atij mjedisi të rrasur në atë luginë, ku nuk dukej se ndodhte gjë prej gjëje. Megjithatë Koloneli dhe të tjerët e dinin se atë natë aty kishin jehuar krisma, që herë nga njëra anë e herë nga ana tjetër kishin shpërthyer dhe, po ashtu e dinte se

në atë heshtjen shurdhe e cila kishte pllakosur më pas ishte futur togeri Huber dhe kushedi se ku i kishin mbetur gjurmët bashkë me veprimet në dukje të pambikëqyrura, që edhe po t'i arsyetonte sjellja hysterike dhe sulmi i saj, ato megjithatë mbeteshin të paqarta.

Nga ajo pikë nuk po shihej gjë. Për herë të parë Koloneli hoqi dylbitë nga çanta e lëkurës dhe i vuri në sy, por ato, pos ia afruan dhe ia rritën përmasat e atij shkretimi, nuk i sollën tjetër. Madje, më kot u mundua ta gjente edhe atë teqenë e dervishit, që u kishte thënë se shtrihej në pjesën tjetër, aty ku rruga ndahej për në Leqe. Përpara i dolën vetëm ato pesë shtëpi të ulëta, me mure dheu që dukeshin sikur të ishin të thata fare. Në atë hapësirë të cilën ia zinte syri pritueshëm nuk kishte as lëvizje kafshësh e lërë më njerëzish. Kjo sikur i futi të dridhura Kolonelit, ngaqë e gjitha i lidhej me paralajmërimin e sharrimit në ndonjë askundje të pafund, prej nga vështirë liroheshin. Këtë nuk ia tha Skulptorit, por mjaftoi shkarja e pasigurt nëpër hartën që kishte sjellë konti Sombah për të kërkuar pikën e pjekjes dhe shqyrtimin e saj, pra të qartësohej marshuta, e cila ndonëse iu bë se ishte në rregull, megjithatë pamjes së tij sikur ia hidhte shprehjen e njëfarë dyshimi se mund të ishin pikërisht në atë humbëtirën që mund t'ua ngatërronte përgjithmonë fillin...

Që t'i ikte asaj trysnie Koloneli tha se do të ndiqnin shenjat e hartës, që qonin për në Guras, dhe mori anën e verilindjes, ashtu siç parashihej në udhëzime. Deshi të thoshte se andej kishte nxituar edhe togeri Huber, të cilin gjithsesi se do ta takonin, por i përpiu fjalët, ngaqë kishte parandjenjën se ikja e tij pakokë mund të ishte më shumë se çështje e ndonjë sulmi hysterik kur kihej parasysh se ata që preken prej saj në vend të ikjes shemben pamëshirshëm dhe ngrihen vetëm pasi t'u kalojë shkallmimi i madh. Të tjerët i shkuan pas dhe secili kishte brengën e saksonit, ngaqë druanin se e gjitha mund të merrte kahun e penit pas fijos...

Por saksonin nuk e takuan as kur morën kthesën e parë e cila anashkalonte shtëpitë e shkreta e as kur u gjenden te ai udhëkryqi që merrej me mend se ndante rrugën për në Leqe, ku dervishi thoshte se ndodhej teqeja me fëmijët dhe pleqtë që kërcënoheshin. Pa dhënë kurrfarë sqarimesh Koloneli mori vendim t'i bishtnohej rrugës, për të kërkuar teqenë e Leqes dhe këtë e bëri me bindjen se aty kishte kthyer togeri Huber. Dukej se edhe të tjerët kishin atë mendim, por shpresa me të shpejt u treti, sapo kaluan dredhën e parë dhe ndeshën priftin Gjon Lleshi me studentin Zenel Xhema e sportistin Hajek, të cilët dukeshin fare të shkallmuar dhe të tmerruar.

Koloneli e pati të qartë çfarë kishte ndodhur. Dha shenjë të vazhdonin për në Guras dhe nuk deshi të shikonte tjetër pos një pike në qiell, e cila sa vinte dhe ia zvogëlonte hapësirën që ia kthente në një kube e cila i dukej se së shpejti do t'i shembej sipër. Nuk ua vuri veshin as atyre të cilat prifti po i thoshte rreth asaj si togerin Huber e kishin gjetur të masakruar te teqeja, ku ishte gozhduar për derën e saj dhe të tjerat që lidheshin për atë tmerr, dhe nuk ua vuri veshin as atyre që thoshte për dhjetëra e dhjetëra të vrarë gjatë asaj nate, që kishin mbetur ashtu të masakruar në pjesën e askujt, pra në atë hapësirën djerrë e cila ndante kryengritësit dhe përkrahësit e mbretit, por vazhdoi kah u prinin dy mushkat e ngarkuara, të cilat ecnin të qeta sikur më parë ta dinin cakun, i cili atyre në atë vend të panjohur u ishte ngatërruar fare...

...

Në atë gjendje thuajse marramendëse Koloneli kishte bindjen se po ecte drejt një rrënimi të pashmangshëm dhe njëjtë iu duk ajo rrugë edhe çastin kur po i afroheshin asaj pike, të cilën po e ribënte pas gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, që megjithatë, për t'i ikur përsëritjes dhe për t'u kursye sado pak nga përfytyrimet e saj të hidhura tha se do të bishtnohej Leqja dhe teqeja për të shkuar në Guras para se të binte nata.

Duket se ai vendim i qetësoi edhe të tjerët që kishin mundimin e ballafaqimit me gjurmët e tmerrit të parë dhe rikujtimin e tij, që kushedi se si do të shfaqej. Edhe pse tash nuk i kishte mushkat me vete, të cilat do t'u jepeshin disa jevgjve të Kavajës, që me tërheqjen e

kufomave të cilat mbeteshin në atë hapësirën e askujt, ishin të vetmit të cilët në atë luftë shkatërruese kundër vetvetes bënë një punë tepër të rëndësishme, që askush nuk e merrte përsipër, Koloneli bëri sikur i kishte mushkat përpara dhe ndoqi atë përfytyrimin e lëvizjes së tyre të prajshme, që nuk ishte e thënë të kalonte si në ikje prej andej, sepse po në atë pjesën ku niste rrëpira që ndante nga kthesa e Leqes, u shfaq dervishi, i ngrirë mu në mes të rrugës.

„Sikur nuk bënte pa të“, foli Koloneli me gjysmë goje, por mjaftoi që ato të zënë veshin e priftit Gjon Lleshi, i cili nxitoi t’ia hetonte gjendjen.

„Është bërë xurxull...Tek e fundit këtu as që bën ndryshe“, foli prifti pasi u kthye dhe priste udhëzimet se çfarë duhej bërë me të.

Kolonelit i shkoi mendja te mushkat e lëna jevgjve për t’i bartur të vdekurit, para se në atë vapë të bëheshin këрма. Mendoi se po t’i kishin do ta gjuanin sipër njëres. Njëherë i shkoi mendja ta lente ashtu si ishte. Por as kjo nuk e kënaqi, sepse binte në kundërshtim me sjelljen njerëzore, që ishte e vetmja, e cila aty në ato rrethana mungonte dhe ishte aq e domosdoshme. Ky gjykim sikur e kthjelloi paksa dhe e shtyri t’i thotë priftit Gjon Lleshi të bënte ç’ishte e mundur dervishi ta merrte veten. Duket se kjo u pëlqeu edhe të tjerëve, që sikur kaheër kishin pritur diçka të tillë, secili në mënyrën e vet, iu dhanë përpjekjeve të veçanta t’i ndihmohej njeriut të shkretë të cilit i kishte rënë mundimi të sillej andejpari si fantazmë e pashmangshme. Kështu, telegrafisti Bruner nisi t’ia fërkonte duart dhe këmbët dhe të shpjegonte pa pritesë se ashtu gjaku i kthehej trurit dhe këtë e kishte mësuar nga një mjek i cili në vendlindjen kishte bërë nam në saje të asaj se atje pihej pa karar. Njëri nga oficerët gjermanë po ia ngrehte flokët kujdesshëm, që edhe ai thoshte se ai veprim ishte pjesë e mjekësisë popullore në pjesët veriore prej nga vinte, ndërsa togeri von Hase, i cili mbante disa rruaza të kaltra qelibari, po ia sillte përpara dhe thoshte disa si lutje në një gjuhë fare të panjohur. Kështu, e gjitha nisi të kthehej në njëfarë sëkëlldie, që kushedi sa mund të zgjaste, po mos të ishte prifti Gjon Lleshi, i cili kur kishte pa atë shfrim që shkonte kah fanitja e përgjithshme, e cila rrezikonte të kthehej në një pengesë ngecjeje kur ishin edhe një copë rrugë për të bërë, hoqi nga rruga dy grushte pluhur dhe ia hodhi fytyrës dervishit, që sapo ia prekën sytë dhe hundët, lëvizti aq fuqishëm sa shembi manash ata që po merreshin ç’prej kohësh me të dhe nisi të çirrej me fjalët ngojë se shejtani e kishte mbajtur ashtu ç’prej mija vjetësh dhe ndoshta përherë. U falënderua dhe, sikur të mos i kishte parë ndonjëherë, hallakatshëm mbërtheu kah shpinte rruga e teqesë së Leqes.

„Ka shkalluar, i gjori“, tha prifti Gjon Lleshi dhe i erdh keq që ajo ditë, e cila iu duk se nuk kishte të sosur, tashmë ishte ngarkuar edhe me një të papritur të tillë, së cilës mund t’u shtoheshin edhe tjerat...

Dervishin nuk e kishin parë më, por si kishte marrë vesh telegrafisti Bruner, as ai nuk i kishte shpëtuar asaj lufte të papastër dhe tmerreve të saj që përplaseshin andejpari pamëshirshëm pa kursyer njeri. Dihej vetëm aq se ishte qëlluar nga një plumb qorr i zbrazur në atë drejtim nga grupet e ndryshme kryengritëse të vendosura në ato anë pasi ishin tërhequr forcat e qeverisë së përkohshme, dhe në mungesë të kundërshtareve, herë pas herë kishin hapur shkëmbime zjarresh sa për ta dëshmuar praninë e tyre, ose për ta thyer bezdinë që kishte pllakosur, dhe kjo kishte ndodhur kur kush e di pse, nga ndonjë lajthitjeje apo shtysë tjetër fare e pashpjegueshme me të cilat ngarkoheshin të tillët, ai kishte bërë përpjekje të largohej nga hapësira e teqesë së Leqes, së cilës të gjithë i rrinin larg pa marrë parasysh bindjet politike dhe qëllimet që kishin në atë luftë fare të paqartë së cilës nuk i shihej fundi.

Sidoqoftë, pjesën tjetër të rrugës deri në Guras, që sipas të gjitha parashikimeve, nuk do të duhej të zgjaste edhe më shumë se dy orë, do ta hanin para se dielli t’i afrohej kodrinave të cilat e ndanin nga deti, por për Kolonelin mbetej e paqartë se çfarë do të bënin aty, atë natë dhe të nesërmen, pos të rraseshin gjumë?...

...

Herën e kaluar, para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, kur kishte filluar ajo bredhja zvarritëse në kërkim të luftës së tyre në mbrojtje të Shqipërisë, e cila bëhej sipas vijave të hartës të cilën e kishte sjellë konti Sombah dhe shënimeve të pakta që ndodheshin në të, pra në atë nismë të paqartë, në Guras duhej të takonin përfaqësuesin e mbretit, që mbase për arsye fshehtësie nuk i përmendej emri, por nga një njoftim i besueshëm Koloneli e dinte se ai ishte njëri prej pjesëtarëve të familjes Vlora, diplomat me përvojë për nga profesioni, që ndonëse i pari i tyre, Ismail Qemali kishte shpallur pavarësinë në Vlorë, kishte lëshuar vendin, pasi këtë kishte kërkuar Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, ai ishte vu në shërbim të mbretit të caktuar nga jashtë dhe thuhej se në sajë të autoritetit që gëzonte në vend dhe lidhjeve të mira me Vjenën dhe Berlinin, rreth kurorës mbretërore ia kishte dalë të bashkonte bejlerët dhe ata pak intelektualë të vendit, siç kishte bërë që kjo çështje të përkrahej nga përfaqësuesit më të lartë të besimeve, pa marrë parasysh se më vonë, do të jenë pikërisht disa nga titullarët e bashkësive fetare nga rrethet, që do të bëhen bartësit kryesor të përçarjeve dhe luftës vëllavrasëse, në të cilën do të futen gishtat nga të gjitha anët, si nga jashtë e edhe nga brenda. Kolonelit ia thoshte mendja se Skulptori edhe mund ta njihte përfaqësuesin e mbretit nga koha e Austrisë, por asnjëherë nuk e kishte pyetur nga shkak se vlerësonte se misioni mund të qëndronte edhe pa shkëmbimin e të gjithave që i nënkuptonte lufta e organizuar e një shteti. Se në atë takim disa gjëra do t'i nënshtroheshin njëfarë mbikëqyrjeje dhe rregulli, kjo nuk vihej në dyshim, sepse edhe përfytyrimi më i shlrshëm i asaj lidhjeje, parashikonte minimumin e sjelljes së përbashkët, që pa marrë parasysh se a do të quhej urdhër apo komandim, duhej nënshtroar të gjithë. Kjo mbase ia kishte shtuar rëndësinë atij takimi dhe kishte bërë Koloneli ta presë me njëfarë shqetësimi të ngatërruar me emocione, pa qenë në gjendje t'i shpjegonte se çfarë ishin ato në të vërtetë, por kishte dëshiruar të bëhej sa më parë.

Por, takimi me përfaqësuesin e mbretit nuk u bë as atë mbrëmje, si ishte paraparë, dhe nuk u bë kurrë. Në vend të tij, aty nga gjysma e natës, kur pjesa më e madhe e tyre i ishin dhënë kotjes, ishte shfaqur njëfarë i dërguari i oborrit të mbretit, që nuk i ishte kuptuar as emri e as rendi, po sipas një shifre të cilën të nesërmen e kishte kapë telegrafisti Bruner të ardhur nga Vjena, sa u përket formaliteteve, takimi mund të merrej si i kryer dhe me këtë, sipas fjalëve të të dërguarit të oborrit të mbretit, prania e njësitit të vullnetarëve nga Vjena *në mbrojtje të mbretit* të merrej e filluar, që pas ndërhyrjes së Kolonelit, ajo të quhej *në mbrojtje të Shqipërisë*, dhe si e tillë edhe ishte pranuar, sado që i dërguari i oborrit kishte propozuar, si njëfarë marrëveshjeje përkufizimin *në mbrojtje të qeverisë së përkohshme*, të cilën konti Sombah me të drejtë e kishte quajtur politikisht të papranueshme, ngaqë sjellja dhe veprimtaria duhej t'i nënshtrohej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, që askush nuk e donte. Pas ujdise rreth emërimit të misionit të tyre, sikur takimi kishte marrë fund dhe ato fjalë të pakta që ishin këmbyer midis tyre, kishin qenë llafe të kota.

Që takimi megjithatë të mos dukej fare i parëndësishëm dhe me këtë në nismë të mos zhvleftësonte misionin, i dërguari i oborrit të mbretit i kishte thënë Kolonelit se „Oborri ia njihte dhe ia pranonte komandimin“ dhe ia kishte bërë me dije se së shpejti do të merrte takim me njërin nga oficerët e lartë të këshillit të shtetit, i cili do ta njoftonte rreth veprimeve ushtarake, të cilat mund të ndërldheshin “gjatë situatave të veçanta”. Ai po ashtu i kishte thënë se përderisa të bëhej ky takim ishte mirë të rrinin në gjendje gatishmërie në përputhje me marshutën e tyre dhe të përpiqeshin të ruanin asnjësinë, pa marrë parasysh provokimet që mund t'u bëheshin nga kundërshtarët e qeverisë së përkohshme dhe të mbretit, që tha se ishin të shumtë dhe vinin nga të gjitha anët dhe për betim të përbashkët kishin moslejimin e punës së qeverisë së përkohshme e as të mbretit, por krijimin e një hallakame dhe gjurulltie të atillë ku nuk dihet kush ha e kush paguan në mënyrë që botës t'i dërgoheshin mesazhe se Shqipëria nuk mund të bëhej, ngaqë nuk e donin vetë shqiptarët!...Në fund tha se me anën e telegrafistit Bruner, do të pajiseshin me depeshet e oborrit dhe do të njoftoheshin edhe për pikat e furnizimeve me armatime, por edhe me ushqime dhe për të tjerat që vinin...

I habitur pa masë nga ato që kishte dëgjuar aq hapatrupash nga i dërguari i oborrit të mbretit, Koloneli ishte përmbajtur nga çfarëdo reagimi, pos kishte kërkuar çështja e furnizimeve me ushqime të ndahej nga çështjet tjera të cilat i quajti „të natyrës së veçantë“ dhe të fillonte menjëherë, ngaqë me vete kishin ushqime vetëm edhe për një javë. I dërguari i oborrit pranoi këtë ndërhyrje dhe kërkoi njeriun e tyre të ngarkuar me çështjet e furnizimeve ta përcillte për pak, që Koloneli pa hamendje i tha se ishte studenti Zenel Xhema, dhe kjo mund të merrej me mend se atij duhej t'i jepej shifra e nevojshme për ndërlidhje, e cila ishte e domosdoshme në ato rrethana.

...

Takimin dëshpërues me të dërguarin e oborrit të mbretit Koloneli kishte dëshiruar ta harronte sa më parë. Nuk ishin për brengosje vetëm sjelljet tepër mospërfillëse të të dërguarit të oborrit e as padia që shfaqte ai në çdo pikëpamje, që edhe do të mund të faleshin, megjithatë shqetësimin ia kishte shtuar të menduarit rreth gjendjes në të cilën ndodhej shteti shqiptar në formim si dhe pasojat që do të kishte për ardhmërinë e tij tepër të pasigurt nëse drejtohet nga të tillët. Shqetësim e këtij paralajmërimi mbase më së miri ia kishte pasqyruar sjellja e dervishit të teqesë së Leqes dhe ato që kishin përjetuar aty në rrugë e sipër për atë takim, kur me masakrimin e togerit Huber u ishte bërë me dije se çfarë i priste dhe me çfarë do të ballafaqoheshin.

Atë natë, pra para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, megjithatë Koloneli kishte pasur Skulptorin pranë, që në njëfarë mënyre, me ato të cilat ia kishte thënë përgjithësisht për artin, krijimtarinë si dhe filozofinë, paksa e kishte ngushëlluar, dhe kishte pasur po ashtu bindjen se ndodhej në nismë të një rruge, nëpër të cilën gjithsesi se duhej kaluar, sado që ajo nuk do të kishte fund por vetëm një cak drejt arritjes së një synimi afatgjatë, që i kishte ndihmuar t'u bënte ballë të papriturave të para dhe madje t'i merrte për të natyrshme.

Por, gjashtëdhjetë e gjashtë ditë më vonë, kur serish ndodhej në atë vend, ndonëse ishte natë dhe terri ia kishte mbuluar për pak trishtimin atij rrethimi, atë gjendjen e rrëmetit që e merrte me mend si e kishte përfshirë hapësirën shkrete, e cila kishte fatin tragjik të mbetet vend i askujt, për herë të parë Koloneli e lidhi me fatin e vet si dhe atë fundin e një synimi si fund dhe humbje, që mund t'i kthehej në cak...

Ky përfytyrim sikur e përcolli gjatë gjithë natës dhe i tillë iu shfaq edhe në agsholin e parë, kur në frymëmarrje do të ndjejë shkrumbin e blozës tek vinte nga afër si dhe dufin e tharë të tokës, e cila gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve i ishte nënshtruar një dielli përcëllues, që sikur për aty kishte ruajtur rrezet më të forta t'i shpërndante pamëshirshëm. Mbase ajo pamje trishtuese, që ende nuk i ishte përfillur si duhej, ia nxori oshtimën rreth sjelljes së pafund nëpër një askundje të trisht dhe hapësirën e vdekjes, e cila ndonëse e flashkët, kishte nxënë veshin e priftit Gjon Lleshi, i cili i ishte afruar dhe i kishte ndihmuar të hiqte pjesët e xhakëtës, që dukej se gjatë fjetjes i ishin lidhë për fyti dhe shtrëngimi i saj mund t'i kishte shkaktuar ankthe...

„Përpara kemi edhe një ditë të nxehtë dhe tepër të gjatë“, tha prifti për t'ia bërë me dije praninë dhe nevojën të merrte veten.

Deshi t'i thoshte se përpara nuk kishin asgjë, pos hiqësisë së asaj askundje ngulfatëse, se edhe ajo ditë, si ajo që kishin lënë pas, nuk ishte për tjetër pos për të përkujtuar edhe një humbje, pra vdekjen e dytë me radhë, atë të poetit Hartman, rreth së cilës Koloneli në ditar kishte lënë shënimin se „Shqipëria kishte mbetur pa vjershëtarin që ëndërronte ta hartonte epopenë e saj në vargje të njëjtë me atë të Iliadës...“, dhe si do të theksojë më vonë, për të, „ajo vdekje paraqiste të kuptuarit se atë fat e kishin gjithë ata që lidheshin me idetë e singerta të bërjes së Shqipërisë Shqipëri...“

...

Poeti, i cili vinte nga vendlindja e mbretit, pra nga qyteza e bukur Noj Vid e Gjermanisë, u ishte bashkangjitur i paparashikuar në Trieste, pasi i kishin dështuar të gjitha rugët e rregullta për t'iu bashkuar suitës së tij, që në vend se të nisej solemnisht nga Noj Vidi për në Këln, si parashihej, në çastet e fundit, ata që kishin bërë protokollin, kishin vendosur e gjitha të fillonte nga Mynheni, ku solemniteti zyrtar për pak do të ripërsëritej në Grac dhe pastaj rruga e trenit të shpinte për në Trieste dhe prej andej me anije të soste në Durrës. Poeti Hartman, që mbahej si i njohur i konteshës Sofi nga derë princore e Shonburgëve të Magdeburgut, me të vërtetë kishte pasur ftesën e mbretëreshës së Shqipërisë për solemnitet, dhe këtë e tregonte kudo me mburrje, që si duket ajo do t'i bëhej edhe exhël, por si e tillë i kishte ra në dorë para se të bëhej ndryshimi protokollar, dhe ai, nga Këlni, me trenin e parë, me të shpejt ishte nisë për në Mynhen me shpresën që së paku atje do të zinte një pjesë të ceremonialit, ku do të mjaftonte konteshës Sofi dhe personalisht t'ia dorëzonte vjershën kushtuar qiftit të ri mbretëror dhe mbretërisë së Shqipërisë, të cilën po atë ditë, gazeta „Rheinische Zeitung“ e Koblencit kishte botuar në faqen e parë bashkë me një urim redaksional të shoqëruar nga fotografia e pritjes së delegacionit shqiptar, i cili në prill të atij viti, në Këln ia kishte dorëzuar mbretit kurorën e Shqipërisë me përkrenaren e Skënderbeut, ku madje jo pa arsye jepej edhe shpjegimi shtesë se „kurora e Skënderbeut mbretit i ishte vu në kokë bashkarisht nga krerët kryesor të Shqipërisë Esad Pashë Toptani dhe Hasan bej Prishtina...“, që pak ditë pas ardhjes së mbretit në Shqipëri, ata do të marrin kahet e kundërta, njëri kundër mbretit dhe tjetri në përkrahje të tij, me të cilat do t'i hapeshin dyert asaj vëllavrasje të tmerrshme që do ta gjakosë deri në palcë vendin...

Në të vërtetë poeti Hartman, i cili të nesërmen kishte arritur në Mynhen dhe me kot kishte pyetur për nisjen e suitës mbretërore për në Shqipëri, ngase askush nuk dinte gjë për të, por duket se edhe pa kujt ia kishte tërhequr vëmendjen aty, nuk ishte dëshpëruar dhe as kishte hequr dorë nga rruga e filluar. Sapo kishte marrë vesh se „ishin çështjet e protokollit“ ato që gjërat i kishin ngatërruar sa ai të mos e zinte solemnitetin, të cilat edhe i kishte arsyetuar disi, ishte kthyer në Noj Vid, dhe pasi kishte vu lidhje me zëdhënësin e familjes princore dhe ia kishte treguar të gjitha, sidomos qëllimet që kishte në Shqipëri të shkruante, si ishte shprehur „historinë e saj të lavdishme në vargje, që këtij vendi krenar i mundësohej në rrethanat e reja“, ishte vu në listën e parë të pritjes së pjesës së suitës përcjellëse, të paraparë pas dy javësh do të shkonte në Shqipëri, bashkë me disa pajisje të tjera, si ishin mobiliat e veçanta dhe biblioteka e mbretëreshës, që duhej ta stolisnin pallatin e ri mbretëror. Në pritje të asaj dite më të rëndësishme të jetës, poeti Hartman, krahas projektit për „poemën e madhe shqiptare“, që e kishte bluar pareshtur në kokë, kishte hartuar edhe një vjershë tjetër, kushtuar qiftit mbretëror, i cili tashmë ndodhej në Shqipëri dhe ua kishte dërguar disa redaksive të njohura në Berlin, Mynhen dhe Hanburg për botim, me „rekomandimin“ se „ishte e shkruar nga miku i mbretëreshës“, por askush nuk ia kishte varë. Madje, vjershën nuk e botoi as gazeta lokale „Rheinische Zeitung“ e Koblencit, si kishte vepruar ditën e nisjes së tyre për Shqipëri. Meqë as shtypi nuk i bënte farë opinionit qëndrimit të mbretit dhe mbretëreshës, që i ishin dhuruar fronit të Shqipërisë dhe kur dukej se as shtëpia e mbretit në Noj Vid nuk tregonte gjithaq interesim për dërgesën e pjesës së sendeve tjera në Durrës, poeti Hartman, i cili kudo thoshte se „vlonte nga trysnia e ngacmimit të pareshtur të poemës së Shqipërisë, që priste të shpërthente“ vendosi kryenëvete të gjente rrugën e Shqipërisë, që me atë vjershën kushtuar qiftit mbretëror të fitonte të drejtën e privilegjit të poetit të oborrit mbretëror, me çka, si ëndërronte, përfundimisht i hapej rruga për t'iu bërë i famshëm, Homer i Shqipërisë. Bëri çfarë bëri dhe një ditë ai mori vesh për vullnetarët nga Vjena, të cilët niseshin për Shqipëri dhe pas shumë e shumë telashesh me adresat dhe të tjerat, ia doli t'iu bashkohej, gjë që Skulptori ishte entuziazmuar se me vete kishin edhe një poet, i cili si thoshte, kishte edhe njohësi me mbretëreshën dhe vlonte nga zjarri i frymëzimit për ta shkruar historinë e Shqipërisë në vargje.

“Të tillët i duhen Shqipërisë“, kishte thënë Skulptori dhe mbase kjo mund të lidhej edhe me atë se edhe vetë ishte ndër ata, që njësoj parashikonte, kur të bëhej shtetit shqiptar, në masivin shkëmbor të maleve të Krujës por edhe në ndonjë bjeshkë tjetër të Shqipërisë, të gdhendte shtatoren e Skënderbeut, të ngjashme me atë të portreteve të presidentëve amerikan në Kolorado.

Mënyra si u paraqit poeti Hartman para të tjerëve, kur pa një pa dy nxori vjershën dhe zuri ta lexonte me aq ndjeshmëri sa iu lagën edhe sytë, si dhe ato që thoshte pareshtur rreth „Iliadës“ shqiptare, e cila mund të shkruhej vetëm në Shqipëri dhe „në ambientet e shtetit shqiptar“, njësitit sikur ia hoq zymtinë dhe seriozitetin që i vinte nga ushtarakët e profesionit që ishin njëzet sosh.

Kolonelit i erdhi mirë se me vete kishin edhe një krijues të ndjeshëm, veçmas kur ai ëndërronte të shkruante gjëra të mëdha, që një ditë mbase do ta ngritnin në poet nacional, por druante se poetët ishin të papërshtatshëm për rrethanat nëpër të cila do të kalonin nga shkaku i gjendjeve emocionale, që ata u nënshtrohen lehtë. Kishte parasysh një thënie të Norës, e cila poetët i quante „shpirtra që shpejtë nxeheshin e më shpejtë ftoheshin...“

Dhe përnjëmend doli se pas ngjarjeve që kishin pasuar ditën e parë me dervishin e teqes së Leqes si dhe masakrimin e togerit Huber para teqesë, poeti Hartman sillej sikur të ishte tjetër, fare i përdalë. Prifti Gjon Lleshi ia kishte bërë me dije gjendjen e tij dhe Koloneli i kishte thënë ta mbante në përkujdesje, së paku deri të nesërmen kur do t’i jepej përfaqësuesit të mbretit, pasi t’i bëhej me dije se kishte ftesën e mbretëreshës. Por meqë përfaqësuesi i mbretit nuk kishte ardhur dhe ai gjithë kureshtje kishte përcjellë ato që kishte thënë i dërguari i oborrit, ku për habinë e tij nuk i ishte përmendur emri e as vjershat e tij, të cilat duhej t’i dinte mbretëresha, pse jo edhe të tjerët, pra në një gjendje thuajse shkalluese dhe tepër dëshpëruese, se si ishte përvjedhur dhe kur studenti Zenel Xhema me telegrafistin Bruner për pak kishin përcjellë të dërguarin e oborrit deri ku e pritnin ata të cilët e kishin sjellë, nga ana e kundërt poeti Hartman i ishte vu prapa të dërguarit të oborrit, dhe ndonëse nuk dihet se a e kishte takuar apo jo, nga letrat e grisura, ku bëhej fjalë për shkrimin e „Iliadës“ shqiptare, të cilat kishin mbetur para se të binte qëllimisht apo të sharronte me pahiri në baltinën e lumit, merrej me mend se ishte dëshpërimi i thellë i përjetuar nga mospërfillja ose zhgënjimi i tmerrshëm, që kishte mundur të çonte te ai përfundim?...

Më vonë, nga shënimet e lëna në teqe, Koloneli sikur e kishte ndryshuar këtë qëndrim dhe fatqësinë e poetit Hartman, e cila kishte ndodhur natën e takimit me të dërguarin e oborrit, e kishte parë si vdekje të paralajmëruar, e cila e kishte ndjekur atë dhe është dashtë ta gjente krijuesin i cili ishte plot përkushtim të shkruante, si thoshte „historinë e Shqipërisë në vargje“, që ai e quante „Iliadë të njëmendtë“, e ku pasqyrohej një mendësi e lartë antike, të cilën bota duhej ta njihte dhe me këtë, si kishte ndodhur me Olimpin grek, edhe Alpeve shqiptare t’i pranohej „statusi i vendit të hyjnive“...

II

Ndonëse nuk e kishte thënë haptas, Koloneli kishte pasur bindjen, se ishin takimet e rastit apo të qëllimshmet të cilat përherë sillnin kobe apo që u hapnin udhë atyre, sado që nuk mund t’u ikej. Gjatë gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të ngarendjes si hije nëpër atë rripin e tokës së askujt, që kishte ndarë kryengritësit nga mbrojtësit e qeverisë së përkohshme, por edhe kishte krijuar atë unazën e tragjedisë shqiptare, kishin qenë edhe tri takime të tjera, të cilat Kolonelit i ishin lidhur me tri vdekje, të cila, si do të shihet më vonë nga shënimet e ditarit të shkapërderdhur të lënë në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ato vdekje do t’i marrë si vrasje të kryera me paramendim dhe të paralajmëruara, ku thoshte „se vritej ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri...“ Këtë përshtypje e kishte pasur edhe telegrafisti Bruner, kur

gjashtë vjet pas mbarimit të luftës botërore shënimet ia kishte dhënë Skulptorit, e ai, pasi i kishte lexuar e rilexuar me shumë kujdes dhe ishte pajtuar plotësisht me mendimet e Kolonelit, ia kishte dërguar të fejuarës Helenora von Branun, në një klinikë psikiatrike në të cilën kishte përfunduar pasi kishte kaluar gjashtë vjet në një burg francez nën akuzën se ishte zënë si reportere lufte diku në Shqipëri, me çka ishte trajtuar si pjesëmarrëse në anën e austriakëve.

Takimi i parë, e me këtë edhe vrasja e polakut Avramicki, që do ta përcjell atë, do të bëhet në ditën e dymbëdhjetë me një ushtarak të lartë të perandorisë osmane nga mbetja e regjimentit të shkapërderdhur të Selanikut në afërsi të një kënetishte e cila kapej me detin. Takimi tjetër, që lidhej me vdekjen e sportistit çek Hajek, do të bëhet me përfaqësuesit e fanatikëve islamistë, ditën e njëzet e dytë, diku në afërsi të Shijakut dhe, takimi i fundit, ku kishte humbur përgjithmonë studentin Zenel Xhema, ishte bërë me kosovarët, ditën e dyzet e dytë, në pjesën e cila lidhte Lezhën me Matin, pikërisht aty ku përfundonin vijat e frontit të kundërshtarëve të qeverisë së përkohshme me kryengritësit dhe fillonin ato të ngatërresave të pafundi shqiptare, që pasqyroheshin me shfaqjen e forcash gjithë fare, të cilat i bashkonte vetëm ajo që nuk donin, pra bërja e Shqipërisë Shqipëri.

Takimin me gjeneralin Hasan Pasha, zëvendës komandant i batalionit të dikurshëm të Selanikut, Koloneli nuk do ta dëshironte e as ia kishte marrë mendja se do të ndodhte në ato rrethana aq të mjerueshme për dy ushtarakët e dikurshëm të lartë të perandorisë osmane, ku njëri kishte pasur edhe më tutje mundësi të bënte luftë të denjë kundër britanikëve, por kishte heqë dorë prej saj kur kishte hetuar se as ato nuk do ta ndalnin rrënimin e perandorisë së Bosforit që kishte filluar ta brente nga brenda, dhe tjetri, që kishte humbur një luftë vendimtare në Ballkan thuajse pa e bërë atë si duhej, dhe kjo kishte ndodhur në sajë të marrëveshjeve të fshehta politike të Portës me francezët dhe rusët, dhe si kundërpërgjigje për këtë, kërkonte rastin për një hakmarrje, kur e dinte se kjo nuk ishte fare e mundshme dhe e gjitha mund të çonte te një vetëvrasje tjetër fare e panevojshme.

Një kohë të gjatë e kishte shikuar gjeneralin e bezdisur nga dëshpërimi dhe nënçmimi i thellë tek fliste rreth një lufte të re dhe të mundshme, të cilën duhej bërë në ato anë dhe thoshte se nuk ishte pa gjasa të fitohej, nëse kihej parasysh se në hapësirën e dikurshme të armatës së Selanikut dhe asaj të Janinës, që tash kontrolloheshin nga serbët dhe grekët, ndodheshin me qindra oficerë, të cilët nuk kishin dashtë t'i nënshtroheshin kapitullimit, dhe po ashtu ndodheshin mijëra e mijëra ushtarë të shkapërderdhur, që silleshin si të pakokë, për të cilët thirrja e luftës do të paraqiste më shumë se një shpëtim për t'i ikur gjendjes së rëndë dhe të pashpresë në të cilën ishin lënë dhe kjo vlente sidomos për ata dhjetë mijë e sa ushtarë të shkretë të divizionit të Janinës, që edhe më tutje ndodheshin në jug të Shqipërisë në një gjendje të mjerueshme skaj një kënetishte nën mbikëqyrjen e forcave ndërkombëtare në pritje të atij evakuimi, i cili bëhej shumë ngadalë dhe kishte gjasa të dështonte fare nga disa prapaskena të xhonturqve, të cilët edhe pse, sipas tij, e kishin shitur Shqipërinë te Rusia dhe Franca, që ajo t'u dorëzohej sllavëve të jugut dhe grekëve për t'i forcuar gjoja njëherë e mirë themelet perandorake në Azinë e Vogël, pas atyre që ndodhnin, sikur shpresonin se në Shqipëri serish do të ringjallej perandoria e tyre dhe kjo do të bëhej në sajë të „rikthimit të frymës nacionaliste turke“ dhe shihej si e vetmja rrugëdalje për të shpëtuar nga kaosi që kishin sjellë mashtrimi i pavarësisë dhe ëndrrat e saj të kota me të cilën i ishte kthyer arma perandorisë dhe sipas tyre ishte sjellë ujku në torishtë...Xhonturqit, thoshte Hasan Pasha, kudo nëpër Shqipëri kanë hapur emisarë, të shumtën agjentë tebdil si hoxhallarë, të cilët kanë për detyrë të luftojnë me çka munden mbretin krishten dhe mbretërinë vasale të Europës dhe të kërkojnë herë një princ mysliman, herë perandorinë osmane e herë diçka që do t'i përngjante njëfarë protektorati të portës, sado që shumëkush e di se e gjitha mund të jetë vetëm një ëndërr vere, e cila u duhet në ato rrethana atyre të cilët bëjnë hesape pa hanxhinë...

“Agjentët e tyre sillen edhe në radhët e oficerëve të dëshpëruar dhe ushtarëve të lodhur nga malaria dhe uria duke u premtuar një luftë të re, tepër të veçantë, e cila bëhet në emër të Allahut, që do t’u sjell nam dhe pasuri...Pra, xhonturqve u duhet një pështjellim ballkanik, u duhet një mish-mash për të dëshmuar se janë në gjendje edhe më tutje të bëjnë diçka aty ku me shekuj ishin, në mos për të mirë, për sherr po se po...”

Pasi foli e foli të shumtën duke përsëritur ato që thoshte pa fund e krye, dikur heshti dhe pas pak iu lëshua një dënesje e cila sikur iu kthye në vaj, që fliste për gjendjen e rëndë shpirtërore në të cilën ndodhej pa shpresë ta përballonte.

Koloneli e shikoi me dhimbsuri dhe e pyeti se ai i besonte përnjëmend asaj lufte, apo këtë e kishte nga dufi i poshtnimit që kishte përjetuar dhe nevoja e hakmarrjes?...

Pa ndonjë hamendje gjenerali foli e tha:

„I besoj luftës. Po mos t’i besoj do t’ia krisja vetit...”

„Dhe mendon se ajo luftë mund të bëhet“, pyeti Koloneli?

„Mund të bëhet...Pse jo?...Ushtarakët nuk janë për tjetër...Vetëm lufta i shpëton nga çmendia dhe nënçmimi“, ia ktheu qetas.

„Ta thotë mendja se një armatë e mashtuar, e lënë në baltë dhe e bërë pikë e pesë, pas një katandisje gati dyvjeçare, serish mund ta marrë vetën për të bërë luftë kaçakçe, kur nuk ka qenë në gjendje ta bëjë si e rregullt?...“

„Pse jo“ tha ai dhe shpjegoi „se armata e tij as që kishte luftuar në hapësirën e shtetit të shpallur shqiptar, edhe pse e shkallmuar, (fjalën e kishte te njësitë e mbetura që pritnin evakuimin dhe ato të shkapërderdhura nëpër vend që i kishin ikë zënies rob), po të vendoset nën një komandë, shpejt merr vetën“.

Shtoi se edhe ashtu, e ashtuquajtura mbretëri shqiptare, ishte nga fundi, se ajo nuk e kishte të gjatë, meqë ishte kthyer në një krijesë qesharake të mbyllur në Durrës, ndërkohë që përreth ndodhën forcat e ndryshme shqiptare pikë e pesë, të cilat luftohen pamëshirshëm ndër veti dhe në atë gjakosje të pashembullt rrënojnë vendin, dhe sado që të përbashkët e kishin pamundësimin e mbretërisë, në rrethanat e kaosit në të cilin ka sharruar vendi, shfaqja e çfarëdo armate të organizuar, nuk do ta kishte fare të vështirë t’ua mbyllte gojën si duhet, dhe kjo madje do të përshëndetej nga popullata e lodhur prej tyre...Tha se nga ky teatër i kurdisur nga fuqitë ndërkombëtare e pësonin shqiptarët, të cilët e kishin të qartë se u duhet ndihma, se u duhet një luftë e përbashkët dhe e udhëhequr nga ushtarakët e profesionit, qoftë ajo edhe kundër gjithë botës, që me siguri se do t’i bashkoheshin i madh e i vogël, jo nga shkak i plotësimit të ndonjë ideali, si ishte ai tashmë i përdhosuri keqas i pavarësisë, me të cilin sekush ishte ushqyer deri vonë, por për arsye se çfarëdo lufte i nxirrte nga gazepi i hallakamës dhe ndjenja e pasigurisë së përgjithshme, që ishte përhapur në ato hapësira, ku edhe gjallimi më i thjeshtë kishte humbur çfarëdo kuptimi...

“Tek e fundit a nuk është më e mirë një luftë, edhe nëse duket marroqe, nga ajo e pa fund që bëhet për vdekje kundër vetvetes?...“

Duket se kjo hamendje Kolonelin e ktheu te pika që atij më së shumti i digjte dhe e shtyri ta pyeste si duhej organizuar ajo luftë, kundër kujt do të bëhej dhe çfarë qëllimesh politike shtronte ajo?

Sikur pyetjet e shtruara të Kolonelit t’i kishte marrë si shenjë të tumirjes së atyre që thoshte dhe me to të afrimit të tij kah ajo luftë, i krekosur befas, gjenerali serish nisi të fliste gjerë e gjatë rreth forcave të shumta të shkapërderdhura ushtarake të perandorisë osmane nëpër Shqipëri, por edhe të tjerave nga formacionet e rregullta, që nga Edreneja, Izmiri e deri te Anadoli, të cilat tha se do t’i bashkoheshin kësaj lufte sapo të fillonte ajo si dhe të zinte ngojë nevojën e shpresës që duhej t’u kthehej njerëzve nga mbrojtja të cilën do ta gëzonin, e cila u mungonte...Shtoi se vetëm lufta ishte ilaç për Shqipërinë e katandisur, por nuk tha gjë si duhej organizuar ajo luftë dhe aq më pak që shkoi kah qëllimet politike që shtronte ajo, të cilat për të ishin ndër kryesoret.

Koloneli nuk deshi ta çonte më gjatë dhe kjo sikur e preku gjeneralin, i cili me çdo kusht kërkonte miratimin e tij për atë luftë, që ishte më se e qartë se për të paraqiste një ngushëllim, qoftë se edhe po t'ia hante kokën, dhe asgjë më tepër. Deshi t'i thoshte sikur ishin luftërat e pakryera, ato familjare, private dhe të tjera, që në atë pjesë ishin më bollëk dhe sillnin kobe të pandalshme, por nuk e pa të arsyeshme, ngaqë do ta lëndonte edhe ashtu njeriun e katandisur nga nënçmimet dhe dëshpërimi i madh nëpër të cilin kishte kaluar për shumë kohë dhe nuk shihte tjetër pos të gjente mundësinë atë gjendje të mjerë e pa shtegdalje ta përfundonte me ndezjen e ndonjë lufte çfarë do qoftë ajo... Andaj, i përfshirë nga ndjenja ngushëlluese se megjithatë dikush po e dëgjonte tek përhapte ato andralla, jo vetëm nuk e hiqte nga goja luftën që duhej bërë, por tha se aty ishte t'ia ofronte postin e komandantit të përgjithshëm, pastaj, pse jo, edhe të mbretit të Shqipërisë, që nuk ishte vetëm dëshirë e tij, por edhe e shumë e shumë oficerëve të tjerë, me të cilën, shtoi se tek e fundit, mund të shpëtohej edhe perandoria nga shembja, të cilin e kishin të përbashkët dhe ku mund të vdisnin me nderim në vend se të bëheshin kërma nëpër moçalet e këtushme...

Ishte e qartë se ai muhabet duhej të mbaronte, si kishte filluar, me një mundim të dyanshëm, që gjeneralit të harruar iu qep sapo Koloneli u ngrit në këmbë dhe dha shenjë se takimi kishte përfunduar. Dukej fare i shkallmuar dhe sapo e përshëndeti ushtarakisht zuri të dëneste dhe kërkoi megjithatë mos ta hiqte mendsh atë se vetëm lufta, që do ta bënte, mund ta shpëtonte nga vdekja e padinjitetshme dhe poshtëruese nëpër bllaquke...

„Gjeneralëve u ka hije lufta e madhe...“ tha dhe shtoi se „nga kjo dergjë vdekjeprurëse Shqipërinë, e nxjerr vetëm një luftë, çfarëdo qoftë ajo...“

...

Kur mbet vetëm, Koloneli sikur u pushtua nga një shtrëngim që po mos të shfaqej Skulptori do të ngulfatej. Ato që ai ia tha rreth telasheve me furnizimet, të cilat sa vinin e shtoheshin nga mos përgjegjësia e të dërguarit të oborrit, i cili nuk i rrinte në fjalë studentit Zenel Xhema kur ai me shumë vështirësi ia dilte të paraqitej aty ku ndodheshin pikat e përkohshme të furnizimeve të qeverisë, si dhe rrugën e mundimshme që duhej bërë të nesërmen, e cila shkonte skaj një kënetishte me shumë mushkonja, iu duken asgjë. Koka i rëndonte nga fjalët e gjeneralit turk si dhe katandisja e tij, që sikur i dukej se po i bashkohej, ngaqë ajo njëherësh paraqiste edhe katandisen e Shqipërisë, të cilën ai e kishte krahasuar me atë „dergjën vdekjeprurëse“.

Koloneli kërkoi të pushonte, në mënyrë që t'i ikte disi atij parafytyrimi të ligë të ndjenjës së dergjës dhe të katandisjes nënçmuese, të cilën ia la gjenerali turk, por pa i mbyllur sytë hyri prifti Gjon Lleshi dhe i tha se polaku Avramicki ishte gjetur i therur jo shumë larg nga përcjellësit e gjeneralit. Ç'është më keq, me atë rast, polakut i ishte marrë edhe ajo pjesë e thesarit që kishin për rastet e jashtëzakonshme, e cila vinte nga ndihmat dhe faljet në Vjenë dhe gjetiu në Austri, të shumtën nga mërgimtarët por edhe dashamirët tjerë të Shqipërisë, të cilët nuk ishin të paktë.

Prifti i tregoi se gjatë kohës sa bisedonte me gjeneralin turk në kasolle, nuk dihet si, përcjellësit e tij i kishin ra në fije plakut, dhe pasi kishin hy në muhabet me të, që dukej fare i rëndomtë, e kishin përvjedhur në anën e qufrinave dhe atje e kishin plaçkitur dhe e kishin therur...

Se e gjitha a ishte bërë në dijeni me gjeneralin, apo ishte vetëm çështje e ndonjë taksirati, që kishte pjellë ashtu rastësisht nga ato të cilat polaku Avramicki do të kishte mundur t'i thoshte në besim dhe pa ndonjë sherr rreth atyre të cilat kishte me vete, kjo as mund të merrej vesh në ato rrethana dhe as çonte kandar. Por, ajo që gjithë çështjes i jepte peshën e dyshimit të një vrasje të bërë me paramendim dhe të paralajmëruar madje, lidhej me njoftimin e dalë aty se te polaku ishte gjetur një si memorandum, ku paraqiteshin projektet bashkë me vizatimet e bankënotës shqiptare, ku në disa syresh jepeshin edhe vlerat e tyre nga një, dy, pesë, dhjetë, pesëdhjetë, njëqind dhe pesëqind, të cilat do t'i nxirrte Banka e

Mbretërisë Shqiptare së shpejti. Bankënota pesëshe, krahas peizazhit të Krujës dhe të Prizrenit, kishte portretin e Skënderbeut, nga një si gravurë e vjetër, e cila ruhej në muzeun e Vjenës. Nga të dhënat, në formë hetimesh të shpejta që Koloneli ia besoi konti Sombah dhe togeri Hafner, dilte se pikërisht memorandumit i bankënotave shqiptare, i hartuar nga çifuti polak, mund të kishte paraqitur shkakun e vdekjes, dhe e gjithë meselja e gjeneralit turk për atë luftën e luftës e cila duhej të bëhej bashkë me dokrrat tjera, që ia kishte paraqitur Koloneli gjatë asaj bisede të mundimshme, mund të kishte qenë vetëm një kurth e hedhur nga kundërshtarët e shtetit shqiptar ndaj simboleve që mund ta bënë atë?...

Madje kishte hamendje se gjenerali i shkallmuar, me ato që thoshte rreth luftës që duhej bërë dhe të tjerat, as kishte ditë për atë çështje, por llaparçitjet për luftën e cila nuk do të bëhej dot, që i nxirrte pareshtur dhe kudo, mund të ishin shfrytëzuar prej atyre, të cilët me çdo kusht e donin këtë vrasje, ta kryenin gjatë atij takimi që një ditë e dinin se gjithsesi se do të bëhej...

Sado që polaku Avramicki asnjëherë nuk e kishte nxënë ngojë punën e bankënotave të shtetit shqiptar, pos kishte thënë se i interesonte hapja e ndonjë banke në Shqipëri për qëllime afariste dhe asgjë tjetër, që nuk kishte pse t'i pengonte kujt, gjetja e memorandumit rreth bankënotave të para të mbretërisë shqiptare, dhe ato që u thanë qoftë edhe si mëdyshje të lira, Kolonelin për herë të parë e bënë të mendonte se mos ajo bredhje e bezdisshme, pa marrë parasysh si do të përfundonte dhe pa marrë parasysh se çfarë qëllimeve të fshehura u shërbente, megjithatë ishte e gjykuar të lente si dëshmi të shkapërderdhura idetë që i takonin domosdosë së bërjes së shtetit shqiptar, të cilat nuk mund t'i zhdukte as vullneti i madh i përçarjes vëllavrasëse, që kishte shpërthyer me aq tërbim në të gjitha anët dhe më shumë se çdo gjë tjetër e rrezikonte atë, dhe nuk mund ta zhdukte asnjë luftë, pa marrë parasysh ato të cilat sjellë?...

Edhe pse në shënimet e lëna në teqenë e Leqes vrasjen e polakut Avramicki Koloneli e kishte shënuar si një atentat kundër idesë së bankënotës shqiptare, pra kundër themelit të shtetit, dhe kishte shtuar se asaj ngjarje herdo-kurdo do t'i kthehej, megjith që kjo nuk kishte ndodhë, mund të merret me mend se ajo kishte luajtur një rëndësi të veçantë tek meditimet e tij të mëvonshme për bërjen e Shqipërisë Shqipëri, të cilat do të pasqyrohen aq fuqishëm në shënimet e kohës së mbylljes në dhomën e madhe të ziqrit të teqesë së Leqes.

...

Takimit me fanatikët e Haxhi Qamilit, i parapriu vrasja prej tyre e sportistit çek Hajek, kur ai i veshur me një kimono sportive po ushtronte, si thoshte për të marrë pjesë në garën e kampionatit të ardhshëm europian të atletikës në Romë pas dy vjetësh, e ku shpresonte se do të ishte sportisti i parë i shtetit shqiptar në një garë ndërkombëtare me gjasa të mira të fitonte edhe medalje. Një hoxhë dhe dy të tjerë, pak pasi ishte dëgjuar ajo krisma atje ku ushtronte sportisti, sollën të mbështjellë me një çevre jeshile trupin e pajetë të tij dhe ia hodhën priftit Gjon Lleshi përpara, pa thënë tjetër pos se sqarimet do të jepeshin pas çindisë kur përfaqësuesit e tyre do të vinin në vizitë si mysafirë dhe u larguan ashtu fare mospërfillshëm si ishin shfaqur duke lënë pas mundimin e një trysnie të rëndë, që spanjollit Rafaelo kishte dashtë ta thyente aty për aty me një kundërpërgjigje zjarri nga bereta e lehtë, të cilën priste me padurim ta përdorte. Po të mos ishte Koloneli dhe konti Sombah që e zuri përdore, me siguri se do t'ia shkrepse hoxhës pa marrë parasysh çfarë do të ndodhte. I dëshpëruar, pse nuk mund ta mbronte as dinjitetin më të thjeshtë, përplasi armën për tokë dhe tha se nuk do ta merrte më...Nuk tha se çfarë do të bënte dhe si do të sillej pa armën që nga Vjena e mbante si diç të hasretit, por la qartë për të kuptuar se veprimet, ku ndonëse luftës i rrihej larg, mund të vdisesh sikur të luftohej, por pa pasur mundësi mbrojtëse, nuk mund të shpjegoheshin ndryshe pos „me qëllime të dyshimta...”

Me fjalët e spanjollit të thëna haptas, sikur ishte pajtuar edhe Koloneli, që si do të shihet nga shënimet e lëna në teqenë e Leqes, thoshte se „ishin pikërisht zvarritjet e tyre

përgjatë linjave të frontit, të cilat shkonin dhe ndiqnin gjithnjë atë hapësirë e vdekjes, që ndonëse kishin hequr të gjitha dyshimet e fillimit se njësi i vullnetarëve nga Europa kishte ardhur për të mbrojtur mbretin, ashtu si silleshin ushtarakët e saj dhe si i rrinin larg luftës, me të drejtë kishin zgjuar dyshimin që mund të shpinte të përfundimi se ishin vetëm agjentë të ndryshëm, që duhej mbajtur në shënjestër...”

Fanatikët e Haxhi Qamilit, të bindur se kishin fituar një hapësirë të duhur e cila u mjaftonte për ta hequr qafesh qeverinë e Durrësit dhe, të prirë që në matjen e pashmangshëm me esadistët, (të cilët tashmë ishin një faktor tjetër force dhe ndonëse të ndarë nga mbreti, ata pretendonin ta trashëgonin legjitimitetin e tij), atyre u duhej kushdo, qofshin ata edhe të tillë që në atë luftë shfaqeshin nga jashtë dhe silleshin si hije, pa qëllime të shpallura dhe pa farë kërkesash, por mund të merreshin me mend se çfarë ishin në të vërtetë ato, vendosën t’u afroreshin, dhe këtë ta bëjnë njëanshëm dhe me aso veprime me të cilat jepej me kuptue se me dobësimin e trupave të qeverisë si dhe humbjen e tyre përfundimtare, të cilën tashmë e shihnin si çështje të kryer, ishin ata që duhej marrë parasysh si faktor i pashmangshëm force, me të cilët duhej biseduar për ardhmërinë e vendit, dhe si thoshin, ajo nuk mund të ishte tjetër pos pjesë e „tepihut të gjelbër islamik“, i cili po thurej „me gjakun e atyre që nuk shihnin rrugë tjetër pos asaj të Allahut...”

Sado që hoxha kishte thënë se do të vinin miqësisht, Koloneli, qysh më parë e kishte të qartë se ku do të rrihej teli dhe kërkoi nga Skulptori dhe konti Sombah, që do ta shoqëronin, të mos shtronin asnjë pyetje, pos të dëgjonin, nga bindja se me të tillët duhej sjellë ashtu që të fshihen këmbët sa më shumë të ishte e mundur...

Megjithatë, ajo krismë e kobshme atë mesditë me diell përcëllues, Kolonelit ia kujtoi takimin e parë me sportistin çek në Vjenë, në prag të nisjes, i cili ishte gjithë shpresa. I kishte thënë se për te shteti shqiptar paraqiste një rast të mrekullueshëm të dëshmohej në një garë të madhe ndërkombëtare, të cilën nga Vjena nuk mund ta arrinte dhe ndonëse nuk e tha haptas, la për të kuptuar se fanatikët e derës së Habsburgëve nuk i shihnin gjitha që me sy të mirë çekët, të cilit kishin synime të ngjiteshin në majat ndërkombëtare. Koloneli nuk kishte folur tjetër pos i kishte uruar suksese dhe e kishte përgëzuar kjo përnjëmend të ndodhte.

“Shqipërisë i duhen të gjithë, që ajo të dëshmohej gjithanshëm”, i kishte thënë Koloneli çekut të hareshëm, gjë që ai i ishte falënderuar dhe i kishte thënë se kyçja në radhën e vullnetarëve i afronte dy mundësi njëherash: shkuarjen në Shqipëri, me të cilën i hapeshin dyert e shpresës së suksesit, dhe ç’ ishte më e rëndësishme për të, ndodhja pranë lufte, por pa prekur armët, i jepte rast të mbante kondicionin, që një atleti të shumëgarëshit i duhej në çdo kohë. Ai vlerësonte se bërja dhe forcimi i shtetit shqiptar përkonte me kalendarin e tij të ushtrimeve dhe të garave si dhe me kohën e mbajtjes së kampionatit europian të atletikës, pas dy vjetësh, por ajo që më së shumti e trimëronte ishte shtetësia shqiptare, e cila i mundësonte paraqitjen më kohë të letrave dhe të tjerave, të cilat shteti shqiptar duhej t’ia kërkonte federatës ndërkombëtare të atletikës për t’ia hapur rrugën pjesëmarrjes në garë. Tha se fjala ishte për cikërrime administrative që nuk i kushtojnë asgjë mbretit, pos ia hapin gjasat e prestigjit ndërkombëtar, ku mund të marrë pjesë në garën finale, që ai ishte i bindur se deri te ajo do të shkonte dhe do ta fitonte madje...

“Aty do të valojë flamuri shqiptar... Vetëm sporti mundëson këso gëzimesh...”

Dhe përnjëmend gjatë atyre njëzet e dy ditëve, sportisti çek thau se ditë për ditë i ishte përmbajtur orarit të ushtrimeve sikur të ndodhej në ndonjë përgatitore me rregulla të forta dhe orar të saktë. Koloneli e kishte parë çekun tek vraponte me përpikëri të madhe që nga mëngjesi deri në mbrëmje, me pushime të shkurtra, të cilat i plotësonte me meditime të përqendruara. Edhe përkundër telasheve si dhe vrasjeve të njëpasnjëshme, që deri më atëherë kishin përfshirë pesë veta, sportisti çek sikur kishte mendjen vetëm te gara dhe ajo dita kur do ta fitonte atë dhe me këtë rast flamuri i mbretërisë shqiptare do të ngrihej solemnisht para mijëra e mijëra shikuesve. Madje edhe dëshpërimin, që ishte i pashmangshëm me rastin e atyre vrasjeve, sportisti çek mendohej ta rrudhte sa më shumë, të mos ia merrte forcën dhe

idealin që kishte, të cilin, në shënimet nga teqeja e Leqes, Koloneli e kishte quajtur „ndër më fisnikët dhe më të sinqertit...”

...

Biseda që atë pasdite ishte zhvilluar me përfaqësuesit e lëvizjes së fanatikëve të Haxhi Qamili, ku kishte qenë një hoxhë, i cili me njëfarë mburrjeje kishte thënë se e kishte të kryer medresën e madhe të Shkupit, dhe dy të tjerë, të paraqitur si „pari e qifllëqeve“, edhe pse për shkak kishte gjoja qartësimin e vrasjes së rastësishme të sportistit çek, që sipas fjalës së hoxhës „kishte ndodhur nga një pakujdesi e shmangshme nga një besimtar, i cili nga namuzi që kishte nuk kishte mundur të duronte sorollatjet e meshkujve gjysmë lakuriq aty ku mund t’i prekte edhe syri i granimit“, ajo megjithatë paraqiste një demonstrim të hapur, me të cilin atyre u bëhej me dije, së pari - se mbreti dhe mbretëria shqiptare, me ata që i shkonin pas, ashtu si e kishin përfytyruar të huajt nuk e kishte të gjatë; dhe së dyti - ishin të ashtuquajturit përfaqësues të çifllëqeve, pra të masave popullore, që udhëhiqeshin nga kleri fanatik islamik, të cilët kërkonin kthimin e Shqipërisë nën kurorën e perandorisë osmane me ligjet e sheriatit dhe të gjitha atyre që u shkonin, dhe se vullneti i tyre, gjithsesi duhej marrë parasysh, veçmas kur kjo mundohej t’i mohohej me çdo kusht, por zhvillimet në vend e kishin bërë të kundërtën dhe kishin qitë në pah fituesit e njëmendët...

Si pritej, takimi kishte filluar me këndimin e disa sureve të „Kuranit“, që hoxha i kishte mbuluar me një zë të kulluar, të cilat Koloneli ia kishin përkujtuar kohën e namazeve kur si fëmijë i përcillte në „Aja Sofinë“ e mrekullueshme, i përhumbur në morinë e atyre të cilët faleshin dhe luteshin. Hoxha i cili kishte njoftime për të dhe të kaluarën e tij si ushtarak i lartë perandorak dhe ato që lidheshin me atë luftën e suksesshme në hapësirat arabe kundër britanikëve, më kot kishte pritur Koloneli t’i bashkohej këndimit të lutjes. Koloneli kishte hetuar se hoxha i kthehej dhe i rikthehej duashë dhe sa herë e bënte këtë sikur hetonte shikimin e tij tek i përplasej qortueshëm. Dhe kur u bind se Koloneli nuk do t’i bashkohej, hoxha i dha fund këndimit dhe të parat fjalë që tha ishin ato se „Allahu do t’i dënojë ata të cilët largohen nga rruga e tij“, gjë që ashtu u hapi udhë kërcënimeve të tjera, të cilat do t’i bëjë haptas dhe fare ne mos përfillje. Pasi foli për kryengritjen dhe luftën e drejtë „të atyre që ishin në udhën e Allahut dhe dëshirojnë përherë të mbesin në të“, nxitoi asaj t’ia vente baraspeshën e të kundërtës, pra të „pjesës tjetër“, që nuk tha xhaurë, si mund të pritej, por la qartë me kuptue se ishte pikërisht ajo e cila ndodhte në atë vend, që ai asnjëherë nuk e quajti Shqipëri, por fushëbetejë „ku luftonin për vdekje e mira me të ligën, insani dhe shejtani“, e ku shtoi se pashmangshëm, „ashtu si kishte ndodhur ç’prej njëmijë e katërqind e tre vjetësh, do të vendosej njëra ndër betejat më të rëndësishme, që njerëzimin do ta kthejë kah rruga e dritës dhe e zotit, pra për t’i dhënë fund të ligës e cila kishte fituar hapësirë nga fuqia e të pafeve “. Hoxha shkoi aq larg sa dikur dukej se po ngatërrohej i tëri me ato që thoshte se aty „nuk do të ishte më lindja perëndim e as perëndimi lindje, por perëndimi do të ishte lindje dhe lindja do të ishte lindje e perëndimit dhe vetëm lindje, ku nata do të ishte ditë e dita nuk do të ishte natë“ dhe tjera e tjera, fjalë këto gjithë trysni, të cilat Koloneli pak nga pak po ia krijonin ndjenjën e turbullimit, e cila po i kthehej në njëfarë ngulfatje...

Dukej se ngjashëm ndjeheshin edhe konti Sombah dhe Skulptori, të cilët rrinin si të ngrirë dhe, nga shkak se nuk kuptonin ato që thoshte hoxha, herë pas herë e vidhnin me sy Kolonelin për të hetuar ndonjë shenjë prej tij. Megjithatë, Koloneli rrinte si i ngrirë dhe lente me kuptue se kishte ndërmend të vazhdonte shirin, pa marrë parasysh sa do të zgjaste ai

Në shënimet e lëna nga koha e mbylljes në teqenë e Leqes, kishte theksuar se trysnia e jashtëzakonshme e cila i kishte ardhur nga hoxha dhe ato që thoshte, mbase e kishte detyruar për herë të parë të kërkonte mbrojtje nga meditimi i thellë shpirtëror bektashian, i ngjashëm me atë të sofizmit, që mund të merrej me mend se më vonë, Koloneli do ta ushtronte shpesh e

më shpesh në atë teqenë e Leqes, ku do të mbyllej përgjithmonë në pritje të vrasjes së paralajmëruar.

Sado që hoxha më në fund, në saje të sehirit të Kolonelit dhe durimit të jashtëzakonshëm të kontit Sombah dhe Skulptorit, ishte detyruar ta pranonte humbjen e parë, megjithatë kishte vazhduar rrugën e nisur, dhe „nga çështjet e Allahut“, kishte dalë te ato “të robit“, që nuk paraqitnin tjetër pos një zhveshje të meditimeve të pakmëparshme, ku ai kishte filluar t’ua hapte „librin e mëkateve“ atyre të cilët shtoi se aty kishin ardhur me qëllime të sprovonin një teatër tragjiko-komik për me vazhdue pastaj shfaqjen e saj edhe në pjesët tjera të perandorisë së madhe përderisa ta përçudnonin botën dhe rregullin e saj të vendosur me aq mund nga ata të cilët ishin në rrugë të drejtë, por trazoheshin nga mësimet e shejtanit dhe prapështitë e tij, që ishin bërë tepër të rrezikshme...

Aty, me emër e mbiemër, hoxha fajësoi „komplotin e fuqive të mëdha“, që i quajti „xhaurrë“, siç fajësoi me emër e mbiemër edhe „xhuxhët vendorë dhe larot tjerë“ dhe gjithë ata, të cilët me dije apo padije, ishin vu në shërbim të atij teatri, ku sprovohej një shtet i cili nuk mund të ishte tjetër pos një kukull qesharake, që nuk mund të pranohej assesi, pos nëse i vihej në tërësi çevreja jeshile, siç e meritonte. Ndonëse nuk tha atë „duam babën“, të cilën klerikët fanatikë e thoshin pareshtur nëpër tubimet e masës dhe nëpër xhami, klithmë kjo që kishte arritur edhe vijat e fronteve dhe me të ngojë ndodhte të vdisej me besimin e patundur se jehona e saj shkon edhe tutje deri në qiell, hoxha u dha shenjë shoqëruesve ta qartësonin „vullnetin e miletit“, për të cilin ata me mburrje thanë „se ishte i paepur, se vdisej me dëshirë“ dhe theksuan „se edhe më tutje do të vdisej deri në frymën e fundit deri sa të bëhej vullneti i Allahut...“

Në ditarin e teqesë së Leqes, fjalët e tyre Koloneli do t’i quajë si „tepër helmuese, me të cilat bëhej përpjekje, që me përhapjen e të ashtuquajturës luftë të shenjtë në atë pjesë të botës, e cila assesi nuk mund të bëhej më pre e perandorisë osmane, të fshihej fryma nacionaliste e xhonturqve, të cilët kërkonin dorën e fortë të udhëheqjes qendrore dhe këtë dëshironin ta bënë me mashtrimin e fanatizmit fetar, të cilit i ishin kthyer aq paskrupullt aty ku ai asnjëherë nuk kishte pasur hapësirë, por përkundrazi, prania e besimeve të ndryshme, kishte dëshmuar bashkëjetesën e tyre edhe atëherë kur kjo dukej fare e vështirë...“

Koloneli po ashtu do të shtojë se „ishte pikërisht toleranca e besimeve dhe ajo etnike që perandorinë e kishte ngritur, e kishte mbajtur në këmbë për aq shekuj dhe e kishte zhvilluar dhe e kishte bërë të fuqishme nga shkaku se popujt, të cilët i kishin takuar, pa marrë parasysh rrethanat që i kishin futur në përbërje të saj (vasalitetet apo pushtimet), kishin parë mundësinë, që mbërthimin e ngushtësisë bizantine dhe përçarjet e kobshme, të cilat kishin ndodhur gjatë viteve të shembjes së saj nga brenda, ta zëvendësonin me një ecje të shlrishme përpara dhe të ngjiteshin deri te majat e saj madje...

“Meqë nuk ishte e mundur që në ato hapësira të ndreqej një perandori, e cila edhe më tutje do të mbështetej mbi mëvetësinë e pjesëve europiane me Shqipërinë si epiqendër të saj...“, dhe këtë e kishte quajtur si një „dështim të madh civilizues“, Koloneli kishte shënuar se „në atë pjesë të botës, ku përherë ishin puqur por edhe tragjikisht ishin fërkuar kufijtë e qytetërimeve, shpëtimin nga ngjalljet dhe ringjalljet e tilla të fanatikëve çfarëdo qofshin ata, që për shekuj kishin skuqur botën me gjak, e mundësonte vetëm bërja e Shqipërisë Shqipëri...“

Por, si doli nga ajo bisedë dhe si ishte parë edhe nga veprimet e lëvizjes së klerikëve fanatikë dhe militantë të Haxhi Qamilit, të cilët udhëhiqeshin nga agjentët e shumtë të xhonturqve, por edhe nga gishtat e fuqive fqinje: Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë si dhe mentorët e tyre në Paris dhe Petersburg, të cilët pamëshirshëm e kishin sakatuar trungun e Shqipërisë, Koloneli e kishte të qartë se aty dhe me atë lëvizje kishte lëshuar rrënjë, si do ta quajë në shënimet e lëna gjatë mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes „exheli i Shqipërisë së qytetëruar dhe i shtetit shqiptar në hapësirat etnike“, por njëherash aty ndodhte „edhe exheli i perandorisë osmane“, ngaqë ajo krijesë, që nuk paraqiste kurrfarë modeli

praktik as për xhonturqit, ishte një karrem i kurdisur nga armiqtë e saj, në radhë të parë serbët dhe grekët, por edhe fuqitë e caktuara europiane, të cilat, ashtu si shfaqej dhe çfarë synonte, kishin duart e lira me e shkatërrue gjithë hapësirën shqiptare, para se ajo të kthehej gjoja në një gogol fundamentalist islamik, si u binin daulleve tmerruese propagandat e shumta, të cilat me këso arsyetimesh kishin për qëllim luftimin e me çdo kusht të shtetit shqiptar...

Këto Koloneli nuk ia tha hoxhës dhe shoqëruesve të tij, të cilët aty ishin për t'ia mbajtur ison atyre që thoshte ai. Me shtrëngimin e tmerrshëm të gjuhës dhe përpjekjet e mëdha të mos pëlçiste, u bëri ballë të gjithave, dhe kur ata nuk kishin çfarë të thoshin më, kur e dinin se duhej dalë aty ku kishin parasysh, dhe me shumë cinizëm, hoxha i propozoi, si ushtarak i lartë perandorak që ishte, si tha, "kishte dëshmuar në fushëbeteje si mund të mbrohet nderi i saj", të merrte përsipër „udhëheqjen ushtarake të asaj luftë për jetë a vdekje në atë hapësirë që edhe më tutje paraqiste nyjën e botës“, Koloneli nxori një buzëqeshje të thartë, të cilën ata e kuptuan si refuzim, me të cilën sikur u vërtetohej ajo që kishin dyshuar se Koloneli ishte një agjent i rrezikshëm i të pafeve, e tjera, e tjera, që do të thoshte se me atë takim mund t'u merrnin fund sorollatjet dhe fillonte një kohë tjetër, ku doemos i ballafaqonte me tërbimin e tyre...

Koloneli i kishte pasur të gjitha të qarta dhe kishte qenë i vetëdijshëm se fanatikët e lëvizjes së Haxhi Qamilit, do ta qëllonin njësoj si kishin vepruar me sportistin e shkretët, pratinëzisht dhe në përputhje me ato që synonin t'i arrinin nga prania e tyre në hapësirën e askujt, e cila së shpejti mund të ngatërrohej fare. Kjo i shqetësoi ushtarakët që kishte me vete, saqë togerët Klain dhe Hafner, pas një bisede me kontin Sombah dhe mendimin e rumunit Skanea, i cili përballë situatave që kërkonin ujdinë e ushtarakëve, përpiquej të trajtohej si „i dërguar i mbretëreshës Karolina të Rumunisë“, (e cila dihej se ishte teze e princ Vedit dhe kësaj ai nuk ishte që ndonjëherë nuk dëshironte t'ia nxirrte yndyrën), kishin kërkuar një takim të ngutshëm për të rishqyrtuar gjendjen para sa të bëhej vonë. Në atë takim, si pritej, pasi kishte dëgjuar me vëmendje togerin gjerman dhe atë austriak, të cilët përpiquehin brengën e shfaqur të mos e shisnin si ujdë të përbashkët, Koloneli, sikur të kishte kaluar gjithë sèkëllidinë që ia kishte lënë takimi me përfaqësuesit e lëvizjes së Haxhi Qamilit, fare qetë kishte pyetur se çfarë mendonin ata se duhej bërë. Togerit Klain, i cili të shumtën belbëzonte, u zu i tëri nga ato që kërkoi Koloneli. Disa herë mbërtheu fytyrën me duar dhe kur u bind se fjalët i kishin mbetur të lidhura, preku togerin Hafner, së paku ai të thoshte atë që atij i kishte mbetur në fytyrë. Dukej se edhe togerit Hafner po i merrej goja, por pas pak ai tha se megjithatë nuk e kishte të qartë se çfarë duhej bërë, nga shkak se me përcaktimin që me ndjekjen e pikave të marshutës së asaj harte, të cilën e kishin nga konti Sombah, ishte anashkaluar lufta dhe kishte sjellë një gjendje e cila i ngjante veprimeve thuajse që u shkojnë misionëve mbikëqyrëse-humanitare, përkundër atyre humbjeve, shtoi se, së paku nga qasja ushtarake, mosveprimi mund të merrej si i dobishëm...

Fjalën „i dobishëm“, togeri gjerman e tha kujdesshëm, që përkujtonte një qasje diplomatike ndaj gjendjes, e cila në ato rrethana sikur i përjashtonte veprimet luftarake, por ashtu si veprohej, pra mosveprimi, sjelljes së tyre i jepte alibinë e mbrojtjes, që do të vlente së paku deri sa të vazhdonte ajo lufta e parregullt ndërshqiptare e secilit kundër secilit, e cila, si thoshte Skulptori, merrte fund çastin kur do të shfaqej ajo lufta e madhe, e cila do ta ndalonte gjakosjen shqiptare dhe do ta shpëtonte Shqipërinë nga katrahura në të cilën sharronte.

Në një fusnotë të vetme, dukej sikur sjellja diplomatike e ushtarakëve, Kolonelit i kishte shërbyer të hidhte shenjën e parë të dyshimit, me të cilën, kur thoshte se „oficerët austriakë dhe gjermanë nuk ishin aty për atë luftën e brendshme shqiptare dhe daljen prej saj, as për ta mbrojtur mbretërinë, që e dinin se nuk e kishte të gjatë, por ishin për atë luftën tjetër, atë të madhen, e cila ishte në prag“, synohej të shpjegohej pse fatkeqësia shqiptare ishte aq e madhe dhe aq e paparashikueshme...

Se mund të ishte pikërisht prania e ushtarakëve austriakë dhe gjermanë dhe përmbajtja e tyre ndaj luftës së brendshme shqiptare alibi e mirë, që kishte bërë armiqhtë kryesor të shtetit shqiptar, esadistë dhe fanatikët islamistë të Haxhi Qamilit, të mos i sulmonin haptas edhe kur kjo dukej fare e pashmangshme, sikur mund të shpjegohej me atë luftën e madhe e cila ishte në prag, ku faktorët vendorë të forcës, të dalë nga përcaktimi fanatik për ta luftuar me çdo kusht dhe me çdo mjet shtetin shqiptar, i cili në ato rrethana shfaqej si bryma para diellit, ishin të vetëdijshëm se në luftën botërore, duhej të rreshtoheshin kah të fortit, kah të mëdhenjtë, pra kah fituesit, andaj përkundër kërcënimeve që ua drejtonin ushtarakëve të huaj dhe forcave ndërkombëtare, pa ngurruar ndonjëherë të ngatërronin armët me ndonjë që nuk u takonte shteteve të mëdha (siç ishte vrasja e kolonelit holandez Tompson nga esadistët), ata shfaqeshin të kujdesshëm edhe ndaj tyre përkundër qëndrimit përkrahës që kishte Vjena dhe Berlini zyrtar ndaj mbretit dhe qeverisë së tij. Kjo rregull, që Kolonelit nuk i pëlqente dhe sikur ia krijonte bindjen se ndodhej në krye të një misioni i cili ishte për t'i baraspeshuar qysh më parë kurdisjet e ardhshme të një lufte tjetër të madhe, të cilat nuk kishte si të mos bëheshin në dëm të Shqipërisë dhe çështjes së saj, megjithatë njësitit të tij do t'i kushtonte edhe me dy vdekje të tjera të ushtarakëve që nuk ishin nga forcat e vendeve të mëdha (Austrië dhe Gjermanisë), dhe kjo u pa më së miri me rastin vrasjeve të njëpasnjëshme të rumunit Skanea dhe të spanjollit Rafaelo, në afërsi të Tiranës.

Rumuni Skanea, si do të merret vesh pas vrasjes së tij, në Shqipëri kishte ardhur si mbikëqyrës i një numri ushtarakësh rumunë, të cilët ndonëse të paraqitur vullnetarë, ata ishin pjesë e njëfarë marrëveshjeje të pashkruar midis mbretit dhe tezës, Karolinës, e cila ndodhej në krye të kurorës mbretërore të Rumanisë ç'prej shtatëmbëdhjetë vjetësh dhe me shumë sukses kishte shtruar rrugën e formimit të shtetit rumun nga autonomia tek pavarësia. Ajo ishte gjermane nga derë princorë e Hohenzollërve dhe kishte si shumë interes për suksesin e të nipit, që njëherash lidhej edhe me interesat rumune në Ballkan, të cilat me siguri se do të forcoheshin me një shtet të pavarur shqiptar në jug të tij, i cili do t'u rrinte si digë sllavëve të jugut dhe prirjeve të tyre gjithnjë e më të mëdha hegjemoniste, të cilat mbështeteshin nga Franca, Rusia dhe Britania e Madhe, por edhe nga Italia dhe Greqia, ku secila në mënyrën e vet vepronte ta pamundësonte shfaqjen dhe forcimin e tij. Por, nga frika që kishte të ndërlikohej haptazi në prapaskenat e këtyre lojërave, të cilat mund të përfundonin në një konflikt të ri ballkanik, i cili me sjelljet e të huajve në Shqipëri dukej si i kurdisur, mbretëresha Karolina, kishte marrë masat e duhura që ndihma ushtarake princ Vidit të ishte sa më e padukshme dhe „nga pjesë të tjera“, por e mjaftueshme t'i ndihmohej të mos shfaqje, ashtu si kërkohej prej atyre që e kishin caktuar, brymë para diellit. Kështu, togeri Skanea, ishte dërguar në Vjenë t'i bashkohej vullnetarëve të skulptorit Vili Garshauer, si „i pavarur“, ndërkohë pjesa tjetër e njësitit ishte nisur me një anije mallrash për në Brindizi, prej nga ia kishte dalë në ujërat e Shqipërisë t'i zbarkojë të tjerët. Meqë togeri Skanea ndodhej në një anë dhe njësitit në tjetrën dhe kishte rrezik të dështonte ndihma mbretit, disa nga agentët rumunë, të cilët në ato anë nuk ishin të paktë, disi ia kishin arritur ta lidhnin njësitin e vullnetarëve me forcat e qeverisë, ndërkohë komandanti i tyre, togeri Skanea kishte mbetur i shkëputur në përbërje të njësitit të vullnetarëve të Vjenës, gjithnjë në pritje të ndonjë udhëzimi me u lidhë me ta, që assesi nuk po i vinte. Dukej se përcaktimi t'i ikej luftës dhe sjellja nëpër atë hapësirën e askujt, që ndante frontet ndërshtetërore, togerin rumun gjithnjë e më shumë e kishte shqetësuar, por nuk kishte guxuar të jepte shenjat e tij nga shkaku se e dinte se aty ishin shumë nga ushtarakët austriakë dhe gjermanë, të cilët po ashtu kishin detyrë të veçanta dhe udhëzimet të hollësishme si duhej sjellë para situatave të cilat nuk u shkonin për shtati, gjë që pak nga pak ai i ishte nënshtruar pritjes së përgjithshme dhe përpiqej këtë me asgjë të mos e kundërshtonte.

Por, me gjasë se kishte qenë ndonjë rast fatkeqësie apo diç tjetër që kishte bërë njëri nga vullnetarët rumunë t'u binte në dorë esadistëve, e ku mund të merret me mend se nga frika apo ndonjë arsye tjetër ai kishte llogotitë diçka rreth togerit Skanea dhe rolit të tij në

Shqipëri dhe pastaj e gjitha u kishte shkuar në vesh italianëve, përkrahësve kryesor të Esad Pashës, të cilët kishin krijuar planin për vrasjen e tij dhe kjo madje ishte dashtë të bëhej pikërisht me kurthin që togerit rumun i ishte vu nga ushtari i tij, i cili u kishte rënë në dorë esadistëve.

Kolonelit i kujtohej dita e tridhjetë e tretë e kalimi nëpër tokën e askujt, kur kishin lënë pas të ashtuquajturën zonë mbrojtëse të Durrësit dhe, duke ndjekur vijat që ndanin frontet midisi kryengritësve dhe trupave të qeverisë, kishin arritur një pikë e cila ndodhej vetëm disa kilometra larg Tiranës, ku thuhej se atje gjendja ishte po ashtu e paqartë ngaqë nuk dihej me tamam se çfarë synonte Ahmet bej Matit, i cili kishte nën armë tre mijë veta dhe ishte deklaruar në mbrojtje të qeverisë së përkohshme dhe mbretit por assesi t'u bashkohej atyre, ndonëse kishte hyrë në Tiranë, ku ishte pritur mirë nga popullata e atyshme, e cila shpresonte se ashtu kishin fituar një mbrojtje nga sulmet e herëpashershme të trupave të Haxhi Qamilit, të cilat kudo që paraqiteshin futnin tmerre, veçmas me paralajmërimet se Shqipërisë do t'i vihej „një çevre jeshile“, ndër „më të pastrat“ që ishte parë ndonjëherë...

Dita ishte në të sosur kur, te rrëpira e parë ku parashihej bujtja, studenti Zenel Xhema, që rëndom ecte përpara dhe përpiquej të bënte punën e pararojave, kishte sjellë me veti një të panjohur, të shkallmuar fare, që mund të merrej me mend se ishte i huaj, i cili kushedi si kishte mbetur aty. Koloneli e shikoi me vëmendje të plagosurin dhe kishte parandjenjën se ai nuk ishte për të mirë, ngaqë andej kah silleshin mund të takoheshin të vrarët, mund të takoheshin kërmat e tyre bashkë me ato të kafshëve të mbuluara nga orlët, por assesi të plagosurit dhe ata që kërkonin ndihmë çfarëdo qoftë nga shkaku se asnjëra palë nuk i pranonte ata, që do të thotë, se i zëni rob apo i plagosuri, vritej pa çarë kush kokën për të dhe ky veprim madje merrej si fare i natyrshëm... Kështu, gjatë atyre tridhjetë e tri ditëve, ata kishin takuar mbi shtatëdhjetë viktima të pavarrosura, pjesërisht të masakruara dhe po mos të ishin jevgjit e Kavajës, të cilëve u ishin dhënë dy mushkat që kishin, shumë prej tyre do të mbeteshin të pavarrosur. Meqë në atë vend edhe përjashtimi paraqiste rregull, Koloneli i kishte thënë priftit Gjon Lleshi të përkujdeseshin për të plagosurin për aq sa kishte mundësi por pa e marrë në pyetje, dhe pa ra terri ta përcillnin për anën, që do ta zgjedhte. Mbasi i ishte dhënë ndihma dhe i ishte bërë me dije se duhej të largohej, i huaji pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja, ishte nisur, por në atë ecje shalakatëse vazhdimisht kishte kthyer kokën pas sa një çast ishte rrëzuar, gjë që kishte bërë togerin Skanea të nxitonte t'i jepte ndihmë. Kishte thënë se do ta përcillte deri te vija e fundi, prej nga ati i mbetej të largohej.

Në atë zabullimë akujt nuk i kishte shkuar mendja të merrej me të huajin. Kishin hapë çadrat dhe me të shpejtë i ishin dhënë gjumit. Vetëm telegrafistit Bruner, i cili përpiquej të ndreqte njërin nga aparatet e shenjave skaj një druri, i kishte rënë në sy vonesa e togerit rumun dhe, pasi kishte hedhur shikimin andej kah tashmë ishte terr, kishte pyetur priftin Gjon Lleshi se çfarë kishte ndodhur me togerin që nuk po kthehej. Në e parë dhe nga lodhja priftit nuk i kishin bërë aq përshtypje ato që prej tij kishte kërkuar telegrafisti Bruner dhe vetëm pas një kthjellimi, kur kishte hetuar se ai nuk ndodhej, iu kishte afruar studentit Zenel Xhema dhe kishte kërkuar ta shoqëronte andej kah kishte shkuar togeri rumun. Pas pak ata kishin sjellë trupin e pajetë të togerit Skanea, të therur me thikë mu në qafë dhe nga ajo prerje thuajse i ishte shkëputur koka nga trupi.

Me dukjen e atij që e brente ndërgjegjja, Koloneli urdhëroi ta varrosnin po atë natë togerin Skanea. Në shënimet e mëvonshme të lëna në teqenë e Leqes, ngjarjen e kishte përshkruar si tumirje të asaj që lidhej me dyshimin „se ajo që ndodhte ishte pjesë e një paraluftë të papastër, ku mjerisht edhe ashtu kërkoheshin aleancat e ardhshme, të cilat ndonëse i thyenin të gjitha rregullat, kryesisht bëheshin në dëm të shqiptarëve të shkretë...“

...

Ngjashëm kishte ndodhur edhe me spanjollin Rafaelo, një ushtarak nga Granada, i përmbajtur por edhe i prirë me këngë dhe solo vallëzime të thyente heshtjen që i mbërthente gjithnjë e më shumë, që si duket e kishte pagur me kokë vetëm pse kryenëvete kishte filluar të hetonte vrasjen e kolonelit Tompson, e bërë ditë më parë, kur ata ndodheshin në atë bredhjen e tyre midis linjave të frontit që ndanin trupat kryengritëse dhe ato qeveritare, të cilat thuajse ngatërronin istikamet e tyre sa ndonjëherë të mos dihej me tamam se kush kujt ia kthente pushkën dhe kush çka mbronte. Madje, konti Sombah kishte thënë si me shpoti se i dukej se në ato pjesë qëlllohej fare pa cak dhe ndodhte që njerëzit vriteshin me njëri-tjetrin pse nuk dinin shtrirjen e frontit dhe as anët që u takonin.

Në ato rrethana, në të cilat më së miri pasqyrohej tragjedia shqiptare dhe përmasat e saj tejet të kobshme, spanjolli Rafaelo, sikur ia kishte dalë t'u afrohej luftimeve që ndodhnin te ura, e cila lidhte pjesën veriore me rrugën e ngushtë që kalonte për në Tiranë, dhe sapo kishin plasur krismat e para dhe ishte thënë se me to ishte qëlluar koloneli Tompson, i cili sillej andej për të mbikëqyrur hapësirën dhe jo të merrte pjesë në luftime, ai kishte pasur bindjen se Tompsoni nuk ishte qëlluar nga pjesa e kryengritësve, edhe pse ata ishin në pjesën ballore dhe mund ta qëllonin, por plumbi duhej t'i kishte ardhur nga ana e kundërt, pra nga pjesa e vet?... Me disa vija që kishte bërë dhe pareshtur i kishte shikuar atë ditë dhe të nesërmen, spanjolli gjithnjë e më shumë fitonte bindjen se Tompsoni nuk ishte qëlluar nga kryengritësit. Këtë ia bënte me dije secilit dhe kërkonte që kjo të shihej sa më mirë.

“Kjo është një vrasje e dyshimtë.”

Koloneli as që kishte treguar ndonjë interesim për hetimet e spanjollit dhe ato të cilat i thoshte me aq përkushtim ngaqë kishte bindjen se në atë luftë gjithçka, pos luftës së ndershme, ishte e mundur dhe e lejueshme, gjë që as ajo vrasje nuk kishte arsye të bënte përjashtim. Megjithatë, nga një parandjenjë jo e mirë, kishte dashtë me ia ba me dije spanjollit të mos lodhej aq me gjërat që mund ta ngarkonin kot dhe mund t'i kushtonin, por nuk ia kishte thënë ngaqë e dinte se marrja me të mund t'i shërbente së paku t'i bënte ballë bezdisë, që kapte me të drejtë ata të cilët aty ishin jashtë përbërjes së lojërave dhe prapaskenave të tjera.

Me të gdhirë të asaj dite, që e merrte me mend se nuk do të ishte tjetër nga paraprakja, pra se edhe më tutje do të zvarriteshin atyre vijave të ngatërruara të luftës, ku, së paku në pjesët e skajshme të tyre të mbushura me vullnetarë të thjeshtë dhe pa kurrfarë njohurish ushtarake, por që lenin përshtypjen se dikush i kishte shtyrë detyrimisht në atë luftë, dhe në atë hallakamë edhe mund ta pësonin ashtu kot së koti nga frika apo mosnjohja e ndokujt me kundërshtarët, kur po merrej me përfitim të asaj bezdie e cila sikur i bëhej se nuk do të kishte të sosur, Kolonelin e kishin njoftuar se spanjolli ishte gjetur i vlarë skaj drurit ku ai deri vonë ishte marrë me ato hulumtimet rreth vrasjes së Tompsonit dhe aty ishte kotur sa e kishte zënë gjumi.

Skulptori dhe telegrafisti Bruner, të cilët kryenevete kishin marrë hetimet e para, ia kishin thënë shkurt e trup se vrasja ishte bërë nga brenda dhe me këtë përjashtojë çfarëdo dyshimi që mund të dilte se ajo të lidhej me vijat e frontit të cilat i kishin shumë afër. Koloneli nuk kishte denjuar t'i ndiqte arsyetimet dhe hollësitë tjera rreth vrasjes së qëllimshme që ishte munduar t'ia shtronte aq zellshëm telegrafisti Bruner me të cilat duhej të tumirej dyshimi se vrasja ishte bërë nga brenda, ngaqë e kishte më se të qartë se ajo njëmend ishte vrasje e brendshme, që sforcohej edhe më tepër me atë që spanjollit nuk i ish gjetur letrat me të cilat ai gjatë gjithë asaj kohe kishte marrë në shqyrtim vrasjen e kolonelit holandez. Urdhëroi të mblidhej njësi dhe pasi një copë herë i pa të rreshtuar tek prisnin kërkoi nga prifti Gjon Lleshi ta sillnin trupin e pajetë të spanjollit Rafaelo ta vendoste para tyre ashtu të përgjakur deri sa të kryheshin ceremonialet e varrimit.

Në atë ndërkohë sa prifti Gjon Lleshi bashkë me telegrafistin Bruner dhe studentin Zenel Xhema përgatiten varrimin, zuri me sy të gjithë me radhë dhe thuajse qortueshëm i mati me shikim, me ç'rast qëllimisht u ndal te oficerët austriakë dhe gjermanë, që pas vrasjes

së rumunit Skanea, tashmë ishin të vetmit aty. Koloneli një copë herë vazhdoi t'i mbante në shënjestër dhe këtë e bëri aq haptas dhe ashpërsisht sa dikur ata, sikur të pranonin fajësimin me të cilën ngarkoheshin, zunë t'i ulnin sytë sipër kufomës që u rrinte para. Kjo i mjaftoi Kolonelit t'ua bënte me dije se autorët e vrasjes së spanjollit Rafaelo ishin aty midis tyre dhe ai shprehej ashtu nga shkakut se nuk e kishte ndërmend të ndërronte sjelljen përderisa ata të mbeteshin në hapësirën e mbyllur të prapaskenave, që një ditë doemos se do të merrte fund, sapo të bëhej pjesë e atij kobi të përgjithshëm, të cilit nuk mund t'i shpëtonte askush...

Kur e varrosën spanjollin Rafaelo, Koloneli u përmbajt nga çfarëdo bisede, madje edhe me Skulptorin me të cilin në raste të tilla ndërronte ndonjë fjalë për ta darovitur ngulfatjen dhe këtë e bëri nga frika se ashtu do ta humbte durimin dhe mund të thoshte edhe ato që nuk duhej thënë. Kishte bindjen e plotë se ndjekja që i bëhej pikave të hartës së sjellë nga konti Sombah shpjegonte shumëçka nga ato të cilat lidheshin me atë luftë që tashmë kishte kaluar në bezdi dhe tjetrën, e cila do të bëhej, andaj atë rrugë duhej ndjekur deri në fund dhe me shtrëngimin e dhëmbëve për t'u parë të gjithat, ku gjithnjë e më shumë i krijohej bindja se aty gjendej edhe çelësi i asaj që Skulptori e quante luftë të madhe, që mbase për pak botën mund ta lironte nga luftërat e vogla dhe fare të papastra, si ishte ajo e cila bëhej në Shqipëri, por do të niseshin të tjerat, të cilat nuk do t'i hiqen qafësh përderisa të vazhdohej që prishje-ndreqjet e mëdha të bëheshin në kurrizin e të vegjëlve...

Në shënimet e teqesë së Leqes, megjithatë Koloneli do të shkruajë se „vrasja e spanjollit Rafaelo ia kishte bërë me dije se luftës së papastër mund t'i iknin të gjithë pa përjashtim pos atyre që kishin ardhur me sineritet ta mbronin shtetin e sapo pranuar shqiptar dhe mbretin, të cilët do ta pësonin pa përjashtim, por në mënyra të ndryshme...“ „gjë që, si do të shihet kur do të marrë fund marshuta dhe do të rifillojë e njëjta në pritje të asaj luftës së madhe, kjo i kishte shërbyer të menduarit rreth atij fundit të domosdoshëm, që e quante rifillim dhe ribërje e herë rizgjim dhe rinisje të pasosshëm, si një gjendjeje shpirtërore të veçantë, së cilës sikur i ishte nënshtruar dhe e priste duarhapur si pjesë të atij gjykimi të pashmangshëm, i cili nuk do të shkonte huq, ngaqë ishte i lidhur me bërjen e Shqipërisë Shqipëri...

III

Duket se edhe takimi i parë dhe i fundit me kosovarët, i bërë ditën e dyzet e dytë të asaj bredhjeje diku në pjesën e skajshme që takonte hapësirën e Lezhës me atë të Matit si dhe vrasja e studentit Zenel Xhema, që pasoi po atë mbrëmje, Kolonelin e thyen aq sa vendimi i tij të mos takohej me askënd, pa marrë parasysh rëndësinë, kishte qenë pjesë e të menduarit fatalist se aty vetëm vdekja kishte pushtet të plotë, se vetëm ajo ishte reale dhe meqë ishte kështu, atëherë duhej bërë që nënshtrimi asaj të merrej si çështje e një ribërjeje apo rikthimi, që në shënimet gjatë mbylljes njëzet e pesë ditësh në dhomën e madhe në teqenë e Leqes, do ta quajë „ringjallje të domosdoshme për bërjen e Shqipërisë Shqipëri...“

Gjatë atyre dymbëdhjetë ditëve të tjera, të cilat si rëndom ishin shfrytëzuar për të ndjekur bezdisshëm përmbushjen e pikave të hartës së paraqitur nga konti Sombah në atë anijen që i kishte bartur nga Triestja për në bregdetin shqiptar, telegrafisti Bruner kishte shënuar edhe tri kërkesa për takime me Kolonelin, të cilat ai dikur i quante të rëndësishme dhe të mirëseardhura, veçmas atë me mis Dyrhamin - humaniste dhe publiciste e njohur britanike, e cila e njihte mirë Shqipërinë dhe njerëzit e saj por edhe pjesët tjera të Ballkanit. Nuk kishte pranuar ta takonte as poeteshën dhe mjeken bavarase, baroneshën Amalia Gadina, që ndodhej ç'prej kohësh në Shqipëri edhe pse një herë kishte thënë se me dëshirë dhe kudo do ta takonte atë zonjë fisnike punën e së cilës e nderonte shumë, sidomos për angazhimin e saj në shtypin gjerman, e cila me shkrime të njëpasnjëshme dhe shumë tronditëse, ishte ndër të parat që kishte njoftuar për krimet serbe dhe malazeze të cilat bëheshin ndaj popullatës shqiptare dhe

kishte ngritur zërin kundër shtirjes ndërkombëtare që miratonte këtë vrasje të madhe sy botës, ndër më të mëdhatë që ishte parë ndonjëherë kohëve të fundit.

Po me arsyetimin se për të nuk vlente më asgjë çfarë ndodhte jashtë atyre vijave të vdekjes, ku ditëve të fundit gjithnjë e më shumë thoshte sikur i kishin fat, por këtë fat doemos duhej shfrytëzuar për të kundërtën, që njëherë e përgjithmonë ta lirojnë Shqipërinë nga ngulfatja dhe gjykimi i vrasjes, që i ishte bërë, Koloneli kishte refuzuar edhe një gazetar të mirënjohur britanik, me të cilin ishte takuar dy herë sa ndodhej në Berlin si konsull ushtarak i perandorisë osmane, të cilit atëherë i kishte thënë se i kishte dyert e hapura përherë për çfarëdo bisedash dhe takimesh pa marrë parasysh rrethanat.

“Tash e tutje më interesojnë vetëm të vdekurit e gjallë dhe jo të gjallët e vdekur“, i kishte thënë telegrafistit Bruner, që ai e kishte marrë si shenjë të depresionit, të cilat kishte bindjen se gjithnjë e më shumë i hetonte te Koloneli.

Sidoqoftë dhe pa marrë parasysh zhvillimet që do t'i shërbejnë këtij qëndrimi, Koloneli kishte pritë me një shqetësim të madh takimin me kosovarët, për të cilët thoshte se „ishin të vetmit të cilët në atë hapësirë tragjike të rrethit shqiptar luftonin me mish e me shpirt të mbrohej dhe të shpëtohej qeveria e përkohshme bashkë me mbretin...“ Thoshte se kosovarët ishin të vetmit, që në atë pështjellim të pafund u rrinin frikshëm larg prapaskenave dhe të tjerave të cilat ndodhnin aq haptas dhe bëheshin aq pa marifet për t'u dëshmuar anësia e mbrapshtë, sa ajo kishte filluar t'u hakmerrej dhe t'u kthehej në kob madje, që Kolonelin e tmerronte dhe e bënte t'i bashkohej mendimit të Skulptorit se lufta e madhe botërore, në mos për tjetër, duhej të fillonte sa më shpejt për t'i shpëtuar kosovarët e shkretë nga mbërthimi i hurdhës dhe çekanit, ku në njërin anë u vinte nga gjenocidi i hapur serb dhe malazias, i cili ndaj tyre, në pjesët e pushtuara dhe sy botës ushtrohej i papenguar, dhe në tjetrën anë, u vinte nga inatet dhe grindjet e brendshëm shqiptare, të cilat kishin shpërthyer aq furishëm në vend pas shpalljes së shtetit të brishtë shqiptar dhe kishin marrë përmasat e një vëllavrasjeje të pamëshirshme, e cila, për fat të keq, bëhej herë nën trumbetimin e thirrjeve „në mbrojtje të mbretit“ dhe „kundër mbretit“, herë “për kryqin dhe kundër kryqit“, e herë „për ose kundër babasë“ e çfarëdo tjetër, ku në mënyrën më të paskrupullt pasqyroheshin dhe mplekësishin të gjitha prapaskenat dhe komplotet kundër bërjes së Shqipërisë Shqipëri, në të cilat keqas ishin ngatërruar si shumë vetë shqiptarët, të rreshtuar andej-këndeje në përputhje me lojërat që i dëshironin dhe i kurdisnin kundërshtarët dhe armiqtë e Shqipërisë, dhe me gjakosjen e brendshme, e cila ua rrëronte qenien dhe gjithë atë që deri me dje kishte shërbyer si nxitje për pavarësi, u shërbenin atyre mrekullisht.

Nga njoftimet që merrte gjatë sorollatjes midis vijave të frontit, ku pasqyrohej gjithë shëmtimi i asaj lufte vëllavrasëse ndër më të pashembulltat dhe më të ulëtat deri atëherë në botën shqiptare, Koloneli kishte pasur kohë me bollëk të përcillte zhvillimet të cilat çonin te ajo greminë dhe njëherash të mendonte rreth nyjës së atyre ndërskambësave si dhe të tjerat që ato i ushqenin dhe i vënin në lëvizje. Kështu, ai kishte parë se kosovarët ishin të vetmit që dëshironin një luftë pa hile dhe ishin të gatshëm për te të vdisnin, por kjo nuk u mundësohej si duhej, ose u pamundësohej me kurthe të ndryshme dhe të përhershme, të cilat u vinin si nga të ashtuquajturit përkrahës të shtetit shqiptarë, ku bënin pjesë të gjitha lëvizjet e ndryshme dhe grupimet që atë çështje madhore pastaj në përputhje me atë që prisnin nga kulaçi i saj, e copëzonin në përcaktime që lidheshin herë me mbretin, herë me mbretërinë, herë me emrin e atij apo këtij „patrioti“ të shpikur, por për të qenë e keqja edhe më e madhe kjo u pamundësohej edhe nga vetë sjellja e qeverisë së përkohshme, e cila në tërësi mbikëqyrej dhe drejtohej nga përfaqësuesit e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, të cilët ishin të njëmendje vetëm kur atij duhej t'i bëheshin pengesa të mos merrte veten dot. Në pjesën e dytë të shënimeve, të shkruara në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, dhe përballë rrethanave të një mbylljeje të plotë, pra kur ai ishte i shkëputur nga bota dhe kur priste vrasjen e paralajmëruar, ndonëse me shtrëngime të qarta halucinative, kësaj çështje Koloneli do t'i kushtojë vëmendje të madhe, dhe si mund të shihet nga një theksim, ai kishte bindjen „se

ndërkombëtarët, të cilët mbikëqyrin qeverinë e përkohshme, mund të tolerojnë çdo gjë, pos patriotizmin e sinqertë të kosovarëve, që shfaqen si mbrojtësit e vetëm dhe të fundit të shtetit shqiptar dhe me sinqeritetin më të madh janë në gjendje të vdisnin për të pa shtruar kurrfarë kërkesash rreth çmimit që duhej paguar...”

...

Çështjen e mbrojtësve të fundit të shtetit shqiptar nga kosovarët Koloneli e kishte quajtur „edhe kob të Shqipërisë por edhe kob të tyre njëherash“, vlerësim ky, që më sa duket, më vonë do të përqafohej edhe nga të tjerët, veçmas nga e fejuara Helenore von Braun, e cila sa ishin në Berlin kishte mendim tjetër, kur fatkeqësinë e Kosovës në prag dhe pas shpalljes së pavarësisë, madje e merrte si një shtytje të fuqishme e cila do t’i bashkonte shqiptarët ku ishin dhe ku nuk ishin për t’u bërë një dhe të mbështetur edhe për atë gjysmë shteti që kishte dalë, do ta bënin të tërin, ngaqë nuk kishin rrugë tjetër...Ajo shkonte aq larg sa mbetjen e përkohshme të Kosovës dhe viseve të tjera etnike shqiptare nën serbët dhe malaziasit, përkundër të gjitha të këqijave që sillte dhe do të sillte, e shikonte si „shpëtim të vetëm të Shqipërisë...“, si njëfarë „fati në fatkeqësi“.

E frymëzuar por edhe e tronditur nga shënimet e Kolonelit, të cilat i kishin rënë në dorë dymbëdhjetë vjet pasi kishte mbaruar lufta botërore dhe kjo kishte ndodhur në sajë të përkushtimit të madh të telegrafistit Bruner t’i ruante dhe t’i nxirrte prej andej dhe në sajë të përkujdesjes së mëvonshme të Skulptorit t’i plotësonte edhe me pjesët tjera, ndonëse përballë një gjendjeje shëndetësore me çrregullime të shpeshta psikike, që i kishte lënë internimi francez, Helenore von Braun ia kishte dalë në gazetën e saj të dikurshme „Die Presse“, emri i së cilës nga lexuesit e vëmendshëm edhe më tutje kujtohej me respekt, të botonte një shënim rreth kësaj çështjeje, që ishte ndër të parët e llojit të vet pas atyre viteve „të paanësisë së detyrueshme“, me të cilën politika por edhe mediet austriake obligoheshin të mos përsëritnin „huqet e kohës perandorake“, që thuhej se kishin nxitur tragjedinë e parë botërore. Në titullin „Kosova peng i Shqipërisë?“ redaktorja e dikurshme e gazetës më të rëndësishme vieneze dhe gjermanofolëse në përgjithësi, jo vetëm shtronte këtë dilemë, por atë e zgjeronte me vlerësimet tjera se gjithë ajo që kishte ndodhur në prag të luftërave ballkanike, ku kishte nxënë ngojë prapaskenat e diplomacisë franceze-ruse dhe të asaj të politikës së xhonturqve, dhe ato të cilat kishin ndodhur pastaj nga korifeu diplomatik i Europës në prag të luftës së parë botërore, kur nën pretekstet e demonstrimit të „harmonisë“ së fuqive të mëdha europiane në Shqipëri, ishte pranuar krijimi i fakteve të kryera me dhunë nga ana e armatave serbe, malaziasë dhe asaj greke ndaj etnisë shqiptare, pra të gjitha këto i kishte quajtur „përpyetje të gjithëmbarshme ndërkombëtare për t’u ndarë Kosova nga Shqipëria, të dytën me radhë gjatë atij çerek shekulli“, që zbërthyer me gjuhën politike do të thotë ujdë për shuarjen me dhunë të çështjes shqiptare në Ballkan, si një rës ndër kryesoret, ku ajo shprehte bindjen se „pa trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të saj, nuk mund të ketë paqe në kontinentin e vjetër dhe as ardhmëri të asaj hapësire.“

Duke vlerësuar se me ato që kishin ndodhur në Versajë edhe më tutje vazhdohej „komploti ndërkombëtar kundër shqiptarëve dhe Shqipërisë“, e fejuara e Kolonelit, do të tërheq vërejtjen dhe do të bëjë me dije „se gabohen ata që mendojnë se për hir të mbijetimit të Shqipërisë si shtet i përgjysmuar dhe pa aftësi të duhura jetësore, siç ishte pranuar, njëherë e përgjithmonë hiqet nga rendi i ditës çështja e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të mbetura nën Beogradin...“

“Logjika shtetërore dhe interesi i saj nuk do t’i qetësojë asnjëherë shqiptarët për ta pranuar realitetin e kufirit që ndan etninë e tyre...Kosovarët nuk do të pajtohen kurrë me ndarjen, pa marrë parasysh se çfarë çmimi do t’i paguajnë, ngaqë për ta bashkimi do të thotë mbijetim...Atyre nuk u mbetet tjetër rrugë...”

Helenore von Braun shkrimin e kishte mbyllur me vërejtjen „se është hipokrizi e tmerrshme shqiptarëve t’u thuhet: nëse e doni Shqipërinë harroni Kosovën! Apo, kosovarëve t’u thuhet se përcaktimi i tyre për t’u bashkuar me Shqipërinë e rrënon atë...”

...

Thuaje njëjtë me Helenore von Braun kishte menduar edhe Brahim Avdyli, i cili i kishte prirë grupit të kosovarëve prej pesë vetave në takim me Kolonelin atë mëngjesin e ditës së dyzet e dytë të bredhjeve të tyre nëpër vijat që ndanin frontet shqiptare i bërë diku në pjesën ku lidhej Lezha me Matin, takim ky i mbajtur në saje të ndërmjetësimit të studentit Zenel Xhema.

“Ne jemi të detyruem me dekë për Shqipni...Nuk kemi se kah ja mbajmë...”

Kështu kishte folur me një zë të prajshëm Brahim Avdyli, një mesoburrë nga Dushkaja e Gjakovës, që thoshte se fliste në emër të të gjithëve që vdekja i përcillte në çdo hap ç’prej më shumë se një viti e gjysmë, si të atyre që kishin gjetur strehim në Shqipëri, si edhe të tjerëve, të cilët ndodheshin nën terrorin e tmerrshëm të serbëve dhe të malaziasve, që pandalshëm dhe me ashpërsi të paparë ushtrohet prej tyre me qëllim ta lëshonin vatanin.

Ç’është më keq, ai i kishte thënë se për ta zezona bëhej edhe më e madhe nga shkaku i përçarjeve shqiptare për bajraktarllëk dhe interesa të ngushta, që tha se nuk mund të kuptoheshin kur gjysma e kombit gjakosej pa ia da.

“Kjo luftë po na mbyl ma shumë se plagët e shkaut...”

Në vazhdim Brahim Avdyli kishte folur dhe kishte bërë me dije se kur po shihet se Shqipëria gjendet para zhbërjes dhe kjo mund të ndodhë së shpejti, të gjitha shpresat i kishin varë jashtë, pra te ngatërrimi i Serbisë me Austrinë dhe të tjerët përreth, që ishte i mundshëm nga shkaku se Beogradi nuk do të ngihej vetëm me marrjen e tokave shqiptare, por do të kërkonte edhe të tjera, që mbase ashtu i mbesin në fyt...

„Vetëm lufta e madhe na shpëton... Ah, lufta e madhe!”

Tek po fliste për luftën e mundshme, si shpresëdhënëse dhe kur po mundohej të shpjegonte se mbase ajo do t’i mbushte mend shqiptarët rreth çështjes së përbashkët dhe nevojës të luftojnë njësoj për të dhe pa hile, Koloneli i dukej se përpara kishte Skulptorin, i cili mundohej t’ia mbushte mendjen se ajo lufta e madhe do t’i shpëtonte shqiptarët, luftë që ai thoshte duhet lutur të vinte sa më shpejt...

Por, për ndryshim prej Skulptorit, që çështjet i shihte me mjaft shpresë, Brahim Avdyli fliste mundimshëm, sikur të nxirrte copa të mëdha akulli dhe ato që thoshte për shpëtimin dhe shpresën, përcilleshin me hijen e dyshimit të thellë, që shkonte deri te dëshpërimi...

“Stuhia po na rrah nga të gjitha anët dhe nuk e dimë se kush na i hap plagët ma shumë...”

Por, si një shqetësim i përhershëm, Koloneli do t’i mbetën edhe ato që do t’ia thotë Gjon Selmani, kur iu kishte drejtuar me atë „zotni i besës“, që e kishte plotësuar me pandehmën se këtë duhej doemos ta dinte, ngaqë familja e tij bashkë me vëllazërinë e gjerë, që kapte katundet përtej Erenikut (nga Smaçi e deri te Kusari dhe shkonin kah Pashtriku), shtriheshin në pronat „me besë“ të familjes Dreni, të lënë nën mbikëqyrje para tridhjetë e gjashtë vjetësh, me ç’rast ata ishin zotue se ato do t’i mbanin nën betimin e saj...

Fjalët rreth „tokës me besë“, të thëna me një tundim të thellë, të cilat studenti Zenel Xhema po ia përkthente me disa sqarime plotësuese nga droja se nuk i kuptonte, Koloneli po i sillleshin vrullshëm nëpër kokë, siç i ishin vërtitur sa herë kishte dëgjuar të flitej rreth asaj besës dhe fatkeqësive që sjellë ajo pikërisht nga shkaku i përmbushjes së saj, e cila njësoj qëllon edhe në të kundërtën.

Meqë në familjen e tij çështja e besës rendonte përherë me hijen e kobit, ajo qëllimisht ishte anashkaluar sa më shumë që kishte qenë e mundur, por pa u përjashtuar. Kështu i ati, disa herë, si shkarazi e kishte prekur dhe këtë e kishte bërë vetëm në çastet e ndonjë kthese të rëndësishme, (me rastin e shkuarjes për studime në Gjermani si dhe të

emërimi për komandant të zonës ushtarake të Halepit), dhe ndonëse të gjithën e kishte rrudhur të shfaqja e asaj pashmangshmërie që e kishte quajtur „kësmet“, megjithatë me këtë përkufizim sikur kishte pasur për qëllim t’ia bënte me dije se disa gjërave nuk mund t’u iket, pa marrë parasysh si dhe sa u rrihet larg, se vetë kujtimi i tyre, sado i largët qoftë, paraqet shqetësim dhe ndjekje...

Në frymën e asaj droje, shumë vjet më vonë, i kishte folë edhe e fejuara Helenore von Braun kur kishte theksuar se „janë disa çështje që të kthejnë në peng...“

Koloneli kishte dëgjuar me vëmendje fjalët e Norës dhe ato që thoshte, ku jo rrallë, shpjegimi i një norme morale bartej të çështjet e hapura filozofike dhe civilizuese madje, që deshtë a pa deshtë, atë përkufizimin e „kësmetit“ dhe të tjerave, të cilat ia kishte ngulitur i ati, e bartnin tutje, të një rrafshi i gjerë me shumë e shumë të panjohura dhe çështje të hapura, të cilat përnjëmend kërkonin edhe thellime etno-kulturore dhe sociologjike, të cilat një oficeri të lartë, i dhënë pas doktrinave të luftërave dhe gjithë atyre që i shkojnë strategjive ushtarake, i sjellin më shumë ngatërrim se sa qartësim.

Por, Nora, në kërkim të thellimit të tezës së doktoraturës rreth zhvillimeve etno-sociale në Ballkan dhe pasojave të tyre të mundshme pas vendimeve të marra në Kongresin e Berlinit, me theks të veçantë të problematika shqiptare, e më vonë edhe Skulptori, i cili, si thoshte, normën e hakmarrjes e shihte si njëfarë „mbetje të trashëgimisë së ritualit mesjetar të dyluftimit të fisnikëve“, gjithnjë e më shpesh e kthenin te ajo dhe ia kërkonin mendimin, sado që e dinin se ai nuk ishte i lidhur gjithaq me të.

Koloneli zihej ngushtë kur i thoshte se nuk dinte shumë nga hakmarrja dhe „ceremoniali i saj“, pos që njohte normën „gjaku paguhet me gjak“, e cila përherë i kishte tingëlluar frikshëm dhe assesi si „ritual mesjetar i dyluftimit“, si e merrte Skulptori, të cilën e shikonte të tejkaluar dhe të tepërt në rrethanat e vendosjes së pushtetit të ligjit. Por, Nora ndërhynte me vërejtjet se „ishte pikërisht ajo rregull së cilës duhej përmbajtur deri në hollësi si dhe pasojat, që janë të pashmangshme, të cilat po ashtu i nënshtrohen rregullativës së ndëshkimit individual apo të përgjithshëm, të cilat kishin krijuar atë sjelljen e veçantë shoqërore të vetmen si të mundshme për ato rrethana, që del nga baraspesha e ndërsjellë e frikës“, e cila mund të merret si një aspekt i rëndësishëm i saj. Çështjet e hakmarrjes si dhe tjerat, të cilat thoshte se i njohte nga leximet e herë pas hershme që ua kishte bërë teksteve të studiuesve të huaj, Nora i merrte si kode të kësaj kushtetute, të cilat sanksionojnë ligjësinë morale, të cilën ajo e vlerësonte si shprehje të një vetëqeverisjeje të mbyllur me vlera, por nëse nuk u iket, kur t’u pushojë koha dhe rrethanat që i kanë vendosur e mbajtur në fuqi, kthehen në bumerang, sado që disa „çështje nuk mund të kalohen çap-rrap“ nga shkaku se „hija e tyre përcjell...“

Sidoqoftë, ato që Gjon Selmani ia kishte thënë gjithë dëshpërim shkallues „e kemi thye besën, zotni pse nuk kemi mujtë me i mbrojtë nga shkaku tokat që i kishim me besë“, dhe ajo „asht dashtë me dekë për to, zotni, por nuk dinim qysh...“ Kolonelit do t’i mbesin jehonë e një ngacmimi të përhershëm, që do t’i silltet si pjesë e asaj hamendjeje të pasosshme dhe të pakapërcyeshme, që sa më shumë preket, sa më shumë hapet, sa më shumë zgjerohet, sikur të kthen te një pyll që bëhet gjithnjë e më i pakalueshëm nga shkaku i dendësisë, por edhe nga shkaku i kthimit në peng të asaj, që Nora ia thoshte, se të ndjek edhe po t’i rrihet larg.

Si do të shihet nga ato njëzet e dy shënimet e kohës së mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, çështja e besës si dhe përcaktimi i saj i hapur do të vazhdojnë ta ndjekin shkapërderdhshëm Kolonelin, ku ajo do t’i shfaqet herë si *betim*, që assesi dhe me asgjë nuk thyhet, pa marrë parasysh ato që sjell, por do t’i dalë edhe si *besë-besë*, apo *besë e madhe*, të cilën Deli Braha do t’ia lidhë me detyrimin „me dekë për Shqipninë“, që në ditët e fundit të rropatjeve të pafunda me vdekjen, të cilën e shihte gjithnjë e më pranë, gjithnjë e më shumë i shkonte mendja se mbase ajo mund ta kishte penguar bërjen e Shqipërisë Shqipëri dhe ato që lidheshin me fatkeqësinë e tyre dhe tjera e tjera hamendje, ku ndonjëherë, me atë përkufizimin e „kësmetit“ madje duket sikur pranohej ana e saj fatale, dhe kështu mund të

merrej,po mos të ishte ai theksimi, si lajtmotiv, se „vetëm bërja e Shqipërisë Shqipëri liron nga mallkimi i fajeve që ndjekin“,që gjendet i veçuar te „shënimet përmbyllëse“,si fusnotë, bashkë me fjalët e Gjon Simonit se „vetëm kthimi i vatanit shpëton shpirtin...”

...

Po si të shpëtohej nga mallkimi i fajeve kur Shqipëria nuk po bëhej dhe si mund të kthehej vatani jashtë hapësirës së saj në ato çaste të rënda kur së pari ajo të rrosh apo mos të rrosh shkonte nëpër tehun e shpatës dhe shtrohej si çështje e çështjeve,e cila lidhej me mbijetimin më të thjeshtë?...

Brahim Avdyli i thoshte se „jemi të detyruem me dekë për Shqipëri“, ndërsa Gjon Selmani fliste „për shpëtimin e shpirtit me anën e kthimit të vatanit“, që në ato rrethana tepër tragjike nëpër të cilat kalonin kosovarët,ktheheshin në thirrjen klithmë: „kthim me çdo kusht në vatan...“,që doemos kushtëzonte atë mbijetimin e domosdoshëm, pa të cilin nuk kishte jetë e as të menduar për bërjen e Shqipërisë...

Dhe përballë këtyre rrethanave shfaqej dilema tmerrësisht tragjike:Shqipëri,apo vatan?... Bota sikur thoshte të dyja nuk bën... Ngutuni, merrni njërën, se mund të mbeten pa të dyja!...

Edhe po t’i ktheheshe njërës, ishin inatet shqiptare që këtë e pamundësonin. Lufta me njëri tjetrin dhe kundër njëri tjetrit, e cila kishte shpërthyer dhe assesi të ndalej, sikur nuk u lejonte kurrfarë zgjedhje dhe kjo Kolonelit ia fikte atë dritën, të cilën megjithatë mendohej ta shihte diku te fundi, te ai fundi si gjykim, që ai do ta kërkojë me çdo kusht dhe do ta quajë „pjesë të kobit të përgjithshëm“, të cilit nuk mund t’i iket,pos që lejohet zvarritja.

“Na ka mbetë vetëm ymydi te bota dhe zoti“, i tha Brahim Avdyli.

Kjo shpresë shkallmuese si shfrim i rëndë, Kolonelin e rëndoi nga brenda sa nuk u shemb, ndërkohë që ata po e shikonin, sikur të kërkonin doemos t’u thoshte diçka që do t’ua hiqte atë gurin sa bjeshka i cili u rrinte në qafë dhe kjo fliste për atë gjendjen tepër të rëndë dhe të pashpresë në të cilën ndodheshin, që pak më vonë Skulptorit do t’ia pranonte se i përngjante „kapjes për kashtë...”

Ndoshta po mos të ishin veprimet e të tretit, Deli Brahës, që vinte nga Juniku i Dukagjinit dhe gjithë shkallmim tha se ishte pjesëmarrës i tubimit te Verrat e Llukës, me ç’rast ai nga një strajcë e lëkurës nxori një grumbull letrash dhe ia la përpara të shoqëruara me fjalët „asht edhe një besë tjetër që asht dhanë për Shqipërinë“, me siguri se Koloneli do t’ua pranonte dështimin, të cilin nuk kishte si ta shprehte ndryshe pos „ç’e do, po shkojmë drejt një rrënimi...“, që tashmë e lidhte me gjendjen e tij në krye te asaj bredhjeje, së cilës përditë e më shumë i çirreshin maskat, të cilën priftit Gjon Lleshi ia kishte pranuar haptas „si fund i një loje të kobshme, që gjithsesi se duhej ndjekur deri te fundi...”

Koloneli sikur u këndell trandshëm. Pa fytyrën e përsququr të atij që i tha ato e cila sikur po i kthehej në një hije të frikshme. Prapë besa?...Sikur jemi kurthuar për të dhe assesi t’i ikim, u mat të thoshte, por hetoi se kjo do ta kthente te ato që dikur ia kishte thënë i ati rreth kësmetit si fatalitet, që për herë të parë ndjeu se nuk duhej të pranohej.

„Kjo asht besa e besëve“, foli prapë Deli Braha.“Tutje saj nuk shkohet...”

Studenti Zenel Xhema deshi shkaras me ia ba me dije se ç’ishte tubimi i Verrave të Llukës dhe çfarë do të thoshte „besa e besëve“, e cila ishte dhënë atje midis krerëve të lëvizjes për pavarësi, por Koloneli i dha shenjë t’i lente për më vonë,jo pse nuk dëshironte të dinte diçka më shumë rreth asaj që lidhej me letrat të cilat i kishte përpara dhe thuhej se në to ishte edhe „një besë e besëve“, apo „besë e madhe“, e dhënë për Shqipërinë, por pse u druante atyre që mund ta shpërqendronin hapjen e çështjes, e cila po e kthente kah një ndijim i veçantë, të cilin më vonë do ta quajë „kurth të kobëve të pashmangshme...”

Pasi u ngritën dhe thanë se ishte koha të ktheheshin, dhe pasi thanë se nuk e dinin se çfarë do të pjellë e nesërmja, Brahim Avdyli i tha se letrat i kishte amanet.

„Janë disa gjana që duhet me i ditë bota, por ma parë edhe shqiptarët... Nëse robi nuk i sheh, atëherë toka e zezë din me i ruejtë dhe një ditë i nxjerr...”

...

A thua vallë kishte edhe të panjohura të tjera që duhej t'i dinte bota dhe vetë shqiptarët, të cilat në ato çaste nxirrnin kosovarët aq dëshpërueshëm?

Kjo hamendje po i vërtitej furishëm kokës së Kolonelit kur i tha studentit Zenel Xhema t'i merrte letrat që kishin lënë kosovarët dhe t'ua hidhte një sy para se ta njoftonte hollësisht rreth tyre, dhe ajo hamendje, nga përfytyrimi i tmerreve të cilat po i përvijoheshin furishëm e nuk mund t'i largonte, sikur vinte e rëndonte dhe e rëndonte sa i bëhej se po e fuste të gjallë në dhe... Dikur e gjitha i ishte kthyer në një ajgëtim kah një lëmsh i pafund, në të cilin kurthohej e kurthohej bashkë me të tjerët që i shkonin pas dhe në atë kurthim e sipër, nga bindja se ata që kishte pas ashtu mund të mëshiroheshin, sikur qartësonin qëllimet e tyre të njëmenda, të cilat lidheshin me prapaskena të ndryshme, që shkonin deri te vrasjet, të cilat kishin ndodhur gjatë asaj sjelljes nëpër hapësirën e vdekshme, e cila ndante frontet shqiptare...

Koloneli kishte përshtypjen e çuditshme se kjo po e lironte paksa nga mbërthimi i valavamës pa dava dhe me dëshirë do të mbetej në mbërthimin e asaj gjendjeje, po mos të shihte priftin Gjon Lleshi të trishtuar fare, që po i rrinte përpara, me letrat e përgjakura, të cilat ia kishin lënë kosovarët amanet.

Të tjerat as që deshi t'i dëgjonte. Zuri sytë me duar dhe tha ta lenin të qetë deri sa të vinte koha e varrimit. Në të vërtetë, Koloneli për herë të parë mendohej të mbrohej me anën e vetmisë së thellë e fare shurdhe, ku përjashtohej realiteti dhe gjithë ato që i shkonin atij kobi të pasosshëm. Në atë përvijim të trisht, Koloneli kishte parë studentin Zenel Xhema me letrat në duar, të cilat ia kishin lënë kosovarët amanet, tek kërkonte një rrugë që ato disi të ndriçoheshin, të shpalohehin dhe të lexoheshin e të rilexoheshin vazhdimisht... Letrat ishin si të përflakura dhe ngado që hapeshin shkreptinin zjarre të vogla... Kjo sikur i pëlqente studentit Zenel Xhema, i cili kërkonte një zjarr edhe më të madh, një zjarr që nuk do të kishte të ndalur...

Me përfitim të zjarrit në kokë nëpër të cilin kalonte studenti Zenel Xhema bashkë me ato letrat dhe i shoqëruar me ankthe të pandalshme, kaloi deri sa erdhën dhe ia bënë me dije se kishte ardhur koha e varrimit.

Doli si i thyer dhe rrezet e dobëta të diellit që i ranë në sy sikur ia krijuan bindjen se edhe më tutje po ndiqte atë zjarrin e pakmëparshëm nëpër të cilin kishte kaluar studenti Zenel Xhema, e ku kishte mbetur, gjithnjë duke u çirrë se një zjarr të tillë meritonte bota e cila sillej ashtu...

Kur preku tokën e thatë dhe ndjeu kundërmimin që vinte prej saj, pa një varr të hapur dhe ata që rrinin pranë tij me koka të ulura, të cilët iu duken si vrasës...

...

Studentin Zenel Xhema e kishte njohtë nga ditët e Vjenës dhe e dinte se prejardhjen e kishte nga pjesët e Shalës së Bajgorës, por familja e tij ishte shpërngulur nga andej qysh nga zhvendosja me dhunë e popullsisë shqiptare nga Kurshumlia dhe Prokupa, e bërë në dimrin e vitit 1877 nga ushtria serbe prej nga pastaj një pjesë e tyre, në kërkim të bukës së gojës dhe mbijetimit çfarëdo qoftë, kishin marrë rrugën e Sanxhakut, dhe i ati, i cili një kohë kishte punuar si furrtar në Sarajevë e pastaj në Mostar e Grac dhe me punën e bërë err e terr kishte marrë disi veten, e kishte dërguar të studionte në Vjenë, me shpresën se i biri, një ditë, kur të bëhej zot i vetes, dhe me shpresën se ashtu do të të ngjitej sa më lartë në shkallët e pushtetit perandorak, do t'ia dilte të tregonte për ato që u kishin ndodhur viteve të fundit dhe madje të

vihej në mbrojtje të përpjekjeve për bërjen e Shqipërisë shtet, që të tjerëve të mos u përsëritet tragjedia e Kurshumlisë.

Skulptori ia kishte paraqitur si „djalosh të paepur“ dhe i kishte thënë se „është në gjendje të vdesë një mijë herë për Shqipërinë...”

Ai kishte buzëqeshur dhe i kishte thënë se „më me dëshirë pëlqente me jetue për Shqipërinë, me e shijue dhe me e gëzue...”

Ia kishte bërë me dije se vdekjen, ndonëse ishte e pakapërcyeshme, asnjëherë nuk e vente para jetës. Përkundrazi, i kishte thënë se ata që flasin për vdekjen dhe betohen në vdekjen u mungon fryma e jetës, ose kanë aq frikë prej vdekjes sa mundohen ta anashkalojnë me betimin e saj, që për të ishte e njëjta...

Kolonelit i kishte pëlqyer gjykimi i studentit Zenel Xhema, i cili i kishte thënë se përkundër atyre që u kishin ndodhur dhe u ndodhnin, e donte jetën, se shkonte në Shqipëri me luftue për jetën, se shpresonte se ka me qenë jeta ajo që ka me fitue dhe me e ba Shqipërinë Shqipëri dhe jo vdekja, e cila mund ta zhbënte atë. Kolonelit i kujtohej se njohja dhe takimet me studentin Zenel Xhema e kishte ballafaquar me një realitet, që në shënimet e veta e kishte quajtur „rinjohje me vetveten“, që e kishte kthyer hap pas hapi kah një shpalim i domosdoshëm i asaj mbetje diku në një mjegullim, që në çastet e fundit, do të pranojë se „ia kishte mundësuar të sillej në përputhje me atë që ishte pjesë e atij fundi të pashmangshëm, të cilin duhej marrë si të tillë, por edhe si diç që i shërben ringjalljes së domosdoshme, rikthimit dhe gjithë asaj që i duhet bërjes së Shqipërisë Shqipëri...”

Megjithatë, kur e varrosën studentin Zenel Xhema, të marrë nga plumbi, i ardhur prej andej kah gjendeshin forcat e Haxhi Qamilit çastin kur po përshëndetej nga kosovarët me të cilët kishin biseduar, ndonëse i qëlluar për vdekje, Kolonelit edhe më tutje po i përvijoheshin në kokë përpjekjet e jashtëzakonshme të cilat ai kishte bërë në atë gjendje të pashpresë me mundimet e fundit të largohej nga pjesa ku mund t’ia mernin letrat. E kishte marrë me mend se ç’vrull i mundimshëm e kishte përfshirë trupin që po i jepej vdekjes për t’i mbrojtur fletët e lëna amanet dhe po ashtu kishte marrë me mend se me çfarë lehtësimi dhe me çfarë kënaqësie kishte lëshuar frymën e fundit kur kishte parë priftin Gjon Lleshi t’i afrohej dhe t’i ndihmonte të nxirrej prej andej...

...

Ajo vrasje, që nuk do t’i hiqej nga mendja dhe do ta përcjell si ngulfatje deri në frymën e fundit, Kolonelit përfundimisht do t’ia krijojë bindjen se vdekja aty gjente gjithë ata, të cilët luftonin për jetën e Shqipërisë, dhe këtë dëshironin ta pasqyronin me idetë e ndryshme të bërjes së saj, që mbeteshin të pa përkrahura, ndërsa jeta mbështeste ata të cilët vrisnin kundër Shqipërisë dhe vrisnin Shqipërinë, të cilët ishin të shumtë, ishin të pandalshëm dhe ishin të palodhshëm.

Asaj përshtypjeje, për pak i qe bashkuar edhe Skulptori. Mbrëmjen që e varrosën studentin Zenel Xhema Skulptori ishte sjellë si i pa kokë. Herë qante, herë dëneste, herë çirrej herë qeshej sa lente përshtypjen e një të shthururi shpirtëror, që Kolonelit ia kishte futur druajtjen se te ai po shfaqeshin shenjat e një shkallimi të pandreqshëm.

„Sikur do të mbetemi përgjithmonë në këtë pellg të sëmurë?...“, kishte folur përçarë Skulptori. „Kush do ta thoshte këtë?...Kush?...“

„Këtu ka vdekje, që megjithatë duhet parë dhe përgatitur për to...“, ia kishte kthyer Koloneli, duke ia bërë me dije ndryshimin midis atyre gjendjeve.

Përmendja e vdekjes si dhe përgatitja për to kishte trandë Skulptorin sa dukej se aty për aty ia ndryshoi gjendjen me ato që tha se asaj megjithatë duhej ikur doemos...

Koloneli nuk ia kishte kthyer, nga frika se mund të fillonte t’i fliste për atë luftën e madhe botërore, që thoshte se do të bëhej së shpejti, e cila do ta shpëtonte Shqipërinë dhe gjithë botën nga luftërat e vogla dhe sherret tjera, të cilat në ato rrethana, po t’i dëgjonte t’i përsëriteshin, do ta tmerronin nga shkaku se atij tashmë i ishte mbyllë horizonti dhe nuk

paraqiste më kurrfarë rëndësie çfarë do të ndodhte dhe çfarë sillte ajo ndodhje kur i dihej fundi...

Ndonëse ishte më se e qartë se ajo lufta botërore, apo lufta e madhe që i thoshte Skulptori, tashmë ishte në nisje dhe pashmangshëm vinte dhe si ushtarak e dinte se shumëçka ndryshonte, Koloneli ndonjëherë kishte bindjen se andejpari ajo nuk do të ndryshonte gjë prej gjëje, ngaqë prishjet që kishin ndodhur, ia kishin hapur rrugën atij shkatërrimi të përgjithshëm, që nuk lente pa i çuar gjërat deri te fundi, te ai fundi si gjykim, të cilin, megjithatë, si do të shihet nga shënimet e lëna në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, e merrte të domosdoshëm madje të pashmangshëm për të ndodhur rinjohja dhe rikthimi, të cilit gjatë mbylljes në pritje të vrasjes, gjithnjë e më shumë i ishte dhënë dhe e merrte si domosdo te rifillimit.

“Ajo luftë sikur do të jetë pa fund dhe përherë me fitil të ndezur...“,deshi të thoshte, por heshti, ngaqë së voni kishte bindjen se ajo dhe vetëm ajo i mbetej fija e vetme e shpresës, që ishte në gjendje prishjet e nisura t’i çonte te ai fundi pa të cilin nuk kishte fillim, të cilin ai e lidhte me bërjen e Shqipërisë Shqipëri...

...

Heshtja dhe mbyllja e përcolli Kolonelin edhe gjatë atyre dymbëdhjetë ditëve tjera, me të cilat përmbylej koha e përmbushjes së pikave të hartës të parashtruar nga konti Sombah ditën që do të bëhej zbarkimi në Shqipëri dhe ishte pranuar njëzëri prej të gjithëve pa i bërë farë vërejtjesh dhe pa kërkuar farë hollësisht lidhur me to dhe natyrën e tyre. Përballë atij shkallmimi që ia pasqyronte më tepër qëndrimi se sa dukja, Koloneli sikur të vetmen prehje gjente te harta, të cilën e mbante në dorë dhe shpresonte se pikat e shënuara në të, që tashmë ishin në sosje, mund t’i jepnin fund një gjendjeje të paqartë, si ishte ajo nëpër të cilën kishin kaluar, për t’u futur në një tjetër, ku lufta e brendshme shqiptare mund të bartej në atë vorbullën e luftës së madhe, që së paku aty, gjakderdhja e kotë të kthehej në qëllim të caktuar...

Por edhe ai përftim i bëftë shprese i treste përballë realitetit tepër të rëndë shqiptar, ku vijat e deridjeshme të fronteve, ndonëse nuk paraqitnin më ndeshje të kryengritësve më trupat e qeverisë, ato shfaqnin një ngatërrim tjetër të pafund midis formacioneve të ndryshme vendore, të cilat jo vetëm përjashtonin njëra tjetrën, por kundërshtoheshin dhe luftoheshin mes veti nga kërkesa mishmashe ku kush kërkonte babën, kush ndonjë bajrak me ndonjë emër që nuk ishte dëgjuar kund, por kishte edhe aso të cilët haptas kërkonin shtetin grek, kërkonin Italinë e madje kishte ndonjë që kërkonte edhe Serbinë dhe djallin madje, me arsyetimin se ashtu krijohet rregulli i domosdoshëm i cili aty kaherë ishte rrënuar dhe kishte humbur...

Dukej se në hapësirën e lëmshit tragjik-komik shqiptar, ku edhe katundi më i lënë qëllonte të shpallej shtet dhe shteti bëhej pikë e pesë prej kujtdo dhe kurdo, ku secili kaçak apo vjedhës mund të vetëkurorëzohej mbret dhe çmos si t’i tekej, pra në atë hallakamë të pashembullt, Koloneli dhe ata që i shkonin pas, jo vetëm që ndjeheshin të lirë, por përballë ngatërimit shqiptar, që sa vinte e shtoej, thuajse shfaqeshin autoritet i vetëm, i cili në njëfarë mënyre pranohej prej të gjithëve pa përjashtim dhe kjo ndodhte nga shkaku se si ushtarak të huaj, prapa kishin shtete, që ndonëse kishin bërë pikë e pesë Shqipërinë dhe e kishin shkelë për vdekje, ata mund t’u shiteshin apo t’u viheshin në shërbim, gjë që papritmas e shtyri të merrte vendim të ngrehte flamurin e bardhë, i cili do t’u printe gjatë gjithë kohës, me çka dëshirohej atij mashtrimi të mjerë disi t’i mbyllej udha.

„Duhet të dihet se nuk jemi të luftës e as për luftë...“,foli prajshëm Koloneli, por gjithë nënçmim, sikur të nxirrte nga brenda diç që e kishte munduar gjatë dhe me atë qitje bënte një shpagim.

Togeri von Hase dhe rreshteri Klajn thanë se flamuri i bardhë i kthente në të dorëzuar, pra në aso që kishin kapitulluar, që ndonëse nuk i përshtatej gjendjes në të cilën ndodheshin, megjithatë dorëzimi do të thoshte se duhej gjetur dike, pra një palë ushtarake, që si fitues i

shpallur i merrte nën mbikëqyrje dhe mbrojtje madje sipas marrëveshjeve të parapara, nuk i përgjigjej të vërtetës, ngaqë ata aty, pos kishin ndjekur hapësirën e ndarjes midis fronteve, as ishin përfshirë në luftime, e as kishin bërë ndonjë veprim tjetër, përveç vëzhgimeve fare të qeta, të kryera thuajse pa ndonjë qëllim.

„Tek e fundit, këtu nuk ka fitues“, foli rreshteri Klajn, për të arsyetuar qëndrimin kundër flamurit të bardhë, të cilin e merrte për fryrje.

„Por, ka vetëm humbës...“, ia ktheu Koloneli.

Togeri von Hase vuri buzën në gaz dhe sikur ndjeu se me ato që tha Koloneli, mbase edhe pa e gjykuar si mirë, merreshin në mbrojtje ato të cilat u thanë rreth paanësisë së tyre, që paraqiste gjënë më të dobishme në ato rrethana kur çfarëdo veprimi, karshi mosveprimit, do të ishte i gabueshëm.

„Megjithatë, është keq që nuk ka fitues...“, foli Koloneli me një hezitim, që i hetohej te ngjyra e zërit.

„Kjo nuk do të ndryshonte fare gjendjen“, ia ktheu rreshteri Klajn me shpresën se bisedën do ta shpinte kah synohej, pra te ngatërrimi i mundshëm i Kolonelit me çështjen.

Por, Koloneli nuk ngau kalin e tyre ngaqë e dinte se ashtu atij i hiqej freni para kohe. Mendjen e kishte te dita me të cilën përfundonte ndjekja e marshutës, që mendonte, se për t'i dhënë fund asaj gjendje e cila i dukej gjithnjë e më e padurueshme, nuk i mbetej tjetër pos ta shpallte vendimin për shpërndarjen e njësitit dhe, po që se kjo për ndonjë arsye të pakuptueshme nga ndokush, nuk do të pranohej, atëherë duhej të vendoste për hapat e vet, që ende nuk i kishte të qartë se çfarë mund të ishin, dhe shpresonte se, po që nevoja, gjatë atyre ditëve do t'i përcaktonte. E vetmja gjë që ishte i sigurt dhe nuk ndryshonte, kishte të bënte me vendimin se nuk do të largohej nga Shqipëria pa marrë parasysh se çfarë do të ndodhte...

“Këtu njëherë e përgjithmonë sos rruga ime...“, kishte shkruar në shënimet e lëna në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes.

Këtë ia kishte thënë edhe Skulptorit atë mbrëmjen që do të përshëndeteshin para se ai të merrte rrugën e kthimit me i përgjigjur thirrjes së përgjithshme të monarkisë me iu bashkue luftës së madhe, e cila ishte shpallur tri ditë pas vrasjes së princ Ferdinandit në Sarajevë nga nacionalistët serbë, të cilët kërkonin krijimin e Serbisë së madhe, që pas pushtimit të Kosovës dhe të Maqedonisë dhe tumirjes së Konferencës së Londrës e shihnin si çështje të kryer, që pse jo, duhej përfunduar sa më parë...

IV

Shfaqja e flamuri të bardhë sikur ua krijoi përshtypjen se u kishte humbur rëndësia që kishin dhe sa ora i kishte kthyer në aso të cilët kërkojnë mëshirë dhe, kjo sikur i pëlqeu Kolonelit, që ndonëse ato dymbëdhjetë ditë do t'i quajë „të tepërta“ dhe „tmerrësisht të kota“, i kishin shërbyer të fillonte një shqyrtim të thellë me vetveten, që mund të bëhej vetëm brenda atyre rrethanave, që do t'i cilësojë „të mjera“ dhe „për lot“, të cilat „i shkojnë një fundi të tillë të parashikuar dhe të pashmangshëm...“

Në atë ngarendje të bezdisshme nëpër atë ambient të gërmuqur shëmtueshëm, që do të mund të bëhej brenda një dite, ku vijat e frontit gjithnjë e më shumë shfaqeshin fare të paqarta dhe me ngatërime të tilla sa të mos dihej se kush çka donte, ku nuk shihej se kush çka zotëronte dhe nuk dihej se kush çfarë mbronte, ku kishte gjithfarë flamujsh, pos atij të shtetit të pavarur shqiptar, (shfaqja e rastësishme e të cilit sigurisht se do t'ua kthente sa ora shpirtin atyre që luftonin kundër njëri tjetrit), pra në atë gjendje shkalluese kishte menduar për *përmasat e ngritjes dhe të rënies* dhe për ato të cilat çojnë deri te futja në rrathët tragjik prej nga nuk mund të delet, si ishte ajo në të cilën ndodhej...

“Ishim edhe pjesë e ngritjeve të mëdha, që nuk kishin të ndalur, ndërkohë u bëmë pre e kafshimeve të ulëta“, do të thotë Koloneli në shënimet e kohës së mbylljes në dhomën e

madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, i bindur se jeta dhe vdekja e tij (me vdekje ai e quante gjendjen e pashpresë ku ndodhej, që shpinte kah fundi i pashmangshëm, pa marrë parasysh sa zgjatë, së cilës, si gjykim, i ishte paraparë ajo vrasja fizike, e cila do të bëhej për ta rikthyer pastaj te ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri), pra të dyja këto gjendje ishin me i tregue si të mundshme edhe ato zhvillime dhe kthesa që duken të pamundshme, kur thoshte se „gdhiet në një maje dhe perëndohet në ndonjë bllaqë të tmerrshme...”

Si do të shihet më vonë, në kuadër të këtyre meditimeve përgjithësuese, që lidhen edhe me atë gjendjen e veçantë, *gdhirjen në maje* Koloneli do ta përcaktonte si ngritje brenda hapësirave të mëdha, të cilat nuk mund të jenë të tjera pos perandorake, ku vullneti për fuqi kthehet në një shtysë të përhershme nxitëse, ndërsa *perëndimin në bllaqë*, do ta krahasojë me rënien e tmerrshme, të cilën ndonjëherë do ta quajë prirje të pandalshme për *vetëhkatërrim* apo për *vetëngrënie*, që si e tillë shihet e mundshme vetëm në rrethanat si ishin ato shqiptare, ku hapësira e saj, që dikur paraqiste një rën ndërkohë pikat e skajshme të perandorisë më të fuqishme të kohës me atë puqjen e besimeve, megjithatë shënonte pikëpjekjen apo edhe ngatërrimin e dy boteve, të dy qytetërimeve, të cilat kishin ushqyer mentalitetet dhe bindjet e kundërta, të cilat ishin kthyer në grindje dhe fatkeqësi të përsëritshme sa herë kishte ndodhur që t'u dobësohej apo t'u hiqej mbikëqyrja perandorake, e cila kishte qenë përfytyrim i ardhmërisë së hapur...

Dhe për t'u takuar ky ngatërrim apo për t'u parë fatkeqësia që ngarkonte çdo gjë, këtu nuk ishte e domosdoshme të shfletohet historia. Gjendjen e tillë Koloneli e shihte, por edhe e përjetonte, ç'prejse i kishte shkelur këmba në këtë vend, të cilit i kishte rënë fati t'i hetonte, t'i përjetonte, por edhe t'i thyheshin për kurrizi këto dridhje të mëdha, që i ishin kthyer dhe rikthyer në kobe nga shkak i asaj prirjeje të çuditshme të mos pranohet gjendja e kundërshtimive si diçka e pashmangshme, por e gjitha të kthehet në një përpjekje pajtuese të të kundërtave, ku frymonin edhe bindjet e ndryshme, ku pa u grindur dhe gjakosur për jetë a vdekje, bashkëjetonin edhe oltarët e zotave të ndryshëm si diçka e rëndomtë, që lidhej me lashtësinë e njerëzimit...

Nëpër atë zvarritje të pafund „nga njëra anë në tjetrën“, të cilën do ta quajë „labirint të kobit“, ku dukej se ishte ndalur edhe koha, Koloneli, mendohej të mbrohej pikërisht me shqyrtimin e përmasave të atyre thyerjeve të pandalshme, ku gjendjet ndryshoheshin skajshmërisht e bashkë me to edhe rrethanat, të cilat ia përkujtonin fatalitetin e pashmangshëm, që ai do ta krahasojë me përsëritjen e të njëjtës.

Mbase kjo kishte bërë që Koloneli, të nesërmen e varrosjes së studentit Zenel Xhema, kur në ndjekje të përmbushjes së shenjave të hartës së sjellë nga konti Sombah, t'i thoshte priftit Gjon Lleshi se „po shkonin drejt një vdekjeje të paralajmëruar“, që sipas tij „ishte e domosdoshme për me u lirue nga e keqja e madhe me fillue ajo ringjallja e pandalshme...“, së cilës në shënimet e shkruara gjatë mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, do t'i kushtojë vëmendje të veçantë dhe do ta quajë „rikthim apo ribërje e domosdoshme e Shqipërisë për t'u dëshmuar bashkëjetesa e të kundërtave dhe afria e dallimeve si sistem i pashmangshëm i vlerave qytetëruese, që jo rastësisht kishte ndodhur aty ku besimet e ndryshme ishin pranuar dhe pranoheshin si pjesë e besimit të përgjithshëm që përjashtonte ndasitë...”

Ndonëse fjalën „pastrim“ nuk e kishte përmendur dhe, mbase këtë e kishte bërë qëllimisht, që çështjet t'i nxirrte nga shpjegimet që dëlnin nga librat e shenjta, kjo i kishte mjaftuar priftit Gjon Lleshi trajtimet t'i kthente aty ku tashmë ato ishin të vendosura, pra te „lirimi nga mëkatet“, që lidheshin me zanafillën dhe nuk bënte të zhvendoseshin, pa marrë parasysh rrethanat tragjike nëpër të cilat kalohej. Ishte e qartë se prifti dëshironte t'i ndante çështjet e shpirtit me ato të cilat i takojnë përditshmërisë, qoftë që kërkon qasje të veçantë, siç ishte ajo nëpër të cilën kalonin.

„Një ditë do të pastrohemi të gjithë dhe kjo paraqet shpresën më të madhe“, i kishte thënë priftit Gjon Lleshi.

„Një ditë do të sharrojmë të gjithë dhe kjo paraqet dënimin e përgjithshëm, si ndëshkim ndaj nënshtërimit të ligës“, ia kishte kthyer Koloneli, me një zë të marrur, që lente me kuptue se nuk kishte vullnet të kapej me ato të cilat përherë përsëriteshin e përsëriteshin, që paralajmëronin e paralajmëronin shpresën dhe shpërblimin që i bëhej bindjes dhe përlësisë, ndërkohë gjërat nuk ndryshonin, pos ndiqnin rrjedhën e njëjtë, pra përsëriteshin dhe përsëriteshin bashkë me kobët dhe fatkeqësitë, të cilat nuk kishin të ndalur.

Kjo megjithatë nuk e kishte lënë të qetë priftin Gjon Lleshi, që si i kujtohej telegrafistit Bruner, i cili nga afër kishte përcjellë me vëmendje gjithë bisedën e zhvilluar midis tyre në gjuhën gjermane dhe kjo ishte bërë nga shkak se Koloneli i cili mezi lidhte ndonjë fjali të përbërë në shqipe, por edhe prifti, që studimet kishtare i kishte kryer në Austri, mbase padiktueshëm kishin ndjerë nevojë t'u qaseshin meditimeve të thella për t'i ikur sado pak asaj gjendjeje, e cila i ngarkonte njësoj dhe nuk kishte si të mos përjetoheshin njëjtë, edhe pse ndryshe-ndryshe shpjegoheshin.

„Nuk duhet humbur shpresa“, kishte folur prifti Gjon Lleshi, që shihej se edhe në ato rrethana tepër tragjike nuk dëshironte të shkiste nga mësimet e librave të shenjta ngaqë kishte bindjen e thellë se në ato rrethana ato ishin të vetmet që mund t'i ndihmonin përmbajtësimit nga vetëshkatërrimi i tmerrshëm.

„Nuk duhet pranuar mashtrimi“, ia kishte kthyer Koloneli, që sipas telegrafistit Bruner, përkujtimin e shpresës nga ana e priftit e kishte marrë si një shkas të mirë bisedën ta kthente tek çështjet që kapeshin me realitetin e hidhur shqiptar në të cilin ndodheshin, ku Koloneli denjoi vlerësimit të pakëmaparshëm rreth shkuarjes drejt „vdekjes së paralajmëruar“, t'ia shtonte arsyetimin se „ajo që ndodhte hë për hë aty“, e ku tha „se ishin përfshirë të gjithë, edhe ata që dëshironin të rrinin manash dhe të shikonin çfarë ndodhte, dhe ishin përfshirë edhe ata që pjesëmerrnin dhe përpëliteshin në atë fatkeqësi pa ditë si t'i ikej, por ishin përfshirë edhe ata që me dëshirë do ta përjashtonin nga kujtesa atë botë, që mendonin se nuk u përkiste dhe nuk kishte të bënte me ta, pra e gjitha ishte pjesë e atij rrënimi, i cili do të ndodhte dhe njësoj do t'i gjente dhe do t'i përfshinte e qëllonte edhe ata të cilët e kishin paraparë t'u shërbente, se do t'i përfshinte dhe qëllonte edhe ata që i rrinin larg, por do t'i përfshinte dhe do t'i qëllonte edhe ata që nuk e dëshironin...“

Pas një pushimi të vogël Koloneli kishte dalë aty ku doemos se kryqëzoheshin më së shumti shpatat midis bindjeve të ndryshme.

„Nuk ka të keqe të vogël dhe të keqe të madhe, siç nuk ka mëkat të vogël dhe mëkat të madh, që pastaj ai të jetë më pak i falshëm apo më shumë i falshëm“ kishte folur thaujse qortueshëm duke shtuar se „kur ndizet zjarri ai përfshin çdo gjë...“

„Megjithatë, njeriu është i mëkatshëm, se ka lindur me të dhe çështje është që në këtë botë ai duhet të pastrohet sa më shumë dhe sa më parë...“ - ia kishte kthyer prifti Gjon Lleshi, i cili po ashtu kishte bërë me dije se nuk hiqte dorë nga armët që kishte.

Koloneli kishte hetuar se prifti edhe më tutje dëshironte ta mbante bisedën të lidhur për çështjet e librave të shenjta dhe kjo nuk i kishte pëlqyer, jo pse ato i merrte të parëndësishme, se duhej hequr dorë prej tyre, por pse në ato rrethana, shpjegimet përgjithësuese, që kapeshin me të mirën dhe me të keqen si të pashmangshme, sikur kishin për qëllim t'ia bënim me dije se gjendja në të cilën ndodhej duhej parë dhe marrë si diçka që nuk mund t'i ikej, të cilën ai parimisht e pranonte, por nuk i bëhej të pajtohej se ajo ishte e tillë nga shkak i mëkateve të zanafillës e të tjerat, të cilat kishte bindjen se prifti i dinte dhe i kuptonte fare mirë dhe aty ai ishte nga shkak i tyre, por pse edhe ai ndjente njësoj shqetësimet që kishin gjithë ata të cilët shihnin si po u shembej atdheu, të cilët duhej ndihmuar me çdo kusht ngaqë ai rrënim njëherash paraqiste edhe rënien e secilit veç e veç, qoftë ai gjeneral, prift apo djall...

Edhe pse kohëve të fundit kishte bindjen se shkonte kah një fund dhe gjithnjë e më tepër lente përshtypjen se u ishte dhënë sjelljeve të cilat përkujtojnë atë që është dorëzuar para asaj që vjen pa tentuar të bëjë as më të voglën përpjekje kundër dhe madje këtë jo rrallë

edhe e shprehte me pandehmën se „vetëm qëllimet e liga përmbushën“, Koloneli foli ashtu që thëniet e priftit Gjon Lleshi, ndonëse të përfolura me përpikëri nga librat e shenjta, i quajti fataliste dhe po të merreshin për të tilla, atëherë ato shfaqësonin shkaktarët e kobit të Shqipërisë, për të cilët tha se „ishin shumë dhe ndër më të mëdhenjtë e të gjitha kohëve...“

Sikur të dëshironte t'ia bënte me dije se nuk kishte ndërmend t'i merrte në mbrojtje ata që i kishin bërë të këqija Shqipërisë dhe vazhdonin t'i bënin, por përkundrazi t'i gjykonte dhe t'i mallkonte madje, prifti Gjon Lleshi shtoi se ato të cilat ndodhnin në atë hapësirë aq të vogël, por që prodhonte kobe të mëdha sa po të shpërndareshin përputhshëm gjithë botën do ta helmonin, megjithatë ishin pjesë e asaj së keqeje, e cila nuk kishte si të mos lidhej me mbërthimin e mëkatit nga i cili duhej liruar sa më shumë dhe përherë. Ndonëse nuk e përmendi djallin dhe pushtetin e tij të ligë, atij ia detyroi peshën më të madhe të mëkateve, të cilat aty shpaloreshin aq haptas dhe aq dhunshëm...

„Fajet duhet kërkuar te njerëzit dhe sjelljet e tyre e jo gjetiu“, kishte ndërhyrë Koloneli, me frikën se ashtu biseda e tyre do të mund të shkiste andej kah nuk do të dëshironte të shkonte, pra te zënia ngojë apo emërtimi i atyre të cilët me sjelljet dhe veprimet kishte bindjen e thellë se i shërbenin kobëve shqiptare.

Meqë edhe prifti Gjon Lleshi ishte i vetëdijshëm se Koloneli mund ta drejtonte gishtin kah ato veprime që tashmë ishin pjesë e fatkeqësisë në të cilën bashkarisht sharronin, serish shtroi nevojën e kërimit të ndihmës te librat e shenjta dhe të porosinë e krijuesit, si tha, „t'i ndihmohet shpirtit, ta ruajë drejtpeshimin edhe atëherë kur kjo është tepër e vështirë...“

„Këtu kaherë janë ngatërruar edhe librat e shenjta dhe mësimet e tyre“, ia kishte kthyer Koloneli qartaqefash, me çka priftit iu kishte kthyer dorja se Koloneli, pak nga pak, po e humbte besimin e me këtë edhe shpresën se aty mund të ndihmohej sado pak që e keqja të mos bëhej më e madhe...

...

Prifti Gjon Lleshi, që u ishte bashkuar vullnetarëve të Vjenës, të cilët për në Shqipëri ishin nisur me betimin se do t'i ndihmonin shtetit të sapo pranuar shqiptar të merrte veten si duhej dhe kjo të ndodhte nën kurorën e mbretit, ndonëse nga jashtë dhe i caktuar nga fuqitë e mëdha, mund të paraqiste një shenjë bashkuese për të gjithë ata që pavarësinë e vendit e shihnin si një domosdo mbijetimi në ato rrethana fare të paqarta dhe me shumë rreziqe që vinin nga të gjitha anët, pra ai më pak i kishte besuar demonstrimit të forcës së misionit drejt sendërtimit të qëllimeve të parashtruara dhe më shumë ia kishte ushqyer shpresën se shfaqja e tyre nën hijen e flamurit shqiptar, në mos për tjetër, të pavendosurve, të hutuarve me të drejtë apo të luhatshmëve, që në ato rrethana ishin të shumtë, do t'ua kthejë besimin se vetëm bërja e shtetit shqiptar ishte shpëtim, se atë rrugë duhej ndjekur dhe duhej bërë çmos të jetësohej. Kishte bindjen se parakalimi i vullnetarëve të huaj qoftë sa për sy e faqe, nën komandën e një koloneli shqiptar, që dikur kishte udhëhequr një pjesë të forcave të perandorisë osmane në luftë kundër britanikëve, me të shpejtë do t'i paqësonte gjithë ata shpirtra të shqetësuar, që së paku të mos binin pre e thashethemeve dhe kurtheve të shumta, të cilat thureshin nga të gjitha anët kundër shtetit shqiptar, i cili nga shpallja e tutje assesi ta merrte veten...Ia hante mendja se ushtarakët e ndryshëm gjermanë dhe austriakë, si dhe të tjerët me ta, të udhëhequr nga Kolonel Dreni, ngado të shfaqeshin do të ngjallnin shpresën se Shqipëria megjithatë po bëhej, se ajo, përkundër kundërshtimeve dhe të tjerave që i ishin qasur, nuk kishte të ndalur, dhe sherret që ngjanin tutje kënetave dhe luginave të harruara, nuk ishin tjetër pos pjesë e mjegullës e cila hidhej qëllimisht nga kundërshtarët dhe armiqtë e saj për ta zhbërë...

Dhe në këtë përfytyrim prifti Gjon Lleshi kishte përjashtuar në tërësi luftën, të cilën nuk e kishte dashtë, jo pse ishte kundër saj kur ajo ishte e drejtë dhe e domosdoshme, por nga bindja se çfarëdo lufte në Shqipëri patjetër se prekej nga përçarjet e brendshme, si një sëmundje që pastaj nuk kishte të ndalur dhe as shërim...

Sado që me Skulptorin, por edhe me të tjerë në Austri dhe gjetiu, bashkëjetesën e besimeve në Shqipëri e kishte quajtur një shembull të jashtëzakonshëm, që duhet mësuar prej saj, por realisht e kishte shpjeguar jo me ndonjë dhunti e cila vjen nga lartë, me qartësimin e të cilës shumëkush ngatërrohet, por nga rrethanat e mbijetimit të domosdoshëm, kur përshtatja dhe gjendja e vasalitetit të gjatë sikur kishin përcaktuar atë farë sjelljen e asnjësisë dhe botëkuptimin që ishte pasqyruar me laramaninë e besimeve dhe kishte dronë se lufta e fundit, e cila kishte plasur me e pengue bërjen e shtetit shqiptar, pa marrë parasysh që shfaqej i cunguar, pikërisht do të kapej për atë që i kishte mbajtur shqiptarët bashkë, pra te bashkëjetesa e besimeve, për me e shfrytëzue atë për të kundërtën, për përçarje vëllavrasëse, e cila shpejt do të mund të merrte përmasat e një kryqëzate të paparë, që kundërshtarët e zellshëm të Shqipërisë do t'i trimëronte më shumë se kurrë, në mënyrë që zhbërjen e saj ta arsyetonin me nevojën e paqësimit të saj nga jashtë për hir të „vendosjes së qartësive civilizuese, por edhe të atyre politike dhe diplomatike“ në ato hapësira.

Në Vatikan e më vonë edhe në Vjenë prifti Gjon Lleshi përherë kishte zënë ngojë shembullin e familjes së tij, si të përzier apo laramane, ku pa telashe bashkëjetonin kryqi dhe gjysmëhëna dhe kjo ndodhte jo pse fisi i tij i vendosur në një pjesë thuajse të pakalueshme të Malësisë së Gjakovës, kishte njohuri profetike, as pse kishte ndonjë veçori të jashtëzakonshme shpirtërore, por e gjitha ndodhte nga shkak se ata kishin përqaftuar besimin në një zot qëkur krishterimi i mirëfilltë ishte përhapur në ato hapësira dhe ai besim nuk ishte çrregulluar as nga ndarja e kishave dhe fesatet që dolën prej saj dhe nuk ishte çrregulluar as me shfaqjen e myslimanizmit, që edhe në rrethanat e sundimit osman, sikur edhe më parë, aty nuk kishte qenë në gjendje të ndikonte ndryshimin e rrethanave jetësore, të cilat edhe më tutje ishin udhëhequr nga kanuni dhe normat e tij të fuqishme morale, të cilat nuk ishin ndryshuar nga ata që venin pushtet. Vlerësonte se ky faktor ishte ai që besimet i kishte kthyer në bashkëjetesë, që për Skulptorin kishte paraqitur një shembull, siç thoshte shpesh, të „ekumenizmit të thjeshtë civilizues shqiptar“, ku ndonjëherë fjalën „të thjeshtë“ e ngatërronte me atë „primitiv“, që thoshte se do t'ia dëshironte krishterimit, i cili pikërisht nga mungesa e tij ishte përfshirë në vorbullën e luftërave të brendshme qysh nga koha e ndarjes së kishave dhe pastaj me shfaqjen e reformacionit, lëvizje këto që u ishte paguar shumë gjak dhe vazhdonin të përçanin...

“Kapërcimi“ apo „leximi i drejtë“ shqiptar i librave të shenjta, duhet të kthehet në shëmbëllesë“, thoshte Skulptori, që priftit Gjon Lleshi i sillte të dridhura, ngaqë e kishte të qartë se çfarë mund të pille ajo, veçmas kur te një pjesë e madhe e opinionit politik europian tashmë ishte ngulitur gogoli „i djallit laraman shqiptar“ dhe ndërlidhjes së tij „të sherrshme“ me gjysmëhënën, të cilën e kishte përhapur propaganda sllave, e interesuar me të të krijojë alibi për shkatërrimin e qenies së tyre etnike dhe biologjike madje dhe këtë ta bënte nën pretekstet e pastrimit të juglindjes së kontinentit nga çfarëdo ndikimi i fanatizmit islamik, që mund të ringjallej me shfaqjen e shtetit shqiptar në hapësirat etnike.

Zbritjes së kësaj teme aty ku e kishte vendin, gjithsesi se i kishte ndihmuar Koloneli, i cili kishte pranuar se edhe familja e tij, si shumë të tjera, ndaj besimeve ishte sjellë sipas nevojës, por pa ndërruar bindjet themelore jetësore të kushtëzuara nga rrethanat e veçanta, dhe se për të shkalla e lartë e arsimimit si dhe njohuritë e hapura civilizuese që kishte marrë në të dy anët e botës, ia kishin shtuar bindjen se preokupim të përhershëm shfaqte krijimi i botës dhe sistemi i përgjithshëm që nuk ka si të mos lidhet me krijuesin, të cilin dikush e quan perëndi apo zot, por ndërlidhja e tij me besimin bëhet me anën e librave të shenjta, të hershme apo të mëvonshme, sistem ky që ai e kishte quajtur „monopol të forcës e të dhunës, mbi të cilin ishin ndërtuar perandoritë“, që pastaj ua kishin hapur rrugën „vijave të ndikimeve“ si dhe ndarjes së botës.

Edhe pse për priftin Gjon Lleshi mendimet e Kolonelit shpinin te kufijtë e herezisë, ndaj të cilave përherë kishte pasur kujdes, megjithatë ai nuk kishte dënuar t'i kundërshtonte, jo pse, së paku sa për sy e faqe, do të kryente një detyrim që përherë e ngarkonte, por pse ato

mësime si dhe arsyetimet të cilat dilnin prej tyre, rrethanave shqiptare ua hiqnin velin e mistifikimeve dhe prapaskenave, me të cilat ishin mbërthyer dhe u shërbenin mrekullisht politikave kundër bërjes së shtetit shqiptar, qoftë edhe gjysmak dhe me sherre, siç ishte pranuar...

„Është mirë që shqiptarët kapën për një zot, pra për krijuesin, që ata, si duket, qysh nga lashtësia e kanë përjetuar në një mënyrë të veçantë edhe pa qenë librat e shenjta, por nuk është mirë kur ky mësim u jepet nga libra të ndryshme dhe nga anë të kundërta“, kishte thënë njëherë Koloneli, që në një shqyrtim të mëvonshëm, gjatë kohës kur në vetmi të thellë në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, numëronte çastet e fundit, kësaj çështje ia kishte kushtuar memorien „Zot-imi-Shqipëri“, që si anonime, ishte gjetur pas dymbëdhjetë vjetësh, me rastin e rindërtimit të saj, rreth të cilës pastaj ishin zhvilluar shumë e shumë shqyrtime, si për autorin, që mund të merrej me mend, por për më tepër edhe për rrethanat e njëjta, të cilat çuditërisht kishin vazhduar të përsëriteshin, dhe për çështjet që shtroheshin nga një këndvështrim i paparë deri më atëherë, që pastaj, pas njëzet e gjashtë vitesh, një akademik i rëndësishëm nga Vjena, në prag të luftës së dytë botërore, shtetit shqiptar do t’ia propozojë si bazë të një projekti gjithëkombëtar...

...
Se shqiptarët ishin të gjykuar të mos lejoheshin të kapeshin për një zot e madje të vepronin sikur ai të ishte i pjesërishëm, i paqëndrueshëm dhe thellësisht i mbushur me urrejtje, për këtë Koloneli do të bindej ditën e dyzet e gjashtë të ndjekjes së pikave të hartës, kur dy ditë pasi kishin varrosur studentin Zenel Xhema dhe një ditë pasi kishte shpallur vendimin për bartjen e flamurit të bardhë, në rrugë për në pjesën që shpinte kah Lezha, pra në njëfarë udhëkryqi fare të shkretë që puqte kodrinat e zhveshura me bregdetin, kishin takuar shumë kufoma me koka të prera, të përdhosur me kryqe të vegjël të përgjakur, dhe disa hapa më tutje, kishin ndeshur edhe disa kufoma të tjera fare të masakruara, të cilat përkaj kishin çevre jeshile me shkronja arabe me sedefe të arta po ashtu të përdhosura keqas. Në atë vapë të madhe, shumë prej tyre thuajse ishin bërë këрма dhe kundërmonin rëndë...

Koloneli nuk po u besonte syve dhe i pari mendim që i përftoi kishte të bënte me shpërthimin e vëllavrasjes nga përpjekjet për ta zhbërë shtetin shqiptar, përpjekje këto që, për fat të keq, tashmë suksesshëm po i afroheshin fundit, ku me fitilin e përçarjeve fetare, mund të rrënohej në tërësi qenia e saj. Deshi të thoshte se ata që tashmë kishin qëlluar trungun shqiptar, nuk e kishin të vështirë t’ia vrisnin edhe shpirtin, por ndjeu se çfarëdo që do të thoshte përballë atij tmerri do të dukej e zbetë. Shikoi priftin Gjon Lleshi, sikur të kërkonte ngushëllim, dhe mbase ishte i gatshëm këtë ta bënte, por nga anash hetoi dy veta që po u afroheshin dhe kërkonin t’u thoshin diçka, që mund të merrej me mend se ishin sqarime rreth masakrës.

Njëherë Kolonelit i shkoi mendja se ata mund të ishin hallexhinj të përhumbur në atë lëmsh vrastar, që kërkonin ndihmë, dhe kjo nuk do ta befasonte, sado që sekush tashmë e dinte se ata nuk ishin hairi i kujt, por nga kjo mëdyshje e liroi njëri i cili iu afruar priftit me kujdes dhe kërkoi t’ua thoshte meshën e përshpirtshme para se t’i varrosnin në gropën e përbashkët, të cilën tashmë e kishin bërë gati në anën tjetër.

Ai shpjegoi se vrasja kishte ndodhur dy ditë më parë, ditën e festës së bajramit të madh dhe e gjitha kishte qenë një intrigë e madhe e cila kishte filluar kur në xhaminë e katundit, që shtrihej në pjesën lindore të kodrinës, ishte gjetur koka e një derri pikërisht në vendin ku hoxha falte xhematin. Ata që i ishin drejtuar xhamisë për të falur bajramin kishin takuar gjurmët e gjaku nëpër mure dhe të dera, të cilat kishin qenë akoma të freskëta dhe kjo i kishte mjaftuar masës së tërbuar të ndjek thirrjen e njërit i cili kishte bërë me dorë kah pjesa tjetër e katundit, ku ndodhej kisha e vogël me oltarin gjysmë të rrënuar së cilës i rrinin pranë disa shtëpi me mure të ulëta fare të rrezbitura...

Koloneli nuk kishte qenë në gjendje më tutje të dëgjonte rrëfimin e jevgut rreth asaj që kishte ndodhur ditën e festës së bajramit. Ishte larguar paksa deri te hija e një peme të gërmuçur dhe aty kishte bërë përpjekje të mbrohej nga pjesët e shkëputura të fjalëve me të cilat përshkruhej masakra, ku kishin rënë pre njëzet e një veta, kryesisht pleq dhe fëmijë, që nuk kishin qenë në gjendje t'i iknin atij tërbimi apo pse nuk kishin mundur ta merrnin me mend se diçka e tillë do të ndodhte në atë katund të shkretë, ku as kisha e as xhamia, përballë hallevë të mëdha të mbijetimit të thjeshtë, nuk kishin paraqitur më shumë se një prehjeje të flashkët ngushëlluese, ku vareshin vetëm shpresat e venitura të atyre që shpëtimin e shihnin nga lartë dhe përditë luteshin për ndihmën e kotë...

Sado që edhe jevgu i tmerruar nuk dënonte të shpjegonte si ishte gjetur koka e prerë e derrit në xhami dhe kush kishte qenë ai që e kishte përdhosur atë ditën e festës, megjithatë në kokën e Kolonelit tashmë po qartësoheshin autorët e krimit, që ishte i bindur se vinin nga jashtë, pikërisht nga ata që kishin paraparë fitilin e luftës vëllavrasëse me anën e ndezjeve fetare, të cilat, në ato rrethana tejet të turbullta, paraqitnin një mundësi të madhe që shqiptarët tmerrësisht t'i sulleshin njëri tjetrit për vdekje...

Nën mbërthimin e vapës, që bëhej gjithnjë e më e padurueshme, Kolonelit po i shfaqej koka e përgjakur e një derri si endej nga vendi në vend dhe ngado shkonte shpërthente një lum gjaku, që përhapej pandalshëm. Iu bë se ajo kokë e përgjakur, me çirren lemëritëse se shënonte fundin e Shqipërisë, po i afrohej t'ia bënte me dije se aty njëherë e mirë përfundonte edhe ai „zoti i vetëm dhe i përbashkët“ dhe në vend të tij të shfaqej „zoti i veçantë“, ai i librave të shenjta, që luftonin njëra tjetrën pamëshirshëm. Në atë hakërrim të tmerrshëm, ku do të ndihmonte vetëm harresa, Kolonelit seç iu qep për kokë kuptimi i *zotit* si dhe rreziku i moskuptimit të tij, por për më tepër edhe i keqkuptimit të tij, që ia kishte bërë me dije gjuhëtari i ri shqiptar.

Iu kujtua si një herë, dhe kjo kishte ndodhur pasi ishte vendosur përfundimisht nga Berlioni për në Vjenë, në një kafe të vogël në pjesën e skajshme të Rudolfsplatzit, ku rëndom rrinin studentët shqiptarë, Nora e kishte njoftuar me një student të ri, i cili edhe para se të vinte në Vjenë, me disa shkrime rreth lashtësisë shqiptare të botuara në të përkohshmen „Linguistische Vorschungen“, kishte zgjuar kërkimin e opinionit shkencor gjerman. Gjuhëtari ishte një djalosh i prajshëm, me një qetësi të thellë, që ai e shpalonte njësoj edhe kur dëgjonte, edhe kur fliste e edhe kur heshte. Meqë vinte nga një qytet i vjetër shqiptar, ku pasqyroheshin, por edhe bashkëjetonin dhe ndërldheshin ndikimet e kulturës perëndimore dhe asaj lindore, qysh herët gjuhëtari i ardhshëm, kishte pasur rastin të futej në të përbashkëtat por edhe të veçantat e gjuhës amtare me ato të fqinjëve, që më vonë do t'i shërbejnë për të krahasuar por edhe për të gjetur rrënjët e lashtësisë indoeuropiane të shqipja, të cilat do të priten me interesim të madh të studiuesit gjermanë dhe të tjerë, të cilët kishin dhënë paralajmërime të herë pas herë lidhur me lashtësinë e saj, që nuk mund të kontestohet më si dhe rëndësinë që kishte shqipja për shpjegimet e mëtutjeshme të gjuhësisë së përgjithshme si dhe asaj indoeuropiane.

Natyrisht se gjuhëtari i ri, që kishte ardhur në Vjenë dhe në sajë të punës së madhe të cilën e kishte bërë, brenda një kohe të shkurtër kishte arritur të hidhte një dritë të re tek marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e vjetra, veçmas me greqishten dhe me latinishten, me të cilat për shekujsh kishte bashkëjetuar, çështjen e lashtësisë së gjuhësisë shqiptare dhe vendit të saj të rëndësishëm brenda indoeuropeanishtes, e kishte forcuar edhe me kundrimet tjera historike dhe etno-socio-kulturore nga mitologjia, me të cilat nxirreshin në pah edhe elemente të tjera, me të cilat pasqyroheshin mbetjet por edhe vihej në pah vazhdimësia e kulturës antike të shqiptarët, e cila thuajse shfaqej si një tabu për shkencën. Kështu, në një studim të gjerë, që pjesërisht e kishte bartur edhe gazeta „Die Presse“ në faqet e shtojcës javore, gjuhëtari i ri shqiptar, hidhte dritë të vazhdimësia e miteve antike të shqiptarët dhe këtë e bënte me pandehmën se shumë nga emrat e hyjnive antikë të Olimpikut mund të shpjegoheshin

vetëm me shqipen, që i ndihmonin të nxirrte përfundime se jeta kulturore dhe ajo shoqërore e shqiptarëve i takonte qytetërimit antik dhe shkencës i mbetej për t'i treguar vendin e saj të njëmendët në të, gjë që e gjitha në syprinë qite më shumë se një çështje shkencore, e cila nuk kishte si të mos refleктоhej edhe më gjerë. Nora i kishte folur për një kthesë të jashtëzakonshme, që duhet mbështetur gjithanshëm, sado që kishte qenë e vetëdijshme dhe për kundërshtimet që do t'i vinin asaj nga ana e atyre qarqeve të cilat njëanshëm dëshironin ta hedhin këtë tezë si të pabazë nga shkaku se të tillët janë të prirë shqiptarët dhe trashëgiminë e tyre ta përjashtojnë qëllimisht nga lashtësia antike dhe ajo europiane për ta hedhur diku në një turbullim kohor dhe gjeografik diku jashtë saj, në Azi apo gjetiu, me çka ushqehen teoritë e ndryshme politike rreth gjoja origjinës së paqartë të shqiptarëve, që duhet kërkuar diku në mjegullimin e mesjetës dhe assesi më herët me çka pastaj mund të justifikoheshin edhe oguret politike ndaj tyre...

Kolonelit, të cilit i mungonin njohuritë e duhura për shqipen, por edhe ato të tjerat nga gjuhësia, në atë shkrim të lexuar me vëmendje të madhe, por gjithnjë duke kërkuar ndihmë dhe shpjegime nga Nora, i kishte bërë përshtypje shpjegimi i fjalës *zot*, si dhe ndërlidhja e mëtutjeshme kuptimore, veçmas ajo *zot-im*, *zot-imi*, *zot-ësi* si dhe shtrija lartë-poshtë nga *hyji* deri te *krye-zot* dhe *zot-i vetvetes*, që pasqyronin zanafillën e vetëkuptimit dhe të lartësimit, të ngritjes në majë, prej nga lind besimi e tjera e tjera, që në mendjen e tij kishin zgjuar asociacionet e çështjes së të madhërishtes, si gjendje e përhershme e një ndijimi të veçantë, që qon kah shtytja e ngritjes, e cila nuk kishte si të mos lidhej me atë që shekuj më vonë nga filozofët, të cilët do t'i ikin klasikes dhe përgjithësimeve të saj, do të hetohet dhe do të shpjegohet si *vullnet për fuqi*...

“Nuk merrem me filozofi“, i kishte thënë me mjaft modesti gjuhëtari i ri, kur Koloneli ia kishte pasqyruar krahasimin midis asaj *zot*, *zot-im*, *zot-ësi* dhe prirjes *vullnet për fuqi*, që Nora kishte bërë përpjekje t'i plotësonte disi edhe me çështjet e teorisë së *egos* dhe *alteregos*, të cilat asokohe përfolëshin me të madhe në Vjenë në saje të një psikoanalitiku të ri, i cili, pos tjerash, hulumtimet në këtë fushë, mendohej t'i kthente në një lloj terapie mjekësore.

Edhe pse kishte pranuar mangësinë e njohurive shqiptare dhe të tjerave që lidheshin me to, Koloneli ia kishte përkujtuar gjuhëtarit rastin e të et, i cili sa herë ndodhej para ndonjë mëdyshjeje të madhe apo gjendjeje të rëndë përherë nxirrte fjalën *zoti-im*, si lutje apo shfrim i thellë, që ndonëse nuk e kishte kuptuar, i ishte dukë si një çlirim i brendshëm, që megjithatë ishte i lartësues...

Gjuhëtari i ri, gjithnjë i prajshëm, i kishte thënë se çështja e kuptimit *zot*, *zot-imi*, *zotë-si* dhe të tjerat, të cilat i takonin asaj pleksjeje, nuk duhej shikuar si besim i thjeshtë, pra si kategori religjioze, por si kuptimësi që pasqyron gjendjet të cilat i përkasin një ndijimi të veçantë pale si quhej ai, që kanë të bëjë me bindjen dhe shkojnë deri te qartësimi shpirtëror, i cili duhet të shihet i ndërlidhur me *hyjin*, që nuk paraqet nënshtrim as adhurim por prirje për lartësim të përhershëm, ku *maja* shfaqet si *ideal*...

„Zoti që nuk kuptohet kthehet në keqkuptim“, i kishte thënë gjuhëtari i ri dhe ia kishte bërë me dije se me studimet të cilave u kishte hy synonte pikërisht sqarimin e këtij kuptimi, që gjithsesi se paraqet më shumë se një çështje gjuhësore.

Dhe disa vjet më vonë, në një bllaquk shqiptar, Koloneli për herë të parë pa tmerrin e moskuptimit të zotit, që ia kishte bërë me dije gjuhëtari i ri në Vjenë dhe thujse dëshpërueshëm uroi që ai të kishte fatin t'i rrinte sa më larg atij...

...

Gjatë atyre dhjetë ditëve të tjera deri sa kishin ndjekur pikën e fundit të hartës së kontit Sombah e cila kishte sosur në Mollas, Kolonelit i kishte rënë të shihte edhe shumë gjurmë të tjera gjaku që nuk vinin vetëm nga moskuptimi i zotit dhe të ngatërimit të tij, por edhe nga moskuptimi i tmerrshëm i vetvetes, apo *tërbimi kundër vetvetes*, si pasojë e asaj gjendje rreth

së cilës njëherë i kishte folur gazetari shqiptar, i cili në Vjenë kishte filluar të nxirrte një të përkohshme shqiptare, në gjuhën gjermane dhe shqipe, me bindjen se krahas sensibilimit të opinionit të huaj diplomatik dhe politik rreth çështjes shqiptare, që ajo të kuptohej drejt dhe si duhet, do t'u ndihmonte edhe shqiptarëve të shkapërderdhur, si thoshte, ta njihnin dhe ta shihnin veten në pasqyrë, sado që nga kjo ai nuk priste ndonjë mrekulli kur kihej parasysh shkalla e tyre arsimore të cilën e quante „me gjithfarë harrna“ si dhe trysnia e mbijetimit që i çonte ngado edhe shpesh edhe andej kah nuk shkohet...

Gazetari, që ishte shumë i kulturuar dhe me njohjen e shkëlqyer të disa gjuhëve lente përshtypjen e një intelektualit të hollë dhe ngado i mbante dyert e hapura, madje edhe te sallonet më të larta vieneze, Norës, por edhe Skulptorit i kishte ndihmuar si shumë njohuritë e tyre për Shqipërinë dhe shqiptarët t'i zhvishnin nga kundrimet romantike dhe qasjet tjera, të cilat mund të gjendeshin të shkapërderdhura nëpër shënime të shkëputura apo te ndonjë libër misionari dhe diplomati që kishte kaluar nëpër ato vende. Në „Klubin kulturor“ të Vjenës, ku rëndom qarkullonin gazetarët dhe publicistët më të njohur, por edhe diplomatët e ndryshëm, gazetari shqiptar disa herë kishte mbajtur ligjërata, të cilat ishin përcjellë me vëmendje të madhe edhe në saje të qëndrimit kritik, që ai kishte ndaj botës shqiptare, të cilën ai mendohej ta paraqiste me të gjitha telashet e shkaktuara nga robëria e gjatë dhe interesat e të huajve që u ishin thyer në trup dhe kishin bërë të mbesin, siç thoshte „as andej e as këndeje, as në tokë e as në qiell, as me djall e as me engjëj...“

Por edhe kur bënte këso përshkrimesh dhe krahasimesh, që ishin fare të ndryshme nga të ngjashmet të cilat aso kohë jepeshin nga përfaqësuesit e popujve të tjerë, ku mbizotëronte qasja epike dhe ajo romantike, gazetari shqiptar kishte bërë si shumë, me anën e pasqyrimin të mangësive të qarta civilizuese që e përcillnin atë, të lartësonte popullin e vet, duke e nxjerrë atë te një rrënjë e moçme, e cila u kishte bërë ballë të gjitha stuhive, pikërisht në saje të trungut të lashtësisë, që njësoj si gjuhëtari, e gjente te antika dhe qytetërimi i saj i lartë, së cilës i detyrohet qëndrimi shumë i matur i tyre ndaj rrymimeve të ndryshme mbi të cilat ishin bërë përqendrimet por edhe shpërqendrimet e ardhshme civilizuese, të cilat kishin ndjekur rrugën e përjashtimive dhe të fërkimeve në përputhje me shtrirjen e besimeve, të cilat ishin shfaqur si urdhra me të cilat ishte luftuar bindja filozofike si kuptim drejt thellimit të njohurive të gjithanshme, që e kishte karakterizuar botën antike dhe zhvillimin e saj madhor...

Gazetari kritik vlerësonte se ato që nga propaganda antishqiptare, kryesisht ajo sllave, te shqiptarët shiheshin si pjesë të egërsisë primitive, gjoja „si dëshmi të injorancës dhe të mangësisë civilizuese“, të cilat në një libër-pamflet të botuar asokohe në Vjenë dhe Paris, politikanin serb Vladan Gjorgjeviq, do t'i cilësojë madje „si shenja të kanibalizmit“, prej të cilave duhet ruajtur ngaqë, si thoshte, „nëse shqiptarët bëhen shtet atëherë në Europë do të promovohet vetëngrënja“, në të vërtetë ishin shpifje të tmerrshme të cilat bëheshin për qëllime të ulëta politike, ndërkohë që mangësitë e caktuara kulturore dhe të tjera civilizuese, të cilat ai i theksonte në një dritë tjetër, dëshironin t'i shihnte si pasojë e shkëputjeve të dhunshme me mbetjet antike, të cilat megjithatë te ata ishin pasqyruar përherë me prirjen e vrojtimit kah hyji, e cila shfaqej si një eho e turbull, që pa mundur të kthehej në *vetë-dëgjim* dhe në *vetë-kuptim*, pastaj ishte kthyer në *keq-kuptim*...

Gazetari shqiptar thoshte se jo rastësisht shqiptarët kishin mbijetuar të lidhur me majat dhe rrudhjen kah ato, që u ishte kthyer në njëfarë *vetë-ikjeje* si *vetë-mbrojtje*, ngaqë më kohë, mbrojtja e përhershme me vetveten dhe besimin, pa u ushqyer dhe pa u qartësuar si duhej, jo vetëm që nuk u kishte mjaftuar, por u ishte kthyer në mangësi shpirtërore dhe qytetëruese, saqë një ditë, ndonëse edhe më tutje u ishin nënshtruar atyre prirjeve, nuk i kishin kuptuar më dhe kishte ndodhë që ato u ishin shndërruar në instinkte të thjeshta dhe reagime, të cilat i kishin ngjarë tërbimit kundër vetvetes, që pastaj, prej të tjerëve ishin vlerësuar si shenja të primitivitetit të thellë e tjera, e tjera...

Pas një shqyrtimi të gjatë, si me shaka, gazetari i ri i kishte thënë:

“Ç’ë do se ata që ia kanë dalë të shkëputen nga ky mbërthim dhe kanë qenë fare të paktë, janë bërë perandorë. Të tjerët kanë mbetur vrasës...”

Ishte vallë kjo vetëm metaforë e thjeshtë, apo pasqyronte një të vërtetë të thellë, që duhej kohë dhe mund për t’u shpjeguar?...

Vlerësimi i gazetarit shqiptar kishte bërë që Koloneli t’i kthehej të menduarit rreth shqiptarëve si perandorë, por edhe si vrasës, pikërisht ashtu si i shfaqeshin gjatë atyre ditëve që sillej me flamur të bardhë në pjesët të cilat ndanin linjat e fronteve vrasëse, të cilat kishin mbërthyer atë hapësirën e vogël të shtrirjes së Qeverisë së Përkohshme dhe Mbretit të sjellë nga jashtë dhe nuk lejonin ajo të frymonte as në përputhje me atë hartën gjysmake që Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit ia kishte caktuar shtetit shqiptar gjoja për t’u vetëadministruar dhe vetëdëshmuar edhe atëherë kur kjo u pamundësohej me të gjitha mjetet dhe me të gjitha mënyrat.

Tek zvarritej nëpër hapësirën e vdekjes, nga mbamendja dhe ato që kishte lexuar, Koloneli po mendohej të bënte shpalosjet e shkëputshme, ku shqiptarët i shfaqeshin perandorë të shumtë, që nga koha e Romës, e Bizantit e deri te sadriazemët dhe pashallarët e fuqishëm, të cilët për pesë shekuj kishin udhëhequr me aq sukses dhe kishin mbikëqyrur plotësisht majat e perandorisë osmane. Krahas tyre shihte ushtarakë të shumtë, që fitonin betejat të panumërta, me të cilat perandorisë i forcoheshin themelet, shihte kadiasçerë, serasçerë, ulema dhe mjeshtër të mëdhenj, që kishin ndërtuar xhami, ura dhe pallate të shumta anembanë perandorisë së pafund...Shihte pastaj tregtarë, bankierë dhe guvernatorë, që udhëhiqnin me sukses krahinat e ndryshme në të tri kontinente, ku vendoseshin administrata të qëndrueshme...Aty i shfaqeshin poetë të njohur, mendimtarë dhe shkencëtarë, të cilët drejtonin universitetet e para dhe përpiqeshin të hapnin shtigjet e tjera të diturisë, të ngjashme me ato që bëheshin në pjesët tjera të botës, me bindjen se vetëm ashtu shkohej përpara, se vetëm ashtu ajo ngjijte kthehej në një mbetje tek lartësitë...

Të gjithë, që të gjithë ata i flisnin për atë *shtytjen e ngritjes*, për atë *vullnetin për fuqi*, që gazetari shqiptar e shihte të mundshme vetëm në rrethanat e perandorive dhe të hapjeve të pasoshme, ku energjia e madhe kishte mundësi të kthehej në krijimtari, ku ajo bëhej pushtet, ku ajo gjente shprehjen e vet të madhe dhe të pandalshme...

“Prirjes së lartësisë u duhen hapësirat, u duhet perandoria“, i kishte thënë ai dhe kishte shtuar se „vetëm me atë vetëdije ndiqen majat, ndiqen sukseset e jashtëzakonshme, ndiqen ngritjet...Kur mungon hapësira, kur mungon perandoria, atëherë ajo kthehet në vetëndjekje, kthehet në vetëshkatërrim...”

Ai ia kishte thënë edhe këto:

„Kush nuk bëhet perandor me siguri se bëhet vrasës...Tjetër rrugë nuk ka...”

...

Të menduarit „*perandor,ose vrasës*“, që e kishte nga gazetari i njohur shqiptar, tashmë Kolonelit i ishte kthyer në një përndjekje të pandalshme dhe të përhershme, ku në njërin anë i dukej se përcillej nga moria e perandorëve të fuqishëm, që kishin udhëhequr perandori dhe kishin lënë gjurmë të pashlyeshme në gjithë botën dhe, në tjetrën anë, ndjekej nga ata që vrisnin dhe vriteshin aq pamëshirshëm, gjithnjë duke pasqyruar atë tërbimin e tmerrshëm kundër vetvetes, i cili ia përkujtonte të kundërtën e hapësirës, mbylljen e errët me kundërshtarë kryesor vetveten...I bëhej se ata sa ankoheshin se nuk kishin perandori për t’u bërë perandor, e sa çirreshin se kishin thikat në duar për t’u bërë vrasës...

Pamjet e të masakruarve dhe të përdhosurve me kryqet e thyer dhe të përgjakur, që kishte lënë pas në afërsi të katundit Fikas si dhe ato që ndeshnin ngado që kalonin, ku shiheshin të vrarit dhe të varurit me mbishkrimet “xhaur”, “hor”, “manifik”, “thi” e të tjera si dhe kufomat e shpërndara herë pa kokë e herë pa gjymtyrë, që u hiqeshin për t’i shëmtuar sa

më keqas edhe si të tilla, Kolonelit po ia ushqenin mëdyshjen se mbase i gjithë tërbimit kundër vetvetes dhe makabriteti i shfaqjes së tij mund të shpjegohej vetëm me atë sindromën „perandor ,ose vrasës“, (që në memorien-manifest „Zot-imi-Shqipëri“ do ta ngritë te motoja „zot ose bishë“), ndjenjë kjo që çuditërisht nisi t’i kthehej në njëfarë përsiatjeje të pandalshme sa ditën e parafundit, pra atë buzëmbërmbjen kur bashkë me Skulptorin dhe telegrafistin Bruner do të hetojnë se nuk u kishte mbetur tjetër pos të nesërmen, pasi të kalonin përroskën gjysmë të tharë që kishin para, të arrinin kodrinën e zhveshur të Mollasit dhe me këtë përmbusheshin pikat e hartës së kontit Sombah, do të flasë si përçartë se aty „përfundonte hapësira e vrasësve dhe fillonte ajo e perandorëve“, që prifti Gjon Lleshi e kishte marrë si shenjë të mirë, me të cilën mund të paralajmërohej kthesa e lirit të Kolonelit nga depresionet e shumta, në të cilat ai kishte sharruar qysh para njëmbëdhjetë ditësh kur kishte shpallur ngarendjen nën flamurin e bardhë dhe me të kishte përhapur atë farë gjendjen e kapitullimit të plotë, me çka pranohej dështimi i misionit në përkrahje të mbretërisë shqiptare, por edhe hapej mëdyshja e sjelljes së tyre në ato rrethana, të cilat dukeshin gjithnjë e më të turbullta.

Si do të shihet nga shënimet e mbajtura në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, mëdyshja darovitëse „perandor,ose vrasës“ Kolonelin do ta përcjell thujtëse pareshtur gjatë gjithë kohës që e çonte kah fundi, dhe me të dhe me atë gjendje, do të njëjtësohej plotësisht sa një çast do të thotë se „kufiri midis perandorit dhe vrasësit paraqet kufirin midis arritjes dhe mosarritjes, midis ngritjes dhe rënies, midis vullnetit të së mirës dhe vullnetit të së keqes“, që do t’i quajë „njësoj pjesë dhe veti të gjeniut...“

V

Arritja e kodrinës së Mollasit të nesërmen, me çka kishin përfshirë të gjitha pikat e hartës që kishte sjellë konti Sombah, të ndjekura me përpikëri gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve, nuk kishte shënuar as përfundimin e hapësirës së vrasësve e as fillimin e asaj të perandorëve, si kishte thënë Koloneli një ditë më parë, kur u kishte dalë përpara ai lumi gjysmë i tharë, që i nxirrte nga mbërthimi i vijave të frontit dhe tmerret e tyre nëpër të cilat ishin zvarritur gjatë gjithë kohës, por nuk ua kthente as frymëmarrjen e as sjelljen e natyrshme, që pandehej dikur.

Përkundrazi, ajo ditë për Kolonelin kishte qenë tepër e mundimshme, ngaqë shënonte ndarjen përfundimtare me Skulptorin, me të cilin mbrëmjen e asaj dite me shumë zabullimë, që ua kishte rënduar frymëmarrjen, kishin zhvilluar atë bisedën lamtumirëse, të cilën Skulptori ishte përpjekur ta quante shpresëdhënëse, ngaqë ai kishte bindjen se tashmë po hynin në kohën e asaj lufte të re dhe të madhe, ndër më të mëdhatë që ishin bërë deri më atëherë në botë, e cila, pos tjerash, do t’i jepte fund vëllavrasjes shqiptare dhe me këtë hapte mundësitë e pakufishme që Shqipëria të bëhej, si për inat të kundërshtarëve të saj nga jashtë dhe, të vetë shqiptarëve, të cilët e kishin qëlluar për vdekje gjatë asaj kohe sa duhej të jepte sprovat më të rëndësishme të dëshimit...

Koloneli kishte dëgjuar me njëfarë prehje shkallmuese ato që thuheshin për atë luftën e luftërave, e cila, në mos për tjetër, kobit shqiptar mund t’i paraqiteshin si ngushëllim, pse ajo kishte nisur mbi bazat e ngatërimit të tij e tjera, e tjera, që Skulptorin me gjasë e kishte trimëruar të fliste dhe të fliste edhe ato që i merrte për të tepërta, ndërkohë Koloneli kishte pasur mendjen të rifillimi i bredhjes së njëjtë, e cila do të bëhej në pritje të fillimit të luftës së madhe, pa qenë i bindur se a duhej nënshtruar edhe më tutje rastisjes zvarritëse dhe shtirjes gjithnjë e më e tejdukshme, si ishte vepruar pas ditës së dyzet e katërt, kur ishte takuar me kosovarët dhe pas vrasjes së studentit Zenel Xhema, kishte përjashtuar çfarëdo takimi me këdo çoftë, si thoshte “me iu dhanë fundit të pashmangshëm, të cilit nuk mund t’i ikej“, apo,

sa për sy e faqe dhe për nevojat e pritjes, që aty dhe në ato rrethana kishte kuptim të veçantë, duhej përfytyruar ndonjë cak fare të parëndësishëm, doemos të binte në kundërshtim me ushtarakët dhe sorollatjet e tyre të përgjimit, qysh kishte ndodhur gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, me çka së paku do të ndikonte t'i hiqeshin qafësh oficerët austriakë dhe ata gjermanë, që ishte i bindur secili në mënyrën e vetë ndodheshin në përgjim të përgatitjes së luftës së re, ku tashmë nuk dyshonte se ata me atë qëllim edhe ishin nisur nga Vjena për në Shqipëri dhe po ashtu ishte i bindur se gjatë gjithë kohës, edhe pse shiteshin si të dëgjueshëm, si të paanshëm, që me asnjë veprim nuk dëshirojnë t'i ndihmojnë luftës vëllavrasëse shqiptare, e të tjera, e të tjera, ata plotësonin detyrat e marra dhe prisnin çastin kur do t'i shpallnin haptas qëllimet, të cilat nuk mund të ishin tjera pos të lidheshin me njëfarë ripushtimi ushtarak të hapësirës shqiptare, që më vonë, në rast fitoreje, me te të bënin politikë dhe kusuritje në përputhje me interesat e tyre, që ndoshta nuk ishte e thënë gjithaq të binin ndesh me ato shqiptare, por gjithsesi se do të ishin të huaja?...

Mbase kjo edhe kishte qenë arsyeja pse Koloneli me aq përkushtim kishte ndjekë pikat e hartës së sjellë nga konti Sombah për të parë të fshehtat e saj dhe ato që mund të pille ajo gjë që shumë shpejtë e kishte kuptuar se e gjitha e misionit të tyre ishte një aktrim, i cili megjithatë kishte qitë në spikamë tragjedinë e cila i kishte përfshirë ata që nuk bënin pjesë në këtë lojë, por kishin ardhur për t'i përmbushur idealet e tyre në Shqipëri, si ishin poeti Hartman, sportisti Hajek, polaku Avramicki dhe studentit Zenel Xhema, të cilët në mënyra të ndryshme ishin vlarë pse synimet e tyre ishin lidhur me bërjen e Shqipërisë shtet çfarëdo qoftë ai, por ajo fatkeqësi njësoj kishte gjetur edhe oficerët tjerë, të cilët nuk i kishin takuar pjesës austriake-gjermane, rumunin Skanea dhe spanjollin Rafelo, me çka ishte parë se nuk kishin qenë pjesë e atyre ngatërrimeve, të cilave po ashtu loja me Shqipërinë u shërbente si shesh për të realizuar qëllime të ndryshme.

Edhe pse përballë kësaj gjendje, Koloneli ishte ndjerë si i mashtruar dhe, megjithëqë ndodhej në krye të atyre të cilët shtireshin se aty ishin t'i ndihmonin mbijetimit të shtetit të sapoformuar shqiptar dhe mbretit gjerman, ndërkohë kryenin punë të tjera, nuk ndërmori as më të voglin veprim t'ua prishte terezinë apo t'u hakmerrej, ani që këtë mund ta bënte pa ndonjë vështirësi dhe kurdoherë. Përkundrazi, heshtazi pranoi rregullat e lojës së tyre dhe nuk shpërtheu as atëherë kur kishte bindjen se oficerët austriako-gjermanë me një qyqarllëk të paparë qëruan hesapet me spanjollin Rafaelo, i cili ishte në rrugë e sipër të ndriçonte sado pak vrasjen e kolonelit Tompson, që lente për të kuptuar se në atë mesokohën e lojës me shtetin shqiptar, ajo ishte pjesë e një komploti të ndërkombëtarëve për t'u hequr gjithë të paanshmit dhe ata që ishin të përkushtuar t'i ndihmonin qeverisë së përkohshme dhe mbretit të merrte veten qoftë edhe rastësisht. Madje edhe në çastet më të rënda, zuri gjuhën dhe nuk denjoi t'ia shprehte dyshimet as Skulptorit, të cilin e merrte për njeriun më të afërm dhe më të sinqertë, që kishte takuar ndonjëherë, i cili njëherash ishte miku dhe dashamiri më i madh i Shqipërisë, që nganjëherë me këtë dashamirësi edhe e tepronte ngaqë dukej e interesshme, ndonëse nuk ishte e tillë...

“Të heshtësh është më vështirë se të veprosh“, kishte shkruar Koloneli në shënimet e lëna në teqenë e Leqes, kur kishte dashtë të shpjegonte arsyet pse kishte pranuar t'i mbetej besnik asaj rruge, që ishte i bindur se e shpinte kah një dështim i pashmangshëm, ndërkohë kundërshtarëve të Shqipërisë dhe atyre që bënin hesape mbi kurrizin e saj u hapte mundësi të reja thujse të pakufishme me veprue në përputhje me interesat e tyre...

Por, ishte sjellja e tij tepër e përmbajtshme, tepër e mbyllur, që megjithatë nga jashtë kishte nxjerrë në pah pakënaqësinë dhe kundërshtiminë e thellë me gjendjen së cilës i ishte nënshtruar, dhe pikërisht ajo kishte shpalosur shqetësimin përvëlues të Kolonelit, atë dufin që i ngulmonte brenda dhe mund të shpërthente çdo çast për ta hedhur llavën e nxehtë. Prifti Gjon Lleshi, por edhe të tjerët, kishin vërejtur luftën e brendshme të Kolonelit dhe me kalimin e kohës, sekush e kishte pasur të qartë se përmbajtja e tij paraqiste diçka të jashtëzakonshme, një mrekulli sadiste, që mbase ishte tronditur paksa vetëm atëherë kur kishte urdhëruar bartjen

e flamurit të bardhë, nën hijen e të cilit ata kishin kaluar dymbëdhjetë ditët e fundit, me çka së paku para atyre që i përgjonin dhe shpresonin se një ditë do t'u duheshin t'u shërbenin apo t'u shiteshin pa çarë kokën për çmimin e mjerë, ishin privuar nga mundësia e respektimit të panevojshëm...

Në ato rrethana Koloneli ishte mbrojtur me meditimet, të cilave u ishte dhënë gjerësisht dhe për herë të parë kishte pranuar rëndësinë e tyre për t'u ruajtur pusulla edhe në rrugën drejt rënies së pashmangshme, të cilën në atë rrënim e sipër, e kishte përfytyruar, por edhe e kishte parë si „pjesë të rikthimit dhe të atyre, që i shërbejnë bërjes së Shqipërisë Shqipëri...”

...

Me gjithë që rinisjen e kishte filluar me fjalët „lavdi zotit...“, që i kishte nxjerrë fare të ftohta dhe me gjysmë goje e pa ato „lavdi luftës së drejtë“, Koloneli, por edhe ata që i shkonin pas luginës së butë e cila do t'i shpinte përtej përroskës thujse të tharë dhe gjithë kundërmim të rëndë, e kishin të qartë se ngjitja e ardhshme, e cila do t'i nxirrte në Guras, njëherësh do të paraqiste fundin e asaj shtirjeje finoke, që i kishte përcjellë gjatë gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të shkuara dhe doemos do të pasqyrohej me shpërbërjen çastin që do të merrej vesh largimi i mbretit nga Shqipëria, me çka ishte i bindur se fillonte ajo lufta e madhe, së pari midis Austrisë dhe Serbisë e pastaj edhe midis të tjerëve për t'u kthyer në një luftë botërore, të parën në historinë e njerëzimit, paraloja e së cilës ishte përgatitur në Shqipëri me aq shumë prapaskena që i ishin luajtur bërjes së saj shtet, së pari nga ata të cilët kishin marrë zotime në dobi të saj, si dhe të tjerët, që kishin për qëllim zhbërjen e saj të me çdo kusht.

„Më në fund po bien maskat“, i tha vetes dhe kjo sikur e qetësoi Kolonelin, që në atë shalakatje babaxhane kujtoi me njëfarë malli vajtues Norën dhe gjithë ato të cilat i kishin paraprirë nisjes për në Shqipëri, dhe me dëshirë do të mbetej në atë përvijim të lirimit nga maskat po mos të ishin ballafaqimet e pashmangshme, së pari me masakrimin e togerit Huber, që kishte ndodhur te teqeja e Leqes dhe, pastaj tragjedia e poetit Huber, e cila ngjau të nesërmen, kur ishin takuar me të dërguarin e këshilltarit të mbretit, të cilin kishte dëshiruar ta harronte sa më parë.

Në atë buzëmbërme, e cila i ishte dukë shumë e gjatë, që po të ndiqeshin pikat e marshutës së para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, do të thoshte mbetje kotnasikoti në Guras edhe për dy ditët tjera në pritjeje të të dërguarit të mbretit, përkundër asaj se ai tashmë ishte në ikje e sipër, nga frika se mund t'i nënshtrohej përsëritjes së kohës shurdhe dhe me zbrazëti të ethshme prapa së cilës ushtarakët austriakë dhe gjermanë, në pritje të asaj lufte të madhe, thurnin planet e tyre, që mendja ia thoshte se nuk mund t'i sillnin kurrfarë të mire Shqipërisë, seç iu tek mu aty e kryenëvete dhe fare njëanshëm, ta shpallte shpërbërjen e njësitit e bashkë me të edhe të misionit të vullnetarëve i filluar me moton „në mbrojtje të mbretit dhe të shtetit të sapoformuar shqiptar“ dhe këtë e bëri aq lehtë e aq thjeshtë sikur të ishte ndonjë gjësend me të cilin mund të vepronte si t'i tekej.

„Ishte tiktaku i orës së brendshme që e bëri këtë“, do të sqarojë Koloneli më vonë dhe do të pranojë se çështjen e shpërndarjes së njësitit dhe me këtë të përfundimit të misionit në mbrojtje të mbretit dhe shtetit të sapoformuar shqiptar njëherë i kishte shkuar mendja ta pleqnonte me priftin Gjon Lleshi, por shpejt kishte hequr dorë nga bindja se ai, si rëndom, do të rrudhte krahët dhe do të kryqohej. Jashtë ushtarakëve, i mbetej vetëm telegrafisti Bruner, i cili po ashtu, çfarëdo t'i thuhej, i nemitur do ta shikonte pa bërë vër me gojë dhe kjo përkonte me atë se ai i nënshtrohej vetëm gjuhës së shenjave, e cila ishte e heshtur dhe me përkushtimin që mendimet e kapura, të rrudhura sa më shumë, të ktheheshin në porosi të thata që i bartte teli.

Pra, përballë gjendjes, kur çuditërisht hetohet një epërsi ndijore çasti ndaj të tjerëve, që jo rrallë krahasohet me mbërthimin e të jashtëzakonshmes si shtytje, pra në shijim të saj, fare shkurt e trup Koloneli kishte thënë se në Guras përfundonte misioni i tyre nga shkaku se

atje nuk kishte kurrfarë kuptimi të ndiqeshin pikat e hartës së sjellë nga kontit Sombah kur ato ishin përballuar gjatë bredhjes gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, dhe po ashtu, tha se edhe po t'i nënshtroheshin shtrirjes së përsëritjes, nuk duhej shpresuar se do të shfaqeshin të dërguarit e mbretit e as duhej pritur ballafaqimin me të njëjtat ngjarje kur ato ishin të pamundshme...

Deshi të thoshte se ishte lufta e re, e cila pritej të shpërthente çdo çast, që shtronte kërkesa të tjera, që si e tillë binte ndesh me qëllimet e misionit të tyre, por hoq dorë nga kjo, sepse ashtu pranonte mashtrimin dhe nënshtrimin atij, si diçka të natyrshme, që pastaj lidhej me prapaskenat dhe të tjerat të cilat thureshin kundër Shqipërisë. Nuk dha ndonjë arsyetim tjetër pos bëri të ditur se nga ai çast secili merrte përsipër fatet e veta në duar dhe ishin të lirë të vepronin në përputhje me qëllimet që kishin, por edhe detyrat...

Sikur ai çast të ishte pritur të ishte i tillë dhe aty, askush nuk nxori zë. Hetoi vetëm priftin Gjon Lleshi që i doli nga ana e majtë dhe telegrafistin Bruner, i cili mundohej të merrte veten nga një kollë e thatë, e cila papritmas iu lidh për fyti dhe mund të shpjegohej me atë se ai ishte i vetmi që nuk e kishte pritë atë dhe as kishte qenë i përgatitur për të, së paku jo në ato rrethana. Të tjerët, nga konti Sombah, kapterët Hesler, Bauman, Hunt dhe Alfred, togerët von Hase dhe Klein, oficeri i marinës Bauer e deri te ushtarakët pa nishane Vogst dhe Haller, bënë një hap prapa dhe iu kthyen rregullimit të pajisjeve që kishin me vete, dhe pas pak, në përbërje të dhjetëshes, iu shfaqen përpara, ku pas një parakalimi të cilin e udhëhoqi konti Sombah, një nga një e përshëndetën me respekt të lartë, sikur të niseshin për një detyrë, e cila kryhej me urdhrin e tij.

Për pak u mat si t'u përgjigjej, por vendosi të hiqte dorë nga përshëndetja ushtarake, me çka ua bënte me dije se nga ai çast merrte fund shtirja, se megjithatë qysh moti ua kishte kuptuar qëllimet, se ua dinte detyrat, që do të thoshte se ndaheshin përfundimisht pa lënë kurrfarë shtigje lidhesh me njëri-tjetrin, por kjo nuk përjashtonte mundësinë që, si për të e edhe për ta, Shqipëria të paraqiste fundin e pashmangshëm, ndryshe nga e kishin përfytyruar, fund ky që nuk do të ishte tjetër pos i njëjtë me fatin e saj...

Si do të merrej vesh më vonë, nga të gjashtë oficerët austriakë dhe katër oficerët gjermanë, vetëm oficeri i marinës Bauer do të presë fundin e luftës së parë botërore dhe këtë do ta bëjë me gradën e kontraadmiralit të flotës detare gjermane, e cila gjatë gjithë luftës veproi në ujërat e Dardaneleve nën flamurin e perandorisë osmane. Si shumë të tjerë edhe ai u zu rob prej britanikëve, por nuk iu nënshtrohej kurrfarë procesi gjyqësor. Përkundrazi, ishte liruar pas gjashtë muajsh qëndrimi në Britani prej nga ishte kthyer në bazën e Rostokut, ku edhe kishte vazhduar shërbimin e marinarit në përputhje me mbikëqyrjen ndërkombëtare që i ishte caktuar shtetit të mundur gjerman. Të tjerët, kush më herët e kush më vonë, me emra të tjerë, apo të shënuar vetëm si numra, kishin rënë në krye të detyrave që kishin, kryesisht në frontin e gjerë ballkanik, i hapur me zbarkimin e forcave franceze-britanike në Selanik.

Njëfarë përjashtimi këtu bënë vetëm vdekjet e togerit gjerman Klein dhe ushtarakut fare të pavërejtur austriak Haller, vdekje këto që ndodhën në Shqipëri në rrethanat kur atje nuk luftohej si në pjesët tjera të kontinentit të vjetër dhe më gjerë, por bëhej një luftë tjetër e ashpër për vendosjen e ndikimit austriako-gjerman në hapësirën e cila merrej si bërthamë e shtetit të ardhshëm shqiptar, që asokohe me të madhe projektohej në Vjenë dhe Berlin në kuadër të programit kulturor për pjesët juglindore të kontinentit, që duhej t'i nënshtroheshin ndikimit dhe mbikëqyrjes së Vjenës dhe të Berlinit, që tashmë ishte thadruar edhe në kokat e shumë gjermanëve, të cilët ishin të bindur se e ashtuquajtura „rilidhje gjermane“ midis Gjermanisë dhe monarkisë së Habsburgëve duhej të kthehej në një model të perandorisë së Karlit të Madh, ku thuhej se „bashkëjetesa shqiptare e besimeve“ nuk mund të merrej si kurrfarë modeli civilizues, që i kishte treguar ato të mundshme dhe të pajtueshme madje, por për të kundërtën, si një çrregullim i ardhur nga ai vakum i papërcaktuar i krijuar nga pikëpjekjet e tyre në atë hapësirë e askujt...

Kështu, togeri gjerman Klein ishte vrarë në afërsi të Lezhës, jo shumë kohë pasi forcat gjermane kishin arritur t'i thyenin trupat serbe, të cilat fare të rraskapitura nga ajo humbje e

rëndë që kishin marrë kishin tentuar nëpërmjet kalimit nëpër Shqipërinë e veriut të gjenin strehim në Korfuz. Në atë intermexon e promenadës së fitores së madhe ushtarake gjermane ndaj Serbisë, mund të merret me mend se Togeri Klein, në pritje të zhvillimeve të reja, ku do të ngarkohej me detyra tjera, sigurisht në sajë të njohjes me të hershme me shkrimtaren bavarase Amalia Gadina, e cila ndodhej në Shqipëri në një mision humanitar, kishte nxituar ta takonte dhe thuhej se për disa ditë ata ishin parë së bashku pranë tendave të spitalit fushor gjerman, të vendosur përkaj detit, ku edhe më tutje shëroheshin disa nga pjesëtarët e gardës së shkatërruar mbretërore si dhe ndonjë ushtarë i trupave qeveritare, por i gjithë shërbimi mjekësor ishte në pritje të luftës së sapofilluar. Nuk dihet me tamam se ato takime a kishin qenë pjesë e ndonjë dashurie apo vetëm hyrje e saj për të cilën dukej se në ato rrethana kishin pasur nevojë të dytë, por ndodhi që ajo u shkëput me një plumb të shkrepur nga ana e pishave, i cili kishte gjetur kokën e togerit Klain një buzëmbërme të qetë kur ai me një buqetë lulesh në dorë po bëhej gati të takonte Amalia Gadinën, e cila me ta dëgjuar krismën, kishte vrapuar shthurshëm në drejtim të togerit, të cilin e kishte takuar pa jetë.

Nga një shënim që kishte lënë pas luftës në një gazetë gjermane, në pamundësi të sqaronte vrasjen e panjohur që ia kishte marrë dashurinë e vetme, të cilën e kishte pasur në zemër dhe kishte ëndërruar që pikërisht në Shqipëri të jetësohej, gjithë dëshpërim do të pranojë se „në Shqipëri kishte ngjarë diçka e tmerrshme, ngaqë aty ishin keqpërdorur edhe qëllimet më fisnike të atyre që këtij vendi kishin dashtë t’i ndihmonin me gjithë shpirt“ dhe për të kjo paraqiste „me tepër se humbjen e një dashurie“.

...

Edhe austriaku Haller ngjashëm kishte gjetur vdekjen në Shqipëri, por kjo kishte ndodhur tre vjet më vonë, një mbrëmje tetori me shi dhe murmurima të shumta në një kafene të errët në pjesën e Marashit në Prizren, pasi thuhej se ushtaraku i pavërejtur Haller ia kishte dalë të sillte dhe pështillte shumë e shumë ngatërresa në hapësirën shqiptare nga Tirana, Shkodra, Prizreni e deri në Shkup, ku ai kishte vepruar në cilësinë e njërit ndër agjentët më të rëndësishëm të shërbimit sekret austriak, me autorizime shumë të mëdha dhe sipas të gjitha gjasave ai kishte pasur në shërbim shumë e shumë agjentë dhe bashkëpunëtorë të tjerë të pavërejtur, të cilët gjatë vitit të dytë dhe të tretë të vendosjes së protektoratit ushtarak austriak në viset shqiptare, kishin bërë të kundërtën e atyre që thuheshin në Vjenë rreth „ribashkimit të etnisë shqiptare dhe kthimit të saj në shtet të fuqishëm“, pra kishin ndjekur nacionalistët e mirëfilltë shqiptarë dhe të gjitha ato forca që kishin bërë përpjekje të luftonin për bashkimin e trojeve shqiptare, të cilët nuk donin hile nga askush, qofshin ata edhe armiq të armiqve të tyre. Haller dhe njerëzit e tij kishin qenë të ashpër veçanërisht në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë ndaj atyre, të cilët, të pakënaqur me zhvillimet dhe kahet e luftës në të cilën ishin përfshirë dhe dukej se mund të mbeteshin të mashtruar keqas, kishin organizuar lëvizjen për mbrojtjen e etnisë shqiptare jashtë mbikëqyrjes së Vjenës. Thuhe se agjentët e Hallerit në mënyra të ndryshme kishin kërcënuar krerët e kësaj lëvizje, duke mos ngurruar ndaj të paluhatshmëve të ndërmerrnin masa të rrepta nga izolimet, burgosjet, deportimet në Austri e gjetiu deri te vrasjet e fshehta, të cilat ishin kryer me shumë mjeshtri, që rëndom, me përhapjen e thashethemeve të caktuara, u lehej pas tymi i përçarjeve të brendshme. Ngjashëm ishte vepruar edhe ndaj intelektualëve dhe politikanëve, të cilët çështjet dëshironin t’i shihnin nga këndvështrimi më i gjerë i interesave shqiptare, por asnjëherë nuk e kishin përjashtuar ndihmën austriake dhe gjermane, si të natyrshme, e cila përputhet me to dhe u ndihmon të sendërtohen, që do të nënkuptonte edhe ndikimin e këtyre vendeve te politika shqiptare për aq sa lejohet.

Ashpërsia e Hallerit kishte marrë hov sa më shumë ishin vërejtur shenjat e humbjeve ushtarake që pasqyroheshin në frontet lindore. Bëhet e ditur se kohëve të fundit disa agjentë të tij të besueshëm kishin pasur në dorë edhe aso urdhëresash dhe autorizimesh me të cilat u

lejoheshin veprimet kryenëvete deri te qërimi i hesapeve i atyre që merreshin të dyshimtë dhe vlerësohej se rrezikojnë interesat perandorake dhe, po mos të ishte plumbi i cili atë natë të turbullt tetori ishte shkrepur ndaj tij në atë terrin e kafenesë së Marashit në Prizren, me siguri se vrasjet në fushatë nuk do të kishin të ndalur...

...

Me muzgun e parë, që pas pak ia kishte lënë vendin një terrimi të lodhshëm, i cili mezi ia delte t'i përpinte trajtat e sendeve të atij shkretimi, Koloneli hetoi vetminë e thellë dhe të pafund, që ndonëse e dinte se diku pranë kishte priftin Gjon Lleshi dhe telegrafistin Bruner përherë të heshtur, ajo po e përshkonte gjithanshëm me një pushtet të jashtëzakonshëm, së cilës sikur iu dha pa ndonjë kundërshtim me njëfarë përshtypje të çuditshme ku i bëhej se ashtu për herë të parë ndodhej jashtë kohe dhe hapësire, në një gjendje të pasosshme dhe të paprekshme, ku mund të merrej me veten dhe vetëm me veten, pa qarë më kokën për pikat që duhej ndjekur nëpër tokën e askujt dhe pa u lodhur për ata të cilët i shkonin pas si hije, të cilët luftën e re e lidhnin me zhbërjen e shtetit shqiptar, që tashmë thuajse kishte ndodhur.

Në atë kthesë dhe ato çaste vendimtare, që ndonëse Koloneli do t'i përshkruajë si „hapat e fundit të vetmisë kah vetvetja dhe të kuptuarit e saj të veçantë“, që do ta shpijnë pashmangshëm kah mbyllja e plotë dhe shkëputja me botën, megjithatë duhet thënë se ishte prania e telegrafistit Bruner, që asaj vetmie dhe atij fundi tragjik ia kishte ruajtur kuptimin dhe dinjitetin madje, qoftë me vendimin e austriakut të heshtur t'i rrinte pranë deri në fund dhe me këtë të lente përshtypjen se Koloneli nuk kishte shkalluar, por i mbyllur në teqenë e Leqes priste ngjarjeve t'u hiqej turbullira me u vu në krye të lëvizjeve të reja me të cilat Shqipëria përfundimisht bëhej, (që në ato rrethana për dike mund të ishin shenja shprese), qoftë me përkujdesjen e përhershme që kishte treguar t'ia ruante ato të cilat Koloneli i kishte shkruar gjatë kohës së mbylljes së plotë në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes. I vetëdijshëm se ishte fjala për një amanet të veçantë, ku Koloneli kishte derdhur mendjen dhe shpirtin, por edhe dëshpërimin e jashtëzakonshëm që bota po merrte një kah që e çonte kah shkatërrimi i saj, shënimet e lëna, gjashtë vjet pas luftës do t'ia dorëzojë Skulptorit Vili Grashauer në Vjenë, e ai të njëjtat, pasi i kishte plotësuar edhe me memorandumin e kosovarëve „*Besa për Shqipërinë*“, të cilin ia kishte dërguar prifti Gjon Lleshi, të gjitha ia kishte dhënë të fejuarës Helenora von Braun, e cila ndonëse pranë një gjendjeje me kriza të thella të herë pas hershme psikike, të shkaktuara nga ngjarjet që e kishin përcjellë në atë luftë e ku tragjedia e Kolonelit kishte luajtur një rol të veçantë, për aq sa kishte mundë, pjesërisht i kishte mbarështuar me shpresën se një ditë do të gjente ndonjë botues. Por, me vdekjen e saj të hershme, ato kishin mbetur të paluara në një dosje, që njëzet vjet më vonë, i nipi Gynter Hajne, arkitekt i njohur, pasi me një testament të veçantë, kishte trashëguar shtëpinë e hallës dhe me dëshirën e saj e kishte kthyer në një galeri, ia kishte dorëzuar Arkivit Shtetëror të Vjenës, ku ruhen në kuadër të materialeve të tjera të shumta ende të pasistemuara të dosjes së trashë shqiptare.

Ashtu si do t'ia pranojë Kolonelit me një sinjeritet të madh, telegrafisti Bruner, besnikërinë ndaj tij, e cila më vonë do t'i kalojë në një virtyt të sinqertë njerëzor, që thoshte se „jetës së tij i kishte dhënë një kuptim të veçantë sa e kishte mbrojtur nga nënçmimi i harresës nëpër të cilën kishte kaluar“, e kishte të detyrueshme, ngaqë dy ditë para se të arrinin Mollasin, pra kur ndodheshin në hapësirën ku pushonin vijat e fronteve që deri pak më parë kishin ndarë përkrahësit e shtetit të sapoformuar shqiptar dhe armiqtë e saj të brendshëm, të cilat i kishin ndjekur gjatë gjithë atyre ditëve të bredhjes dhe fillonte ai ngatërrimi tjetër i papërshtueshëm i armiqtësive shqiptare, që do të vazhdojnë edhe pas largimit të mbretit dhe dështimit të qeverisë së përkohshme dhe do të vazhdojnë edhe atëherë kur do të largohen trupat e shteteve të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe vendin e tyre me të shpejtë do

ta zënë forcat ushtarake serbe, malaziase, greke, italiane që serish do të futen si pushtues dhe do të vazhdojnë avazin e nisur, pra në atë ngatërrim të madh, telegrafistit i kishin humbur lidhjet të cilat i kishte mbajtur me qendrën informative austriake diku në afërsi të Durrësit me anën e aparatit „SM-10 Wolf“, të fshehur brenda rraqeve të ndryshme gjatë gjithë kohës së bredhjes.

Mund të ishin ngjarjet e vrullshme të cilat kishin ndodhur ato ditë pas vrasjes së princit Ferdinand në Sarajevë dhe shqetësimet që kishte sjellë shpallja e luftës së re, që pritej çdo çast, të cilat kishin shkaktuar çrregullimin e shifrave të qendrës e me këtë edhe humbjen e lidhjeve, ose ndoshta shkëputja me hafijet e shumtë të shkapërderdhur në pjesët e ndryshme të Shqipërisë dhe të Ballkanit mund të ishte pjesë e planit të ri të luftës, që si masë të parë kërkonte rishqyrtimin e tyre para se lidhjet të rivendoseshin, të cilat për pak ose përgjithmonë e kishin nxjerrë nga loja telegrafistin?...

Sidoqoftë, telegrafisti Bruner kishte mbetur i shkëputur dhe më kot ishte munduar të vendoste lidhjet e mëparshme, gjendje kjo që me të drejtë e kishte ballafaquar me një pasiguri dhe kishte frikësuar pa masë nga shkaku se „heshtja e përkohshme“ do të mund të zgjaste shumë apo përfundshëm, që sipas rregullave të pashkruara të shërbimit, e detyronte të pranonte gjendjen e gatishmërisë së përhershme qoftë edhe si të pavërejtur, të cilën më së miri ia siguronte mbetja pranë Kolonelit në atë vend.

Kur kishin ardhur në Mollas dhe gjatë asaj dite kishin përkujtuar me pikëllim ato me të cilat ishin ndeshur para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, pra kur kishte filluar misioni i tyre në Shqipëri në mbrojtje të mbretit dhe të qeverisë së përkohshme, telegrafisti Bruner e kishte pasur të qartë se lidhjet e tij të deriatëhershme me bazën kishin marrë fund dhe duhej pritë të reja, që kushedi se kur do të vendoseshin, dhe edhe nëse ndodhte kjo, çështje ishte se a do të ishte në gjendje t'u përgjigjej nga shkaku se mund të ishin rrethanat ato që këtë nuk e lejonin?...

Dhe përballë asaj gjendjeje, që pa lidhjet e rëndomta me bazën, telegrafistit i ishte dukë shumë e rëndë dhe ia kishte përkujtuar sendin e lënë dhe të pavlefshëm fare, vendimin e Kolonelit ta shpërndante njësitin, sado i befashuar, e kishte pritur me njëfarë lehtësimi, ngaqë ashtu dhe aty fitonte mundësinë e pritjes, pa rrezikuar të futej në ndonjë veprim i cili mund t'i kushtonte shtrenjtë. Ai e dinte se për iformantin, që mbetet jashtë veprimit, me pa dashje, (nga ndonjë arsye teknike), apo me dashje, (kur këtë e bënte baza pa shpjegime), koha e pritjes është më e rënda dhe më e rrezikshme, ngaqë humbja e pusullës dhe e mbikëqyrjes, mund të ketë pasojë të paparashikueshme, të cilat ndonjëherë shfaqen të pandreqshme dhe të kobshme madje.

„Jam peng i gjendjes“, i kishte thënë Kolonelit me një zë si në vajë, pasi që dhjetëshja e oficerëve austriakë dhe gjermanë, e udhëhequr nga konti Sombah, ishte larguar në drejtim të kodrinave që shpinin kah deti, me çka mund të kuptohej qartë se telegrafisti Bruner nuk kishte qenë pjesë e të njëjtave shërbime, por doemos se i takonte ndonjë shërbimi të veçantë, që gjithsesi se në ato rrethana nuk ishte pa rëndësi.

Koloneli e kishte shikuar qetas telegrafistin e bërë shuk pa prituri shpjegime të tjera prej tij se çfarë do të thoshte nga pikëpamja ushtarake „pengu i gjendjes“. Kishte dashtë t'ia bënte me dije se ishte i lirë të sillej e të vepronte si t'i tekej dhe barte përgjegjësinë për veprimet e veta, por ai kishte kërkuar ta dëgjonte për pak dhe pastaj të vendoste për të. Por, edhe pasi Koloneli i kishte thënë se nuk kishin kurrfarë detyrimesh ndaj njëri-tjetrit, se mund të sillej si ta shihte të nevojshme dhe të vepronte në përputhje me interesat e veta, telegrafisti Bruner, sikur të ishte tjetër për tjetër, i liruar nga akulli dhe mbërthimi i gjuhës së shenjave, një për një ia kishte hapur zemrën dhe ia kishte treguar hallin, gjë që Kolonelin as e kishte befashuar e as e kishte shqetësuar.

„Ke bërë detyrën tënde me të cilën ke qenë i ngarkuar“, i kishte thënë Koloneli dhe kishte shtuar se ajo ia kishte ruajtur kokën.

Qëndrimi i Kolonelit e kishte prekur telegrafistin, gjë që gjithë ngashërim, kishte bërë përpjekje të sqaronte dhe të shfaqësohej madje me arsyetimin se mbajtja e lidhjeve me bazën, me anën e shifrave, nuk kishte qenë në kundërshtim me misionin e tyre në mbrojtje të mbretit dhe të qeverisë së përkohshme shqiptare dhe as të Shqipërisë, por në shërbim të saj dhe të tillë e kishte kuptuar dhe ushtruar.

Koloneli serish ia kishte përsëritur detyrimin dhe ia kishte përkujtuar se për këtë nuk kishte nevojë të ndjente kurrfarë brejtje të ndërgjegjes dhe i kishte thënë se në botën e humbur shqiptare ishte i lirë edhe më tutje t'i ndiqte qëllimet që kishte dhe këtë ta bënte pa kurrfarë ngurrimi.

„E keqja është se nuk kam kurrfarë qëllimesh dhe as që mund t'i kem, ngaqë ato më përcaktohen“, i kishte thënë telegrafisti, i cili kishte pranuar se u takonte njerëzve të cilët futën në strehën e parë që takojnë dhe kjo nuk kishte të bënte gjitha që me profesionin i cili nënkuptonte shndërrimin e fjalëve në shenja të thata e të ftohta sa me pasigurinë e cila përherë e kishte ndjekur si njeri i vetmuar.

Kolonelin deshi ta ngushëllonte paksa, por hoq dorë meqë e dinte se nuk mund t'i ndihmohej atij që aq haptas pranonte varësinë dhe nënshtrimin që shkonte tutje detyrës së marrë. Madje, po mos të ishin ato që pak më parë ia kishte thënë rreth „pengut të gjendjes“, sjelljen e tij do ta quante të drejtë dhe pa zgjidhje, që edhe më tutje e mbante në shërbim të përmbushjes së detyrës, mendim që Kolonelit befasi ia zgjoi dyshimin se mbase mund të ishte pikërisht ndërprerja e papritur e lidhjeve me telegrafistin, si një shtirje, në shërbim të asaj që ai t'i mbetej pranë dhe t'i përcilleshin lëvizjet?...Mendja ia tha se nuk kishte asgjë të keqe që mund të ishte kështu dhe deshi t'i thoshte telegrafistit përherë ta mbante aparatin të hapur dhe të përgjonte me vëmendje „ringjalljen“ e tij, por këtë nuk e bëri nga bindja se ai ashtu edhe vepronte...

Mbase ndjenja e përgjimit të përhershëm dhe e përcjelljes, kishte bërë, që në shënimet e mëvonshme Koloneli disa herë të shprehet me mirënjohjeje rreth „hijes“, e cila e ndjek dhe fundit të tij i jepte një domethënie të veçantë...

Sikur t'ia kuptonte mendimet dhe mëdyshjet, telegrafisti tha se zemërgjerësia e tij e trimëronte, por kërkoi të deklarohet rreth mbetjes pranë tij përderisa të merrte urdhra të tjera.

„Kjo as që është e nevojshme, ngaqë sillemi në një tokë pa zot, ku mund t'i vihet pëllëmba si të duash dhe ku të duash“, i tha Koloneli.

Arsyetimi nuk e kënaqi telegrafistin Bruner, por ai nuk kishte si t'ia bënte ndryshe. Heshti dhe dha shenjë se çështjen e merrte si të kryer. Duket se nga ai çast do të fillojë jo vetëm mirëkuptimi i veçantë midis telegrafistit dhe Kolonelit, që do t'i përngjajë gjuhës së heshtur të telegrafit, por do të vihet edhe ajo lidhja e tyre e ndërsjellë, të cilën telegrafisti gjatë një bisede të gjatë që kishte pasur me Skulptorin në Vjenë në prag të asaj lufte të dytë botërore, do të pranojë se çastet e fundit me Kolonelin dhe atë që e kishin përcjellë atë, jetën e tij e kishte nxjerrë nga nënçmimi dhe kotësia, që e kishte fat të pashmangshëm...

“Kur po i afrohem fundi, sikur gjithnjë e më shumë ndjej frymën e Kolonelit bashkë me mendimet e tij të shkëputura e gjithfare si lidhen dhe rilidhen në mua sa ndonjëherë bëjnë të njësohem i tëri me atë qenie dhe kjo po më ngushëllon...”

...

Për Priftin Gjon Lleshi shpërndarja e njësitit ishte tepër dëshpëruese, ngaqë nuk ia kishte marrë mendja se e gjitha mund të përfundonte ashtu, sikur të ishte pjesë e ndonjë loje të përgatitur më parë, së cilës i duhej ajo mesokoha për t'u çuar më tutje shumë çështje të tjera, dhe kjo e kishte trishtuar pa masë, sepse ia kishte përkujtuar edhe të papriturat tjera, të cilat mund të merreshin me mend se çfarë do të ishin kundruall atij pështjellimi fatkeq tashmë të thadruar keqas, por i përballuar me atë gjendje, me bindjen e një humbësi të madh, që nuk duhej ta pranonte, kishte një arsye më tepër të kthehej në famulli që të lutej për të keqen e futur në mendjet dhe shpirtin e atyre që drejtonin punët e botës kryesisht në dëm të të vegjëlve

dhe të të pambrojturve, siç ishin shqiptarët, dhe prej andej gjithë shqetësim të përcillte zhvillimet e turbullta, që ishin në prag dhe këtë ia kishte pranuar Koloneli thuasj me gjysmë goje e me ndjenjën e një fajësie të thellë.

„Njerëzit e zotit nuk e humbin shpresën“, i kishte thënë Koloneli, fjalë këto që priftit Gjon Lleshi i kishin tingëlluar si një ngushëllim i rëndë për të cilin më së paku kishte nevojë.

Kur i ishte bashkuar misionit në Vjenë, prifti kishte pasur bindjen se përnjëmend mund t’i shërbente një përpjekjeje të drejtë me të cilën ndihmohet bërja e Shqipërisë shtet nën kurorën mbretërore, që për ato rrethana të mbetjes së gjysmës së vendit jashtë kufijve të saj, paraqiste njëfarë ngushëllimi të hidhur, por edhe shpresë se një ditë vetëm ajo, e lidhur me vendet e rëndësishme europiane, si Austria dhe Gjermania, mund t’i kthente ato të cilat i ishin shkëputur aq tmerrësisht trungut të saj.

“Ma kanë nda atdheun“, i kishte thënë prifti Skulptorit gjithë shqetësim kur kishte marrë vesh se Konferenca e Ambasadorëve në Londër kishte lejuar mbetjen e Kosovës nën Serbi dhe kishte shtuar se „i madh e i vogël duhet të luftojmë për ta kthyer sa nuk bëhet vonë, sepse e humbim edhe pjesën tjetër...“

Me këtë rast kishte bërë me dije se ajo shkëputje ia kishte ndarë përgjysmë familjen dhe farefisin, të cilit i ishte vu në mes një kufi, që po u forcua, ua shuante rrënjën jetësore...

“Gjakova dhe Dukagjini janë shkëputur dhunshëm nga Malësia dhe kjo vret Veriun shpirtërisht, ekonomikisht dhe fizikisht...”

Meqë kishte studiuar në Vjenë dhe aty kishte formësuar shumëçka të bindjes intelektual dhe shoqërore, qysh nga koha e studimeve Gjon Lleshi kishte rënë në lidhje me intelektualët e ndryshëm gjermanë dhe studiuesit, të cilët atëbotë sikur ishin të vetmit që i ndihmonin ndriçimit të lashtësisë shqiptare por edhe dëshmimit të etnisë së saj si një tërësi, që nuk duhet copëtuar, si ishte vepruar në Kongresin e Berlinit. Frika se kjo kahe do të vazhdonte edhe më tutje e kishte shtyrë të shkonte në Grac, ku ishte takuar me albanologun e njohur Gustav Majer, por takime kishte pasur edhe me Shuflain dhe historianët tjerë, të cilët me ngulm punonin në fushën e studimeve gjuhësore dhe historike, dhe gjatë atyre takimeve, krahas mirënjohjes së shprehur për punën që bënin, ua kishte bërë me dije rëndësinë e fjalës së tyre tek qarqet e vendosjes që shqiptarët të mos dëmtoheshin me pretekstet antishkencore dhe antihistorike të cilat ziheshin nëpër kuzhinat politike dhe diplomatike europiane dhe kryekreje ushqeheshin nga propaganda e njohur e qarqeve intelektuale dhe shkencore serbe, franceze dhe ruse. Që rëndësia e çështjes shqiptare dhe zgjidhja e saj e drejtë të mbahej sa më e zgjuar dhe të alarmohej nga rreziku i prapaskenave që i kërcënoheshin, kishte mbajtur lidhje të ngushta me studentët shqiptarë në Vjenë, të cilët ishin gjithnjë e më të shumtë dhe gjithnjë e më të përkushtuar rreth bërjes së Shqipërisë shtet.

I mbërthyer pas këtyre punëve, Gjon Lleshi nga njëherë kishte hetuar pakënaqësinë e përgjegjësve, të cilët ia kishin përkujtuar se ishin studimet kishtarë dhe ato të shpirtit të cilave duhej përkushtuar para çështjeve të tjera që ata i kishin quajtur „përditshmëri“, gjë që e kishin shtyrë t’ua bënte me dije se pavarësia dhe lufta e cila bëhej për të në ato rrethana nuk bënte përjashtime ngaqë ajo ishte një luftë për mbijetimin të thjeshtë.

“Ndodhemi para asaj të rrosh apo mos të rrosh“, kishte thënë dhe kishte bërë me dije se në të kaluarën edhe prelatët e njohur Budi, Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi dhe të tjerë, krahas punës së madhe që kishin bërë me përkthimin e librave të shenjta në gjuhën shqipe dhe në mbledhjen e trashëgimisë kulturore, kishin qëndruar në krye të lëvizjeve për emancipim dhe mëvetësi. Veprat e tyre prifti përherë i kishte marrë si shëmbëllesë, ku njësimi i punëve të shpirtit dhe atyre intelektuale me ato të atdheut paraqiste detyrimin më të madh dhe të përhershëm për secilin.

Gjatë takimeve të para me Kolonelin, pak kohë para se të niseshin për në Shqipëri, prifti, që i kishte treguar se vinte nga Malësia e Gjakovës dhe rridhte nga një familje e madhe laramane e krishtere dhe myslimane, të cilën pushtimi serb e kishte ndarë në dy pjesë, përherë kishte thënë se zëri i atdheut të plagosur për vdekje i bashkonte të gjithë në radhët e tij, dhe

kjo thirrje kishte bërë të kërkonte leje nga liceu për t'u nisur me vullnetarët, e cila i ishte dhënë pasi i ishte parë përkushtimi nga kjo rrugë të mos hiqte dorë qoftë edhe me çmimin e largimit nga urdhri.

„Pa atdhe nuk ka as uratë e as jetë“, kishte folur gjithë shqetësim.

...

Kur Prifti Gjon Lleshi i kishte thënë se „nuk i mbetej tjetër pos të kthehej në famulli dhe atje të lutej për shpëtimin dhe për mëshirën“, Koloneli ia kishte shikuar me vëmendje fytyrën e hajthme si i merrte pamjen e një fëmije të frikësuar dhe çuditërisht iu kishte dukë e njëjtë si atëherë kur në tavernën e anijes „Dunau“, sapo kishin parë tokën shqiptare e cila hapej para tyre si një krijesë e trandur, i kishte thënë se duhet përmbushur thirrja e Pjetër Bogdanit se „*në Prizrend duhet me value të bashkuem kryq e flamur...*“

„Ne nuk po ndahemi, por po bashkohemi përgjithmonë“, kishte folur Koloneli dhe kishte shtuar se megjithatë „janë disa gjëra që dështimet i bëjnë edhe më të fuqishme“, fjalë këto të cilat priftit Gjon Lleshi i kishin ardhur si të dala nga një humnerë në të cilën tashmë kishte sharruar. Vetëm pasi i kishte përsëritur dhe përsëritur, prifti kishte tumirur me lëvizjen e kokës, por pa u liruar si duhej prej mbërthimit të tyre, kishte shpërthyer në vaj, që nuk kishte mundur ta fshehte.

„Ka kohë që po na qanë shpirti“.

Koloneli këto fjalë ia kishte thënë kur e kishte zënë për krahu dhe po e mbante si fëmijë.

Pasi e kishte marrë veten dhe i ishte falënderuar me gjithë zemër për ato të cilat i kishte mësuar prej tij gjatë atij qëndrimi, të cilin e kishte quajtur „dhembje madhështore“, prifti kishte kërkuar leje të nisej.

„Më ndajnë njëmijë vjet rrugë deri te famullia, por mendja ma thotë se do ta bëj dhe pastaj do të kthehem, së paku të përshëndetëm nga kjo botë...“

„Nuk mund të ndahemi nga bota jonë... Jemi të lidhur për të dhe ajo nuk na lëshon...“, i kishte thënë Koloneli, që pasi ia kishte shtrënguar duart e vogla, e kishte marrë në gryk si fëmijë.

Serish i kishte thënë se bashkoheshin përgjithmonë dhe ia kishte bërë me dije se për shpirtrat e tyre vendi i vetëm i prehjes së amshueshme ishin Bjeshkët e Nemuna.

„Në ato maja rikthehem dhe ribëhem ata që jemi... Ai lartësim nuk e pranon rënien...“

Kur kishte folur kështu, Koloneli nuk ishte e qartë se a ndodhej në ndonjë gjendje transcendentë, në të cilën gjithnjë e më shumë po sharronte, apo fliste nga dëshpërimi i thellë që ia kishte shkaktuar vendimi i prituri i priftit të largohej për në famulli?...

Me atë përpëlitje sikur nuk kishte hetuar largimin e priftit, që i ishte dukë se ishte bërë pjesë e atij terrimi i cili po përfshinte hapësirën, si diçka që paralajmëron natë të pafund, një natë shekujsh...

„Jemi të pandashëm... Shpirtrat tonë do të prehen amshueshëm të bashkuar te Bjeshkët e Nemuna dhe atje do të kthehen dhe do të rikthehen pandalshëm për t'i ndihmuar bërjes së Shqipërisë Shqipëri... Këtë e kemi fat...“, kishte folur Koloneli me një zë të marrur sa ato që kishte thënë i bëhej se qëllimisht i ishin kthyer mbrapsht të mbushura me një dridhërimë shqetësuese, si paralajmërim kobi...

...

Ç'është e vërteta, Prifti Gjon Lleshi ishte kthyer edhe një herë aty dhe kjo kishte ndodhur dy ditë para se Koloneli të vritej në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes në rrethana fare të panjohura dhe të pashpjegueshme, të cilat gjashtë vjet më vonë në Vjenë

telegrafisti Bruner ia kishte cilësuar Skulptorit të atilla „sikur t’i kishte ardhur plumbi nga qielli“.

Kur kishte hyrë në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes dhe me shumë kujdes i ishte afruar brendisë së saj me një dridhërimë shurdhe, e cila i ishte bërë edhe më e ftohtë nga shpatat, thikat, gjyrynyrët e gjata dhe të pluhurosura që rrethepërçark vishnin muret e saj dhe preknin minderet, përballë atij mbërthimi të frikshëm, prifti Gjon Lleshi kishte parë Kolonelin fare të shkalluar, të mbështetur për dritare, me kokën e lëshuar në disa letra, që i mbante sikur t’i ruante nga dikush. I tmerruar nga gjendja e tij e rëndë, që për ato njëzet e dy ditët, ishte kthyer në një grusht njeri të tharë e të rrudhur eshtrash, e kishte shikuar ashtu pa ditë si të vepronte...Në pjesën tjetër, po ashtu kishte parë letra të shkapërderdhura dhe disa libra të hedhura.

Dikur, sikur ta kishte hetuar priftin Gjon Lleshi, i cili me mund të madh po përpiquej të mos jepej para pamjes me të cilën ishte përballuar, pa lëvizur fare dhe me një zë mbytës Koloneli kishte përsëritur fjalët „jemi të pandashëm“, që i ishin ngjizur për gojë njëjtë si atë mbrëmjen para njëzet e dy ditësh, kur ishte larguar për në famulli me premtimin se një ditë megjithatë do të kthente.

„Ka njëmijë vjet apo gjithmonë që ecim bashkërisht...Kjo ecje nuk do të ndalet kurrë...Kurrë...“

Prifti iu kishte afruar Kolonelit me përshtypjen e pashpjegueshme se po njëjtësohej me frymën e një qenie të jashtëzakonshme, tepër të madhërishme, që kobi dhe vetmia e kishin lartësuar dhe ngritur deri te shkalla e hyjit, dhe përballë atij ndijimi të veçantë, të cilit assesë nuk kishte mundur t’i ikte, por e kishte pranuar duarhapur, ia kishte ledhatuar fytyrën dhe ballin. Kishte bërë përpjekje mos t’ia hetonte ngashërimin e vajit që nuk e përmbante dot.

„Do të takohemi te Bjeshkët e Nemuna, te majat e saj“, kishte folur Koloneli me çapitje pasi i kishte lëshuar letrat nga duart, të cilat i ishin derdhur përpara dhe ia kishte bërë me shenjë se duhej t’i merrte.

„Gjithmonë bashkë“, kishte folur prifti me një zë të vajshëm.

„Këtë e kemi fat...“ kishte thënë fare i përhumbur Koloneli dhe serish kishte mbështetur kokën për dritaren që shikonte nga pjesa e kopshtit, ku fletët e trëndafilave të veshura për xhama kishin marrë trajtën e therrave, prej nga dy ditë më vonë do të qëllohet për vdekje nga ai plumbi i panjohur...

Priftit Gon Lleshi nuk i kishte mbetur tjetër pos t’i merrte letrat, që si i kishte thënë telegrafisti Bruner, të shkruara orëve të vona të natës, kur sado pak merrej, ishte i bindur se Koloneli i kishte ruajtur për të...

VI

Mbyllja përfundimtare e Kolonelit në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ku do ta gjente vdekja, të cilën e kishte pritur dhe plotësisht i ishte nënshtruar, si diçka që asaj bredhjeje i jepte një kuptim të posaçëm, sipas telegrafistit Bruner kishte filluar nga dita e parë e takimit me atë ambient të strukur në atë vend, të cilin Koloneli e kishte cilësuar „si të gjetur mrekullisht për fundin...“, që gjashtëdhjetë e gjashtë ditë më vonë do ta quajë „si të pashmangshëm“, fund ky i cili gjatë atyre njëzet e dy ditëve do të përmbushej me kuptimin e meditimeve të shkruara dhe porosive të tjera, të cilat Koloneli do t’i lejë të shkapërderdhura në divanin e samahanës së dhomës së madhe të ziçrit të teqesë.

Tri ditët tjera, pra ato të fundit, të cilat do të vinë pas vizitës së papritur dhe të shkurtër të Gjon Lleshi, (që do të mbahet mend nga lirimi i Koloneli prej memorandumit të kosovarëve „Besa për Shqipninë“ i mbëltuar me gjakun e studentit Zenel Xhema, të cilin ai ia kishte lëshuar në dorë priftit sikur të lirohej nga një barrë e madhe shpirti), bazuar në shkrimet e mbetura, të cilat mbajnë shenjat e ditëve, mund të gjykohej se kishin qenë të

heshtura fare dhe në pritje të vdekjes së paralajmëruar, me ç'rast Koloneli nuk kishte lëvizur nga dritarja, ku rrinte i mbështetur dhe sikur parafytyronte plumbin tek po i vinte nga një hapësirë e panjohur, që ishte nisur ngaherë dhe duhej ta qëllonte çdo çast.

Mirëpo, ato njëzet e dy ditët tjera, që pasuan pas shpërndarjes së njësitit dhe largimit të priftit Gjon Lleshi për në famulli, telegrafisti Bruner i kishte cilësuar si „shkëputje e pandalshme e Kolonelit me jetën drejt një ndërlidhjeje të ngadalshme por të paralajmëruar me gjendjen pas vdekjes“, që nga shpjegimet e lëna nëpër shënime, mund të merrej me mend se atë kapërcim Koloneli e kishte quajtur „të pashmangshëm dhe të domosdoshëm madje drejt një rinjohjeje“, që sipas tij i shërbente „rizgimit shpirtëror dhe rikthimit, i cili një ditë do të ndodhte doemos...“

Telegrafisti Bruner nuk kishte marrë guximin të gjykonte se çfarë paraqiste ajo „gjendja pas vdekjes“, të cilën Koloneli e kishte theksuar herë si „një ringjallje“ e herë si „një rinisje drejt cakut të madh“, që mund të lidhej vetëm me idenë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, e cila në ato shqyrtime atij i ishte kthyer në një përndjekje të pashkëputshme mendore dhe shpirtërore, por kishte hetuar se ajo „gjendja pas vdekjes“, te Koloneli kishte zënë të hetohej e të pasqyrohej e mbase edhe të përjetohej shumë më herët për t'i treguar shenjat e saj më se të dukshme me shpërndarjen e njësitit, kur fjalët e qeta, të cilat do t'i thotë rreth përfundimit të misionit, do të përcillen me një nurë tepër të qartë që aty për aty fytyrës së tij do t'ia japë pamjen e atij që vrullshëm shkrihet nga brenda.

Se kjo kthesë e Kolonelit nuk ishte e rastësishme, por shprehje e një ndryshimi të thellë, që lidhej me përjetimin dhe pasojat e ngjarjeve të bredhjes gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh nëpër vijat e frontit të kobshëm të vrasjes ndërshtepëtare, telegrafistit Bruner i kishte mbetur në kujtesë si diçka e pashlyeshme dhe e veçantë, që do të pasqyrohej me vazhdimin e ndryshimeve të tjera të mëdha dhe fare të pashpjegueshëm, të cilat i kishte vërejtur të nesërmen te Koloneli, kur drita e mëngjesit të freskët, i kishte gjetur në pjesën e udhëkryqit që ndante udhën e teqesë së Leqes me atë te kodrinës e cila shpinte për në Mollas dhe ai kishte parë një shpërfytyrim njeriu, të ngjashme me atë të kufomës e cila për ditë të tëra mbetet jashtë varrit.

Aty ku mbrëmjen e kaluar fare papritmas Koloneli kishte shpallur shpërndarjen e njësitit dhe mbylljen, si kishte thënë „të e misionit të tyre në mbrojtje të Shqipërisë pa filluar fare“, fjalë këto që ishin përcjellë me nurin e çuditshëm që i ishte ngjitur për fytyrë, telegrafisti Bruner kishte parë Kolonelin e thyer dhe thujse tjetër për tjetër sa nuk u kishte besuar syve se brenda një nate të vetme njeriu mund të ndryshonte ashtu, kur një trup i shëndetshëm dhe i bëftë sa ora kthehej në një krijesë asht e lëkurë, të rrudhur e të përgjysmuar çuditërisht, të thinjur dhe me sy të përvijuar nga një mbufatje e papërshtatshme, që shikimit ia kishin hedhur paqartësinë e turbullimit...

I tmerruar nga ndryshimi i madh i gjendjes trupore të Kolonelit, me atë dukjen e një të përdali nga vetja, telegrafisti Bruner një copë herë kishte fërkuar sytë me bindjen se aty dhe te ta do të gjente shkakun e asaj katandisje fizike, por sa më shumë që i mbyllte dhe i hapte ata, me dëshirën se mashtrimi i tyre nuk do t'i tumirej, aq më shumë i sqarohej pamja e mjerë e Kolonelit sa një çast dëshpërueshëm pranoi gjendjen e re me shpresën se mbase ajo mund të ishte kalimtare dhe Koloneli herdo kurdo do t'i jepte ndonjë shpjegim ngushëllues.

Por Koloneli, as atëherë e as më vonë, nuk do ta thotë as më të voglën fjalë rreth atij ndryshimi të jashtëzakonshëm fizik, nëpër të cilit kishte kaluar gjatë asaj nate, që telegrafisti Bruner e kishte marrë për vendimtare, jo vetëm nga ngjarjet të cilat kishin ndodhur por për më tepër nga ndryshimet e sjella te Koloneli, që po ta shihte ndokush të kthyer në një xhuxh asht e lëkurë, nuk do ta njihte, ndërkohë që ai, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, kishte pritur rrezet e para të diellit me një kredhje të lehtë të kokës së mbetur sa një grusht, të përcjellë me një fërkim po ashtu të lehtë të fytyrës me duart e thara dhe pasi ishte ngritur në këmbë dhe pa ia vu fare veshin ndryshimit që e kishte gjetur aq befasi, (ngaqë mund ta kishte marrë si pjesë

të natyrshme të atij fundi të pashmangshëm), kishte thënë se „përpara kishin një ditë tepër të rëndësishme, që ndonëse shfaqej e pasosshme, duhej përmbushur me kujdes çastet e saj...”

„Ka filluar të bjerë tiktaku i orës së përhershme“, kishte thënë Koloneli pa dhënë shpjegime të tjera, pos që kishte marrë strajcën me tesha në dorë dhe ishte nisur kah teqeja e Leqes, që për telegrafistin Bruner kishte qenë më se e qartë se rruga e tyre do të përfundonte aty, ku gjashtëdhjetë e gjashtë ditë më parë kishin takuar dervishin e hallakatur dhe të nesërmen kishte ndodhur masakrimi i togerit Huber, që për ata të cilët u kushtonin rëndësi paragjytimeve, e gjitha nuk paraqiste ndonjë shenjë të mirë...

Sidoqoftë, Koloneli kishte ecur si një kufomë në kërkim të varrit të hapur, që ishte aty diku, ose në bishtnim të tij, krejt një, ndërsa telegrafisti Bruner i kishte shkuar mbas me dyshimin se nga përgjuesi i një lufte, e cila pritej, do të kthehej në përgjues të shpirttrave të çrregulluar, mëdyshje kjo që i ishte tumirë nga ato të cilat ia kishte thënë Koloneli çastin që i ishin afruar derës së jashtme të teqesë së Leqes, e cila dukej fare e shkretë, me ç’rast ai kishte theksuar „se aty merrte fund rrugëtimi i tij i kotë nëpër askundje dhe i fillonte ajo bredhja e përhershme me shpirtit, që nuk do të kishte të sosur, ku do të kthehej e rikthej për të kaluar të njëjtave mundime përderisa të bëhej Shqipëria Shqipëri...”

Kur kishte shkelur pragun e teqesë dhe po bëhej gati të futej në dhomën e madhe të ziçrit, Koloneli ia hodhi për pak një shikim pjesës së lënë prapa, pa dënuar të jepte as më të voglën shenjë shqetësimi që po ndahej përgjithmonë prej asaj, që ia kishte përcaktuar tridhjetë e tri vitet e jetës, që bazuar në qëndrimin e shfaqur me atë rast, mund të thuhet se i kishte flakur sikur të mos ishin.

Telegrafistit Bruner nuk i kishte mbetur tjetër pos t’i shkonte pas Kolonelit dhe të përballohej me kundërmimin e tharë të gjetheve dhe sendeve të tjera të lëna shkret, që vinte nga pjesa e brendshme e oborrit të teqesë. Te shatërvani i vogël, të cilit megjithatë i shkonte uji i lodhur nga vapa e fundit e gushtit, kishte parë kumritë dhe zogjtë tek freskoheshin në pjesën e hapësirës së gurtë, që ia kishte bërë me dije se jo gjithçka në atë hapësirë i ishte nënshtruar rrënimit të pandalshëm dhe pushtetit të pakufishëm të vdekjes...

...

Koloneli kishte pasur bindjen se teqeja e Leqes ishte vendi i vetëm dhe më i përshtatshmi në Shqipëri ku vdekja mbrohej nga çfarëdo përdhosje dhe, në ato rrethana tepër të vështira, sado kudo ruante dinjitetin e vet. Këtë mendim nuk e kishte vetëm nga vdekjet e shumta poshtëruese që kishte ndeshur gjatë asaj zvarritjeje gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh midis vijave të fronteve shqiptare, kur për të vrarët dhe të masakruarit kujdeseshin vetëm jevgjijtë e Kavajës, të cilëve u ishin dhënë mushkat që varrosjen ta bënë sa më shpjet, por këtë mendim e kishte edhe nga bindja se teqeja e Leqes dhe hapësira e saj e rrethuar me mure të bardha përsikaj me qiparisa të hollë, të cilët aty diellit sado pak t’ia thithnin nxehtësinë e tepërt, kur në ato anë derdhej pamëshirshëm, ishte i vetmi vend në gjithë hapësirat që deri para pak ditësh kishte ndarë vijat e luftës midis forcave kryengritëse dhe besnikëve të qeverisë së përkohshme dhe mbretit, e së voni ato të ngatërrimit të fronteve vëllavrasëse shqiptare, që kishte mbetur jashtë luftës dhe ishte kursyer prej saj, ku mund të thuhet se deri në atë çastin e kobshëm të plumbit i cili i ishte drejtuar atij, paanësia e saj ishte ruajtur njësoj prej të gjithëve dhe ishte marrë si diçka që ngrihej mbi ta dhe ligësitë e mëkatet e tyre. Madje edhe masakrimi i togerit Huber, që kishte ndodhur ditën e dytë të ndjekjes së pikave të hartës së kontit Sombah, pra para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh, i menduar se kishte qenë vepër e dervishit histerik apo e ndonjë fanatiku tjetër, që mund të merrej me mend se në ato anë nuk mungonin, për çudi nuk kishte ndodhur në pjesën e teqesë, por shumë larg saj, në pjerrësirën e që shpinte kah Gurasi, ndërsa spikatja që i ishte bërë kufomës së togerit gjerman para derës së teqesë sikur kishte pasur për qëllim të dëshmohej e kundërta e asaj e cila ndodhte në ato pjesë, pra të paraqiste „vrasjen e parë e cila mbase bëhej në mbrojtje të Shqipërisë?...“

Këtë të vërtetë telegrafisti Bruner do ta mësojë nga Koloneli të nesërmen e futjes së tyre në teqenë e Leqes, kur ai kishte kaluar natën në pjesën e bujtinës, në të cilën ishte strehuar edhe gjatë atyre ditëve sa Koloneli kishte ndejë në dhomën e madhe të zierit, ku kishte mbetur edhe gjatë gjithë kohës sa kishte vazhduar ajo lufta e madhe botërore dhe dy vjet më vonë, me ç'rast teqeja kishte vazhduar të qëndronte e paprekur, e vetmuar, dhe mbase kështu kishte ndodhur edhe nga shkaku se krahas frikës që kihej nga hakmarrja e shpirttrave kur ata shqetësohen, (e kjo bënte që edhe vrasësit më të paepur të përmbaheshin nga afria dhe hidhërimi i saj), kushedi se si në rrethim, pas asaj përmytjeje të përgjithshme që ishte parë pas dështimit dhe të shkatërrimit të shtetit jetëshkurtër shqiptar, si një shpresë e cila u duhet njësoj vrasësve dhe të vrarëve, ishin hapur fjalët se në të ndodhej një ushtarak tepër i rëndësishëm, ose një evlia i pikur nga qielli, që ishte aty të përgatiste një shpëtim, i cili mund të vinte vetëm me anën e bërjes së një luftë të re gjithëshqiptare, që do të ishte më e madhja deri më atëherë, ku flitej e përflitej se do të ndiqte rrjedhat e botës, që do të drejtohej prej ushtarakëve më të njohur shqiptarë, të mbetur pa nishane dhe ushtri në përbërje të perandorisë osmane, të cilët ishin lënë në baltë, e të tjera, e të tjera, pra ajo luftë që po e përgatiste Koloneli do të kishte për komandantë ushtarakët e njëmendët dhe jo asi të vetëshpallur të shumtën njerëz të hunit dhe të litarit, të fesateve gjithfarë, të dalë si fara e hithrave nga bllaquket e fronteve vëllavrasëse shqiptare dhe nuk shihnin tjetër pos karshillëqëve të ndërsjella për ta mbizotëruar keqas hapësirën e mallkuar të askundjes, që prej mbikëqyrjes së saj të nxirrnin përfitime marramendëse, me të cilat ata kishin varrosur shtetin shqiptar, që këto dhe fjalët e ngjashme pastaj ishin përcjellë me shumë e shumë thashetheme, dhe të gjitha ishin hapë e përhapë me muaj e me vite sa kishte zgjatë ajo lufta e madhe edhe pse Koloneli qysh moti kishte qenë i vrarë e i varrosur nën hijen e manit të teqesë, pranë varreve të sheh Banit, të sheh Metit dhe sheh Ibrahimit, ku trupi i kishte pushuar i qetë për njëzet vjet deri ditën kur ishte shpallur mbretëria e Shqipërisë me mbretin Zogu i Parë, me ç'rast qendra e Bektashinjve në Tiranë, për së vdekuri e kishte nderuar me urdhrin e lartë „sheiit i vatanit“ dhe ishte marrë vendimi që eshtrat t'i bartën në kubënë e teqesë, pranë atyre të Baba Talit të shpallur katragjysh të tarikatit...Madje, kishte pasur kërkesa që krahas këtij nderimi t'i jepej edhe titulli „fedainj“, por kjo ishte pamundësuar nga fjalët e Baba Qazimit, i cili kishte thënë se megjithatë „Kolonelin e panjohur nuk duhej ngarkuar edhe me të gjitha ato që u kishin munguar...”

...

Atë mëngjes, kur Koloneli do të shfaqet te shatërvani dhe fare i qetë do të thoshte se „kishte ardhur ta takonte vdekjen, e cila ishte dashtë të ndodhte para gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh dhe falë një lajthitjeje ishte shtyrë për pak“, por që kishte vazhduar ta ndiqte err e terr dhe të tjerave që kishte thënë se „aty, në atë hapësirë të mbyllur do ta sprovoheshin pandalshëm deri ta ngadhënjente“, fjalë këto të cilat nga habia e madhe telegrafisti Bruner nuk kishte qenë në gjendje t'i kapte si duhej, pra të gjitha ato do t'i mbeten të ngulitura në kokë si një shqetësim i jashtëzakonshëm, jo vetëm pse kishte qenë takimi i fundit dhe i përgjithmonshmi me Kolonelin gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të ardhshme, por për më tepër për mënyrën si ishte shpjeguar masakrimi i togerit Huber dhe rrethanat e ndodhjes, të cilat sikur e kishin lënë pa mend.

Kolonelit fjalëpakë, atë ditë çuditërisht iu kishte çelur goja aq sa fliste si me njëfarë keqardhje për vdekjen e cila e kishte anashkaluar nga një trulllosje që i ishte shfaqur togerit gjerman jo nga sulmi i papritur histerik, (i cili sipas tij mund të shpjegohej me rëndësinë e detyrës së marrë përsipër dhe frikën se mos ajo mund të dështonte nga një pakujdesi apo kurth i papritur, të cilave ai me të drejtë është dashtë t'ua ketë drunë), por nga shkaku i mospërmbushjes së të ashtuquajturave „rrethana formale“ të cilat lidheshin me vrasjen, kur togeri Huber, shfaqjen e dervishit e kishte ngatërruar me ardhjen e përfaqësuesit të mbretit në atë takim in e parë të Mollasit, që do të bëhej të nesërmen, ku kishte pasur udhëzimet të

përpikta, që sapo të hetonte ardhjen e përfaqësuesit të mbretit, i cili duhej ta takonte Kolonelin, këtë duhej ta parandalonte me vrasjen e Kolonelit, e cila pastaj do të shpjegohej e gabimshme, si çështje e sulmit hysterik, që atë do ta shfaqësonte, por njëherësh lente për të kuptuar se me vrasjen e tij, të cilën në ato rrethana dhe në atë vend nuk do ta merrte vesh kush, misioni i nisur nga Vjena, që gjoja udhëhiqej nga një kolonel shqiptar, edhe më tutje do të vazhdonte me mbulesën e „mbrojtjes së mbretit dhe të shtetit të sapo njohur shqiptar“, dhe do të drejtohej në përputhje me qëllimet e fshehura austriake dhe gjermane, të cilat fund e krye bëheshin në përgatitje të asaj lufte të re, e cila do të shpërthente në fillim të vjeshtës...

Meqë togerit Huber i ishte qepë ai hutim dhe shfaqja e dervishit ia kishte turbulluar hesapet fare, nga përgjegjësia e madhe për kryerjen e detyrës dhe trysnia e ushtrimit të saj, kishte reaguar fare shthurshim duke marrë rrugën e luginës me shpresë se në atë hallakamë, së paku do të delte ndokush t'i jepte sqarime dhe udhëzime të tjera si duhej vepruar drejt përmbushjes së detyrës?... Dhe mund të besohet se kjo kishte qenë edhe arsyeja e ngarendjes së tij, e cila po atë natë do t'i kthehej në kob, që po mos të ishte një dëshmi e shkruar prej tij, (pasi që mund të merret me mend se ai i ishte dorëzuar dervishit, e ai mund ta kishte dërguar te të tjerët që e kishin marrë në pyetje, e ku togeri Huber i kishte pranuar të gjitha, mbase pse kishte shpresuar se dervishi mund të ishte ndonjë hafije tebdil i përfaqësuesit të oborrit mbretëror, që ashtu u kishte dalë përpara qëllimisht për ta drejtuar në përputhje me ndryshime të cilat ai nuk i dinte), pra e gjitha do të mund të dukej vdekje e qëllimshme, që do të paraqiste gjoja kundërvënien e parë të forcave të brendshme ndaj të ashtuquajturve „mercenarë vrasës të mbretit, që vinin nga jashtë për ta rrënuar Shqipërinë“ e mesele të tjera, të cilat përhapeshin në gjithë vendin nga ata që nuk lënin gjë pa bërë për ta sjellë para dështimit qeverinë e përkohshme dhe përkrahësit e saj.

Koloneli më tutje kishte shtuar, se masakrimi i togerit Huber, mund të mos kishte kurrfarë lidhjeje me dervishin, pos se ai i ishte kthyer në sherr atij kotnasikoti, nga shkaku i mendjelehtësisë së togerit që në atë gjendje kur kishte humbur pusullën t'i paraqitej për ndihmë, që mund të kuptohet se dervishi xurxull, ngaqë nuk kishte ditë se çfarë të bënte me të gjorin, sa për ta hequr qafe dhe pa të keq, e kishte drejtuar andej kah e kishin bartur këmbët, pra në istikamin e parë, dhe aty, ata që mezi kishin pritur aso mezesh, pa çarë kokën për mbllaçitjet e togerit të shkretë dhe ato që thoshte, kishin vepruar pamëshirshëm, jo pse në ato rrethana kujt do t'i shkonte në mend për ta mbrojtur Kolonelin nga një vrasje me arsyetimin se ajo nuk duhej të bëhej meqë si ushtarak i lartë që ishte vlerësohej herdokurdo i rëndësishëm, (që nga ndokush madje do të mund të merrej si shenjë e rrallë patriotizmi në ato rrethana fatkëqija shqiptare), as pse po të merrej përsipër vrasja e Kolonelit, (me kusht të gjenin porositësit e saj), mund të nxirrej ndonjë përfitim, pra ata të cilëve togeri u ishte shfaqur si cjapi te kasapi, e kishin thënë si dele gjermanin dhe ajo vrasje, mund të thuhet se pos tjerash, ua ushqente instinktët e ulëta të gjakut, të cilat ua kishte ndezur ajo luftë e secilit me secilin dhe e secilit kundër secilit, të cilën e shihnin si një mundësi të mirë për t'u zbrazur sa më shumë që ishte e mundur nga e keqja dhe e liga, e cila u ishte bërë mulla dhe gjithë ajo që nuk kishte për synim ndërtimin por rrënimin?...

Me siguri se po të tjerrej e gjithë puna hollë e hollë, masakrimi i togerit Huber do të mund të shpjegohej ndryshe-ndryshe edhe me shumë e shumë teori, që nuk do të kishin fund. Megjithatë, në shënimet e veta, Koloneli disa herë do ta marrë në shqyrtim rastin e vrasjes së togerit Huber, jo nga këndvështrimi i ndodhjes së saj, por nga pikëpamja e pasojave që kishte sjellë ajo, që ndonëse ia kishte shtyrë vdekjen për pak dhe asaj gjithsesi i kishte dhënë përmasat e një paralajmërimi të sigurt, që do të bëhej, ajo kishte hapur edhe çështje të tjera, të cilat lidheshin me prapaskenat e shumta, që thureshin në qendrat e ndryshme europiane, por edhe në bllaqkun shqiptar, kundër bërjes së Shqipërisë Shqipëri, ose zhbërjes së saj njëherë e përgjithmonë, që në trupin e saj të shfaqeshin ngrehinat e huaja me të cilat ajo bëhej e paqenë...

Meqë Koloneli kishte bindjen se tashmë e kishin radhitur ndër ata që i takonin bërjes së Shqipërisë Shqipëri, e cila për pasojë të natyrshme kishte vrasjen, që do ta gjente dhe, si thoshte, tashmë ndodhej në kërkim të saj, kjo e kishte mbushur me një ndijim të jashtëzakonshme shpirtëror, të ngjashme me nirvanën, me ç'rast ai me dëshirë kishte zgjedhur teqenë e Leqes dhe hapësirën, ku mendonte se vdekja ishte e dinjitetshme dhe si e tillë mund të merrte kuptime të cilat e mbronin dhe madje një ditë mund ta kthenin në shëmbëllesë, qëllim ky që më së miri kishte gjetur shprehjen dhe ishte pasqyruar te njëzet e dy shënimet, të cilat Koloneli i kishte shkruar gjatë atyre njëzet e dy ditëve të mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit në një gjermanishte të rrjedhshme me nivel tepër të lartë letrar, me shumë e shumë prehje eseistike-filozofike, të ndërlydhura dhe të shoqëruara me vargje të poetëve të mëdhenj gjermanë, që telegrafistin Bruner e kishte mahnitur sa të krijojë bindjen se një shkallë e tillë e të shprehurit gjuhësor ishte e mundur vetëm në saje të një kulture shumë të pasur intelektuale...

Dhe për të bërë me dije se „rasti Huber“ ishte më shumë se një vrasje, që paraqiste një pleksje të madhe, të cilat Shqipëria e vogël nuk ishte në gjendje t'i barte, por megjithatë i ishin vu barrë, e tjera, e të tjera, të cilat për t'u sqaruar sado pak ato që fatkeqësinë shqiptare duhej ta bënë sa më të madhe, kërkonin të harxhoheshin shumë e shumë fjalë, pra atë mëngjes të nxehtë me rreze të ndritshme Koloneli kishte zgjedhur telegrafistin si dëgjues, jo pse ishte i bindur se me to nxirrte në shesh diç që shpalosej doemos si dëshmi e cila duhej të mbetej, por pse ndjente nevojë që ato zëshëm t'ia përsëriste vetes, atij tjetrit te ai, të cilin e kishte zbuluar, por edhe e kishte ndrydhur gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve sa i kishin zgjatur bredhjet nëpër vijat e fronteve tragjike të vetëvrasjeve shqiptare, të cilat një herë duhej të hapeshin ashtu dhe në atë mënyrë, që në atë hapësirë pastaj ato si dëshmi të jashtëzakonshme, t'i bartte ajri, t'i thithte toka, që pasi t'i ruante, herdo-kurdo do t'i nxirrte...

Kur ishte shfryrë fare, gjithë qetësi, kishte lëshuar përpara dëshminë e togerit Huber, të shkruar dhe të nënshkruar me dorën e tij atë natën kritike, që i kishte paraprirë vrasjes, të cilën Koloneli e kishte gjetur në minderin e dhomës së madhe të ziçrit mbi librin „Lufta e Qerbelasë“.

Dhe para se të hynte në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, nga e cila nuk do të dalë më, pos si i vdekur pas njëzet e pesë ditësh, kur do ta qëllojë ai plumbi i cili do t'i vijë si prej qiellit, Koloneli do të thotë:

„Po perëndoj si lajmëtar...“

Këto fjalë Koloneli i kishte nxjerrë nga brendia sikur t'i fliste dikush tjetër në të dhe ato i kishte përsëritur disa herë me aso emocione, sa dukej se hapësirës së qetë përreth teqesë, si një shungullime e papritshme, ia kishin kthyer njëfarë shqetësimi të jashtëzakonshëm, që telegrafisti Bruner kishte qenë i bindur se asaj si jehonë nuk i ishin hequr as sa kishte zgjatur ajo lufta e parë botërore e as më vonë...

...

I tronditur thellësisht nga ato që kishte dëgjuar për herë të parë aq haptazi prej Kolonelit, telegrafisti Bruner kishte marrë në dorë një letër të zhubrosur dhe gjysmë të përgjakur, që duhej të ishte ajo dëshmia e togerit Huber para se ta vrisnin, dhe nuk kishte qenë i sigurt se përballë çfarë gjendjeje kishte qenë Koloneli në çastet kur përpara ia kishte lëshuar atë si një leckë, e cila megjithatë kishte një rëndësi të jashtëzakonshme drejt sqarimit të atyre të cilat kishin ndodhur në atë hapësirë të harruar?...

Sidoqoftë, telegrafistin e kishte munduar shumanshëm ajo që Koloneli ia kishte thënë „po perëndoj si lajmëtar“, mendim ky, që si përmbyllës, e kishte takuar edhe te shënimet e lëna, i cili për të nuk paraqiste vetëm të kundërtën e një pajtimi fatalist me ato që përnjëmend vinë e njeriut të rëndomtë do t'i dukeshin të paparamendueshme nga shkaku se vdekja gjithherë paraqet frikë dhe një të panjohur të madhe, së cilës duhet ikur sa më shumë që

është e mundur dhe nuk duhet menduar për të edhe kur është fare pranë e ta zë rrugën, por aktin e saj ai e shihte si paralajmërim i një rilindjeje, e cila lidhej me idenë e pamposhtur të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, me të cilën jo vetëm përmbushej një ideal i drejtë, por plotësohej edhe një nevojë civilizuese, që botën e lironte nga pengu i luftërave të mëdha, të cilat nuk do t'i ndaheshin përderisa të pranonte bashkëjetesën e të kundërtave në hapësirën ku ishte përvijuar kufiri i ndarjes së saj...

Meqë nuk ia kishte dalë të ndiqte kohen e sheshimeve të Kolonelit dhe t'i shpjegonte ato në përputhje me derdhjen e tyre në atë hapësirë të mbyllur, megjithatë domethënien e tyre për gjendjen dhe pasojat e drejtpërdrejta në të cilat ndodheshin, telegrafisti kishte denjuar paska ta gjykonte vetëm në saje të sjelljeve të Kolonelit, që mund të thuhet se nga çasti kur do t'ia hidhte para letrën me dëshmitë e togerit Hubër dhe do t'ia thoshte ato fjalët „*po perëndoj si lajmëtar*“, të fundit që i kishte dëgjuar prej tij, ai i ishte nënshtruar plotësisht mbylljes dhe vetmisë së thellë dhe të madhe, e cila ishte ndërprerë vetëm një herë dhe për pak në ditën e njëzetë e dytë, kur fare papritmas, ishte shfaqë prifti Gjon Lleshi dhe pa folë asnjë fjalë me telegrafistin, kishte hyrë brenda dhe prej andej kishte dalë me fletët e memorandumit të kosovarëve „*Nji besë për Shqipninë*“.

Sado që prifti Gjon Lleshi ishte larguar siç kishte ardhur pa hapë gojën, letrat që ia kishte parë në dorë me rastin e daljes, për telegrafistin kishin qenë një shenjë e mjaftueshme se Koloneli, për faktin se po lirohej nga gjërat që i kishte mbajtur vetëm për vete dhe me to thuajse kishte kaluar çastet e fundit dhe më dramatike të jetës, ishte në pritje të vdekjes, pikërisht ashtu siç kishte paralajmëruar para njëzet e dy ditësh, kur i kishte thënë „se atë do ta ndiqte deri sa ta takonte“, qëndrim këtë që telegrafisti Bruner më vonë do ta korrigjojë jo vetëm në saje të njëzet e dy shënimeve të cilat Koloneli i kishte lënë të shpërndara nëpër dhomë e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes të shkruara, (të cilat gjashtë vjet më vonë, në Vjenë, ia kishte dorëzuar Skulptorit), por këtë do ta bëjë edhe në saje të atyre të cilat i kishte marrë vesh pas shumë vjetësh rreth manifestit „*Zoti-im-Shqipëri*“, (po ashtu e shkruar në gjermanishte të përkryer), e cila do të gjendet me rastin e meremetimit të teqesë, edhe pse anonime ishte marrë si e tij dhe si e tillë i ishte dërguar qendrës së Bektashinjve në Tiranë, prej nga ajo ishte dërguar në Arkivin e Shtetit dhe, me gjasë prej andej, rrugëve të ndryshme, dikush e kishte nxjerrë jashtë vendit (ta ruajë apo ta shkatërrojë), por për fat të mirë, pasi që i kishte rënë në dorë një historiani të njohur hebre, që ishte marrë me hartimin e Historisë së Shqipërisë në prag të Luftës së Dytë Botërore (pas leximit me kujdes dhe ai kishte shprehur adhurim të madh për atë ese të paparë deri më atëherë ndër shqiptarë, sa e kishte propozuar për platformë të ardhshme kombëtare), ajo kishte përfunduar në Arkivin e Gracit, ku edhe atje nuk kishte gjetur qetësi, ngaqë ishte dalë dikush, që nën pretekstet e hulumtimit, ia kishte dëmtuar shumë faqe...

Për telegrafistin Bruner, i vetmi që kishte përcjellë nga afër çastet e fundit të Kolonelit deri sa atë ditën e njëzet e pesë të mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes do ta gjejë ai plumbi që kishte pikë si prej qielli dhe do t'ia marrë frymën, të cilën megjithatë Koloneli ishte i bindur se e kishte lënë të shpërndarë nëpër ato shënime të shkapërderdhura, pra ato që kishin ngjarë në atë pikë të vetme të anashkaluar ose çuditërisht të kursye nga lufta vëllavrasëse shqiptare, së cilës megjithatë tagrin do t'ia paguajë vrasja e Kolonelit, të gjitha kishin filluar dhe kishin përfunduar me „rastin Huber“, pa të cilin ai vlerësonte se shumëçka do të ishte ndryshe, ose së paku, disa gjëra nuk do të merrnin kohen që kishin marrë...

Por, sjelljet dhe veprimet e mbylljes së Kolonelit në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, do të mbeteshin fare të pavërejtura dhe madje do të mund të shpjegoheshin si akt i ndonjë pajtimi fatalist me atë që e priste, pa shënime, të cilat si ditar i kishte lënë gjatë atyre njëzet e dy ditëve si dhe ato që kishte shtruar në to, të cilat do të sforcohen dhe plotësohen me manifestin „*Zoti-im-Shqipëri*“, e gjendur dymbëdhjetë vjet më vonë me rastin e meremetimit të teqesë.

Sado në dukje të pambikëqyrura, ato me të cilat ishte marrë Koloneli gjatë atyre çasteve, që , si kishte pohuar „fatmirësisht, ndodhej nën mbizotërimin e plotë të frymës dhe jashtë pjesës fizike...“, kishin ndjekur rrugën e njëzet e dy trajtimeve të veçanta, të cilat ndonëse lënë përshtypjen e meditimeve të shkapërderdhura, të përbashkët e kanë „sjelljen në rrethin tragjik shqiptar...“dhe „të menduarit për përballimin e tij me anën e rikthimit dhe të ribërjes...“, që mundësohej „pasi të prekej fundi“, që paraqiste një dëshpërim të thellë, por „ishte i domosdoshëm me u kuptue e vërteta“, pa të cilën ai thoshte se „nuk ka as rikthim, nuk ka as rifillim, nuk ka as shërim e nuk ka as bërje të Shqipërisë Shqipëri...“

VII

Trajtesa nismëtare, e shkruar nga Koloneli natën e parë të mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, e cila nuk kishte si t'i shpëtonte „rastit Huber“, ishte quajtur „*Në kthetrat e vrasjes së paralajmëruar*“.

Aty shihej qartë se gjithçka e saj ishte lidhur me përpjekjet për vrasjen e idesë së bërjes së shtetit shqiptar dhe bërjes së Shqipërisë Shqipëri jo vetëm atëherë, por ngaherë, të cilën Koloneli e kishte parë si njëfarë mallkimi që vjen nga shtrirja e qenies së saj „sipër dy boteve të ndryshme“, që thoshte se „përherë dhe pamëshirshëm kishin luftuar njëra tjetrën“ dhe për pasojë kishte pasur shfaqjen e asaj që quhet *lindje* dhe *perëndim*, ku megjithatë në atë hapësirën tragjike të puqjes, e cila merrej dhe njihej si Shqipëri, kishte pasur vend edhe për asnjësinë apo laramaninë dhe kishte pasur vend edhe për ato që tutje saj merreshin si herezi, me të cilat sikur ishte synuar të dëshmohej se fundi i njëres anë nuk paraqet njëherësh edhe fillimin e anës tjetër, ose anasjelltas, prirje kjo e cila do të luante një rol jashtëzakonisht të madh të nxitja por edhe të zbutja e skajshmërive dhe të të kundërtave, që vetëm si të tilla Koloneli i kishte parë tejet të dobishme dhe të vlefshme në përpjekjet të ruhej baraspesha e qytetërimeve, si çështje e mbijetimit të përgjithshëm, e cila megjithatë, do të personalizohet me theksimet se ajo qenie, „kishte pasur fatin por edhe fatkeqësinë të jetë njëherësh një përzierje ndërlidhëse e të kundërtave, të cilat qëllimisht ishin krijuar si të tilla...“

Me gjasë se kjo përpëlitse e përhershme dhe ngatërrimi në të do ta bëjë Kolonelin të shtrojë dilemën e të qenit në kohë dhe hapësirë, e cila do të shihet si një metaforë e hapur, që i përfshin gjithë ata të cilët i nënshtrohen rrethanave të tilla të puqjeve por edhe të ndeshjeve të qytetërimeve, ku ata gjykohen të mbesin peng i tyre...

Rreth kësaj çështje, me njëfarë si vjershe, Koloneli do të meditojë kështu:

*„Një shtrirje e pashkëputshme
Midis lindjes dhe perëndimit
Midis dritës dhe hijes...
Një shtrirje e pashkëputshme
Midis dy boteve
E pandalshme
Si përpëlitse
Dhe vetëm përpëlitse
Nëpër askundjen e ndokundjes
Nëpër ndokundjen e askundjes...
Një shtrirje e pashkëputshme
Një lëvizje e pasosme
Me shpirt
Dhe
Pa shpirt?...“*

Shfrimeve të mësipërme metaforike, Koloneli do t'ua vesh sqarimin e disa kuptimeve, që lidhen me vullnetin për fuqi dhe ndijimin e tij, për të cilin do të thotë se „nuk ka qenë kudo i njëjtë dhe nuk është dëgjuar në përputhje me prirjen e lëvizjes...“, por më tutje do t'u nënshtrohet disa ecejakeve të ngatërruara, të cilat do t'u përngjajnë disa përsëritjeve, kur duket se humbej, por turbullimit të tyre do t'i ik me kapjen pas përpëlites se asaj lëvizjeje të paqartë, ku do të thotë se „i ka mbetur shpirti, i ka mbetur qenia“, prej nga Koloneli pastaj do të sharrojë në hapësirën e një labirinti, që do të theksojë se ajo përpëlítja „vazhdon t'ia përcaktojë fatalitetin ndasisë“ me ç'rast e gjitha i kthehet në një kob të përhershëm „nga shkaku se nuk është në gjendje t'i pajtojë të kundërtat, që nuk është dashtë të jenë të tilla, kur ato luftohen pandalshëm dhe pamëshirshëm në emër të librave të shenjta dhe nga shkaku se nuk është në gjendje të flak njërën apo tjetrën anë nga tërësia që i është ndërlidhur, të cilën ai e ndjen si pjesë të qenies së vet, si pasuri dhe si mallkim njëherësh...“

Koloneli do të bëjë përpjekje të sqarojë se ndarjen, që ka ushqyer kundërthëniet dhe luftërat madje, e ka sjellë „prirja prej vasali“ dhe ajo e „mbrojtjes me përshtatje“, që sipas tij, nuk ka qenë në gjendje t'i nënshtrohet vullnetit të lëvizjeve drejt hapësirave, për ta derdhur në to mendjen dhe fuqinë, por i është kthyer vetvetes, me ç'rast do të thotë se në këto rrethana kishte lindur ai „zoti i urdhrave“, i cili do ta kundërshtojë „zotin e lirë“ dhe në emër të tij do të vrasë!

Shpjegimin e „zotit të lirë“, që doemos vinte nga të menduarit e lirë, Koloneli do ta bëjë kështu:

„Qysh nga zanafilla, kuptimi dhe vetëkuptimi si dhe ndërlidhja me hyjin e kthyer në besim kanë përcaktuar kahen e lirë të qytetërimeve, e cila është pasqyruar me madhështinë e krijimtarisë së lirë, ku secili ka mundur të shpreh fuqinë e mendjes dhe të shpirtit dhe të njësohet me të madhërishmen...“

Rreth kësaj Koloneli do t'i thotë edhe këto:

„Besimi te hyji ka paraqitur liri të pakufishme...“

Besimi te hyji ka paraqitur burim frymëzimi...“

Besimi te hyji ka paraqitur vullnet për fuqi...“

Besimi te hyji ka paraqitur lëvizje...“

Sentencat e sipërme Koloneli do t'i arsyetojë kështu:

„Ata që nuk kanë qenë në gjendje t'i nënshtrohen vullnetit për fuqi dhe lëvizjes, pra ata që kanë pranuar vasalitetin, kanë humbur edhe lirinë e të menduarit dhe lirinë shpirtërore. Të tillët jo vetëm që kanë pranuar urdhrin, por atë e kanë kthyer në mënyrë të të jetuarit, me ç'rast zoti i lirë është kthyer në herezi...“

Koloneli do të sqarojë se ishte pikërisht ndeshja midis zotit të urdhrave dhe zotit të lirë, ku ai ishte përcaktuar për këtë të dytin, që ia kishte futur të menduarit se i pari, pra zoti i urdhrave, ndonëse kishte fituar shumë beteja, ndonëse kishte shumë vartës, nuk do ta fitonte luftën përfundimtare, ngaqë ishte zoti i lirë, ai që e pengonte atë, pa marrë parasysh se kundërshtimisë do t'i mbathet „peshë e mëkatit“ dhe madje edhe mallkimi i përhershëm, që do të nxjerrë klithmën:

„Si të lirohem nga ky mallkim, që më ndjek përherë!?...“

Në pamundësi që t'i jepte një përgjigje asaj që e shihte si kob të pashmangshëm, pse në vend të zotit të urdhrave kishte pranuar zotin e lirë, megjithatë, „vrasjen e paralajmëruar“, që e kishte pranë dhe nuk kishte si t'i ikte, Koloneli çuditërisht e kishte lidhur me idenë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, si diçka që kishte të bënte me zotin e lirë, ndërkohë që kundërshtimin e saj e lidhte me zotin e urdhrave, ku gjendeshin vrasësit e Shqipërisë. Andaj, nuk ishte e rastit pse në atë gjendje ai pareshtur bënte thirrje që Shqipëria nuk guxonte të vritej, meqë ashtu vritej zoti i lirë, prej nga pastaj kishte dalë edhe ajo motoja „t'i bëhesh Shqipërisë themel është ringjallje“, së cilës Koloneli do t'ia kushtojë edhe një ese të vogël:

„Kam me u ringjallë dhe do të vij te ju, të dashurit e mi, çastin që rruga ime e papërfunduar ka me u bërë cak i shpirtit tuaj...”

Kam me u ringjallë dhe do të vij te ju, të dashurit e mi, kur do të zgjoheni nga kotësia e pafund që shkallmon...

Kam me u ringjallë dhe do të vij te ju, të dashurit e mi, bashkërisht me ecë drejt asaj kodrine që shpien te rinjohja...

Kam me u ringjallë dhe do të vij te ju, të dashurit e mi, me e kthye besimin, që do të na shpijë përpara kah ajo maja e lartë, ku fryjnë erërat e freskëta, që ushqejnë mendjen dhe shpirtin...

Kam me u ringjallë dhe do të vij te ju, të dashurit e mi, dhe mos pandehni se do të më ndalin mëkatet tuaja.

Ato që moti ua ka falur bërja e Shqipërisë Shqipëri... “

Me gjithë besimin se ringjallja do të vijë pas asaj vrasjeje të madhe, që po ndodhte dhe nuk do të ndalej pa u kryer, Koloneli nuk do t'i hiqej nga mendja Huberi dhe ato që lidheshin me ngarkimin e vrasjes dhe çështjen e urdhrit për vrasje, që i ishte dhënë togerit si dhe masakrimi i tij pikërisht kur ai duhej ta kryente urdhrin dhe, për ta bërë këtë, nuk e kishte të vështirë aty ku vrasja ishte puna më e lehtë dhe pa farë zarari...Ai do të thotë:

„Togerin Huber nuk e ka vrarë as dervishi, nuk e kanë vrarë as vrasësit e panumërt që ishin kudo, e nuk e kanë vrarë as përkrahësit e qeverisë së përkohshme shqiptare, të cilët ishin gjithnjë e më të paktë e gjithnjë e më të pafuqishëm...Togerin Huber nuk e kanë vara as dashamirët e zhbërjes së Shqipërisë, e nuk e kanë vrarë as përkrahësit e saj, por togerin Huber e ka vrarë fryma e ndëshkimit të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, që megjithatë do t'i ndjek kundërshtarët e saj...”

Trajtesën e parë Koloneli do ta mbyll me vargjet:

„Nuk i frikësohem vrasjes nga vrasësit e Shqipërisë

Ajo nuk është vdekje...

I frikësohem harresës Shqipëri

Ajo vret...”

...

Bindjen se po shkonte drejt vdekjes, që pas saj të niste një fillim tjetër apo një rikthim, si e quante, i cili pashmangshëm duhej të çonte kah bërja e Shqipërisë Shqipëri, Koloneli do ta pasqyrojë më së miri në trajtesën „Qiri“, ku mund të thuhet se i ishte kthyer frymës së misticizmit lindor, rreth të cilave ai kishte njohuri të bollshme dhe, sikur prirjen ndaj tyre e kishte shfaqur gjithnjë e më shumë gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve sa kishin bredhur midis linjave fatkëqija të fronteve shqiptare.

Telegrafistit Bruner do t'i kujtohej ajo biseda e Kolonelit me priftin Gjon Lleshi, e bërë në kalim e sipër nga pjesa e vijave të luftës të cilat çonin kah Tirana, kur përballë një dëshpërimi që ia kishin shkaktuar vrasjet e njëpasnjëshme të togerit rumun Skanea dhe të oficerit spanjoll Rafaello, që ishte i bindur se ishin kryer nga brenda, pra nga pjesa e oficerëve austriakë dhe gjermanë, kishte thënë se „do të vijë koha kur vrasësit, që ecin si engjëj, një ditë do të marrin pamjen e bishave dhe do të kthehen në egërsira për të bërë përfundimisht jetën e tyre dhe e gjitha do të ndodhë kur shpirti do t'u dënohet për krimet e bëra nën përfytyrimin e mashtrimit të njeriut...“, ndërkohë priftit Gjon Lleshi i kishte folur „për gjykimin dhe gjyqin e madh që vjen pas vdekjes, të cilit do t'i nënshtrohen të gjithë pa përjashtim, ku edhe mëkatarët do të marrin dënimet e merituar dhe çdo gjë do të sqarohet“, por Koloneli edhe më tutje kishte vazhduar të fliste për shndërrimin e vazhdueshëm të shpirtit nga qenia në qenie në përputhje me sjelljet dhe veprat...

“Nuk ka gjykim të madh e as të vogël e nuk ka mëshirë, si nuk ka fillim e as nuk ka fund, pos përsëritjes, ku ndodh shndërrimi i përhershëm i shpirtit lartë-poshtë apo anasjelltas“, kishte folur Koloneli, mendim këtë që pastaj e kishte qartësuar me atë se ajo *lartë* - do të thotë ngritje kah majat, ku njeriu fisnikërohet dhe shkon kah hyji dhe, ajo *poshtë* – shfaqet si rënie e cila shpjen kah rrënimi i pashmangshëm, ku shpirti i cili tregon prirjet e pandalshme të së keqes, zhvleftësohet në kafshë dhe, po vazhdoi njëjtë, atëherë kthehet në egërsirë, që han veten dhe kështu me radhë përderisa të humb gjithë fuqinë e së keqes dhe të bëhet fare i parrezikshëm...

Koloneli po ashtu kishte thënë se „*kahu lartë-poshtë* është i vetmi, që përcakton por edhe qartëson rrugën drejt asaj *për t’u bërë zot apo për të mbetur rob...*“

Pastaj kishte shtuar se „nuk ka sjellje të ndërmjetme, as ashtu e as kështu dhe as mish e as peshk, se nuk vlen ajo andej edhe këndej“ dhe veçmas kishte theksuar dëmin që këtij përcaktimi ia ka sjellë „*premtimi i mëshirimit*“ dhe „*falja e mëkateve*“ pas pendimit, që e kishte quajtur „mashtim të madh“ me „pasoja të mëdha...“

Kishte thënë se „ata të cilët ecin përpara dhe rrugës së saj, doemos shkojnë kah maja, ndërsa ata që nuk e bëjnë këtë, por të kundërtën, bien poshtë dhe atje, përfshihen në atë pështjellim të shfrimeve ndër më të ulëtat, ku dihet se çfarë ndodh...“

Prifti Gjon Lleshi, pa u pajtuar me ato që për të përkufizoheshin me herezinë, edhe më tutje ishte munduar të mbante bisedën kah parimet e librave të shenjta, të cilat lidheshin me gjyqin e madh, por Koloneli i përhumbur fare, kishte vazhduar të fliste për shndërrimin e shpirtit sipas veprimeve në jetë dhe gjithë çështjen e kishte përfunduar me vlerësimin se në këtë përsëritje ndodh ai dëshmimi i devotshëm „*krijues ose rrënues*“, që kishte thënë se „të parit i bie barra e *shkrirjes* për ta mbrojtur qenien njerëzore dhe për t’i ndihmuar ngjitjes së saj kah lartësitë, ndërsa i dyti ngarkohet me të ligat që nuk kanë fund, të cilat shfaqen si çështje e sprovës së përhershme...“

Koloneli ia kishte thënë priftit Gjon Lleshi edhe këto:

“Krijuesit ndërtojnë vepra, siç është Ura e Shenjtë dhe Rozafa, siç ishin kullat e Babilonit, piramidat dhe madhështitë tjera, ndërsa rrënuesit përkujdesen për të kundërtën...Pra, kush ndërto ditën me mund të madh, e kush rrëno natën me vullnet të madh...Po të mos ishte flijimi dhe flijuesit e rrallë, rrënuesit e shumë përfundimisht do të fitonin, sado që të ligat e tyre botën shpesh e kanë çuar deri te zgripi...“

Prifti Gjon Lleshi nuk kishte heqë dorë nga theksimi i „*prirjes së të mirës*“, që duhet ndjekur me çdo kusht dhe përherë, dhe „*mundjen e së keqes*“, e cila shpëton shpirtin dhe këtë madje e kishte lidhur edhe me çështjen e Shqipërisë dhe të shpëtimit të saj.

Koloneli ia kishte kthyer se „Shqipërinë e bëjnë vetëm idealistë, ata që janë në gjendje të shkrihen si qiriri për të“.

...

Mbas asaj që kishte dëgjuar nga Koloneli rreth rasti Huber e dita i ishte dukë e pasosme dhe mezi kishte pritur natën, telegrafistit Bruner i kujtohet se nga pjesa e skajshme e teqesë së Leqes, ngjit me derën kryesore, ku ishte strehuar dhe aty kishte mbetur jo vetëm gjatë atyre njëzet e pesë ditëve sa kishte zgjatë mbyllja e Kolonelit në dhomën e madhe të teqesë deri kur e kishte qëlluar ai plumbi vdekjeprurës, por kishte qëndruar edhe gjatë gjithë luftës botërore dhe dy vjet të tjera pas saj deri sa ishte larguar përfundimisht nga Shqipëria, pra nga ajo pjesë e heshtur kishte parë një qiri në dhomën e madhe të teqesë, që përherë kishte pipërritë lodhshëm në terrin e natës përderisa ajo ia kishte lëshuar vendin dritës. Andaj, pa hy në simbolikën e asaj fjale, telegrafisti kishte qenë i bindur se ajo dritë e flashkët që kishte përcjellë Kolonelin gjatë asaj vetmie, nuk kishte si të mos i bëhej pjesë e meditimeve të pandalshme.

Kështu, qiriu për Kolonelin si dhe bredhjet e tij të mendjes ishte më shumë se një marrje me shoqëruesin e vetëm dhe të përhershëm gjatë asaj mbylljeje së cilës i kishte dhënë

fund vrasja e paralajmëruar, të cilën ai e priste dhe e merrte si një fillim të ri, që e quante herë rizgjim, herë rilindje, herë ri kthim e herë ribërje.

Në bazë të atyre që Koloneli kishte lënë të hedhura nëpër letrat, të cilat telegrafisti Bruner i kishte mbledhur çastin që ishte dëgjuar ajo krisma nga dika dhe gjithë nxitim kishte hyrë në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë dhe të parën gjë që kishte ndërmarrë ishte përkujdesja për shkrimet e shkapërderdhura shthurshëm, çështja e qiriut, si preokupim por edhe si metaforë e të menduarit, për Kolonelin shfaqte një njëjtësim të jashtëzakonshëm, që lidhej me ndjenjën e flijimit si bërje, si kuptim i një madhështie, që për të nuk mund të ishte tjetër pos ajo e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, rreth të cilës thoshte se „në flakën e saj pashmangshëm digjen idealistët dhe gjithë ata të cilët atë ndijim të veçantë e kanë shpirtëror dhe vetëm shpirtëror, i cili duket se vjen fare qetas, por nga ajo prajshmëri merr hovin e një shpërthimi të pandalshëm“, bindje e thellë e cila përfundon me atë që ai e quan „vetëdjegie të përhershme, pa të cilën nuk ka as shpirt e as Shqipëri“, e cila do të ngrihet deri te motoja se “vetëm ata që vetëdigjen mund ta bëjnë Shqipërinë...Të tjerët e vrasin Shqipërinë...”

Rreth *vetëdjegies shpirtërore* Koloneli do të shkruajë edhe këto:

„Pipërrima e një flakë të flashkët merr me vete frymën e fundit që ushqen dhe vetë-ushqen dhe ky është një fillim i pandalshëm, i pasosëm dhe i përhershëm, që quhet *flijim*...”

Është pra flijimi për atë fillimin e fillimit të madh, për atë që shënon lëvizjen e përhershme dhe kthehet në shëmbëllesë...

Pa këtë flakë dhe pa këtë *djegie*, që është *vetëdjegie*, nuk ka bërje dhe as nuk ka *vetëbërje*, nuk ka lindje dhe nuk ka as rilindje si nuk ka krijim dhe rikrijim të së madhërishmes e cila paraqitet si ideal...

Por vetëflijimi kthehet në flijim vetëm atëherë kur kalon nëpër rrugët e nënshtrimit të bindjes së shpirtit...

Andaj, *vetëdjegia* nuk është *djegie*...

Vetëdjegia është ushqim që mundëson vetëdijesimin deri te shkalla e vetënjohjes më të thellë me vetëkuptimin si shprehje të saj më të lartë...

Vetëm *vetëdjegia* si ideal madhor vdekjen e bën çështje të jetshme dhe e kthen në mjet të një qëllimi...”

Është me interes të thuhet si do ta shpjegojë Koloneli hetimin e kësaj ndjenë dhe kur do t'i jepet asaj i tëri sa ta krijojë bindjen se edhe ajo vrasja e paralajmëruar, që do ta gjente ditën e njëzet e pestë të mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ishte pjesë e asaj të cilën e quante „lartësim të jashtëzakonshëm, që shpien kah hyji, që është pjesë e ngadhënjimit, që është pjesë e jetës së jetshme...”

Në pjesën e fundit të shkrimit Koloneli do të pranojë se ishte ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe rrethanat nëpër të cilat kishte kaluar gjatë takimit me realitetin tragjik shqiptar brenda atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve sa kishte bredhur në krye të misionit të vullnetarëve nga jashtë, që e kishin shpjerë dhe e kishin kthyer të tërin kah ky ndijim dhe po të shikohej në përputhje me kobin që sillte, mund të thuhej se kishte qenë dëshpërimi i thellë i cili e kishte kushtëzuar atë shpalim dhe përcaktim, i cili do të mund të merrej si njëfarë ngushëllimi në prag të dështimit të plotë...Përkundrazi, Koloneli do të thotë se „përmasat e tragjedisë shqiptare“, që i zbuloheshin aq haptas dhe me aso pasoja të tmerrshme sa nuk i hante mendja e njeriut, ia kishin krijuar bindjen se „nuk ishte dorëzimi para tyre lirim nga tmerri i asaj që mbërthente, por të menduarit e përballimit të tyre“, që në ato rrethana „mund të lidheshin vetëm me idealin e bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe idealistët që kërkonte ajo“, ku e gjitha nuk mund të ishte tjetër pos një ndjenjë superiore, e cila i detyrohet vetëflijimit të atyre që së pari janë në gjendje ta hetojnë dhe ta përpunojnë atë e pastaj të tjerëve, të cilët ia dalin ta kthejnë në një përcaktim të gjerë dhe të përhershëm shpirtëror, ku nuk përjashtohet edhe veprimi drejt jetësimit...

„Nuk ka gjendje të përhershme gjysmake, që mund të merret as e atillë e as e këtillë“, kishte thënë Koloneli dhe kishte shtuar „se këtu duhet parë edhe shpëtimin, që vjen nga lëvizja...“

Duke sqaruar lëvizjen si strumbullar të çështjeve, Koloneli kishte thënë se „çdo gjë nis kah pika dhe i kthehet pikës dhe aty ndodhet edhe gjeneza e asaj lartë-poshtë dhe anasjelltas, zhvillim ky që qet në pah ngritjen dhe rënien, shkëlqimin dhe dështimin që e gjitha lidhet me vullnetin për fuqi, i cili kur mungon apo nuk hetohet si duhet, prirjen me u ngjitë kah majat dhe lartësimin e kthen në të kundërtën, pra në rënie, në amulli, ku ai varfërimi i gjatë shpirtëror dhe mungesa e vetëdijes krijuese kthehen në instinkte rrënuese, të cilat mund të përdoren dhe keqpërdoren pa ndonjë mund të madh për qëllime të ndryshme...“

„Edhe rënia e tmerrshme duhet ta ketë anën e kundërt, pra ngritjen kah lartësitë, apo rilindjen“, kishte shkruar Koloneli me bindjen se këto kthesa ishin të pashmangshme në saje të vetëkuptimit se asgjë nuk ishte e përhershme, pos përpjekjes për ndryshimin e gjendje që ndjek kahet e ndryshme dhe gjithnjë të kundërta dhe në saje të asaj e cila quhet frymë, që është e tjetërsueshme por e pa shpënzueshme, fuqia e së cilës varet nga perimetimet e sasisë dhe të zbërthimit të saj në dobi të veprimit të pandalshëm, gjithnjë si të mbikëqyrur...

Shënimin „Qiri“, Koloneli do ta mbyll me vargjet „qiri, qiri pamuk e vjamë/ti që je pa nanë e pa babë...“, me ç’rast ato i shoqëron edhe me variantin në shqipe, me theksimin plotësues se i kishte dëgjuar si fëmijë t’i këndonte i ati në çastet e mallit të madh i cili jo rrallë e mbërthente, që si duket do t’i shërbejnë të nxjerrë atë gjykimin përfundimtar se „të jesh qiri dhe të vetëdjegësh është ndjenjë kulmore“, ndërkohë të kundërtën do ta quajë „vetëngrënie“, paralele e përhershme e asaj që shfaqet si ndeshje midis krijimit dhe rrënimit, midis të mirës dhe të ligës, ku ndodh edhe ai qartësimi i përhershëm „perëndi ose bishë...“

...

„Perënditë e bëjnë Shqipërinë.

Bishat e rrënojnë Shqipërinë...“

Ky vlerësim thuajse do t’i kthehet në njëfarë përndjekjeje mendore Kolonelit jo vetëm gjatë kohës së mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ku do ta presë vrasjen e paralajmëruar, por do t’i qepet për koke qysh atëherë kur për herë të parë do të ndeshet me përmasat e kobit shqiptar dhe ato të cilat e kishin ushqyer dhe ngritur deri te shkalla e një fatkeqësie të përgjithshme.

Kështu, në trajtesën e tretë, telegrafisti Bruner nuk kishte parë tjetër pos pjesët e atyre bisedave të ndezura të cilat Koloneli kishte bërë me Skulptorin dhe pjesërisht me kontin Sombah qysh nga dita e dyzet e dytë e tutje, pra kur plumbi që kishte ardhur nga ana e forcave të Haxhi Qamilit kishte gjetur kokën e studentit Zenel Xhema, të cilave u ishin ndajmathur edhe disa nga shqyrtimet me ndërprerje, të cilat midis tyre kishin vazhduar deri në atë natën e fundit të rikthimit në Mollas, kur kishte marrë vendimin për shpërndarjen e njësitit, që do ta shpallte të nesërmen në udhëkryqin e Gurasit.

Por, si të gjenden perënditë, të cilët i duhen Shqipërisë për t’u bërë Shqipëri, kishte pëshpëritur thuajse mendueshëm Skulptori atë natën e dyzet e dytë dhe të njëjtën pyetje kishte shtruar edhe natën e fundit para se të largohej, ndërkohë Koloneli për pak kishte heshtur si edhe atëherë pasi kishin varrosur studentin Zenel Xhema në atë tokën e thatë skaj një përroske kundërmuese ku ishte më se e qartë se vërshimi i parë do t’ia shplonte eshtrat për t’ia bartur dhe humbur përgjithmonë kah ndonjë bllaqk i ndotur, dhe ngjashëm kishte heshtur edhe kur e kishin druajtjen se ajo mund të ishte biseda e tyre e fundit.

„Perënditë nuk gjenden, por krijohen“, kishte thyer pas pak heshtjen Koloneli dhe kishte shtuar se „është ndjenja e lartësimit ajo që shpien kah ndijimi i të madhërishtes, e cila pastaj kthehet në bindje prej nga kalon në ideal, dhe për të ndodhur kjo, nevojitet edhe e kundërta e saj, pra fatkeqësia, greminat, rënia, dhe mbi të gjitha kuptimi i tyre dhe vlerësimi i

drejtë se ato janë pjesë e atyre zhvillimeve të gjithëmbarshme dhe gjithëkohore me zik-zake, që duhet të përballohen me mendje dhe shpirt...”

Ato që ia kishte thënë Koloneli rreth krijimit të perëndive, që do ta bëjnë Shqipërinë Shqipëri, të cilat ai i kishte shoqëruar edhe me vargjet e një vjershe të poetit persian Hafez, që ndonëse nuk kishte qenë në gjendje ta thoshte të tërën dhe kishte pranuar se shumëçka e saj i ishte shkëputur, edhe si e tillë kishte tingëlluar bindshëm, Skulptorit sikur ia kishin kthyer ndjenjën e njëfarë dëshpërimi të vetëfajshëm nga i cili gjithnjë e më shumë përfshihej kohëve të fundit. Kishte thënë se kërkimi i majave nga greminat i dukej si pranim i dështimit të thellë, që i duhej ngushëllimi çfarëdo qoftë ai, gjë që Koloneli ia kishte kthyer se „nuk ishte fjala për dështimin, që po të shikohej realiteti tragjik shqiptar dhe ato që ndodhnin aty, ishte më se i qartë, por bëhet fjalë, së pari për hetimin, vlerësimin dhe kuptimin e ndodhjes së fatkeqësisë dhe përmasave të saj tepër të mëdha, e pastaj për rifillimin e përballimit të saj, që nënkupton një rilindje me të cilën shënohet kthesa kah e mundshmja, pra tek ajo që gjithsesi se një ditë do të jetësohet...” vlerësime këto që Skulptorit i ishin dukë paksa si fluturime nëpër qiell, që mund t’i merrte me mend e madje t’i arsyetonte, por kishte thënë se në atë vorbull te zezonës nëpër të cilën përpëliteshin „çështjet duhej të ktheheshin kah shpëtimi i Shqipërisë“, që sipas tij „këtë do ta mundësonte vetëm shpërthimi i asaj lufte të madhe, e cila ishte në prag dhe assesi ndryshe“, mendim që e kishte përsëritur sa e sa herë gjatë asaj bredhjeje, me uturimën e së cilës në kokë edhe ishte larguar nga Shqipëria.

„Unë dua *bërjen* e Shqipërisë Shqipëri dhe *jo shpëtimin* e saj“, kishte thënë Koloneli dhe kishte shtuar se „çështja e shpëtimit ishte çështje e mëshirës“, që nuk i besonte më dhe as ia dëshironte Shqipërisë, çështje këto që i kishte shpjeguar edhe me të *se shpëtimi* ka të bëjë me *zotin e urdhrave*, ndërsa *bërja* lidhej me *zotin e lirë*...

Kthesën e madhe Koloneli do ta arsyetojë me fjalët, të cilat i kishte thënë me një vendosmëri të paparë:

„Ka qenë mashttrim i madh ideja e shpëtimit të Shqipërisë pa u krijuar dhe pa u pranuar si e tillë. Është dashtë të mendohet për bërjen e Shqipërisë Shqipëri në përmasat e saj të njëmendta, jo vetëm si një realitet të domosdoshëm politik, që lidhet me të drejtën etnike dhe historike të një populli për mbijetim dhe zhvillim të barabartë me të tjerët, por për më shumë edhe si çështje e madhe civilizuese, ku besimet e ndryshme kishin bashkëjetuar mrekullisht, në vend se të luftoheshin, siç kishte ndodhur në tokën e shenjtë dhe gjetiu...”

Duket se ky qëndrim, që për herë të parë e kishte dëgjuar t’i thuhej aq prerash dhe aq haptas nga Koloneli, e kishte çrregulluar fare Skulptorin sa atij i ishte përmbysur përnjëherë diçka që gjatëkohë e kishte ndërtuar me mund të madh pa ditë se nuk mund të qëndronte. Thujse shthurshëm kishte ndjekur mendimet e Kolonelit, të cilat gjykuar nga pikëpamja morale e edhe ajo politike madje, i kishte quajtur të drejta, por megjithatë, nuk kishte heqë dorë nga përcaktimi nismëtar, se në ato rrethana fare fatkëqija, e vetmja gjë e cila kishte kuptim ishte mendimi dhe veprimi për shpëtimin e Shqipërisë, që edhe më tutje kishte bindjen se mund t’i vinte vetëm nga lufta e madhe, e cila ishte në prag dhe assesi ndryshe...

„Po nuk ndodhi lufta e madhe Shqipëria zhbëhet pamëshirshëm nga faqja e dheut“, kishte thënë Skulptori.

„Megjithatë, kjo nuk do të ndodhë, edhe pse duket se tashmë ka ndodhur dhe mund të merret si çështje e kryer nga ata që këtë e dëshirojnë e për të kanë punuar err e terr dhe nga të tjerët të cilët çoftë edhe pavetëdijshtë dhe me bindjen se po ia japin krahun, me veprime të pandërgjegjshme i kanë ndihmuar kësaj rënie, ngaqë Shqipërinë e bëjnë perënditë e saj, që e mbrojnë edhe atëherë kur kjo duket e pamundshme“, ia kishte kthyer Koloneli me një tundim thujse demonstrues, që Skulptorit ia kishte futur dyshimin se ishte shkallimi i madh dhe humbja e besimit te njerëzit që kokës së tij ia kishin kthyer ndjenjën e misticizmit, ku ai gjente mbështetjen e vetme dhe prej nga përposheshin edhe ato që dukeshin andralla vere.

„Është hiri i vdekjes që sjell jetën...“, kishte thënë Koloneli.

Ngjashëm i kishte folur edhe kontit Sombah dhe kjo bindje e thënë aq guximshëm prej tij thuajse e kishte nxjerrë prej binarëve ushtarakun dhe diplomatin finok, i cili pas asaj që kishte dëgjuar nga Koloneli t'ia thuhej *rreth bërjes dhe jo shpëtimit* të Shqipërisë, dhe me ato që kishte thënë „se po del se edhe misioni i vullnetarëve dhe të tjerëve të cilët kanë vendosur të vdesin për Shqipërinë ka qenë gabim“, sikur kishte humbur toruan fare, saqë Koloneli nuk kishte pasur nevojë t'ia përgjigjej, pos t'ia përsëriste ato që kishte thënë pak më parë, të cilat i kishte vërtetuar edhe më tepër realiteti tragjik shqiptar, gjë që kontit Sombah mund t'ia ishin dukë edhe më të rënda nga dyshimi se kur fliste ashtu Koloneli mund t'u kishte rënë në fije qëllimeve të njëmenda të atyre që fshihte misioni i vullnetarëve?...

...

I mbyllur në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, Koloneli kishte pasur kohë me bollëk të mendonte për idenë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, si domosdoshmëri civilizuese, që i duhej botës për të shpëtuar nga gremina, të cilën ia kishte thënë për herë të parë Skulptorit dhe më pas kontit Sombah, që njëherësh e kishte shtyrë të arsyetonte mëdyshjen e më vonë edhe heqjen dorë nga *ideja e shpëtimit të Shqipërisë*, që asaj i vinte nga jashtë, goftë me ndërhyrje apo edhe me anën e ndihmave të drejtpërdrejta dhe dërgimin e vullnetarëve, sikundër ishte edhe misioni i shpallur i njësitit të cilit i kishte prirë gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të bredhjeve nëpër linjat e fronteve shqiptare, ose edhe me plasjen e luftës së re botërore, të cilën Skulptori e shihte si të vetmen mundësi të shpëtimit të saj, të cilën ai e lidhte me ndërprerjen e luftës vëllavrasëse si dhe atyre që sillte ajo në ato rrethana, që edhe mund të arsyetohej përballë atyre të cilat ndodhnin.

Në këtë shënim do të gjendet jo vetëm ajo kthesa vendimtare e largimit nga „*ideja e shpëtimit të Shqipërisë*“ dhe fillimisht e përkrahjes së saj, ku pas sqarimit se fjala ishte për një ngatërrimi midis asaj që merrej si qeveri e përkohshme, të cinguar dhe të pashpresë për të marrë veten dhe qenies Shqipëri, e cila me ato vendime dhe veprime nga jashtë duhej ta pengonte bërjen e saj të njëmendët, Koloneli do ta quajë „të gabueshme“, por pak a shumë do të hidhet dritë edhe te arsyet e asaj heshtjes stoike, e cila kishte zgjatë plot gjashtëdhjetë e gjashtë ditë gjatë asaj bredhjes nëpër vijat e fronteve shqiptare në përmbushje të pikave të hartës së sjellë nga kontit Sombah, heshtje kjo e cila më në fund ishte ndërpre me shpërndarjen e njësitit të vullnetarëve atë mëngjesin e të nesërmes që në Mollas ishte dashtë të shënonte atë rifillimin e bredhjes në pritje të luftës së madhe botërore, të cilën Koloneli më vonë do ta quajë „flakë të madhe që botës i vinte si dënim i merituar ndaj mëkateve të cilat ia kishin bërë Shqipërisë, por edhe vetvetes...“

Ndonëse Koloneli qysh me rastin e vendimit për spikatjen e flamurit të bardhë, ditën e pesëdhjetë - kur në pikën që ndante Tiranën me Durrësin përfundimisht ishin mbyllur vijat e fronteve midis trupave kryengritëse dhe atyre qeveritare në dobi të të parëve dhe pastaj kishin filluar ato të ngatërruara deri në paqartësi të pashpjegueshme të luftërave midis forcave të ndryshme ndërshtetërore - kishte bërë me dije se ata gjatë asaj bredhjeje nuk ishin as mbrojtës e as shpëtimtarë të Shqipërisë, megjithatë, me këtë sikur kishte paralajmëruar kthesën të cilën do t'ia shfaqte fare papritmas Skulptorit dhe do t'ia bënte me dije edhe kontit Sombah natën e parafundit e më vonë do ta përqafonte si të vetmen për ta ngritur në ideal madje.

„Durimi të bën perëndi“, kishte shkruar Koloneli rreth kësaj çështjeje dhe kishte shtuar se „gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve, ishte vrarë përditë e nga pak dhe me të drejtë, por e gjitha kishte qenë një stërzgjatje e mundimshme, ku megjithatë një vdekje kishte prodhuar një lindje të re, një rilindje, një rizgjim dhe një rikthim, që kishte çuar drejt kuptimit dhe vetëkuptimit të pakufishëm, që kishte pasur për pasojë një ndijim të jashtëzakonshëm dhe madhështor, ku një gjendje kishte zëvendësuar gjendjen tjetër dhe e gjitha mund të shpjegohet si ngritje kah një lartësim i pafund larg sendeve dhe larg çdo fërkimi me ato që

prekën dhe shijohen për t'u shpenzuar në shërbim të zilisë, të smirës dhe të urrejtjes më të shëmtuar...”

Duket se nga mëngjesi, kur mendja kishte filluar t'i lodhej, por këtë nuk kishte dëshiruar ta pranonte, Koloneli kishte sajuar disa vargje, të cilat pastaj i kishte lidhur në një si vjershë, të cilën kishte deshtë ta shqyente ngaqë këtë ia kishte nxjerrë njëfarë mëdyshje, që nuk duhej të ishte dhe nuk duhej ta pranonte, (dhe kjo dëshmohej prej bërjes shuk të letrës dhe vijave të trasha që u kishte ra vargjeve përmbi), por megjithatë ishte vendosur te fletët tjera të trajtesës së tretë. Vjersha kishte qenë kjo:

*„Rrethi
Fundi
Përsëritja
Një mijë vjet
Dhe gjithmonë
Njësoj
Fundi fillim
Fillimi fund
Njësoj
Dhe njësoj
Një mijë vjet
Dhe gjithmonë
Rrethi
Fundi
Rreth
Vetëm rrethi
Dhe rrethi-rreth...”*

Këto vargje nuk kishin qenë të vetmet. Ato do të shfaqen gjithnjë e më shpesh, herë të shkëputura e herë të lidhura, që duket se Kolonelit i kishin shërbyer për t'i bërë zap rreziqet e bredhjes dhe kapërcimet nga çështja në çështje, të cilat ishin të shpeshta, përkundër asaj se do të sqarojë se „vargjet që lente ishin një përpushje e pashpjegueshme, të shumtën pjesë të mendimeve të huaja, të cilat nuk i kujtoheshin se prej nga ishin dhe pse i qepeshin“, por ndonjëherë do të pranojë se ato mund të ishin pjesë e ndonjë të menduarit „të veçantë“ si ndjenjë apo shpalim i papërmbajtshëm, që i shfaqej kundruall meditimmit të thellë dhe të pandalshëm, të cilin e quante „pjesë të hetimit të vetvetes...”

Disa prej atyre vargjeve, të cilat qëndronin midis shfrimeve tendosëse dhe ngatërresave shpirtërore, që thoshte se i vinin nga „pjesëzat e mendimeve të huaja dhe të panjohura fare dhe assesit t'i ndaheshin“, Kolonelit i ishin kthyer në një refren, që pasqyronin gjendjen me emocione, së cilës po i jepej gjithnjë e më shumë sa më tepër i afrohej atij fundi, të cilin e priste dhe e dinte se e kishte fare afër dhe e merrte për një rifillim, rikthim, që ndonjëherë e quante edhe rizgjim të përgjithshëm dhe ndryshe-ndryshe...

Se vjershat e shkapërderdhura nëpër shënime, megjithatë kishin një rëndësi të veçantë dhe ato nuk paraqitnin vetëm „shfrime të papërmbajtura“, si i quante Koloneli, apo „ngacmime të çuditshme, që i vinin nga dika dhe nuk ishte në gjendje t'i sqaronte“, por ato shfaqnin më shumë se një përpushje të përhershme, të cilat i takonin një ndijimi më të gjerë drejt thadrimmit të asaj që mund të merret si kujtesë e cila kërkonte të kthehej në ndjenjë të hollë dhe tepër sublime, kjo mund të dëshmohej me vargjet-refren („*ndjehem i huaj pa ty/ndjehem i vetmuar me ty*“), të cilat e fejuara Helenore von Braun, do t'i zgjedhë si epitaf varri, kur ato të gdhendura në pllakën e granitit të zi, nga një shtatori i vitit 1939, që njëherësh ishte dita e fillimit të një lufte tjetër të madhe botërore, do ta shoqërojnë përgjithmonë...

...

Po kush ishin ata perëndi të cilët do ta bënin Shqipërinë Shqipëri rreth të cilëve aq shumë kishte meditar Koloneli gjatë vetmisë në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes deri sa do ta gjejë ai plumbi i cili do t'i vijë si prej qiellit pikërisht atë ditën që do të shpallet lufta e parë e madhe botërore, që ai ishte i bindur se fitilin e kishte pasur në Shqipëri dhe aty do t'i mbetej përderisa ajo të bëhej Shqipëri?...

Në trajtesën „Feniksi“ Koloneli do të shënojë se „perëndi të Shqipërisë mund të bëhen ata që dinë të mendojnë dhe ata që dinë të veprojnë dhe ata që dinë të flijohen për të dhe ata që janë në gjendje edhe me mishin dhe gjakun e vet ta rimojnë atë“ sa herë të duhet...

Bashkëveprimin e të menduarit dhe të vepruarit Koloneli e kishte parë si të domosdoshëm që t'u mbyllet rruga atyre prirjeve me të cilat çështjet madhore si ishte ajo e bërjes së Shqipërisë Shqipëri të kthehen në grindje të mundshme për merita dhe karshillëqe tjera me çka rrënohen themele e ngrehinës së saj...

“Atdheu ka vetëm borxhlinj“ - kishte shkruar Koloneli.

Edhe pse në një copë letër do të gjenden shumë e shumë emra pjesërisht të palexueshëm dhe disa të tjerë fare të paqartë, të shquar herë si martirë e herë si heronj, megjithatë dalloheshin ata të studentit Zenel Xhema dhe të kosovarëve Brahim Avdyli, Gjon Selmani dhe Deli Braha, për të cilët Koloneli disa herë kishte theksuar se „vetëm të tillët mund ta bëjnë Shqipërinë Shqipëri“.

Telegrafisti Bruner i kishte të njohura fjalët që Brahim Avdyli kishte thënë rreth asaj se *“ishim të detyruem me dekë për Shqipëri”* si dhe ato të cilat Deli Braha ia kishte thënë me rastin e dorëzimit të qëndrimeve të marra në atë Kuvendin e Verrave të Llukës *„Nji besë për Shqipërinë”*, kur ai kishte thënë se *„duhej me i ditë bota”*, fjalë këto të cilat pastaj Koloneli ia kishte përkujtuar Skulptorit si një mallkim që gjen ata të cilët nuk mendojnë dhe nuk punojnë për Shqipërinë.

Gjatë rrugës së mundimshme gjithë zabullimë, e cila ditën e dyzet e pestë të zvarritjeve nëpër hapësirën e vijave të fronteve shqiptare do t'i qonte për në Fikas, me parandjenjën se me atë mallkim do të takoheshin shumë shpejt, Koloneli i kishte folur Skulptorit gjithë dëshpërim se shkëputja e Kosovës paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm drejt vrasjes së idesë së bërjes së Shqipërisë Shqipëri, që ishte menduar mirë e mirë prej kundërshtarëve të saj, në mënyrë që njëherë e përgjithmonë të shuhej edhe ajo vija shekullore e puqjes së qytetërimeve dhe kjo të ndodhë në zemrën e saj me anën e një ndëshkimi të tmerrshëm pse kishte qenë e tillë dhe pse kishte ruajtur dhe ushqyer çuditërisht ato që nuk duhej të ishin të tilla dhe ishin marrë për herezi, ndërkohë Skulptori i ngarkuar me emocione ia kishte kthyer se ky ishte njëri ndër krimet më të rënda ndërkombëtare që do të mjaftonte të dënohej bota me një luftë të madhe, të cilën e kishte në prag, me kusht që ajo të mos kishte fitues, ku të gjithë do të humbnin njësoj, sado që kjo ishte e pamundur.

Më vonë, pra po atë ditë kur kishin lënë pas kasaphanën e Fikasit dhe gjëmën e luftës vëllavrasëse e cila tashmë kishte filluar andejpari me masakrimin e besimtarëve të krishterë ditën e bajramit të madh në atë katund të shkretë, sikur të dëshironte të largonte vëmendjen nga tmerret me të cilat po ballafaqoheshin, të cilat haptas e shpralllosnin misionin e tyre në mbrojtje të mbretit dhe të qeverisë së Shqipërisë, Koloneli për herë të parë kishte dëgjuar nga konti Sombah të fliste thuajse me gjysmë goje rreth asaj se „Kosova dhe çështja e saj“, të cilën e kishte quajtur „tepër tragjike“, Shqipërisë i mbeteshin „peng i madh që mund ta pengonin bërjen e saj“, ndërkohë Koloneli i kishte thënë se „nga zgjidhja e atij pengu do të varen edhe kahet e luftës së ardhshme dhe luftërave të tjera, të cilat nuk do të kishin të sosur, që do të ktheheshin dhe riktheheshin aty siç i ndodh vrasësit të kthehet në vendin e krimit nga ndërgjegjja e papastër...“

Dhe, duke dëshiruar t'ia kundërshtonte mendimin e pakmëparshëm, ku çështjen e Kosovës do ta quajë „tepër tragjike“, që bazuar në ato të cilat ndodhnin atje përnjëmend shfaqej e tillë, dhe jo si ishte, pra „çështje e okupimit me dhunë e nga ushtritë serbe dhe malaziase dhe e shkëputur nga trungu amë“, të cilën për fat të keq Konferenca e Ambasadorëve në Londër e kishte përligjur, mendim ky që ishte edhe i një pjese të madhe të opinionit austriak dhe gjerman si dhe i shumë qendrave intelektuale të këtyre vendeve, Koloneli do të thotë se „bota së shpejti do të gjendet para sprovës për të korrigjuar gabimet e bëra, apo për t'i dëshmuar si të qëllimshme me çka e merr përgjegjësinë por edhe ndëshkimin për ato që do të pasojnë. Tjetër nuk ka...“

Duket se kontit Sombah, i cili kishte nisë të lëshohej në biseda të tilla me thumba me Kolonelin pasi ai kishte urdhëruar që lëvizjet e tyre të mëtutjeshme drejt përmbushjes së pikave të hartës së sjellë nga Vjena të bëheshin nën flamurin e bardhë, vendim ky i cili nga ushtarakët austriakë dhe gjermanë ishte vlerësuar si provokim dhe nënçmim madje, nën trysninë e fjalëve të fundit të Kolonelit ishte tërhequr paksa, gjithnjë duke u munduar çështjet t'i hedhë „te fatet e luftës“ dhe ato të cilat mund të ndodhin më pas „si dëme të paparashikuara“, gjë që Kolonelit i kishin shërbyer edhe për një kundërsulm tjetër kur kishte thënë se „ushtarakët janë ta bëjnë luftën ashtu si duhet, që prej saj të mos lindin të tjera, të cilat pastaj u përplasen për kokë edhe atyre të cilët nuk e kanë hak...“ fjalë këto të cilat i kishte shoqëruar me kërcënimin se „mallkimit të mëkatit, që vjen nga vrasja e Shqipërisë, nuk mund t'i ikë askush, qofshin ato edhe perandori të forta sepse kështu ka qenë përherë dhe kështu do të jetë edhe më tutje...“ për të shtuar pastaj se „edhe Roma, edhe Bizanti jo rastësisht ngritjet dhe rëniet i kishin përjetuar në atë hapësirë dhe e gjitha ishte lidhur me atë si dhe sa e kishin përfillur apo shpërfillur rëndësinë e saj, si nyje e pashmangshme e botës, si ndërlidhje qytetërimesh, që njësoj mund të ndodhë edhe me pasardhëset e tyre“, ku ai kishte nxënë ngojë Perandorinë Osmane, e cila tashmë ishte në shkatërrim e sipër dhe këtë e kishte peshqesh nga mendjelehtësia e sakrifikimit të saj në vend se ta mbronte, por ngjashëm kishte folur edhe për monarkinë e Danubit dhe ardhmërinë e saj të pasigurt, nëse nuk do të nxirrte mësim nga e kaluara, mendime këto të cilat në njëfarë mënyre i ishin drejtuar jo vetëm kontit Sombah, i cili ishte i vetmi që e dëgjonte në atë mbërthim të zyrtarisë së shkretimeve shqiptar, por edhe përgjegjësve të tij të dukshëm dhe të padukshëm dhe të tjerëve që rrinin në kulltuqet skaj tavolinave të vendosjes me hartat e hapura para, dhe për hesapet e tyre përgatisnin luftërat e reja në trungun e saj të sakatosur pa qarë kokën se ashtu thyenin edhe degën mbi të cilën mund të qëndronin...

Konti Sombah kishte thënë se duhej ndarë çështjet e mëkateve nga ato të cilat i kishte quajtur „veprime të tjera të cilat lidheshin me sferat e interesit“, që mos të ngatërrohet morali me politikën, sado që kishte theksuar se e dyta duhet ta ketë parasysh të paren, por kjo Kolonelit i kishte shërbyer si shkas të jetë edhe më i drejtpërdrejt sa të thotë se „nuk ishte këtu fjala për shitjen e dushkut për gogla por për atë se vrasja e Shqipërisë bëhej pikërisht për të treguar të kundërtën, pra atë se politika vazhdon t'i marrë veset e kamotshme të religjionit, ku përjashtohet çfarëdo afrie e të kundërtave dhe me këtë qytetërimit të njëmendët dhe të lashtë serish i kthehet kufiri i ndarjes, me anatemen *si lindje* apo *si perëndim* krejt një, që për qindra e qindra vjet në ato hapësira kishte vepruar aq pamëshirshëm me çmimin e gjakut të kryqëzatave dhe të kryqtarëve të panumërt, të cilëve u është dashtë *zoti i kundërt* si kundërshtar apo armik, për ta mbrojtur *zotin e vet*, dhe atë *më të drejtën e librit të shenjtë si të vetëm* dhe kjo është bërë gjithnjë duke u luftuar tjetrin...“

Më tutje, Koloneli i kishte thënë kontit Sombah se lufta e madhe botërore, e cila ishte te dera dhe shumëkush e shihte si një bahçe, ku vilen edhe ato që nuk janë mbjellë fare, për pasojë do të ketë hapjen e kryqëzatave të reja, me kërkesa të vjetra nga drejtimit historikisht të njohura dhe ky fitil zjarri i parashikueshëm nuk do të kursente as perandorinë danubiane, as atë të Bosforit, por njësoj, krahas përfshirjes dhe shkatërrimit të tyre, do t'i shembte edhe

krijesat tjera të panatyrshme, të cilat në ato hapësira mund të shfaqen si zëvendësim i tyre, zhvillim ky që kishte thënë se kthente te përsëritja e të njëjtës...

„Bota do të kallët nga mëkatet e veta dhe, sa herë të ndodhë kjo, do të del në pah se nevoja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri i mbetet i vetmi shpëtim...”

Me t’i dëgjuar këto si dhe mënyrën si ishin thënë, konti Sombah thuajse kishte dalë nga vetja, që për pasojë kishte pasur hapjen e një bisede aspak të lehtë me Kolonelin, përmbajtja e së cilës telegrafistit Bruner do t’i mbetet e ngulitur në kokë përherë dhe do t’i silltet dhe pështillet si një mozaik i zhdrejtë, pra jashtë rregullave, që nuk plotëson pamjen nga ato që i ngjiten një nga një, por nga pjesët që i hiqen qoftë edhe me anën e shkëputjeve të dhunshme për ta shfaqur realitetin e ashpër, pra atë të njëmendtin. Dhe duket se nga trysnia e atyre të cilat kishte thënë Koloneli rreth kalljes së botës nga mëkatet e veta si dhe nevojës të shpëtojë me anën e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, pra si të tillë, që shkon tutje realitetit politik për t’u pranuar si vlerë qytetëruese, konti Sombah kishte dalë nga binarët sa të thoshte se „duhej ditur kah silltet bota“, ironi kjo e cila Kolonelit i kishte shërbyer pa hezitim me ia kthye se ashtu si veprohej në atë hapësirë bota sikur e kishte të qartë çfarë nuk donte, por jo edhe çfarë donte, që mjafton për ta humbur pusullën fare së cilës pastaj i paguhet tagër i madh...

...

Kur „kallej bota nga flaka e mëkateve të veta“, ndërkohë që shqiptarët, në vend se të zgjoheshin, ta merrnin veten dhe t’i iknin katrahurës në të cilën ishin futur, tymin e saj e shfrytëzonin për ta luftuar vetveten sa më shumë dhe sa më rëndë që është e mundur, pra në atë tmerr i cili dukej si i pafund, Koloneli do të përmend traktatin „*Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri*“, të kolonel Ibrahim Prevezës, që shfaqej si një mrekulli e njëmendët, të cilën në shënimet e teqesë së Leqes do ta quajë „pjesë e rëndësishme e të menduarit por edhe e të vepruarit për bërjen e Shqipërisë Shqipëri...”

Oficerin Ibrahim Preveza, Koloneli e kishte takuar për herë të parë para trembëdhjetë vjetësh në një betejë afër Halepit, kur kishte komanduar forcat e armatës së dytë lindore të perandorisë osmane kundër britanikeve dhe kjo kishte qenë beteja e fundit, që ndonëse nuk ishte arritur dështimi i plotë i forcave kundërshtare, megjithatë britanikëve u ishte bërë me dije se nuk do ta kenë të lehtë të shembin ngrehinën perandorake të Bosforit, po qe se ajo, në vend se të mundohet të mbrohet me çdo kusht dhe me allishverishe, që nuk i shkojnë për shtati, do t’i kthehet sulmit si mbrojtje, gjë që nuk kishte ndodhur...Kolonelit i kujtohet që oficeri shtatëlartë Ibrahim Preveza i kishte thënë se perandoria nuk e kishte të gjatë nga shkaku se ishte përfshirë nga letargjia e njëfarë shpëtimit me anën e pazarllëqeve të shumta e të rrezikshme, që nuk kishte si të përfundonin ndryshe pos me dështim dhe humbje të pashmangshme...

“Ata që kërkojnë fitoren dhe veprojnë për ta arritur mund ta kenë ardhmërinë, ndërsa ata që mendojnë për shpëtimin të dosidoshëm nga jashtë mund të ngushëllohen vetëm me mëshirën nënçmuese dhe dështimin...”

Në përputhje me këtë qëndrim kishte ndryshuar edhe përcaktimi i kredos themelore të Kolonelit ndaj realitetit shqiptar dhe ardhmërisë së tij, me ç’rast ai do t’i kthehet të menduarit por edhe veprimeve të drejtpërdrejta që thoshte i shërbenin bërjes së Shqipërisë Shqipëri, me çka hiqej dorë dhe përjashtohej plotësisht ideja nismëtare e „*shpëtimit të Shqipërisë*“, të cilën dikur e kishte përkrahur dhe i ishte bashkuar motos së saj kur kishte ardhur në krye të vullnetarëve në Shqipëri, që nga larg ajo tingëllonte fare ndryshe, si një veprim i domosdoshëm ku do të mbrohej mbreti dhe shteti shqiptar e jo t’i bëhej sehir asaj zhbërje të pamëshirshme. Dhe kur ishte më se e qartë se nuk kishte shtet shqiptar që do t’i bënte ballë së paku një stine edhe çështja e mbretit nga jashtë, shfaqej vetëm si një iluzion, të cilin më vonë do ta quajë „lojë e huaj“ dhe „kurdisje të madhe“, ishte e natyrshme që gjendja tepër tragjike nëpër të cilën po kalonte bota shqiptare ta kthejnë te ideja e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, si

domosdoshmëri politike dhe vlerë e përgjithshme qytetëruese, me të cilën ajo përfundimisht mund të nxirrej nga kthetrat e lojërave të ndryshme diplomatike dhe prapaskenave politike, të cilat e kishin çuar te shtrati i vdekjes, ku ai shkëputjen e Kosovës e merrte për pjesë të asaj vrasje të tmerrshme, që si thoshte „megjithatë nuk do të bëhet realitet i përhershëm, edhe po e pranoi e gjithë bota këtë, edhe po e mundësuan shqiptarët e pandërgjegjshëm, ngaqë kosovarët nuk do ta lejojnë kurrën e kurrës...“

Mbi këtë preokupim zaten Koloneli i ishte krijuar ai halucinacioni dhe ai farë ngatërimi i vrasjes vetanake me atë të Shqipërisë, që edhe ishte i kuptueshëm, ngaqë të menduarit e thellë dhe nënshtrimi i plotë bindjes se përkundër ndodhjes së një krimi të paramenduar po i jepej një gjendjeje të lartësimit shpirtëror, pra ajo bindje atë e kishte njëjtësuar tërësisht me vrasjen e paralajmëruar e cila i ishte përgatitur aq haptas Shqipërisë, që edhe do të ndodhte me fillimin e asaj lufte të madhe botërore, por përkundër saj dhe fatkeqësive të cilat do të sjellë ajo njëherësh do të paraqesë edhe fillimin e pashmangshëm të rrugës së gjatë dhe të mundimshme të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, të cilën ai e lidhte me domosdonë e shfaqjes së diçkahës që u jepte fund gjithë atyre përplasjeve botërore, gjithë atyre ngatërresave dhe prapaskenave, të cilat i ishin drejtuar asaj, por çuditërisht u ishin kthyer në një mallkim të përhershëm sa të kërkojnë shpëtim prej saj...

„Shqipëria dhe vetëm Shqipëria shpëton vrasësit e saj dhe kjo është gjëja më e madhërishtme“, kishte shkruar Koloneli përballë asaj gjendjeje transhedente, me ç’rast kishte shtuar „se asaj doemos do t’i kthehen një ditë për t’i kërkuar falje madje!...“

...

Marrja me traktatin „Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri“ të kolonel Ibrahim Prevezës dhe ato që do të thuheshin për të, në të vërtetë paraqesin vetëm një pjesë të përfytyrimeve shpërqendruese midis ëndrrës dhe anktheve dhe atyre me të cilat kohëve të fundit ishte ngarkuar si shumë Koloneli në atë dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ku kishte pritur vrasjen e paralajmëruar, ngarendje këto që kishin gjetur pasqyrim edhe në shënimet e lëna, të cilat gjithnjë e më tepër vuanin nga shkëputjet, që ndonjëherë ato i lenin të pakryera, por edhe si të tilla pasqyronin gjendjen e njëmendët në të cilën ndodhej aty ku kufiri midis jetës dhe vdekjes bëhej gjithnjë e më i paqartë sa të ngatërrohej fare, gjë që këtë e kishte shpjeguar me pandehmën „po sillem andej kah të vdekurit shfaqen të gjallë dhe të gjallët të vdekur...“

Pasi do të përkujtojë se kolonel Ibrahim Prevezën e njihte nga koha e luftës kundër forcave të perandorisë britanike që kishin bërë bashkarisht skaj një shkretëtirë e cila lidhte vendet e Sirisë me ato të kalifatit të Bagdadit dhe si me nostalgji do të flasë për mijëra e mijëra ushtarë të rreshtuar në shumë e shumë kontingjente, që do të bëjnë një luftë të madhe, me çka perandorisë osmane do t’i kthehej për pak vetëbesimi i humbur nga disfatat e shumta ushtarake të përjetuara në Egjipt dhe pjesët tjera arabe, por nuk do t’i ndalej dergja që do t’i kthehej në exhel, Koloneli do të ndjek pjesët e një ëndrre me paqartësi të shumta, ku kolonel Ibrahim Preveza i ishte shfaqur befasisht herë me rrobe të një gjenerali, e herë si një qiri përmasash të mëdha, që vetëdigjej e shkrihej dhe ashtu në atë shndërrim të vazhdueshëm kishte zënë t’i fliste me dhimbshuri për katandisje në të cilin ishin zhytur pas gjithë atij shkëlqimi perandorak nga shkaku se u pamundësohej t’i përgatisnin dhe t’i udhëhiqnin luftërat e rregullta të cilat për fat të keq u ishin lënë në dorë atyre që nuk i kuptonin ato për t’i kthyer kundër vetvetes dhe po ashtu po i tregonte për një vrasje e cila ishte bërë në një luftë tjetër të madhe botërore, që sikur përsëritej nga stina në stinë si një mallkim i pandalshëm së cilës i paguhej haraç i madh gjaku...

Atë ëndërr-bisedë, që më tutje do t’i japë shkas për të përkujtuar traktatin „Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri“ të bashkëluftëtarit të dikurshëm të betejave të mëdha perandorake, kolonel Ibrahim Prevezës, Koloneli do ta përshkruajë kështu:

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Deri kur do të sillesh bllaqukeve shqiptare?...“

Përgjigjja:

„Deri sa të vritem...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„E mandej?...“

Përgjigjja:

„Do të ringjallem... Do të rikthehem... Do të rizgjothem...“

(Përshtetur një e qeshur e thartë, që i kishte ardhur si thekmë e ashpër...)

Kolonel Ibrahim Preveza:

„E mandej?...“

Përgjigjja:

„Mandej, do ta kaloj lumin...Pastaj, do të ngjitem një përpjete të pasosme...Pastaj, do ta mbledh një ushtri të madhe, ndër më të mëdhatë... Mandej, do të bëj atë luftën që do të jetë e jona dhe për qëllimet tona...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Nuk ke frikë se serish mund të kthehesh në bllaqkun shqiptar?...“

Përgjigjja:

„Do ta kapërcej lumin...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„A nuk ta thotë mendja se përtej lumit serish do të takosh vrasësit e Shqipërisë, ata që çirren në mbrojtje të saj ndërkohë nga të gjitha anët ia fusin thikat?...“

Përgjigjja:

„Ata nuk do të jenë më...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Do t’i lëshojë toka?...“

Përgjigjja:

„Sapo ta kalojnë ujin, do të shndërrohen në hardhuca, në bretkosa...Të tillët i pret dënimi i pashmangshëm i shndërrimit...Nuk kanë ku të ikin...“

(Pason një e qeshur e thatë...)

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Mendon se përgjithmonë do të mbesin të tillë?...“

Përgjigjja:

„Nuk bën ndryshe... Bishat do të kthehen në jokurrizor... Ky është dënim që i pret shpirtrat e ligë dhe ata që luftojnë kundër vetvetes...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Ndoshta mashtrohesh?...“

Përgjigjja:

„Prapë do ta kapërcej lumin...“

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Prapë dhe prapë?...“

Përgjigjja:

„Prapë dhe prapë, deri sa të vijë ai fundi, që sjell rifillimin, rizgjimimin...“

(Pason një e qeshur tjetër e fortë)

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Dhe prapë e prapë deri te ajo prapaprashtja që shpjen te shkretimi i askund-kurrkundjes?...“

Përgjigjja:

„Fundin do ta kthej në fillim... Ndryshe nuk bën...“

(Pason një thekmë tjetër)

Kolonel Ibrahim Preveza:

„Prapësht dhe prapësht?...“

Përgjigjja:

„Deri sa të vijë vrasja... Deri sa të shfaqet lumi... Deri sa të rikthehem... Deri sa ta bëj luftën time, luftën tonë...“

(Pason edhe një e qeshur e fortë, e cila ndërpritet me fjalët e Kolonel Ibrahim Prevezës rreth një vrasjeje dhe ri vrasje, si dhe një tjetre, që mund të sillte ringjalljen, të cilën e priste, që i kishte thënë se mund të zgjaste me qindra e qindra vjet, por megjithatë do ta priste dhe do ta priste pa marrë parasysh zgjatjen dhe pa marrë parasysh se më pastaj prapë mund të vritej dhe të rivritej...)

Në vazhdim, Koloneli do të sjell diç nga kallëzimi i kolonel Ibrahim Prevezës rreth një bisede për një luftë të përbashkët në atë luftën e dytë të madhe botërore, që është dashtë të lidhë midis forcave të ndryshme shqiptare të shkapërderdhura në anë të ndryshme, që për fat të keq kishte dështuar dhe po ashtu do t'i flasë për atë vrasjen e dytë, që i kishte ardhur nga shkaku se kishte shkruar dhe mbrojtur traktatin „*Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri*“.

Rrëfimi i kolonel Ibrahim Prevezës do të shënohet kështu:

„Dukej se ishte në prag përfundimi i asaj lufte të madhe botërore, të dytës me radhë, që kishte ndodhur njëzet e një vjet pas përfundimit të luftës së parë të madhe botërore dhe ne ishim në pritje të atij qartësimi që do të mundësonte rifillimin e përpjekjeve tona për bërjen e Shqipërisë Shqipëri, përpjekje këto që mund të kurorëzoheshin me sukses nëse do të sendërtohej bashkimi i të gjitha forcave luftarake nën udhëheqjen e Ushtrisë së Përbashkët Shqiptare, e cila do të merrte në dorë fatet e luftës për t'u rreshtuar përkrah atyre që do ta fitonin atë luftën e madhe botërore, të dytën me radhë...“

Natyrisht se për këtë duhej një marrëveshje, duhej një përpjekje e madhe që forcat e shkapërderdhura luftarake shqiptare në anë të kundërta të bashkoheshin dhe kjo nuk mund të bëhej pa vendimin e prerë dhe betimin e atyre që luftonin nën flamuj të ndryshëm dhe nën ombrellë të huaja se në të ardhmen lufta e tyre i nënshtrohej idealit të bërjes së Shqipërisë Shqipëri në përputhje me të drejtën për bashkim dhe shtet të përbashkët, siç e kishin të tjerët...

Por, ç'e do se në atë luftë, si edhe në luftërat e mëparshme, dikush i binte thumbit e dikush patkoit, kush andej e kush kënde, kush për lisa e kush për fshisa...

Megjithatë, në një teqe të Gjakovës, skaj Çabratit, njëherë për të vetmen herë dhe për të fundmen herë, u bisedua për luftën e përbashkët, u bisedua për atë që quhej ardhmëri, me çka u dëshmuar se ndodhja në anët e kundërta mund të ishte edhe rastësi, por mbetja në to do të thoshte më shumë se fatkeqësi... Pra, të gjithë e kishin të qartë se duhej heqë dorë nga rastësitë, që në sajë të fjalëve mashtrimitare mund të dukeshin joshëse, për t'iu kthyer marrëveshjeve me të cilat parandalohej fatkeqësia e madhe që ishte në prag dhe kjo mund të bëhej nëse shikohej interesi i përbashkët, i cili nuk mund të ishte tjerë pos bërje e Shqipërisë Shqipëri... Marrëveshja, pra, po të bëhej, do të thoshte mundësi e mirë për shpëtimin e vatanit, se po nuk u bë, atëherë hapeshin plasaritjet e pashmangshme të një lufte të brendshme vëllavrasëse, që do ta qëllonte pamëshirshëm idenë e bërjes së Shqipërisë Shqipëri, por do të sillte edhe kobe të tjera, të cilat nuk do të kishin të ndalur...

Baba Tali tha se përçarja do të rendonte mbi ata që nuk do ta bënë këtë bashkim që do të shkonte edhe te gjeneratat e ardhshme si një mallkim i tmerrshëm.

Këtë e dinin të gjithë, por krimbi i ndarjes ishte më i madh se vullneti për bashkim, që shpirtit tonë ia kishte lënë sëmundjen e pashërueshme të ngarendjes pas flamujve të huaj, pas kurorave të huaja, pas ngjyrave të huaja...

Me një fjalë, nuk duhej bashkimi...

Nuk duhej lufta e përbashkët...

Nuk duhej ngaqë ishin rishfaqur ato luftërat e veçanta, ku tashmë kishte ideologji, ku kishte revolucion, ku kishte zotime të internacionalizmit proletar dhe ç'mos tjetër, pos zotimit për bashkim të njëmendët kombëtar...

Duhej, pra, lufta ideologjike...

Duhej, pra, revolucion i botëror...

Dhe kështu ajo lufta e madhe botërore, e dyta, siç ndodhi edhe gjatë luftës së parë të madhe kur u zhbë ajo Shqipëria, u kthye në luftë të brendshme, prapë u kthye në luftë vëllavrasëse dhe serish hapësira shqiptare u përgjak dhe u vetëpërgjak deri sa u kthye në një bllakull amull në të cilin ka mbetur...

Lufta e brendshme vëllavrasëse shqiptare filloi dhe vazhdoi me përcaktimin dhe kundërpërcaktimin rreth traktatit „Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri“, që mori aq shumë e aq shumë koka, që vendin e ktheu në një ployë të re të gjakut...

Dhe traktati „Për bërjen e Shqipërisë Shqipëri“, me betimin „ta bëjmë Shqipërinë Shqipëri“ edhe më tutje ndan shqiptarët... Edhe më tutje vret shqiptarët... Edhe më tutje së pari vret pandalshëm hartuesit dhe përkrahësit e saj, siç i ka vlarë atë ditën që do të përfundojë ajo lufta e dytë e madhe botërore nga gjykimi që u erdhi prej atyre të cilët i kishin ikur luftës së përbashkët ngaqë kishin përkrahur bindjet internacionaliste, dhe do t'i vrasë të gjithë ata që për qëllim kishin bashkimin kombëtar dhe një të ardhme demokratike, të cilët nga fitimtarët ishin shpallur tradhtarë të rrezikshëm me të cilët duhej qëruar hesapet sa më parë dhe sa më ashpër...

Ai gjykim më vrau edhe pas luftës së dytë të madhe botërore dhe ndoshta do të më vrasë edhe pas luftës së tretë të madhe dhe do të më vrasë pas të gjitha luftërave, nëse edhe më tutje do të vazhdojë ajo mosmarrëveshja ndëreshqiptare rreth bërjes së Shqipërisë Shqipëri...”

Përsëkrimi e asaj ëndre me halucinacione Koloneli do ta mbyll me një si kërcënim, që e kishte dëgjuar në atë gjendje ankthi dhe nuk ishte i sigurt a i kishte ardhur nga ato që ia kishte thënë kolonel Ibrahim Prevezës apo nga gjetiu, ku thuhet se në rrethanat e përçarjeve ndëreshqiptare „janë të gjykuar për vrasje të pashmangshme të gjithë kolonelët...”

Në vazhdim të atij përfytyrimi me ankthe, Koloneli do të shkruajë se krahas shfaqjes së kolonel Ibrahim Prevezës, të cilin e kishte njohur nga ajo lufta e përbashkët, që e kishin bërë diku në hapësirat arabe trembëdhjetë vjet më herët kundër forcave perandorake britanike dhe krahas fjalëve të tij për atë vrasjen që e kishte gjetë në një luftë tjetër të madhe, që ishte e dyta, (sado që ende nuk kishte përfunduar e para, e cila sapo kishte filluar), për njëfarë gjykimi dhe për vrasjen e paralajmëruar i kishte folur edhe një kolonel tjetër, i cili si në mjegull dhe me zukatje ia kishte treguar emrin, të cilin nuk kishte qenë në gjendje ta qartësonte pikërisht nga ajo zabullimë që ia kishte mbërthyer kokën, por në atë shungullimë kishte kuptuar se pas atyre dy luftërave të mëdha botërore, sesi aty ishte shfaqur edhe një luftë tjetër e çuditshme, jashtë rregullave dhe fare e mjegulluar për nga qëllimet, që dal nga dalë kishte ngatërruar dhe barazuar vrasësit me të vlarët, por edhe kishte vazhduar t'ua merrte kokat kolonelëve dhe gjithë ushtarakëve të përgatitur, veçmas atyre të cilët kishin komanduar armatat e fuqishme perandorake, që pas shembjeve të tyre dhe mbetjes as andej e as këndeje, për ideal kishin bërjen e Shqipërisë Shqipëri dhe jo ngarendjen e verbër pas flamujve të huaj dhe atyre premtimeve joshëse, që kur shiheshin mirë e mirë, nuk shkonin tutje rikthimit tek gjendja e turbullt në të cilat ishte shfaqur ajo ndarja dhe prapaskenat e ndryshme, të cilat sikur vazhdimisht mbeteshin të lidhura për frymën e atyre marrëveshjeve të kamotshme, me të cilat ishte gjymtuar trangu shqiptar...

„O zot, prapë luftërat që janë bërë për ta penguar ngritjen e Shqipërisë Shqipëri, dhe prapë vriten kolonelët, të cilëve nuk u lejohet t'i parashohin, t'i përgatisin dhe t'i udhëheqin luftërat me të cilat bëhet Shqipëria Shqipëri?!“ kishte klithur Koloneli.

...

Mbase kishte qenë përmendja e Gjakovës në rrëfimet gjithë ankth te kolonel Ibrahim Prevezës, që Koloneli ia kishin kthyer përqendrimin te ajo besa, e cila para tridhjetë e dy vjetësh familjes së tij i ishte kthyer në mallkim, kur Maxharr Pasha, me rastin e përplasjes

me krerët e Lidhjes Shqiptare rreth zbatimeve të vendimeve të Kongresit të Berlinit, i kishte hy në kullë Avdulla Pashë Drenit dhe kështu kishte vu në veprim mekanizmin e saj të brendshëm me çka ishte hapur një luftë nga jashtë me pasoja të mëdha për të gjithë...

Koloneli do të përkujtojë se kur ishte nisur për shkollim në Gjermani, i ati i kishte folur diçka rreth besës dhe atyre të cilat ngërthente ajo, që kur e kishte lidhur me ato që i kishte sjellë familjes së tij gjatë Lidhjes Shqiptare, e kishte quajtur fat, të cilit nuk mund t'i ikej, dhe ashtu si e kishte nxjerrë nga goja atë fjalë të shkëputur por njëherësh të ngjizur nga një trandje e brendshme, thuajse kishte tingëlluar si fatkeqësi, si kob...

Ky shpjegim Kolonelit për pak i ishte përvijuar nëpër kokë si një vërejtje përdëllese, që me kalimin e kohës sikur i ishte fashitur fare nga anashkalimi i saj. Dhe po mos të ishte e fejuara Herlenore von Braun, (që besën dhe gjithë ato që lidheshin me të e kishte prekur nga shkaku i hulumtimeve publicistike që bënte, e ku ato që kishin ndodhur në Gjakovë atë ditën e gjashtë të shtatorit të vitit 1878, i kishte parë si „dëme të mëdha që Lidhjes Shqiptare i kishin ardhur nga ndërlikimi i pengut të saj në ato ngjarje“), me siguri se atë do ta harronte fare. Tek e fundit, pse duhej të merrej me një çështje që mendja ia kishte marrë se me ato që ia kishte thënë i ati mbetej e mbyllur, si një kujtim i hidhur, që duhej mbajtur sa më larg...

“Megjithatë, janë disa gjëra që të ndjekin pas qoftë edhe si hije“, i kishte thënë Helenore von Braun kur ai kishte rrudhur krahët para atyre që ajo zinte ngojë rreth besës dhe pushtetit të saj, që thoshte se shtriheshin nga hapësira individuale dhe shkonin deri te ajo shoqërorja në përgjithësi, ku nuk kishte përjashtime dhe pikërisht kjo e bënte të veçantë atë sa ta kthente në një normë tepër të rreptë dhe tepër të frikshme gjithëpërfshirëse, që barabartash shpërndan detyrimet, përgjegjësinë por edhe fajin, të cilën e kishte quajtur „gjykim i tmerrshëm që nuk mund t'i iket“ dhe kur kishte folur ashtu gjithë shqetësim, sikur kishte pasur për qëllim t'ia përkujtonte, por edhe t'ia bënte me dije çmimin që i paguhet betimit të saj edhe nga ata të cilët drejtpërdrejt nuk i prekë, por fryma e saj i detyron dhe përherë i mban të lidhur për të...

Koloneli do të pranojë se besa me ato që i takonin, rreth të cilave aq shumë i kishte folur Helenore von Braun, e që Skulptori herë i kishte ngatërruar me besimin e herë me „mbetjet e fënikërisë mesjetare“, megjithatë i ishte rikthyer si një dridhërimë shqetësuese çastin që Gjon Selmani, në atë takimin që ditën e dyzet e dytë të bredhjeve nëpër vijat e fronteve shqiptare, i kishte folur se ndjehej i turpëruem pse nuk e kishte mbajtur besën, që kishte thënë se „asht dashtë me deké e shkanë mos me e lanë aty ku prek betimi i saj“, dhe ngjashëm do ta ndjejë atë shqetësim nga ato, që në fund të atij takimi, ia kishte thënë Deli Braha rreth „besës së madhe“, e cila ishte lidhur te Verrat e Llukës nën betimin „*Nji besë për Shqipërinë*“, të cilën duhej ta dinte bota se për të vdiset dhe do të vdiset.

Duket se fatkeqësia shqiptare, që më së egri ishte pasqyruar me tragjedinë e Kosovës si dhe ato që ndodhnin midis tyre në mbrojtje dhe kundër shtetit të përgjysmuar, i cili po jepte grahamën e fundit, Kolonelit ia kishin futur frikën se çështja e Kosovës dhe shkëputja e saj përnjëmend mund të ktheheshin në një mallkim të ri shqiptar, i cili do t'i mbante ata peng dyanshëm pikërisht nga shkaku i ndërlidhjes së besës në të, jo si normë e pashkruar morale, por pse këtë herë ajo ndërlidhte shpërputhshëm çështjet e një mbijetimi të thjeshtë me kalkulimet e hapura, ku kosovarët bërjen e Shqipërisë Shqipëri e shikonin si kusht kryesor të saj, që për të ishin në gjendje edhe të vdisnin dhe këtë duhej ta bënin ngaqë nuk kishin zgjidhje tjetër, ndërsa në tjetrën anë, pranimi i atij gjysmë shteti shqiptar, edhe pse shfaqej si bryma para diellit, por me hesapin se le të bëhet njëherë gjysma se kështu mund të fitohet edhe gjysma tjetër, pra qoftë edhe me Kosovën nën pushtimin serbo-malazias, e cila kurrën e kurrës nuk do të pajtohej me këtë ndarje, për fqinjët të cilët e kishin sakatosur trungun shqiptar dhe për fuqitë europiane, që kishin nxitur dhe pranuar këtë, do të paraqiste më shumë se një shkas shtetit shqiptar, edhe si gjysmë, të mos i lejohej kurrë të merrte veten...

Përndjekja e kësaj frike, e cila do t'i kthehej në ankth, Kolonelin e kishte mbërthyer gjithnjë e më shumë gjatë atyre ditëve sa kishte ndejë i mbyllur në dhomën e madhe të ziçrit

të teqesë së Leqes në pritje të vrasjes, gjë që pasqyrimin e saj më të hapur e kishte gjetur te trajtesa „Besa që vret“, ku kishte dëshmuar prirjet fataliste, të cilave po u jepej sa më shumë i afrohej fundit, por njëherësh kishte shprehur edhe shkëputjet përfundimtare me ato bindje të cilat do t'i quajë „kurthe morale“ dhe gjitha ato që mund ta ngarkonin bërjen e Shqipërisë Shqipëri.

Me shumë shkëputje dhe fjalë të cilat do t'i shkruajë e rishkruajë si dhe fjali të tëra, që herë pas here do t'i heq nga përdorimi me arsyetimin se „nuk vlejnë“ apo „nuk i përputhen me bindjet“, Koloneli kishte ardhur te përfundimi se „besa, megjithatë, vret“ dhe atë e kishte arsyetuar kështu:

„Lufta mund të niset dhe duhet të niset me përkushtimin e fitores, por ajo nuk mund të fitohet me betimin e vdekjes...“

Lufta bëhet për të fituar jeta dhe jo vdekja...

Lufta nuk niset për të vdekur, por për të fituar dhe për të jetuar...

Lufta, pra është jetë nëse mbron jetën dhe ngjall jetën...“

Më tutje Koloneli kishte shkruar:

„Tjetër është vdekja që të kërkon, e tjetër është vdekja që e kërkon...Sepse, vdekja që të kërkon, që është vrasje çfarëdo qoftë ajo, në të vërtetë bëhet nga jashtë për t'u penguar një qëllim, për t'u vrarë ndonjë ide apo vepër, ndërsa vdekja që e kërkon apo që kërkohet, bëhet nga dëshpërimi, bëhet nga frika e dështimit, që nuk paraqet tjetër pos humbje...“

Me siguri se marrja me dallimin midis „vdekjes që të kërkon“ dhe „vdekjes që kërkohet“ për Kolonelin kishte paraqitur më shumë se një ndryshim të gjendjeve dhe bindjeve, ngaqë ai ishte njësuar me vdekjen e cila e kërkonte, e cila ishte një vrasje e paralajmëruar, që do ta gjente ditën e njëzet e pestë të mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, vrasje kjo e cila në atë gjendje të pashpresë doemos se ndërthurej me kuptimin e një ringjalljeje, të një ribërjeje, te një rilindjeje dhe ndryshe ndryshe, që do t'i ndihmonte idesë së bërjes së Shqipërisë Shqipëri, ndërsa „vdekjen që kërkohet“, do ta ndërthurë me atë betimin e kosovarëve „me dekë për Shqipninë“, që lidhej me atë mallkimin e përhershëm dhe të dyanshëm, i cili do të mbetej i tillë të prodhonte fatkeqësi dhe kobe të tjera të pandalshme përderisa e gjitha të kthehej në betimin „me jetue për Shqipninë dhe me punue për me e ba Shqipninë Shqipni...“, refren ky i cili thoshte se duhet përfshirë gjithë botën shqiptare, të gjitha pjesët e saj, pa marrë parasysh shkëputjet dhe ndasitë, që i janë futur në mes nga kundërshtarët e saj...

Asaj „me jetue për Shqipninë dhe me e ba Shqipninë Shqipni...“, Koloneli do t'ia kushtojë një si shkrim eseistik, që do ta vendos në fund të trajtesës dhe do të theksojë se „ishte pjesë e të të menduarit të Deli Brahës“, që „ia kishte shkoqur nga koka“ dhe, mbase do të thotë kështu nga bindja se të menduarit „besa që vret“ doemos i duhej e kundërta, si baraspeshë, pra ajo pjesa tjetër, që mund të merrej me mend, por ai nuk kishte dashtë ta quajë „besa që ngjall“ apo ndryshe, ngaqë kishte pasur frikë se në atë mënyrë, në atë mjegullën e cila edhe ashtu ishte e fuqishme, hapte një paqartësi tjetër, e cila do të mbetej e hapur dhe me pasoja tjera të paparashikueshme.

Mendimet, si porosi, të cilat Koloneli i kishte quajtur të Deli Brahës dhe „të shkoqura prej kokës së tij“ ishin:

„Kemi me jetu dhe me luftu, por edhe me fitu, që Kosovën me e kthye dhe me ba Kosovë dhe me e ruejt për jetë të jetëve Kosovë...“

Kemi me jetu dhe me luftu, por edhe me fitu, që Kosova me qenë ajo që gjithmonë ka qenë, nyje dhe trung i botës shqiptare...“

Kemi me jetu dhe kemi me punu Kosova me e ba Shqipninë, qysh ka qenë përherë dhe me mbetë përherë...“

Duhet theksuar se porositë për të cilat Koloneli kishte thënë se ishin të Deli Brahës, përcilleshin me një si fusnotë me vargjet: „Bylbyli këndon në Çabrat/Vajzë mos kaj me lot/Se dashnia jote/ m'ka nxanë përgjithmonë...“ të paraqitura së pari shqip dhe me njëfarë si

përkthimi të lirë në gjermanisht, e të shoqëruara me sqarimin „se ato i ishin qepur në pritje të plumbit“ dhe shpjegonte se „ashtu si i kishte riprodhuar, kishte bindjen se dikur i kishte dëgjuar t’i këndonte i ati në Saraj kapi në brigjet e Bosforit kur takohet me farefisën dhe të afërmit gjatë ndejave të mbyllura“, pjesëza këto që thoshte, sado të vonuara dhe të ngatërruara, ia lidhnin shkëputjet me vetveten...

...

Se „dashunia, që m’ka nxënë“ për Kolonelin përnjëmend paraqiste më shumë se një ndjenjë, e cila „ngroh përherë shpirtin“ dhe thotë se „kthen edhe te një gjendje e veçantë dhe superiore, pa të cilin nuk mund të bëhet Shqipëria Shqipëri“, kjo do të pasqyrohet në trajtesën „*Letra e vetme*“, e cila mund të merret me mend se i ishte kushtuar të fejuarës Helenora von Braun, të parën dhe të fundit të llojit të tillë, që telegrafisti Bruner do ta ndesh në shënimet e lëna nga Koloneli, të cilat, më vonë, pas largimit nga Shqipëria, me rastin e kthimit në Vjenë, gjashtë vjet pas përfundimit të luftës së parë botërore do t’ia dorëzojë Skulptorit duke ia bërë me dije se në ato shkrime marramendëse të dala nga një gjendje thuajse shthurëse, por çuditërisht ndonjëherë të pakapshme sa edhe shumë largpamëse, pra në atë gjendje kur ai thuajse ndodhej përballë një ngatërrimi të pafund shpirtëror, Koloneli kishte paraparë edhe shkatërrimin e perandorisë osmane dhe të monarkisë së Danubit, të cilat i gjente si mallkim ndaj sjelljeve që nuk e kishin mbrojtur Shqipërinë si duhej të bëhej Shqipëri, por kishin luajtur me të dhe fatin e saj, dhe Skulptori, dy vjet më vonë, pasi i kishte lexuar dhe rilexuar me aq kujdes dhe ishte mrekulluar nga bredhjet por edhe largpamësinë e atij shpirti të mbyllur në një botë të humbur, dhe pasi që Helenore von Braun të ishte kthyer prej internimit francez me depresione të mëdha psikike të cilat nuk do t’i ndahen kurrë, do t’ia japë asaj, të shoqëruara edhe me shënimet „*Besa për Shqipërinë*“, që kosovarët ia kishin lënë amanet në atë takimin e mbajtur ditën e dyzet e dytë të bredhjeve të tyre nëpër frontet shqiptare në pjesën e skajshme që Lezhën e bashkonte me Matin, të cilat tri ditë pa u vrarë Koloneli ia kishte dorëzuar priftit Gjon Lleshi, kur ai i paparalajmëruar dhe papritmas ishte futur në dhomën e madhe të ziçrit në teqenë e Leqes dhe njëherësh kishte qenë vizita e parë dhe e vetme gjatë njëzet e pesë ditëve të fundit të jetës së tij, që i kishte kaluar i mbyllur dhe në vetmi të plotë, i mbërthyer nga ankthe dhe gjithfarë parafytyrimesh si dhe ngarkesa emocionale, të cilat megjithatë do t’ia dalë t’i mbikëqyr dhe herë pas herë t’i zbraz në ato njëzet e dy shënimet e shkapërderdhura pa të cilat fundi i tij do të ishte i paqartë dhe i parëndësishëm madje.

Nga mbamendja telegrafistit Bruner i kujtohet dita kur nga Vjena bashkërisht ishin nisur për në Shqipëri dhe në atë përcjellje të pavërejtshme ishte e vetmja Helenore von Braun, e njohur nga jeta publicistike, e cila ishte shquar me shkrimet e saj rreth luftërave ballkanike si dhe ndriçimin e krimeve të armatës serbe dhe malaziasë që kishin ushtruar ato në Kosovë dhe Maqedoni ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare, që nga propaganda e Beogradit ishin arsyetuar me „kthimin e djepit serb“, që e quanin edhe „qendër të rëndësishme të qytetërimit të krishterë“, e cila gjoja „duhej të kthehej pas robërisë pesëqind vjeçare...“ E heshtur dhe me një brengë në fytyrë e kishte zënë Kolonelin për krahu dhe e mbante shtrëngueshëm sikur të dëshironte ta ndalte për vete. Nga heshtja e akullt nuk ishte liruar as kur ishin përshëndetur, që ajo e kishte bërë me një përqaftim të gjatë, e nuk ishte liruar as atëherë kur treni ishte nisur dhe ajo kishte mbetur si e ngrirë në peron me dorën e djathtë të ngritur.

Ngjashëm ishte sjellë edhe Koloneli, i cili kishte mbetur me sy të ngulitur kah ajo edhe kur treni kishte marrë kthesën e parë dhe kishte lënë stacionin pas dhe, fare i ftohtë, kishte mbetur edhe atëherë kur terri i mbrëmjes heshtjen e kishte mbushur me një zbrazëti të frikshme, që telegrafistit ajo ndarje ia kishte lënë përshtypjen se vetëm një dashuri e thellë, e cila mbetej e pa shqetësuar nga asgjë, që është e përhershme, mund të shprehej ashtu tepër natyrshëm thjeshtërisht dhe njëherësh tepër madhërisht...

Nga përvoja që kishte me telegramet të cilat lidheshin me shpalljen e dashurive, apo ruajtjen e tyre me dërgimin e porosive, të cilat bëheshin me anën e shenjave të telegramit, të cilat sa e sa herë i kishin kaluar nëpër duar gjatë punës në shërbimin e posttelegrafit publik, por më vonë edhe në atë „të mbyllurin“ për nevojat shtetërore të ministrisë së komunikacioneve, telegrafisti Bruner e dinte se dashuritë më të thella dhe më të qëndrueshme shpreheshin me pak fjalë dhe thuajse qetas, sa nganjëherë edhe shenjat u dukeshin të tepërta, ndërkohë që telegramet me fjalë të rrëmbyeshme, me shfrime të pandalshme dhe gjithfarë derdhje të ndjenjave, të shumtën ishin mashtrime, pos kur nuk bëhej fjalë për ndonjë papërvojë në dashuri, që ishin të rralla.

Gjuhën e prajshmërisë së asaj dashurie, që telegrafisti Bruner e merrte si dëshminë më të fortë të asaj lidhjeje të veçantë, e cila do të mbetej e përhershme, ai do ta përcjell edhe gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditësh bredhjeje nëpër vijat e fronteve shqiptare me anën e dy porosive që i kishte nxënë të hedhura në telegrafin e tij, të cilat ajo i kishte dërguar nga redaksia e „Die Presses“ të rrudhura në fjalët „bashkërisht përgjithmonë“, që ai për arsye të ruajtjes së konspiracionit të detyrës, nuk ia kishte dorëzuar Kolonelit, sado që kishte pasur ndërmend t’ia jepte kur të ktheheshin, natyrisht me shpjegimet e duhura pse ishte vepruar ashtu. Megjithatë, telegrafistit i kishte shkuar mendja se do të ishte mirë ta thyente këtë zotim çastin që Koloneli ishte futur në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes dhe ishte mbyllur në të përgjithmonë pasi që i kishte folur për „fundin e pashmangshëm“ dhe „vdekjen që do ta kërkonte“, por këtë nuk e kishte bërë nga hutia, që ia kishin shkaktuar ato që Koloneli ia kishte thënë rreth „rastit Huber“ dhe detyrës që kishte pasur me e vra Kolonelin sapo të arrinin në Shqipëri.

Më pastaj, kur Koloneli ishte mbyllur në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes dhe në hapësirën e samahones jeshile u ishte dhënë mendimeve të pafund rreth vrasjes e cila e priste si dhe të tjerave që në shënimet e lëna i kishte quajtur „pjesë të atij rifillimi dhe rikthimi që do ta bënte Shqipërinë Shqipëri“, telegrafisti i cili e dinte se gjatë asaj vetmie Koloneli kishte përjashtuar plotësisht realitetin bashkë me ato që i takonin, nuk e kishte parë të arsyeshme ta shqetësonte me porositë e fshehura të Helenora von Braunit të kapura në telegrafin e tij dhe as që e kishte brejtur ndërgjegjja për atë „shkelje të kodit të telegrafit“, ngaqë Kolonelit dashuria e flaktë ndaj Helenore von Braun i ishte kthyer në një ndjenjë të përhershme, e cila do ta përcjellë deri në vdekje, andaj, çfarëdo dëshmimi, me letër apo ndryshe nuk do të paraqiste tjetër pos lëndim të saj...

Këtë përshtypje telegrafistit ia kishte tumirë edhe trajtesa „*Letra e vetme*“, që mund të merrej me mend se Koloneli e kishte lënë për Helenore von Braun, sado që askund nuk ia kishte përmendur emrin, gjë që kjo „heshtje“ atë e kishte bërë edhe më të fuqishme, e kishte bërë edhe më të gjithëkohshme, që telegrafistin e kishte bindur se ajo shprehte një dashuri të pasosshme, që mbase të tillë e bënte edhe ajo pandarja shpirtërore, e cila përkundër shkëputjes që u ishte futur në mes, kishte ushqyer flakshëm ndjenjën e pavdekshmërisë së asaj, që ata i kishte lidhur përgjithmonë...

Andaj, telegrafisti e kishte ditë se ajo dashuri nuk mund të kishte tjetër pos një letre të vetme, që shkruhet vetëm një herë, që mund të lexohet vetëm një herë dhe mbetet e gjithëhershme...

Por „*Letra e vetme*“, të cilën e kishte lënë Koloneli, pas leximit të parë, të përcjellë me atë përfytyrimin e Helenore von Braun në stacionin hekurudhor të Vjenës, kur telegrafisti edhe më tutje atë e shihte të heshtur dhe të zhytur të tërën pas Kolonelit, pra ai lexim që ia kishte rishfaqur atë madhështim, të cilit i ishte kthyer gjithnjë e më shpesh, ia kishte krijuar përshtypjen se „*Letra e vetme*“, paraqiste më shumë se një dashuri, se në të vërtetë ajo ishte një himn poetik-filozofik i përgjithësuar kushtuar dashurisë si mbidashuri, me të cilën përmbushet qenia e njeriut të shkëputur dhe të shkapërderdhur nëpër kohë dhe hapësirë, ku njohja dhe rinjohja kthehen në një ndjenjë të fuqishme vetënjohëse dhe vetëshpaluese, e cila shfaqet si e domosdoshme për t’i dhënë kuptim një përcaktimi që kalon në ideal...

Koloneli i rritur në majat e një perandorie, e cila po numëronte ditët e fundit dhe rrënia e saj kishte rrezik të përmbyste gjithë atë qenësi që e kishte ngritur dhe e kishte mbajtur atë, nuk kishte si të mos ndjehej në mbërthimin e një shtruhare zhbërëse, ku, në atë termet përmasash të mëdha, e para gjë që rrezikohej ishte pamundësimi i dashurisë, me të cilën lidhet zemra dhe shpirti, ndjenja dhe qenia dhe gjithë ajo që shfaqet si fole e atij madhështomi. Dhe ishte më se e qartë se për të bërja e Shqipërisë Shqipëri paraqiste më shumë se përmbushjen e një të drejte për mbijetimin, e cila në ato rrethana tragjike lidhej me shpëtimin e një populli nga asgjësimi që i kërcënohej nga të gjitha anët, pra ajo ishte edhe një dashuri e pashueshme, së cilës nuk i duheshin fjalët, por shpirti, e cila nuk shpallej, por hetohet, ndjehet dhe përjetohet deri te ndijimi i djegies, që Koloneli e kishte quajtur edhe „vetëshkrirje“, ku e gjitha do të gjejë pasqyrimin më madhështor me vargjet:

„Të ndjej në tokë dhe në qiell

Të ndjej në gjakun tim, që nuk falet...“

Kuptimit të këtij shkrimi të jashtëzakonshëm, të ndjeshëm dhe tepër të fuqishëm, që për telegrafistin Bruner paraqiste më shumë se një moto të letrës, gjithsesi i duhet ndërlidhja edhe me ato katër vargjet, si fusnotë, të cilat Koloneli do t'ia bashkëngjisë të ashtuquajturave „porosi të Deli Brahës“, që do të thotë se „ia kishte shkëputur nga koka“, ku ndjenjën e dashurisë e lidh me „bylbylin që këndon në Çabrat“ dhe porositi vajzën „mos kaj me lot“ për t'ia bërë me dije se „dashunia jote/m'ka nxanë përgjithmonë...“, pra mbetej si zjarr i pashuar...

„Ka diçka të jashtëzakonshme në shkrimet e Kolonelit, që sado të veçanta janë, ndjehen dhe përjetohen njësoj nga ata të cilët kalojnë edhe nëpër rrugë të ndryshme“, i kishte thënë telegrafisti Bruner Skulptorit gjatë takimit të vetëm që e kishin pasë në Vjenë, shumë vjet pas mbarimit të luftë së parë të madhe botërore, kur ia kishte dhënë shënimet e shkruara gjatë kohës së mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, duke ia bërë me dije se fryma e tyre kahmot e kishte mbërthyer dhe e kishte ushqyer sa t'ia ndjente si të vetat...

...

Nga shifrat e toponimeve të cilat kishte, telegrafisti Bruner e dinte se *Çabrati*, që ishte një kodër e cila i rrinte Gjakovës përmbi dhe paraqiste vendlindjen e farefisit të Kolonelit, ashtu si zihej ngojë dhe mënyra si përmendej, pasqyronte lidhjen dhe kthimin përfundimtar të tij shpirtëror kah rrënja, kah trugu, pra kah ajo veçanti e cila përkufizon përmasat e njëmenda të qenies dhe nuk mund të tjetërsohet dhe as të vendoset ngjet, pa marrë parasysh bredhjet nëpër hapësirat e huaja, ndërsa *vajza*, që qante, paraqiste mallin, pikëllimin dhe atë dashurinë për atdheun, si ndjenjën e thellë jetësore, së cilës i duhet afria e ndërlidhjes dhe rinimi me qenien e vet të shkëputur dhe të shkapërderdhur...

Këtë ndjenjë dhe domosdonë e shpalimit të saj, ashtu si shfaqet te shënimet e fundit, telegrafisti do ta lidhë edhe me zhvillimet se lufta e fundit dhe gjithë ato të cilat i kishin paraprirë, ku perandoria osmane nga dita në ditë po humbte hapësirën e vetë dhe të ardhmen, Kolonelin e kishin qëlluar dyanshëm dhe me të drejtë, ngaqë në atë rrënim të përmasave tepër të mëdha që po ndodhte, ai humbte atë pjesë të qenies, që si veçanti frymëzuese, për shekuj ishte shtrirë në perandorinë e madhe si ngritje e fuqishme, pa qenë në gjendje asgjë të asaj dhe atij realiteti ta rikthejë te zanafilla dhe ajo që mbetet vendlindje dhe atdhe i dhunshëm, i cili asses i të bëhej...

Përmasat e kësaj dashurie e cila shfaqej si mbidashuri si dhe porositë e saj të thella, që nuk kishte si të mos i kuptonte drejt dhe mirë edhe e fejuara e Kolonelit Helenore von Braun, e cila pak ditë para se të fillonte lufta e dytë e madhe botërore, pra me gjashtë shtator, dhe tri ditë para se të vdiste, në „Die Presse“ do të botojë shkrimin „*Letra (ime) e vetme*“, dhe me atë „ime“ në parantezë, që do t'ia shtojë asaj të Kolonelit të lënë në shënimet e teqesë së Leqes, do të kryejë detyrimin e rikujtimit në opinion por edhe të ringritjes së një çështje të hapur, siç ishte ajo shqiptare, të cilën ndonëse e drejta ndërkombëtare „ad acta“ e kishte quajtur të

mbyllur, ajo edhe më tutje mbetej e pazgjidhur ngaqë ngarkesat e saj edhe më tutje do të prodhojnë fatkeqësi tepër të mëdha, rreth të cilave ajo kishte tërhequr vërejtjen „se nuk mund të mbesin përherë vetëm të shqiptarëve“ dhe sigurisht kur kishte shtruar këtë mendim kishte pasur parasysh ato që Koloneli i mbyllur në teqenë e Leqes, i tëri i mbërthyer nga obsesioni i vdekjes së paralajmëruar, që ai e lidhte me vrasjen e Shqipërisë, e cila sikur kishte ndodhur, pra pa filluar mirë lufta e parë botërore, kishte paraparë shkatërrimin e perandorisë osmane dhe të asaj danubiane, që u vinte si mallkim bartëseve të dy qytetërimeve të mëdha botërore, që për shekuj bashkëjetesa e tyre si shëmbëllesë ishte pasqyruar aq haptas dhe aq natyrshëm në hapësirën e saj, gjë që publicisten e njohur e kishte shtyrë të bënte publike edhe ato të cilat Koloneli ua kishte paraparë perandorisë së kuqe të Kremlinit dhe krijesës së Versajës - „dorës së zezë“ ballkanike, të cilat pas rrënimi të monarkisë danubiane dhe asaj osmane, shkatërrimin e kësaj vlere, e kishin marrë përsipër ta kryenin në emër të gjoja „misionarizmit qytetërues krishten“ duke qëlluar pamëshirshëm qenien shqiptare dhe tolerancën mbi të cilën kishte qëndruar dhe ishte zhvilluar, që t'i hiqej çfarëdo mundësie „ringjalljes së frymës së kuptimit të të kundërtave“, ku besimet e ndryshme, në vend se të luftoheshin në emër të „zotit të vet“ dhe kundër „zotit të huaj“, kishin bashkëjetuar mrekullisht në emër të Krijuesit të përgjithshëm dhe të përbashkët...

Kur telegrafistit Bruner, në një spital të Vjenës, ku ai mezi ruante të pamunit e turbullt nga rraskapitja e viteve të Shqipërisë, të cilat ai megjithatë i quante të vetmet që jetës së tij i kishin dhënë njëfarë kuptimi, ia kishin lexuar shkrimin „*Letra (ime) e vetme*“ të Helenore von Braun, kishte ndjerë të njëjtat tronditje emocionuese por edhe shtangimet e jashtëzakonshme si edhe atëherë kur në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes për herë të parë ishte ballafaquar me „*Letrën e vetme*“ të Kolonelit dhe i kishte ardhur mirë që ajo, qoftë edhe në atë mënyrë, i ishte paraqitur opinionit austriak, që tashmë e kishte të qartë se prapë po futej në vorbullën e një lufte tjetër të madhe, me një problem të bartur nga lufta e parë e botërore, që flaka do t'i mbetej e hapur, por duhej ta kuptonte se e gjitha nuk paraqiste vetëm një të drejtë të thjeshtë mbijetimi të një populli në ato hapësira, të cilën duhej ta kishte, por ajo pasqyronte diçka më tepër – pra atë dramën e pashkëputshme të një qenësie të tërë, të shkapërderdhur në një ngrehinë perandorake, ku për qindra vjet ata kishin pasur suksese jashtëzakonisht të mëdha, të cilat pasqyroheshin me ngritjen deri te postet më të larta të qeverisjes dhe të drejtimit të saj, rrënimi i së cilës pashmangshëm çrregullonte edhe qarkun jetësor dhe qytetërues të atyre që kishin qenë pjesë e saj dhe i kishin ndihmuar asaj ngritjeje gjatë shekujve dhe këtë e kishin bërë me përkushtimin se përkatësia perandorisë, pa marrë parasysh çfarë ishte ajo dhe nga vinte, pos që ua hapte hapësirën ku mund të ngriheshin, mbi të tjerat, ua hiqte edhe mallkimin e gjendjes së mbetjes në kryqëzimin e dy boteve, së cilës përherë duhej paguar haraç i madh, që si veprime nga pazarllëqet e fuqive të mëdha, serish i kthente në atë gjendje, por tash në vend se të gjendeshin në ndonjë hapësirë të madhe, ku do ta derdhnin qenien e tyre pandalshëm, i bënte pre e fqinjëve grabitqarë, të cilat nuk kishin preokupime perandorake pos etjes së pangopshme që ndaj tyre të ushtronin gjenocid të paparë dhe këtë ta bënin „në emër të përjashtimit të mbeturinave të fundit të perandorisë osmane nga Ballkani“!

...

Me *shpirtrat*, që thoshte se e shoqërojnë, e do t'i quajë „përcjellës të pashmangshëm“ me të cilët „ndërlidhej fuqimisht në kërkim të vetvetes“, Koloneli do të merret gjithnjë e më shumë veçmas nga dita e gjashtëmbëdhjetë e mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, dhe ato përfytyrime e ankthe, si biseda të bëra në pahintikë apo mendime të lëna prej tyre, do t'i hedh në letër, sikur të ishin pjesë të vizitave të rëndomta por edhe atyre lamtumirëse, të cilat i bëheshin në ato çaste të fundit të jetës.

Telegrafisti Bruner, që po ashtu rrinte fillikat në bujtinën e skajshme të teqesë së Leqes dhe nga andej, me mendje por edhe me shikim err e terr përgjonte lëvizjet e Kolonelit, pa humbur shpresën se një ditë, mbase për pak, mund ta thyente vendimin e mbylljes, që së paku një herë të shihte por edhe të krahasonte dallimet midis „brendësisë dhe jashtësisë“, e merrte me mend se përballë asaj gjendje në të cilën ndodhej Koloneli, përherë i mbërthyer me mendimin e vrasjes, nuk kishte si të mos ballafaqohej me përfytyrimin e atyre të cilët i ishin vlarë gjatë bredhjeve si hije midis fronteve të ngathëta por tepër mizore shqiptare, hapësira e të cilave kishte ndjekur njëfarë gjysmëharku që ishte sjellë në pjesët djerrë të cilat lidhnin Durrësin me Tiranën dhe në jug shkonin kah Kavaja e Shijaku ndërsa në veri kah Lezha dhe Mati. Dhe, ky farë harku tragjik shqiptar, që lidhej me detin, të cilit në kushtet e rëndomta nuk i nevojiteshin më shumë se disa orë ecje për t’u kaluar, gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të zvarritjeve nëpër të, kishte mbledhur aq shumë kobe dhe fatkeqësi sa duhej një jetë e tërë në paqe për t’u përballuar tmerret e tij. Telegrafisti e kishte pasur të qartë se Koloneli mundahej sa më shumë të përmbahej nga çfarëdo shfrimi, pa marrë parasysh dhembjen që tragjedia shqiptare ia shkaktonte nga brenda. Të vetmen herë që kishte pasur rrezik të shpërthente kishte qenë vrasja e studentit Zenel Xhema, e cila kishte ndodhur kur ai po i përcillte kosovarët pas atij takimi të dhimbshëm me ta. Me ta dëgjuar krismën e ardhur nga ana e pjesës ku shtriheshin forcat e Haxhi Qamilit, pa dënuar të thoshte gjë, nga dhembja e tmerrshme që ia kishte shkaktuar vrasja, të cilën ai e merrte me mend se kënd kishte qëlluar dhe pse kishte ndodhur, Koloneli me të shpejtë ishte futur në tendën blu, ku kishte mbetur fare i shtangur deri sa ishte afruar koha e varrimit.

Ato që kishte folur gjithë mundim pas varrimit të studentit Zenel Xhema se „morti ka vu pushtet të plotë në këtë askundnjë të pafund...“ telegrafistit ia kishin bërë me dije se Koloneli po sharronte në labirintin e vdekjes, prej nga nuk do të dalë kurrë, dhe si do të shihet nga shënimet e lëna në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, bredhjes deri te ajo dhe vetë aktit të saj, që përmbylej me vrasjen e paralajmëruar, Koloneli do të mundohet t’ia japë kuptimin e një përgatitjeje sikur e gjitha çonte kah një ringjallje, si thoshte, për një rifillim apo rilindje, të cilën e merrte për të domosdoshme në shërbim të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, ku kishte bindjen se jo vetëm vrasja e tij, që e kishte fare pranë dhe do të ndodhte së shpejti, por edhe vrasjet tjera, si ato të poetit Huber, sportisti Hajek, polakut Avramicki, studentit Zenel Xhema, të spanjollit Rafaelo, rumunit Skanea dhe të tjera që ishin bërë dhe do të bëheshin, i shërbenin këtij qëllimi, ngaqë ato drejtpërdrejt lidheshin me idenë e kësaj bërjeje, që ishin shoqëruar me qëllime të hapura dhe të shpallura, të cilat zaten edhe u ishin kthyer në kobe...

Kështu, ishte më se e qartë se Koloneli në pritje të plumbit i cili do ta gjente në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes dhe të ballafaqimit të pashmangshëm me të, të përfshinte edhe pararendësit e njohur dhe të panjohur, që e gjithë çështja të merrte përmasat e një kuptimi, ku gjithë ato vrasje të cilat kishin ndodhur në atë hapësirë tragjike shqiptare dhe të tjerat që do të ndodhnin, të nxirreshin nga kotësia, zhvleftësimi dhe nënçmimi që ashtu dhe aty i pristë, për t’u bartur te ai qëllimi madhor, i cili lidhej me bërjen e Shqipërisë Shqipëri.

...

I ndërthurur me këtë mbërthim të përhershëm Koloneli do ta fillojë bisedën e parafytyruar me sportistin çek Hajek, i cili ishte vlarë nga fanatikë e Haxhi Qamilit kur po ushtronte me shpresën se do të ishte sportisti i parë i mbretërisë shqiptare, që pas dy vjetësh do të merrte pjesë në një garë të madhe botërore të atletikës, e ku ai kishte bindjen se do të fitonte medalje dhe ajo do të ishte medalja e parë e shtetit shqiptarë në një arenë të madhe sportive ndërkombëtare, ku do të ngihej flamuri i mbretërisë shqiptare bashkë me të tjerët dhe, mijëra e mijëra veta do ta përshëndetnin atë fitore, e tjera e të tjera ëndrra që kishte thurur ai

pareshtur, të cilat plumbi i ardhur nga pjesa tjetër atë ditë me diell të fortë sa ora i kishte bërë të paqena...

„Ti do ta fitosh atë garë“, i kishte thënë Koloneli sportistit Hajek, ndërkohë ai ia kishte treguar plumbin si i rrinte në rrashtën e epërme dhe nuk e lente të lëvizte.

„Një e shkrepur dhe merr fund çdo gjë...“, kishte thënë çeku dëshpërueshëm. „A nuk është kjo tepër tragjike?...“

„Ti do të fitosh“, i kishte thënë prapë Koloneli. „Nuk ma thotë mendja se ke hequr dorë prej saj?...“

Çeku kishte buzëqeshur thartë.

„Maratonë i thonë kësaj. Me turr humbet. Me durim fitohet“, kishte folur serish Koloneli dhe ia kishte bërë me dije se tashmë ishte në ngritje e sipër një shteg i gjatë shumë i gjatë, sa gjithë Shqipëria, ku do të ushtrohej e do të ushtrohej përherë, e ku do të kalojnë mijëra e mijëra veta me bindjen e fitores, që më në fund do ta kenë...

„Shqipërinë mund ta ushqejë vetëm bindja e bërje së saj“, i kishte thënë Koloneli.

Çeku edhe më tutje kishte prekur kokën, ku i rrinte plumbi, sikur të dëshironte t'ia bënte me dije se edhe më tutje vazhdonte të vepronte ajo shkrepja e kobshme, që ia kishte shuar të gjitha shpresat përnjëherë.

„Maratona shqiptare nuk do të ketë të ndalur... Ajo ka nevojë për garues të pamposhtshëm, që mund t'i shkojnë deri në fund“, kishte folur Koloneli dhe kishte kërkuar nga çeku të ndiqte rrugën drejt cakut, të cilën dikur e kishte përfytyruar se e kishte përpara.

Çeku edhe më tutje kishte bërë me dorë kah plumbi që i rrinte në rrashtë.

„Do të ketë edhe shumë plumba, që do të shkrepen nga anë të ndryshme, se ata plumba do të qëllojnë pamëshirshëm, por nuk duhet ndalë... Shqipëria duhet bërë Shqipëri pa marrë parasysh sa dhe si qëllohet...“

Duket se përfytyrimi i bisedës me sportistin çek Kolonelit nuk i kishte shkuar si duhej dhe kjo mund të merrej me mend se çeku nuk lëvizte, se ai i ishte dhënë asaj ngrirjeje që ia kishte shkaktuar plumbi i ardhur nga pjesa e forcave të Haxhi Qamilit, që ia kishin gjetur rrashtën... Më kot ishte munduar Koloneli ta bindte se plumbi kishte qenë vetëm një përpjekje për ta ndalur maratonën shqiptare, se plumbi nuk kishte mundur t'ia vriste vullnetin për lëvizje dhe fitore, se ai plumb që ishte shkrepur nga ana e kundërshtarëve të bërjes së Shqipërisë nuk ishte i zoti ta pengonte bërjen e saj përfundimtare e tjera e tjera, por çeku assesi të kthente lëvizjen që Koloneli kërkonte prej tij, atë lëvizje të cilën e merrte si të domosdoshme që Shqipërisë i duhej për t'u bërë Shqipëri...

Vetëm pasi i kishte thënë se „do të lëvizim bashkë“, se „do të vrapojmë asaj maratone që quhet Shqipëri, e cila nuk merr fund me një turravrap por me një garë që mund të zgjasë edhe njëqind vjet e ndoshta një mijë, ku edhe ata që vriten drejt cakut i takojnë atij qëllimi të madh“, vetëm atëherë çeku kishte dhënë shenjat e lëvizjes, që Kolonelin e kishin bërë të çirrej dhe të thoshte se „maratona shqiptare nuk ishte vrapë!...“

„Nuk do të ndalemi pa arritur cakun... Qëllimi ynë është bërja e Shqipërisë Shqipëri, pa marrë parasysh sa zgjat ai dhe pa marrë parasysh plumbat që do t'i hedhen për ta ndalë nga të gjitha anët...“, kishte shkruar Koloneli dhe kishte shtuar se „maratona shqiptare do t'i përfshinte të gjithë, edhe ata që kishin humbur garën pa e filluar fare, edhe ata që kishin mbetur shtigjeve të harruara dhe do t'i përfshinte edhe ata që kishin qenë pjesëmarrës të garave të huaja nga shkakut se diku është dashtë të garonin dhe të luftonin për fitore...“

Kjo ndjenjë për pak Kolonelin e kishte mbushur me njëfarë shprese sa ato që më pas kishte shkruar u ngjanin çasteve sado pak të lumtura, të cilat nuk i kishte pasur fare gjatë atyre gjashtëdhjetë e gjashtë ditëve të bredhjes, që me njëzet e pesë të tjerat të vetmisë në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, të cilat do të përmbyllen me atë plumbin që do t'i vijë si prej qielli tek po e priste në dritare dhe po shikonte trëndafilat që kishin vu gjemba, paraqesin nëntëdhjetë e një ditët e vetme të jetës në Shqipëri, për të cilat thoshte se „ishin të domosdoshme dhe me asgjë nuk do të mund të anashkaloheshin...“, ngaqë ato kishin krijuar

atë „rilidhjen me vetveten,deri te amshimi...“, rilidhje që thoshte i duhet „rizgjimit dhe ribërjes së Shqipërisë Shqipëri...“

...

Edhe përshkrimi i përfytyrimit të bisedës me poetin Hartman do të jetë pjesë e asaj „rilidhjeje të mëtutjeshme me vetveten, që nuk do të ketë fund...“ me ç’rast Koloneli do të pranojë se padiktueshëm kishte hetuar prirjen e vargjeve, të cilat e kishin ngacmuar „nga një thellim i panjohur“ dhe me anën e tyre kishte qenë në gjendje „me pak fjalë të thotë shumë“, por edhe të kuptojë fuqinë e „të shprehurit ndryshe...“

„Ëndërrimtarë jemi të gjithë“, i kishte thënë poeti Hartman dhe kishte shtuar se „vetëm poetet dhe ushtarakët i shprehin ato haptas, të parët me vargje dhe xhepurina të ndryshme, që sikur nuk kanë fund, ndërsa të dytët me humbjet...“

Koloneli ia kishte dredhë se krahasimi midis poetëve dhe ushtarakëve i dukej paksa i paqëndrueshëm nga shkakut se fjala ishte për veprime fare të ndryshme...

„Nuk i kanë të përbashkëta ata ëndrrat dhe dështimet, Kolonel?...“ - kishte folur poeti Hartman fare prajshëm.

Koloneli kishte dashtë t’i thoshte se poezia nuk ishte dështim, se në ato rrethana kishte kuptuar më së miri se ajo ishte ndjenjë e thellë dhe e madhërishtme, por poeti Hartman, ndryshe nga ajo prajshmëria që e shquante, nxitonte t’i fliste për ëndrrën e përbashkët dhe dështimin e përbashkët, që çon te e njëjta, ngaqë përsëriten e ripërsëriten pafundësisht, e të tjera e të tjera, të cilat Koloneli dikur as që ishte në gjendje t’i përcillte nga shpejtësia e tyre sa një çast iu bë se ato që thoshte poeti nuk ishin tjetër pos pjesë e një tingëllime, e cila mbushte hapësirën me zabullimë...

Pasi kishte folur folur dhe dikur i ishte dukur se ishte zbrazur nga një shqetësim shkallues, poeti Hartman i kishte thënë se ndjehej sikur t’i kishin ndërruar rolet...

„Nganjëherë, kur urdhëroj rimat t’u nënshtrohen vargjeve, më bëhet se jam ushtarak dhe kjo sikur më tmerron...“

Koloneli e kishte dëgjuar gjithë kureshtje dhe kishte pritur ta çonte deri në fund mendimin.

Pas një heshtje të shkurtër poeti Hartman kishte shtruar mëdyshjen se megjithatë mund të kishte qenë ushtarak, ndërsa ai poet,që Kolonelin e kishte befasuar.

„Nuk ta ha mendja Kolonel se ke qenë edhe poet, ndërsa unë ushtarak?...“

Koloneli kishte sjellë kokën habitshëm, ndërkohë që poeti Hartman kishte vazhduar të sqaronte mundësinë e ndërrimi të roleve si diç fare të mundshme, që kishte ndodhur dhe ndodhte, por çështje ishte si dhe sa kuptohej...

„Ti ke ëndërruar, ndërsa unë kam vepruar...Nuk të duket, Kolonel, se ishte kështu?...“

Koloneli sikur nuk po e merrte veten. Kishte desh t’i thoshte se nuk ishte pa ëndrra, se pa to edhe nuk bën, se në të vërtetë, ato janë pjesë e çdo nisme, që kthehet në shtysë sendërtimi, e të tjera, e të tjera, por poeti Hartman vazhdonte t’i fliste rreth asaj se „veprimi i ushtarakut nuk ishte tjetër pos ëndërr e pasosme, ndërsa ëndrra e poetit nuk ishte tjetër pos veprim i pasosëm, të cilat realiteti pastaj i kthen në dështim“, që megjithatë Kolonelin pak nga pak po e shpinin kah mundimi i një rikuptimi të asaj ndërlidhjeje, të cilën e shprehte poeti Hartman me aq ngulm saqë dikur ishte i gatshëm të pranonte se pjesërisht mund të kishte qenë edhe poet, por kjo nuk e përjashtonte atë ushtarakin që i takonte dhe mbetej në të përgjithmonë...

Dhe për t’i ikur ndonjë ngatërrimi kah i cili druante se rrëshqiste, Koloneli kishte pyetur për ato që ai dikur i thoshte se „do t’i shkruante“ për t’u bërë „poet kombëtar“, por poeti Hartman sikur nuk i bënin më përshtypje.

„Ishte ëndrra për Iliadën shqiptare mashtrim?...“

„Assesi!...Assesi, Kolonel i nderuar“.

„Epo?...“

„Ajo është e shkruar...Është e gatshme...Nuk e ditke këtë, Kolonel i nderuar?...“

„E gatshme?...“

„E gatshme, pra Kolonel i nderuar.“

„Hë?...“

„Po. Po. Iliada shqiptare është shkruar, Kolonel i nderuar...Është e gatshme...Që moti madje...Vetëm pret të mblidhet...“

Koloneli po trandej i tëri. Deshi të pyeste edhe më,por hetoi se nga habia i ishin sosur fjalët, ndërkohë që poeti Hartman, për ta liruar nga hutimi, që po ia shprehte e gjithë qenia,foli e tha:

„Iliada shqiptare është sikur vetë Shqipëria, një poemë e madhe, që moti e shkruar, por e shkapërderdhur nëpër kohë tepër të lashta në mija e mija vargje, të strehuara në mijëra e mijëra koka e shpirta, që e ruajnë dhe e bartin nga gjenerata në gjeneratë, shpesh pa ditë se janë autorë të një poeme të madhe, të një eposi të pasosëm, i shkrirë në vargje e rima, ku është derdhur një qenësi e tërë...Ato vargje pra presin të mblidhen dhe në atë mbledhje të bëhen, si vetë Shqipëria, që pret bërjen...“

Duket se kjo bisedë e parafytyruar me poetin Hartman Kolonelit ia kishte krijuar bindjen se përnjëmend ushtarakët dhe poetët kanë diçka të përbashkët, që nuk ishte dështimi, siç thoshte poeti Hartman, por e kundërta, pra parashikimi i të mundshmes, qoftë edhe si ëndërr e pasosme, që ai e lidhte me bërjen e Shqipërisë Shqipëri sa një çast kishte shënuar se „poetët e përfytyrojnë Shqipërinë, ndërsa ushtarakët e bëjnë...“

Në fund të trajtesës Koloneli kishte hedhur disa vargje në shqipe, ku me atë: „*shpirt e mendje janë bashkue/kangën tonë me e këndue/me këndue bashkarisht...*“ sikur kërkohej leje nga hyji për vargnim, që nuk kishte sqaruar ishin të tijat apo të kujtuara prej ndokujt.

Mund të bëhet se atë „*presin të mblidhen*“, të cilën poeti Hartman ia kishte thënë rreth Iliadës shqiptare, Koloneli e kishte kuptuar si „*presin të rikëndohen prej secilit*“, që ai e kishte hetuar si një urdhër shpirti për t’i rikërkuar, për t’i rikënduar ato dhe për t’i hedhur në letër pa marrë parasysh pronësinë e tyre...

„Ato që krijon shpirti u takojnë të gjithëve“, kishte shënuar Koloneli.

...

Edhe pse çastin që kishin kthyer rrugën te kthesa e Gurasit kah teqeja e Leqes, Koloneli kishte thënë se „po shkonte aty ku do të mbetej përgjithmonë me trup dhe shpirt“ dhe kishte shtuar se dhoma e madhe e ziçrit „ishte foleja e vetme dhe e fundit“, nga shënimet e ditëve që e afronin me vdekjen, veçmas në atë të tetëmbëdhjetin, të njëzetin dhe të njëzetënjëtin, ishin hetuar bredhje të çuditshme nëpër hapësirën shqiptare, të cilat shkonin nga Teqeja e Madhe e Gjakovës e deri te *Kështjella e Hijes* në Pashtrik, që mund të thuhet se betimi i mbylljes në pritje të vdekjes nuk kishte qenë i mjaftueshëm për t’i bërë zap përfytyrimet dhe gjithë ato që Kolonelit i ishin shfaqur gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të fundit të jetës si ecejake të pandalshme dhe të pambikëqyrura të mendjes, qoftë edhe si të shkëputura dhe herë-herë edhe me ngatërresa të papërballueshme, të cilat plotësojnë mozaikun e asaj gjendjeje të ndërlikuar shpirtërore dhe mendore në të cilën ai ishte përfshirë në ato rrethana.

Telegrafisti Bruner nuk e kishte pasur të vështirë të merrte me mend ngatërrimin midis teqesë së Leqes dhe asaj të Gjakovës, ngaqë të dyja ishin teqe bektashinjsh, që nënkuptonte të njëjtën dhomë të madhe të ziçrit me samahanën jeshile në pjesën ballore dhe pushtoheshin nga e njëjta frymë e rregullave që paraqiste ky urdhër i përhapur, andaj të ashtuquajturën bisedë me Baba Talin, që shkruante se e kishte bërë në Teqenë e Madhe të Gjakovës, e merrte si diçka të pritshme, që edhe ishte e mundshme përballë gjendjes kur ai gjithnjë e më shumë i afrohej fundit, me të cilën arsyetohej fanitja dhe sharrimin në halucinacionet, por edhe zbrazja e plotë me anën e tyre. Megjithatë, telashe i kishte nxjerrë „*Kështjella e Hijes*“ në Pashtrik, të cilën Koloneli do ta përmend në shënimin e parafundit, jo pse ai nuk kishte

njohuri rreth Pashtrikut dhe lartësive të tjera shqiptare, të cilat Koloneli disa herë i kishte shqyrtuar në atë hartën e madhe kur krahasonin pikat e ndryshme nga veriu dhe jugu, ku maja e Pashtrikut dhe ajo e Tomorit kishin të njëjtën lartësi prej 1924 metrash, që ai i kishte quajtur „kuota të rëndësishme strategjike“, por pse ajo kështjellë nuk shënohej kund në hartat që kishin dhe të tjerat që kishte shqyrtuar më vonë, dhe po ashtu, ajo kështjellë nuk përmendej as në shënimet tjera të cilat merreshin me shënjimin e lashtësisë shqiptare apo të asaj mesjetare dhe antike në ato hapësira, e hartuar nga Akademia e Shkencave e Austrisë, e cila merrej si më e përgatitura për këtë çështje...Për atë kështjellë madje nuk kishin njohuri as ata arkeologë e historianë shqiptarë të paktë që kishte njohur më vonë dhe kishte kërkuar prej tyre sqarime, gjithnjë duke e pasur mendjen te ato të cilat Koloneli kishte shkruar rreth „tempullit më të madh shpirtëror antik, ku rrinë hyjnitë shqiptare...“

Sidoqoftë, bazuar në shënimet e lëna,veçmas ato që vinin nga dita e nëntëmbëdhjetë e mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes e deri te ajo e njëzet e dyta, me të cilin përmyllen ato, telegrafistit iu kishte sforcuar bindja se Koloneli mendonte *se në këtë botë ishte të vinte dhe të shkonte pareshtur dhe kjo shkuarje-ardhje* i ishte nënshtuar qëllimit të bërjes së Shqipërisë Shqipëri, si një dhunti por edhe si shëmbëllesë e pashmangshme, që thoshte se i duhet botës të shpëtonte nga mëkatet e mëtutjeshme, se gjatë kësaj përsëritje dhe ripërsëritjeje shpirti duhej t'i afrohej asaj gjendjeje, të cilën e quante „*të lartësueshme dhe të pasosshme*“ njëherësh, si diçka që nuk i nënshtrohet *pronësisë* e as *hapësirës*, që do të thotë se mund të merrej si *e përgjithshme* dhe njëherësh *e pakapshme* dhe *e paprekshme*...

I mbërthyer nga kjo bindje ishte e natyrshme që Koloneli me mendime bredhte sa andej e sa këndeje dhe kështu edhe përfytyrimet më të pabesueshme i kthente në realitete të veta dhe të reja...

E kësaj kahe ishte edhe trajtesa „*Prapë me Baba Talin*“, ku bëhej fjalë për njëfarë takimi „të jashtëzakonshëm“ me Baba Talin në Teqenë e Madhe të Gjakovë, që Koloneli thoshte se e kishin kushtëzuar „të njëjtat mendime“, që kishin gjetur njëra-tjetrën pas shumë e shumë bredhesh, të cilat ai i kishte vlerësuar qindravjeçare apo të gjithëhershme,“të nisura nga një thellësi shpirti, së cilës i duhej të menduarit për durimin si bindje, që nuk lidhet me nënshtimin, por me forcimin e shpirtit si të formësuar, të jetë në gjendje, edhe përballë gjendjeve të vështira, të dëshmohej dhe të vetëdëshmohej pareshtur në përputhje me qenësinë dhe përmasat e forcës së saj...”

Takimin e parafytyruar me Baba Talin në Teqenë e Madhe te Fusha e Sahatit në Gjakovë, Koloneli e kishte përshkruar si pjesë e atij vetëdijesimi të përgjithshëm, e cila doemos i duhej bërjes së Shqipërisë Shqipëri, që kalonte nëpër sprovat e shumta të vetëkuptimit dhe shpinë kah lartësimi, me çka arrihet ndijimi hyjnor, ku shënohet shkëputja përfundimtare nga ajo që quhet bredhje e pafund dhe kotë d i k u n d nëpër a s k u n d je, si parakusht për t'u liruar nga hapësira e humbëtirës, e cila shfaqje pas rënieve të mëdha dhe dështimeve, që pastaj t'i hapën dyert lëvizjes së pafund drejt m a j a v e...

Nga biseda e gjatë me Baba Talin Koloneli do të sjell vetëm një pjesë të atyre që kishin shkëmbyer, të cilat Koloneli i vlerësonte si udhërrëfime por edhe porosi drejtuar atyreve që „duhet të ndjekin rrugën kah lartësimi...”

Baba Tali:

„Ka njëqind apo ndonja njëmijë vjet që të pres...”

Koloneli:

„Ka njëqind apo ndonja njëmijë vjet që të kërkoj...”

Baba Tali:

„Më në fund, kërkimi na bashkoi...”

Koloneli:

„Më në fund, të bashkuar do të kërkojmë lartësimin...”

Baba Tali:

„Së pari do të kalojmë lumin e pastaj do të ngjitemi asaj përpjetës të mundimshme që çon kah maja...”

Koloneli:

„Do të ecim pa pushuar, Baba...”

Baba Tali:

„Pra, nuk do të ndalemi...”

Koloneli:

„Gjithnjë bashkë, Baba...”

Baba Tali:

„Atje na presin librat e moçme, ato të shpirtit...”

Koloneli:

„Do t’i shfletojmë e do t’i shfletojmë err e terr, Baba...”

Baba Tali:

„Dhe do të mendojmë për ngritjen, për atë ngritjen e pafund, që na pret...”

Koloneli:

„Nuk do t’i ndahemi asaj rruge, Baba...”

Baba Tali:

„Dhe prej andej do të kërkojmë secili t’i nënshtrohet vullnetit për fuqi...”

Koloneli:

„Ndryshe nuk bën, Baba...”

Baba Tali:

„Dhe do të kërkojmë lëvizje dhe vetëm lëvizjen...”

Koloneli:

„Kështu do t’i ikim ngecjes, Baba...”

Baba Tali:

„Dhe do të kërkojmë që forca të kthehet në lëvizje të mbikëqyrur...”

Koloneli:

„Fjala jote, Baba...”

Baba Tali:

„Do të kërkojmë lartësinë, ngritjen dhe vetëm ngritjen, por pa u ngutur...”

Koloneli:

„Do t’i kthehemi të menduarit për majën, Baba...”

Baba Tali:

„Pra, im bir, a je gati për udhën e pasosme?...”

Koloneli:

„I gatshëm dhe i përlshëm ndaj bindjes, Baba...”

Më tutje Koloneli shënon se pas asaj bisede (pjesë të së cilës i kishte theksuar), Baba Tali nuk ishte parë më, por ia kishte lënë përpara manifestin „*Durimi dhe lartësimi*“, me arsyetimin se „e kishte hartuar mendësia e gjatë dhe e shumanshme“, që kishte theksuar se „e kishte mbledhur dhe përpunuar në përputhje me rrethanat dhe zhvillimet“, të cilat i quante „aso që çojnë drejt arritjes së çlirimit dhe liritimit përfundimtar...”

Koloneli thoshte se librin e kishte thithë me shikim të atypëratyshëm, gjë që e gjitha kishte mjaftuar që ato qindra e qindra faqe që gjendeshin në të bashkë me mijëra e mijëra fjali dhe mendime t’i shkrinte dhe t’i derdhte në kokë dhe pastaj ato në tërësi t’i merrte për të vetat.

Lidhur me atë përjetim që ia kishte shkaktuar përvetësimi i manifestit „*Durimi dhe lartësimi*“ Koloneli shkruan sikur të fliste vetë:

„*Durimi nuk është pritje e kotë, por mund të kthehet në pritje...*

Durimi nuk është mashtrim, por mund të kthehet në mashtrim dhe vetëmashtrim...

Durimi nuk është nënshtrim, por mund të kthehet në nënshtrim dhe vetë nënshtrim...“

Mundësinë e kundërthënies Koloneli do ta arsyetojë kështu:

„Që durimi të mos kthehet në pritje të kotë, por në një vetëdije mbrojtëse, duhet ndjekë qëllimin e caktuar, që më parë të shtruar dhe të plotësohet me përmbajtjen që i shërben atij...

Që durimi të mos kthehet në mashtrim dhe vetëmashtrim, por në vetëbesim që shpjen kah ndryshimi i gjendjes, duhet të shënohen kthesat të cilat e arsyetojnë atë...

Që durimi të mos kthehet në nënshtrim dhe vetë nënshtrim, por në veprim të matur drejt qëllimit, duhet të ndodh lëvizja e mbikëqyrur, që kuptohet si çështje e vullnetit për fuqi, së cilës duhet nënshtruar secili...“

Rreth qëllimit të qëllimit, Koloneli thoshte:

„... është bërja e Shqipërisë Shqipëri...”

Rreth vetëbesimit të besimit, Koloneli thoshte:

„... është bërja e Shqipërisë Shqipëri...”

Rreth veprimit si lëvizje dhe vullnetit për fuqi, Koloneli thoshte:

„Vetëm ato mundësojnë bërjen e Shqipërisë Shqipëri...”

Edhe çështjet e lartësimit, të cilat Baba Tali i kishte vu në një ndërldhjeje të pashkëputshme me ato të durimit si vetëdije, që shpijnë kah forcim i brendshëm shpirtëror dhe arritja e asaj që quhet *qëllim i qëllimit*, Koloneli do t'i shohë kryesisht të lidhura me bërjen e Shqipërisë Shqipëri, të cilën ai e quante *çështje të çështjeve* dhe sa më shumë që meditante e ngrinte në shkallën e idealit të jashtëzakonshëm, të cilit duhet nënshtruar çdo gjë dhe të gjitha saqë në një gjendje amull Koloneli do të shkruajë:

„Shqipëria dhe vetëm Shqipëria është jetë...”

...

Se Shqipëria për Kolonelin, edhe në ato rrethana kur ai po shkonte drejt vdekjes me të cilën ishte marrë err e terr gjatë njëzet e pesë ditëve të mbylljes në teqenë e Leqes, paraqiste *jetë të jetëve*, që duhej kuptuar si *qëllim të qëllimit të jetimit*, pasqyrimin më të mirë do ta gjejë në trajtesën „*Jeta Shqipëri*“, të cilën do ta shohë si një nuse, të veshur me të bardha, e cila lirohej nga tisi i hollë i vesës së ujërave dhe herë pas herë shfaqej qafave të maleve për të dëshmuar bukurinë dhe madhësitinë e jashtëzakonshme që kishte, që ajo bredhje e saj pastaj, të përcillet me gjelbërimin, me rinimin e natyrës, ku thoshte se „edhe ajo që nuk kishte jetë ringjalles para shfaqjes së saj...”

Është e çuditshme të shihet si në ato rrethana tepër të rënda të asaj fanitjeje shkallmuese me plot e përplot ankthe dhe thuajse kur po numëronte çastet e fundit, të cilat do ta çonin drejt asaj vdekjeje të paralajmëruar, në labirintin e së cilës ndodhej qysh kur ishte futur në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, pra atë ditën e njëzetë të mbylljes, Koloneli do të gjente mundësi për një shkrim të rrallë poetik, që telegrafistit thuajse ia kishte shkri zemrën me njëfarë mallëngjimi të pashpjegueshëm i cili i ishte qepur ngulmushëm, e ku në njëfarë mënyre, për herë të parë kishte hetuar diç të asaj që i mungonte, pa të cilën jeta kthehej në një zbrazëti.

Në të vërtetë, atë nuse të bardhë, e cila dilte nga vesa e ujërave dhe serish kthehej për të mbetur si gjakim i përhershëm, që Koloneli e quante „*Jeta Shqipëri*“, telegrafisti do ta kuptojë si dashuri të veçantë, si diçka që ushqen qenien dhe shpirtin njëherësh, e cila i duhet njeriut për t'u ndërldhur me të nga brenda dhe nga jashtë, me çka jeta fiton kuptimin e saj të njëmendët pa të cilin nuk bën...

Rreth këtij ndijimi, i cili tashmë i kishte kaluar në njëfarë preokupimi të veçantë ndërldhës sa t'i dukej se te ai pak nga pak po shfaqej hija e Kolonelit bashkë me ato

shqetësime që e kishin mbërthyer aq fuqishëm gjatë çasteve të fundit kur po priste vdekjen e paralajmëruar që do ta gjente ditën e njëzet e pestë të mbylljes pranë dritares së teqesë së Leqes, telegrafisti Bruner do t'i flasë gjerë e gjatë, shumë vite më vonë Skulptorit, kur nga Shqipëria ishte kthyer në Vjenë dhe kishte parë përmasat e shembjes së perandorisë danubiane dhe dhembjen e papërshkrueshme për atë rrënim, kur më së paku pritej, që atij i ishin duke të ngjashme me ato të cilat Koloneli i kishte lënë në shënimet e shkapërderdhura, me të vetmin ndryshim se atë humbje të madhe ai e baraspeshonte me bërjen e Shqipërisë Shqipëri, të cilën e përfytyronte si nuse, ndërsa ai atë çrregullim të ndodhur aq dhunshëm në qendrën e kontinentit të vjetër e shihte të shkonte drejt një lufte tjetër të madhe, që mund ta gjymtonte fare edhe atë, e cila deri me dje, nga shumëkush shihej si shembull i krenarisë perandorake.

Mund të merrej me mend se Koloneli, duke ndjekur bredhjet magjike të asaj nuse, e cila shfaqej nga vesa e ujërave dhe serish u kthehej atyre, në atë gjendje që e çonte kah fundi, pikërisht kishte pasur nevojë për atë shfrim domethënës, që do t'i shërbente më tepër se një ngushëllim, i cili nuk mund të baraspeshohej vetëm me përfytyrimin e të fejuarës Helenore von Braun, (që pranonte se shfaqja e saj jetës së tij i kishte dhënë një kuptim dhe domethënie të jashtëzakonshme, që në njëfarë mënyre më së miri do ta shprehë me vargun „*të falem o engjëll që ma hape këtë rrugë...*“), por kjo lidhej edhe me bindjen e patundur të bërjes së Shqipërisë Shqipëri nga e cila nuk do të ndahet dot...

Nga ato që mund të shihen në pjesën e dytë të eses, njësimi i ndjenjës së dashurisë së veçantë dhe gjithëpërfshirëse me jetën dhe veprën, që për Kolonelin do të quhet Shqipëri dhe vetëm Shqipëri, vërteton qëndrimin se vetëm dashuritë e mëdha mund të kthehen në qëllime të mëdha dhe vetëm qëllimet e mëdha jetës i japin kuptim dhe domethënie të njëmendët, që kthehet në shëmbëllesë...Andaj nuk është e rastit pse Koloneli *përkushtimin e dashurisë si jetë* do ta kthejë në thirrjen kuptimplote dhe të amshueshme, që do ta pasqyrojë me vargun përmbyllës:

„*Vdekja ime, ti je pjesë e jetës sime...*“

Për „*vdekjen si pjesë të jetës*“, pra për atë që nuk shënon fundin, një vazhdimësi që i takon përsëritjes, Koloneli do të meditojë në trajtesën e parafundit dhe këtë do ta bëjë ashtu, që ballafaqimit me vdekje, të cilën e kishte fare pranë, t'i jepte domethënien e atij rivazhdimi, të cilin e quante „*rikthim te e njëjta*“ dhe kryekreje e lidhte me bërjen e Shqipërisë Shqipëri, që paraqiste më shumë se një ideal, të cilin e quante edhe çështje të çështjeve, ku gjendej edhe ajo nyja e luftërave të mëdha, të cilat sipas tij, nuk do të ndaleshin përderisa ajo të bëhej...

Natyrisht se *ai rikthim* nuk mund të ndodhte pa atë kundrimin që vdekja të jetë pjesë e jetës, me çka edhe ajo sikur futej në radhën e atyre të cilat asaj i japin kuptim, qëndrim ky që në njëfarë mënyre i baraspeshonte edhe të kundërtat saqë ato shfaqeshin të pashmangshme, por edhe me një radhë të natyrshme.

Duket se me këtë pashmangshmëri Koloneli kishte synuar tragjedisë shqiptare dhe gjithë atyre që ngjisinin dhe do të ngjanin edhe më tutje në gjirin e saj, t'ua jepte domethënien e atyre që ai i quante të domosdoshme e të pandalshme si zhvillim për bërjen e Shqipërisë Shqipëri. Andaj jo rastësisht fjalët të cilat do t'ia thotë spanjollit Rafaelo se „do të vritemi, që të ngjallemi dhe do të ringjallemi që të rivritemi dhe kështu do të ngjajë përderisa të bëhet Shqipëria Shqipëri“ tumirin qëndrimin e paluhatshëm të Kolonelit „se edhe me vdekje shkohet drejt jetës“, se ato nuk janë të kota „kur kthehen në qëllim të qëllimit madhor“, siç ishte për të ai i bërjes së Shqipërisë Shqipëri.

„Nëse vjen në Shqipëri, i dashur Santiago Moreno Sançes Rafaelo, serish do të vritesh dhe serish do të ngjallesh...“, do t'i thotë Koloneli spanjollit në atë pahintikën e fundit, ku do ta përfytyrojë sikur e vizitonte për pak.

„Nuk do të vij më në Shqipëri, i dashur Kolonel Abdi beg Dreni, sepse kam Kordoben time, që së paku, nuk i trazon të vdekurit...“

„Ah, i dashur Santiago Moreno Sançes Rafaelo, të pëlqen të vritesh vetëm një herë?...Mos është pak kjo për qëllimet e mëdha?...“

„Kjo mjafton, i dashur Kolonel Abdi beg Dreni.“

„Ah, i dashur Santiago Moreno Sançes Rafaelo sikur je mësuar me toredon?...“

„Edhe aty vritet, i dashur Kolonel Abdi beg Dreni...“

„Ah, i dashur Satiago Moreno Sançes Rafaelo, a nuk paraqet atje vrasja vetëm një argëtim?...Një zhvleftësim të saj?...“

„Si ta marrësh, i dashur Kolonel Abdi beg Dreni, si ta marrësh...Por mos harro se për dike vdekja e Shqipërisë po ashtu paraqet toredo, një toredo të madhe dhe të përhershme, apo jo?...A nuk është vallë ky një argëtim tragjik pa të cilin nuk bën?...“

„Ah, i dashur Santiago Moreno Sançes Rafaelo ky argëtim do të vazhdojë, por edhe ne do të vazhdojmë të përtëritemi, të rikthehemi, të ribëhemi dhe kështu me radhë, pa heqë dorë nga qëllimet tona të mëdha, apo jo?...“

„I dashur Kolonel Abdi beg Dreni, a ka kuptim kjo përsëritje, që përfundon njëjtë dhe, a mund të quhen qëllime ato që nuk përmbushen dot?...“

„Ah, i dashur Santiago Moreno Sançes Rafaelo, nuk e ke të qartë se nuk ka rrugë tjetër?...“

...

„*Rruga tjetër*“, e cila baraspeshohej me vdekjen e përsëritshme, që më në fund i nënshtrohej jetës dhe do të thoshte bërje e Shqipërisë Shqipëri, pra i gjithë ai përvijim i pandalshëm i cili “soste në trup dhe niste në shpirt“, për Kolonelin paraqiste një ecje të përhershme nëpër leqe të përhershme, që në çastet e fundit i ishte shndërruar në njëfarë besimi të patundshëm se ajo pashmangshëm çonte te „*Kështjella e Hijës*“ në Pashtrik, ku thoshte se „vetëm atje kthehej në atë fundin që njëherësh ishte edhe fillim...“

Siç ishte parë edhe nga trajtesa e nëntëmbëdhjetë, në të cilën Koloneli bënte fjalë për qëndrimin e papritur në Teqenë e Madhe të Gjakovës dhe takimin me kolonel Ibrahim Prevezën, me të cilin kishte zhvilluar atë bisedën, të cilën pjesërisht do ta paraqesë „si një ndërlidhjeje që e kishte shkaktuar bredhja e gjatë shpirtërore bashkë me përpjekjet e rinjohjes“, edhe në trajtesën e njëzet e dytë, me çka marrin fund shënimet e bëra gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, Koloneli do të thotë se „bredhjet e shpirtit e kishin çuar te *Kështjella e Hijës* në Pashtrik“, që së voni i thoshte edhe „*Kështjella e dritës*“, dhe kjo kishte ndodhur ngaqë kishte qenë ndijimi madhor të cilin aty e kishte hetuar si vetëkuptim i thellë dhe e kishte ndërlidhur me frymën e hyjit dhe kishte bindjen se ajo „rinte atje dhe ruante qenësinë e lashtë bashkë me ato që ishin harruar apo fshirë nga kujtesa, e që duhej të riktheheshin...“

Por, para se të ndodhte ajo lëvizja e fundit dhe vendimtarja, Koloneli do të shpjegojë se ishte një takim me studentin Zenel Xhema, që ia kishte hapë rrugën kësaj kthese, të cilën do ta quajë „të natyrshme dhe tepër të rëndësishme“.

Rreth këtij takimi Koloneli do të shkruajë:

„Nuk e di se a isha në mbërthim të ndonjë vjershe, që kërkonte të shpërthente në mua apo e gjitha paraqiste shqetësimin e të menduarit rreth ribërjes, së cilës i isha afruar aq shumë dhe prisja çdo çast shfaqjen e atij kapërcimi, me çka përfundimisht kthehesha në frymë të përsëritshme, që edhe mund të vritej dhe të rivritej, që pastaj të ringjallej dhe të ringjallej dhe kështu me radhë përderisa do të bëhej Shqipëria Shqipëri, kur hetova praninë e dikujt që po më fliste pikërisht për jetën që i falej bërjes së Shqipërisë Shqipëri...“

Ai po më thoshte se po qe nevoja, njëqind apo njëmijë vjet, e mbase përgjithmonë do të ecnim ashtu dhe njësoj do të vepronim dhe ashtu si fliste dhe si shprehej nuk e pata të vështirë ta kuptoja se kush ishte.

-Nuk ke mbetur në atë djerrinën që kah mot është kthyer në kënetishtës, i thashë?...

-Atje kam eshtrat, Kolonel. Shpirti im ka ndjekur *Kështjellën e Hijes* në Pashtrik, ku do të shkojmë bashkërisht. Fryma e saj më rizgjoji dhe ma bëri me dije se duhet t'i kthehem tempullit të shejtnive, ku kemi kujtesën dhe qenien...

Dhe kujtoj se ishte njëfarë nate që na rrinte në mes dhe ishte njëfarë terrimi të cilin duhej ta kapërcenim për tek ajo rrugë e pakthim, që pastaj ajo shpinte kah një ujë dhe një kodrinë përderisa t'u ngjiteshim leqeve që sosnin në të..."

Koloneli do të shkruajë se kishte bindjen se studenti Zenel Xhema e kishte kapë përdore, sado që nuk ia kishte dalluar mirë fytyrën, dhe në atë bredhje të cilën e kishte quajtur „jashtë kohe“, i kishte thënë se nata dhe ai terrimi që shpinte kah uji dhe kodrina do t'i shoqëronin, por kjo nuk duhej t'u pengonte, sepse ishte ajo fryma që qëndronte mbi to drejt atij qëllimi...

Sidoqoftë, Koloneli kishte shënuar se në atë rrugëtim kishin kaluar nëpër shtatë kështjella, që studenti Zenel Xhema ia kishte njehur një nga një dhe ato ishin:

E para:

Kështjella e Damastionit

E dyta:

Kështjella Justiniana prima

E treta:

Kështjella e Përfytyrimeve

E katërta:

Kështjella e Pasqyrave

E pesta:

Kështjella e Territ

E gjashta:

Kështjella e Rrethit dhe

E shtata:

Kështjella e Hijeve dhe e Dritës...

Koloneli shton se para se të niseshin e kishte pyetur studentin Zenel Xhema pse janë shtatë kështjella dhe çfarë paraqesin ato për atë rrugëtim që bëhet vetëm një herë, ndërsa ai ia kishte kthyer se shtatë kështjellat lidheshin me shtatë shtyllat e shëmbëllesës, që është dashtë të kthehen në mësim, por jo gjithnjë ka ndodhur kështu, andaj në atë rrugë ato janë të rrezatojnë ngritjet, por edhe të tërheqin vërejtjen nga rëniet që nuk ishin të pakta, të sfidojnë dhe njëherësh të shtrojnë nevojën për domosdonë e mësimëve nga pësimet. Ata që për ndonjë arsye nuk ia dalin të kalojnë nëpër to, por mbesin në njërin prej tyre, në njëfarë mënyre merren si dështakë dhe duhet t'i nënshtrohen sprovës së përmirësimit dhe të riprovimit, e cila zgjat për aq sa arrihet vetënjohja dhe vetëkuptimi...

“Përpara kemi sprovën e shtatë ngritjeve dhe shtatë rënieve. Të shpresojmë se ajo do të na shpie te caku ynë i fundit, *Kështjella e Hijes* në Pashtrik, ku përmasat e dritës së saj të përhershme dhe ndërlihdja me të, njësojnë me hyjin“, i kishte thënë studenti Zenel Xhema, ndërkohë Kolonelit i ishte dukë se ato fjalë dhe ato mendime qëmoti i kishte pasur diku të strukur, por kishin pritur dikë t'i lëvizte, t'i nxirrte dhe t'i kthente në kuptime...

...

Edhe pse në atë rrugëtim i cili kishte kaluar nëpër terrimin, që herë zbutej, sa bëhej i flashkët fare, e herë dendej, sa i ngjante ferrit, Koloneli shënon se megjithatë kishte hetuar kapërcimet nga kështjella në kështjellë si dhe atë frymën, që studenti Zenel Xhema do ta quajë sfidë të pashmangshme drejt atij shndërrimi, të cilën do të pranojë se „kalimi nëpër kështjellën e parë, atë të *Damastionit*, ia kishte krijuar përshtypjen e hetimit të mbërthimit të një mëdyshjeje të lashtë, që i kishte ardhur si përpëlitje e cila ia kishte hapë rrugën atij ndijimi të jashtëzakonshëm, me ç'rast nga thellësia e një tempulli kishte dëgjuar tek lirohej një zë që

thoshte diçka rreth asaj se nga kujtesa shpalohej *libri i shpirtit...*“ që e gjitha shoqërohej edhe me vargjet:

„*Harresa është humbje
humbja është vdekje
vdekja bëhet e vdekshme
kur unë vdes në ju...*“

„Në Damastion është mbreti Moun dhe Glauku, të cilët ç’prej më shumë se dymijë vjetësh merren me çështjet e shqyrtimit të ngrehinës së shpirtit dhe ndikimit që mund të ketë ajo për rikthimin e mbretërisë së rrënuar nga barbarët, të cilëve Mouni mendonte se u duhej mësimi i qytetërimit për ta kuptuar dhe mbrojtur, ndërkohë që Galuku ia tërhiqte vërejtjen nga instinktet e tyre shtazarake, të cilat ishin tepër të rrezikshme, gjë që doli se Glauku kishte të drejtë, ngaqë po ata barbarë, të cilët mbreti Moun i afroi, u ndihmoi ta merrnin veten dhe përpiquej t’ua tregonte rrugën e hyjit, gjithnjë duke ua bërë me dije se çfarë dobie sjell mësimi, çfarë të mirash sjell dija dhe çfarë sjell urtësia, sapo u vendosën brenda mureve të kështjellave dhe panë tempujt e shumtë bashkë me veprat që kishin krijuar artistët me të njohur të mbretërisë së madhe të diellit, nga urrejtja që nuk e kuptonin të bukurën dhe të madhërishtmen, iu sulen ashpër atij qytetërimi dhe me pasionet më të shëmtuara të egërsisë e shkatërruan tmerrësisht sa fryma e tij ende nuk e ka marrë veten...“

Koloneli shënon se pas atij ndijimi dhe sqarimeve që studenti Zenel Xhema ia kishte thënë rreth frymës së Mounit dhe Glaukut, ai po ashtu ia kishte bërë me dije se në atë kështjellë edhe më tutje vazhdojnë hamendjet e shqyrtimeve të kamotshme rreth asaj se a është më e dobishme që një qytetërim të shijohet dhe të mbrohet si vlerë me anën e të mësuarit që ai të përvetësohet, apo të ushtrohet detyrimia, që ai të pranohet dhe të nderohet, pse jo qoftë edhe me anën e dhunës?...

Kjo hamendje e gjithëhershme Kolonelit sikur ia kishte kthyer të menduarit rreth asaj „*perëndi ose bishë*“, që ai e merrte si të vetmen provë, e cila lidhej me sjelljen e dëshmimit të vazhdueshëm *lartë - poshtë*, që çon nëpër rrugën kah maja, ose shpie kah rrënimi, që sipas tij kjo kahe përherë niste me rënien nga shkaku se prirja e së ligës, si e pambikëqyrur, ishte përherë më e fuqishme dhe kërkonte zbrazjen e shpejtë...

Telegrafistit Bruner i kujtohej se këtë qëndrim Koloneli e kishte mbrojtur edhe gjatë një bisedës të gjatë me priftin Gjon Lleshi atëherë kur misioni i tyre si dhe bredhjet nëpër vijat tragjike të fronteve shqiptare po tregoheshin se nuk ishin në mbrojtje të Shqipërisë por për të kundërtën, të asaj të cilën e kishte quajtur „*krijim të rrethanave për një shkrim të tmerrshëm të egërsisë*“, që kishte thënë se mund të merrte fund vetëm atëherë kur të shfaqej ndonjë perëndi...

Edhe pse prifti mendohej këtë përcaktim dhe gjithë ato të cilat lidheshin me këtë çështje t’i kthente te mësimet e shenjta dhe „*vullneti i krijuesit*“, gjithnjë duke përkujtuar se janë ndikimet e luftës midis të mirës dhe të ligës, të cilat zhvillohen përherë dhe kahu i tyre ato që i japin vulën karakterit të njeriut dhe të një shoqërie dhe jo lëvizjet e thata lartë-poshtë apo çfarëdo qofshin ato të cilat u takojnë vetëm ligjeve fizike, Koloneli nuk kishte hequr dorë nga bindja se „*Shqipërinë e kishte përfshirë egërsia e tmerrshme*“, që po e shpinte kah shkatërrimi, ndërkohë vetëm perënditë mund ta shpëtonin nga ai rrënim i pashmangshëm dhe kjo do të ndodhte sapo ata të shfaqeshin ku duhet dhe kur duhet...

Kur prifti Gjon Lleshi ia kishte përkujtuar se kishte vetëm një perëndi të gjithëfuqishëm, i cili i kishte punët në dorë, ku edhe Shqipëria dhe fati i saj nuk anashkaloheshin, Koloneli ia kishte kthyer se fati i Shqipërisë kaherë ndodhej në duart e të ligjeve dhe i duheshin perënditë ta shpëtonin prej pushtetit të tyre, që kishte thënë se gjithsesi se ata do të shfaqeshin para se të bëhet vonë...

Edhe kalimi nëpër kështjellën e dytë, atë *Justiniana prima*, sikur ia kishte vërtetuar pandehmën se *rendi i qëndrueshëm shoqëror* me rregullin dhe normën e ligjit ishin ato që

krijonin kushte qenësore për dëshmim pa të cilin nuk mund të kishte vlera dhe qytetërim të qëndrueshëm.

“Perënditë krijojnë rend, ndërsa bishat rrënojnë“, kishte shkruar Koloneli dhe kishte shtuar se „perandorët e fuqishëm, ata që u hapin rrugë qytetërimeve, janë perëndi të njëmendët...”

Rasti i luleve „*Dardania Cacaliam*“, „*Abstenium Rusticum*“ dhe „*Iliria Aloites*“ dhe mbrojtja e tyre me dekretin perandorak, të cilin e kishte quajtur „dekret perëndish“, Kolonelin e kishte sjellë para një ndijimi të veçantë, që e kishte shtyrë të hartonte vargjet, që lidhen me frymën e shndërrimit, të cilit thoshte se i ishte nënshtruar gjatë atij udhëtimi:

„*Lulja e parë më zgjoi*
Lulja e dytë më shëroi
Lulja e tretë më ringjalli...
Dhe kështu
Do të shkoj e do të vij
Do të vij e do të shkoj
Pafundësisht
Pafundësisht...“

...

Kalimi nëpër shtatë kështjellat, që Koloneli shënon se ishte bërë me ndihmën e studentit Zenel Xhema, ia kishte sforcuar bindjen se bërja e Shqipërisë Shqipëri ishte më shumë se një domosdoshmëri, e cila në ato rrethana lidhej me një mbijetim, të cilit doemos i duhej ngrehina shtetërore dhe ai rendi i qëndrueshëm shoqëror për t’u shfaqur dhe për t’u mbajtur si e tillë përkrah të tjerave në atë hapësirë, por ajo bërje dhe ato veprime paraqisnin diçka edhe më shumë, që mund të quhej shpalim dhe vazhdimësi antike, e cila ishte ruajtur aq mundimshëm nëpër ato shkëputje, të cilat edhe si të tilla, kishin qenë në gjendje herë pas here të dërgonin porosi, të cilat ishin pranuar jo gjithkund dhe jo gjithnjë ashtu si niseshin, por megjithatë, aty ku kishin prekur dhe ku ishin hetuar, qoftë edhe rastësisht, kishin sfiduar kuptimin, vetëkuptimin deri te nxitja e vetëdijes, që ndonjëherë edhe pavetëdijshëm kishte sjellë vetëdijesimin, qartësim ky që kishte pasur edhe pasoja për ata të cilët nuk kishin qenë në gjendje ta zbërthejnë atë si duhet, ose ta pranojnë si gjendje të re, e cila kërkon sjellje tjetër fare...

Në atë shqyrtim të gjatë me vetveten dhe qenien, që do t’ia nxisë ajo bredhje drejt „*Kështjellës së Hijës*“ në Pashtrik, Koloneli do të pranojë se kalimi i shpejtë nëpër shtatë kështjellat, të cilat i quan „themele të një shpirti antik“, kishte paraqitë shtatë mësimë dhe shtatë njohuri të jashtëzakonshme kah vetënjohja, që ishte i bindur se „thadrimi i tyre nëpër kohë dhe hapësirë shpirtit të tij ia kishte mundësuar kthesën e madhe kah vetja dhe hetimin e thellësisë së asaj për të parë sado pak kush ishte dhe cili ishte...”

Koloneli po ashtu kishte shkruar se ajo bredhje ia kishte hequr edhe mjegullimin e fundit që kishte pse duhej të vritej dhe çfarë fshihej para paralajmërimit të saj, me të cilin ai ishte marrë aq shumë që nga koha e mbylljes në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, sa të vlerësojë se nuk ishte vetëm ideali i bërjes së Shqipërisë Shqipëri që duhej t’i paguante tagër, të cilën ai e pranonte duarhapur dhe e quante të domosdoshme madje, por së fundi kishte bindjen se ishte edhe ai ndijimi shpirtëror, i cili ia kishte gjetur qenien gjatë atij ballafaqimi me vetëveten, që atyre të cilët luftonin me aq zell kundër bërjes së Shqipërisë Shqipëri ua kishte krijuar përshtypjen se me atë vrasje dhe të tjerat të ngjashme doemos dhe me të shpejt duhej ndalë kohen e ndërlidhjes shpirtërore me qenësinë e njëmendët, pra me atë e cila nuk është përfytyrim i thjeshtë por pjesë e një bërjeje të gjatë, para se ajo të gjejë edhe të tjerët që do t’i nënshtrohen asaj, të cilët ishin shumë, dhe para se të ndodhë që në rrethanat e atyre dridhjeve të cilat kërcënonin me dridhmat dhe rrënimet që mund të sillnin luftërat e

mëdha, të cilat ishin në shpërthim e sipër, t'i ktheheshin kujtesës, me gjetë strehim dhe mbështetje në të, që e gjitha pastaj të kurorëzohet me një lëvizje të madhe vetëdijesuese, e cila do t'i përcaktonte hartat e reja shtetërore dhe qytetëruese në ato hapësira, ku bërja e Shqipërisë Shqipëri nuk shfaqej si çështje e lejimit të saj nga të tjerët dhe në përputhje me interesat e tyre, por bërja e saj ndiqte vullnetin e atyre të cilët i takonin asaj bërjeje dhe luftonin për jetësimin e saj...

Rreth këtij preokupimi Koloneli do t'i kthehet një ligjërimi, që thoshte se tashmë kishte bindjen se e kaluara ishte e ardhshme dhe ndjekja e kahes së saj doemos shpinte te një gjendje, të cilën ngatërrueshëm e quante „e nesërme në të djeshmen e sotme...“, e që ishte i bindur se e gjitha do t'i nënshtrohej përsëritjes së kushtëzuar sa do ta shtyjë të nxjerrë përfundimin se „po të mos ishte Mouni nuk do të ishte as Glauku po të mos ishte Glauku nuk do të ishte as Pirrua e po të mos ishte Pirrua nuk do të ishte Enteleu e po mos të ishte Enteleu nuk do të ishte as Bardhyli dhe po të mos ishte Bardhyli nuk do të ishte as Genci dhe po të mos ishte Genci nuk do të ishte as Teuta dhe po mos të ishte Teuta nuk do të ishte as Diokleciani dhe po mos të ishte Diokleciani nuk do të ishte as Justiniani dhe po mos të ishte Justiniani nuk do të ishte as Konstandini i Parë dhe nuk do të ishin as ata, të cilën me shëmbëllesën e vetëdijes së ngritjes dhe vullnetin për fuqi shkuan kah lartësitë edhe në rrethanat kur kjo ishte më së e vështirë...“

Këtë meditim, që do të pranojë se ishte pjesë e një emocioni, Koloneli do ta përmbyll me bindjen:

„Ata që njëherë prekin majat nuk mund të përfundojnë në bllaqk...“

...

Çështjen e „majave dhe të bllaqukut“, dhe atë „të perëndive dhe të bishave“, Koloneli nuk do ta pikasë si metaforë ngushëlluese, që shfaqet përballë një realiteti tepër të hidhur, çfarë ishte ai shqiptar nëpër të cilin kalonte, por do ta shikojë si pjesë të pleksjes së atyre zhvillimeve të pashmangshme nëpër kohë, ku ecuria e ngritje-rënies ndodhë në përputhje me përsëritjen e së njëjtës, ku nuk ka gjendje të dështimeve të përhershme siç nuk mund të ketë edhe gjendje të ngadhënjimeve të përhershme, por ato përcaktohen në përputhje kahen e ndeshjes për mbizotërim midis vullnetit për ngritje dhe prirjeve për rrënim, që megjithatë shprehte bindjen se ecja përpara përherë ndodhë aty ku perënditë mbesin perëndi dhe sillen si perëndi... Në një shkrim të shkurtër ai do të thotë:

„Fanari im
Ndriçon majat
Fanar im
Prek qiellin
Dhe aty mbetet
Fanari im...“

Bindjen e nënshtimit shtytjes së ecjes kah majat, që e merrte si parakusht për bërjen e Shqipërisë Shqipëri, Kolonelit do t'ia tumir edhe më shumë përfytyrimi i asaj bredhjeje të imagjinuar te „Kështjella e Hijes“ në Pashtrik, të cilën së voni do ta quajë edhe „Kështjella e dritës“, që do të përshkruhet gjerësisht në trajtesën e fundit, pra atë të njëzet e dytën, me çka marrin fund shënimet e shkruara gjatë mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, të cilat mund të merren si ngadhënjim ndaj vdekjes, të cilën e kishte fare pranë dhe e shihte të pashmangshme, gjë që ajo pas tri ditësh edhe do ta gjejë me anën e atij plumbi, i cili do t'i vijë si prej qielli kur po rrinte në dritare dhe po shikonte therrat e trëndafilave që i ishin ngjitur xhamit...

Sikur të dëshironte të dëshmonte ngadhënjimin ndaj vdekjes dhe atë ta pasqyronte si çështje e një besimi të përgjithshëm, në pjesën përmbyllëse, Koloneli do t'i kthehet letrave-amanet të Deli Brahës „Nji besë për Shqipninë“, ku ndërlihdeshin ato që ishin biseduar në

atë takimin e madh të Verrat e Llukës dhe do të thotë se atë kuvend do ta shohë, si në mjegull, tek vazhdonte në sheshin e „*Kështjellës së Hijës*“, por në vend të Deli Brahës dhe bashkëkohanikëve, shumica e të cilëve nuk ishin më ngaqë ishin vrarë apo kishin mbetur zvarrë nëpër vijat e fronteve shqiptare dhe rrugëve të botës, merrnin pjesë perandorë dhe gjeneralë të fuqishëm, të cilët kishin udhëhequr tri perandoritë më të mëdha të botës gjatë atyre dymijë vjetëve të fundit, që si duket Kolonelin do ta frymëzojë aq sa do ta quajë „*Kuvend të perëndive shqiptare...*“

„Në atë kuvend të perëndive flitej vazhdimisht diçka dhe ajo që flitej e flitej pastaj ndiqej nga një refren i vetëm korifeu rreth *besës për Shqipërinë*, apo një *bese të madhe* dhe kjo përcillej me një si bubullimë dhe gjëmim që vinte nga maja e bjeshkës...“

Koloneli pranon se nuk e kishte të qartë se çfarë kishte ndodhur me atë kuvendin e perandorëve në sheshin e „*Kështjellës së Hijës*“, por ishte i bindur se jehona e refrenit rreth *besës për Shqipërinë* nuk ishte tjetër pos jehonë e zotimit për bërjen e Shqipërisë Shqipëri, së cilës ai do t’ia kushtojë manifestin „*Zot-imi-Shqipëri*“, që fare rastësisht do të gjendet dymbëdhjetë vjet më vonë me rastin e meremetimit të teqesë së Leqes dhe do të shërbejë që urdhri i Bektashinjve në Tiranë ta shpall „shehit“.

Mbase ajo frymë e cila i ishte qepur gjatë asaj bredhjeje të „*Kështjella e Hijës*“ në Pashtrik dhe ato që thoshte se i kishte parë dhe përjetuar si pjesë e atij fundi, të cilat duhej t’i takonin rikthimit apo rizgjimit shpirtëror, kishte bërë shënimin e fundit, pra atë të njëzet e dytin, ta përmbyll me vargun domethënës:

„*Po perëndoj lajmëtar...*“

VIII

Vargu „*Po perëndoj lajmëtar*“, i vendosur pas theksimit sqarues „*ky është fundi por edhe rifillimi*“, me të cilën mbyllet shënimin e njëzet e dytë, mund të merret me mend se ajo ishte edhe porosia kryesore dhe përmbyllëse të cilën Kolonel Abdi beg Dreni kishte lënë gjatë qëndrimit njëzet e pesë ditësh në dhomën e madhe të ziçrit të teqesë së Leqes, ku bëhet me dije mbetja dhe mbëltimi i përhershëm i frymës dhe shpirtit që e bën Shqipërinë Shqipëri pa marrë parasysht kundërshtimet dhe kundërshtarët që i dalin...

Ky varg shumë domethënës, që telegrafistit Bruner i ishte dukë i ngjashëm me shfrimin e Zaratustrës, që ai diku në një shkretim, ua kishte lënë si kërcënim krijesave të shpërfillura nga shkaku se kishin hequr dorë nga prirja e hetimit dhe dëgjimit të vullnetit për fuqi, me siguri se përjashton hamendjet e mundshme se mos atyre shënimeve, gjatë tri ditëve të mbetura, do t’u ishte ndajmathur edhe ndonjë çapitje tjetër, por njëherësh hap dilemën e drejtë të sjelljes së Kolonelit gjatë atyre shtatëdhjetë e dy orëve të fundit deri sa ai plumbi, i cili do të vijë si prej qiellit, do t’ia gjejë kokën, kur ai në dritare po i shikonte gjembat e trëndafilave që po i ngjiteshin asaj?...Telegrafisti Bruner, i cili gjatë gjithë kohës së qëndrimit të Kolonelit brenda, nga pjesa e konakut të skajshëm të teqesë kishte përcjellë atë mbyllje dhe vetëm në saje të qiririt që ndizej sapo shfaqej terri hetonte vrojtimit e herë pas herë të Kolonelit pranë dritares, megjithatë nuk kishte qenë në gjendje të qartësonte përmbajtjen e atyre tri ditëve të fundit, që bazuar në shënimet e lëna mund të merren të shurdha fare, si diçka, që në pritje të plumbit dhe të fundi, i duheshin atij kapërcimi, të cilin ai e quante pjesë të rifillimit, ribërjes por edhe e rizgjimit?...

Çastin që kishte dëgjuar atë krismën, e cila kishte ardhur si prej qiellit dhe kishte gjetur kokën e Kolonelit, të mbështetur për dritare me currilat e gjakut që kishin prekur minderin dhe pjesën e sixhadesë së mëndafshhtë persiane dhe si të tilla kishin mbetur edhe për katër vite sa kishte vazhduar ajo lufta e parë botërore, pra vetëm atëherë telegrafisti Bruner

kishte parë përmasat e njëmenda të asaj vrasjeje, por mendja assesi t'ia hante si kishte ndodhur, që plumbi i cili kishte ardhur si prej qielli, ta qëllonte Kolonelin për vdekje pa kaluar nëpër xham?...

I tmerruar kishte shikuar nga dritarja, por nuk kishte pasur kurrfarë shpjegimi rreth depërtimit të plumbi brenda pa lënë asnjë gjurmë si nuk dinte se prej nga kishte ardhur ai, kush e kishte shkrepur dhe hamendje të tjera të ngjashme, që kur kiheshin parasysh rrethanat e atyshme të cilat teqenë e Leqes jo vetëm e kishin përjashtuar dhe kursyer nga çfarëdo lufte dhe sherresh me të cilat ishte plot e përplot bota shqiptare, por në afërsi të saj thuajse nuk sillej njeri qysh nga koha e shpërthimit e deri te përfundimi i asaj lufte të madhe botërore, pra për katër vjet ajo kishte mbetur e paprekur, e vetmuar dhe me namin se në të ndodhej një njeri i mbërrimë nga skaji i botës, i cili ishte aty për ta shpëtuar Shqipërinë nga mallkimet edhe më të mëdha, dhe kur diheshin këto, atëherë përnjëmend habia bëhej edhe më e madhe...

Pasi kishte shtrirë trupin e pajetë të Kolonelit mu në mes të dhomës dhe e kishte tmerruar mejt i mbetur një grusht njeri, dhe pasi kishte mbledhur me kujdes gjithë ato fletët që shpërndaheshin nëpër mindere, telegrafisti serish kishte shikuar xhamin me currilat e gjakut në të dhe serish kishte parë atë të tërin, që nga jashtë i rrinin të ngjitura gjembat e trëndafilave të kopshtit bashkë me rrjetin e një merimange, ku kishin rënë disa flutura të bardha dhe pjesë të gjetheve të thara ngaherë.

E vetmja hamendje që telegrafistit Bruner aty për aty ia kishte fashitur paksa habinë e tmerrshme ishte përfimi i mundësisë se mos vallë ai plumbi që i kishte ardhur si prej qielli, ia kishte qëlluar kokën përderisa dritarja për pak kishte qenë e hapur dhe kjo mund të ishte bërë prej vetë Kolonelit, kur ai kishte hetuar se kishte ardhur ai çasti me të cilin një vrasje shënonte fundin që e kishte nga ai gjykimi që i kishte ardhur nga dika, por njëherësh, siç e mendonte dhe e parashikonte, ia hapte rrugën asaj ribërjeje me të cilën njëherë e përgjithmonë Shqipëria ngrihej Shqipëri?...

Por edhe ajo mëdyshje sado e flashkët telegrafistit i kishte tretur si bryma para diellit para asaj se dritaret i kishte parë të gozhdura nga jashtë, si kishin qenë kur ishin futur në teqe dhe si kishin mbetur të paprekura fare dhe me gjurmët e thara të gjakut në xham deri sa kishte zgjatur ajo lufta botërore dhe më vonë, gjë që mund të merrej me mend se ajo mbyllje edhe i kishte pëlqyer Kolonelit, se ai kishte kërkuar një gjendje të tillë, me të cilën përjashtohet jashtësia dhe fërkimi me të, por jo edhe si kundrim, ngaqë e dinte se vënërimi dhe shterimi i tij nga ajo pikë ishte pjesë e atij fundi të pashmangshëm, që e priste dhe me siguri se e kishte dëshiruar të tillë dhe aty pikërisht nga shkaku se përkufizimet e thyerjeve i merrte si puqje të pashmangshme, të cilat i duheshin asaj gjendjeje shpirtërore e cila i përkiste ndijimit të veçantë, që lidhej me amshueshmërinë si kuptim i vetëkuptimit...

Merre si ta marrësh, çështja e plumbit që kishte gjetur kokën e Kolonelit me të cilin ishte tumirë në tërësi dyshimi i asaj vrasjeje të paralajmëruar, që atë do ta mbajë në kthetrat e labirintit të saj gjatë atyre njëzet e pesë ditëve të mbylljes në dhomën e madhe të teqesë së Leqes, mbetej një fshehtësi e cila me siguri se edhe hetuesit më të sprovuar do t'i sillte para vështirësive të papërballueshme sa e gjitha pastaj të vendosej në analet e ndonjë krimi tepër enigmatik me shumë faktorë të panjohur, që këtij rasti telegrafisti Bruner nuk do t'ia dëshironte nga bindja e thellë se çfarë do përpjekje sado formale e ndriçimit në përputhje me „faktorët veprues dhe dëshmitë materiale“ atë do ta ngatërronte dhe lëndonte madje duke e privuar nga „fryma e asaj bindjeje të pashkëputshme“ se fjala ishte për „një ndijim të veçantë shpirtëror“, që Koloneli e kishte lënë të shkapërderdhur në ato njëzet e dy shënimet, të cilat lidheshin me radhën e kalimit të njëzet e dy ditëve, ku ai priste vdekjen e paralajmëruar, të cilës sikur i ishte nënshtruar gjithanshëm madje edhe vullnetshëm ngaqë ajo për të, përballë atij realiteti dëshpërues dhe tragjik shqiptar, paraqiste mundësinë e vetme, së paku të përfytyrimit të atij rifillim, të një rikthimi dhe të një ringjalljeje, që thoshte se ajo vrasje dhe të ngjashmet të cilat kishin ndodhë dhe do të ndodhnin, i shërbente bërjes së Shqipërisë Shqipëri dhe gjithnjë e më bindshëm vlerësohej „pjesë e jetës...“, që nuk ishte e rëndësishme

si do të kryhej ajo dhe nga kush, por doemos të vinte, siç thoshte Koloneli, “nga shkaku i mallkimit që u parashihej gjithë atyre të cilët bërjen e Shqipërisë Shqipëri e kishin ideal dhe prej tij nuk hiqnin dorë...”

Në përpëlitjen e atyre shumë të panjohurave të cilat lidheshin me vrasjen e Kolonelit, të cilat si duket qëllimisht ngatërronin njëra-tjetrën në mënyrë që veli i fshehtësisë t’i bënte ato edhe më të fuqishme, dhe mbase në përputhje me ecurinë të cilën ua kishte paraparë edhe vetë Koloneli, megjithatë gjetja e mëvonshme e manifestit „Zot-imi-Shqipëri“, telegrafistit Bruner ia kishte fashitur atë çështjen e paqartësisë së përmbajtjes së tri ditëve të fundit, të cilat jashtë shënimeve që lidheshin me secilën ditë deri te ajo e njëzet e dyta, dukeshin pezull dhe fare të turbullta, që ai kishte bindjen se „si të shurdha apo të qeta“ nuk i shkonin atij rrëmeti në të cilin ishte përfshirë ai.

Ndonëse me një vonesë prej dymbëdhjetë vjetësh, shfaqja e manifestit „Zot-imi-Shqipëri“, natyrshëm futej në atë mesokohën treditëshe, me ç’rast mund të merrej me mend se Koloneli, pasi u kishte dhënë fund atyre, të cilat pareshtur i kishte quajtur „rikthim nga vetvetja“, dhe pasi që kishte ndjerë nevojë t’i mbikëqyrte bredhjet, dhe si ushtarak që dinte se është rregull ai që i përcakton por edhe i lëviz gjërat, që të shpjegonte se asgjë nuk ishte e rastit dhe çdo gjë kishte kuptim të caktuar, se edhe ngritja dhe rënia e Shqipërisë bashkë me ato që i takonin bërjes së saj Shqipëri i takonin këtij rregulli, i cili duhej të rivendosej me punë të madhe shpirti dhe mendje të secilit që ishte i ndërgjegjshëm për të, sigurisht se kur ia kishte marrë mendja se i kishte thënë të gjitha, se shterimi shpirtëror të cilin e hetonte njëherësh puqej me afrimin e plumbit, që ishte nisur dhe do ta gjente së shpejti, pra në pritje me përballimin e fundit të pashmangshëm, atë ta mbijetojë me shpirt dhe bindje të plotë si diçka që do t’i shërbejë përmbushjes së një ideali të lartë, (që për të ishte bërja e Shqipërisë Shqipëri), i ishte kthyer shkrimit të një manifesti, të cilin zaten e kishte paralajmëruar edhe me atë vargun e fundit „Po perëndoj lajmëtar...”

Telegrafisti Bruner kishte parasysh se çfarë përkushtimi kishte treguar Koloneli gjatë atyre tri ditëve, të cilat ai, me zemër të thyer, për shumë kohë i kishte marrë si të zbrazëta dhe shurdhe fare, duke hartuar manifestin „Zot-imi-Shqipëri“, rëndësia e të cilit do të çmohet aq shumë nga një historian, i cili nga mbretëria Shqiptare kishte marrë përsipër të hartonte Historinë e Shqipërisë, kur ai do ta propozojë si bërthamë të një programi të ardhshëm kombëtar.

Dhe pikërisht ai vlerësim, që i ishte bërë atij teksti, si dhe përpjekjet e pareshtura, ai shkrim i shkruar me një gjermanishte mahnitëse të mos gjente qetësi dhe të ndiqej për t’u shkatërruar, siç i kishte ndodhur dëmtimi i pjesshëm gjatë qëndrimit të përkohshëm në Bibliotekën e Arkivit Shtetëror në Tiranë dhe më vonë në Arkivin e Gracit, kur shumë fletë i ishin shkëputur dhe nxjerrë përgjithmonë, (përderisa ishte vu në indeksin e teksteve të çmueshme), kishin shtyrë telegrafistin pareshtur të rishqyrtonte vrasjen e Kolonelit dhe në përputhje me këto lëvizje të ndërtonte teorinë e tij, sa një ditë t’i afrohej pandehmës se „mos vallë kishte qenë ajo energji aq e madhe që ishte mbledhur aty në atë kokë, e cila kishte krijuar atë plumbin vdekjeprurës, i cili doemos se një ditë do të shkaktonte atë shpërthimin vendimtar“, që më kalimin e moshës atij do t’i kthehej në njëfarë bindje sa në një letër, të cilën do t’ia dërgojë Skulptorit para se të vdiste në një spital të skamnorëve në Vjenë, vetëm pak ditë pasi të mbaronte edhe ajo lufta e dytë e madhe botërore, të thotë me bindje të plotë se „plumbi, që e vrau Kolonelin, nuk e kishte krijuar kush tjetër pos kokës së Kolonelit...”

Bon, 2003

.....

